



GJ E O P O L I T I K A

[Revistë shkencore]

Nr.2

Prishtinë, 2023

G J E O P O L I T I K A

Drejtore & kryeredaktor

Dr Sadri RAMABAJA

Redaksia

Dr Enika Abazi

Dr Selim Ibraimi

Dr Dritan Hoti

Dr Gurakuq Kuçi

Këshilli botues

Dr Odise Çaçi, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

PhD Agim Krasniqi, MASHT

Dr Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, ambasador

Dr Venera Lljunji, Universiteti AAB, Prishtinë

Dr Gjon Berisha, studjues, Insitituti i Historisë, Prishtinë

Emin AZEMI, UEJ, Tetovë

Koordinator: Dr Gurakuq Kuçi

Lektor: Jonuz FETAHU

Revista “Gjeopolitika” një herë në vit. Artikujt e paraqitur duhet të përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata duhet të jenë në gjuhën shqipe ose angleze, të kompjuterizuar, numri i faqeve është i pakufizuar, me shkrim Times New Roman të madhësisë 12 dhe me hapësirë 1.5 ndërmjet rreshtave.

Materialet që na dërgohen duhet të shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe dhe/ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar i takon Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Gjeopolitika”, si vendi i parë i botimit.

**INSTITUTI SHQIPTAR PËR GJEOPOLITIKË / ALBANIAN INSTITUTE FOR
GEOPOLITICS**

Nr 2, 2023

PËRMBAJTJA

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1. Dr Sadri RAMABAJA Gjeopolitika dhe shqiptarët — një kontribut modest për mendimin strategjik që na mungon.....	9
1.2 Akademik Ksenofon Krisafi TË SHPËRNDARË NË 6 SHTETE TË GADISHULLIT BALLKANIK, SFIDAT POLITIKO-JURIDIKE TË BOTËS SHQIPTARE NË MILENIUMIN E RI	24
1.3 Dr Skender ASANI KOMBI SHQIPTAR PARA NJË RIKONFIGURIMI TË RI GLOBAL	33
1.4 Akademik Albert Doja TJETËRSIM STRATEGJIK	38
1.5 ABD Grid RROJI Paria e Tiranës si penguesja kryesore e shtetkombit të shqiptarëve	59
1.6 Dr. Skënder Demaliaj* ROLI VENDIMTAR DHE PËRCAKTUES I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË SHPALLJEN E PAVARËSISË SË KOSOVËS	70
1.7 Dr Mark Veller MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR SHTEGUN DREJT NJOHJES	82
1.8 Dritan GOXHAI, Tiranë KOSOVA, SËRRIA, NATO DHE LUFTA.....	94
1.9 Dr Dritan HOTI TENDENCAT E REJA TË POLITIKËS NDËRKOMBËTARE DHE MARRËDHËNIET SHQIPTARO-AMERIKANE.....	98
2.Dr. Gurakuç Kuçi* “BALLKANI I HAPUR” DHE HIJA E PAQES SË OSLLLOS	101

2.1 Shaban Murati, ambasador VDIQ BALLKANIZMI I “BALLKANIT TË HAPUR”	103
2.2 Dr Lisen Bashkurti “MINISHENGENI” BALLKANIK, TROJKA E DËSHPËRUAR PA MBËSHTETJE BALLKANIKE.....	108

II GJEOPOLITIKA RAJONALE

3. Dr Albulenë HALILI MAQEDONIA MES INTEGRIMIT NË STRUKTURAT EURO- ATLANTIKE DHE GJEOPOLITIKËS BALLKANIKE	112
3.1 Emin AZEMI, publicist SHQIPTARËT, 21 VITE PAS NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË OHRIT	128
3.2 Shaban Murati, ambasador PROVOKACIONI SERB ME REZOLUTËN 1244	132
3.3 Dr Selim IBRAIMI ZVARRITJA E PROBLEMEVE HISTORIKE, I JEP FAVORE NDIKIMT RUS NË BALLKAN	137

III. BOTA

4. Jürgen Habermas, filozof LUFTË DHE INDINJATË.....	141
4.1 Agim KRASNIQI, PhD ROLI I FUQIVE TË MËDHA NË POLITIKËN BASHKËKOHORE BALLKANIKE.....	148
4.2 Olaf Scholz, Kancelar i Gjermanisë PIKA E KTHESËS	160
4.3 Peter Tase MIRËKUPTIMI I LITUANISË PËR TË NXITUR DIKTATURËN E BJELLORUSISË	172
4.4 Mr Sc Shqiprim Pula NËN SULMIN E 'NOVA RUSIA'-S.....	175

4.5 Dr Noah Smith FUNDI I SISTEMIT TË BOTËS.....	178
4.6 Dr Alexander Brotman UKRAINA DHE ZHVENDOSJA E GJEOPOLITIKËS SË HINTERLLANDIT.....	189
4.7 <i>Mario Stefanov</i> / Geopolitika.news, Zagreb POLONIA FILLOI TË KRIJOJË USHTRINË MË TË FUQISHME NË EVROPË.....	193
4.8 Dr Yakoob AHMED* PERANDORIA KUNDËRPËRGJIGJET: A ËSHTË SHTETI-KOMB MODERN SI ZGJIDHJE?	197
4.9 Dr Jeremy Shapiro dhe Dr Jana Puglierin* [ECFR] ARTI I VASALIZIMIT: SI LUFTA E RUSISË KUNDËR UKRAINËS I KA TRANSFORMUAR MARRËDHËNIET TRANSATLANTIKE	201

IV GJEOEKONOMI

5. Akademik Anastas ANGJELI G-20-TA, LUFTA, EKONOMIA, POLITIKA NË FOKUS	220
5.1 Prof.Dr Arben MALAJ KRIZAT BANKARE MË SHUMË RREGULLATORE SE SA MONETARE	224
5.2 Dr Michael Rectenwald ZOTËRIMI I SË ARDHMES: AMBICIET MEGALOMANE TË FORUMIT EKONOMIK BOTËROR	228

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1. Dr Sadri RAMABAJA

Gjeopolitika dhe shqiptarët — një kontribut modest për mendimin strategjik që na mungon

Abstrakt

Detyra e këtij brezi politikanësh drejtues të dy republikave tona (Shqipërisë politike dhe Republikës së Kosovës), por edhe e personaliteteve të mendimit politik gjithandej në hapësirën shqiptare dhe jashtë, tani do të duhej të ishte hartimi i një strategjie të përbashkët për veprim. Në këtë plan politika jonë e jashtme duhet t'i përgjigjet

momentumit historik që ka krijuar lufta në Ukrainë dhe reflektimi i saj në qendrat vendimmarrëse tradicionale, sidomos në Paris, Berlin e Uashington.

Jemi para ndryshimit esencial të rendit politik, përmbysjes së rendit global. Për Evropën, por edhe dy republikat tona dhe Kombin si tërësi, e ardhmja do të varet nga fakti nëse do të jemi dhe sa do të jemi në gjendje ta transformojmë potencialin tonë të brendshëm në fuqi integruese dhe garantuese të sigurisë në rajon dhe më gjerë — duke përfshirë një ndryshim strategjik në mentalitet [1], siç do të thoshte politologu gjerman Jan Techau.

Hyrje

Nga një këndvështrim afatgjatë, edhe pse krijimi formal i Shqipërisë (1912) si një shtet kombëtar tejet i vonuar, shqiptarët si etni e përfshirë në entitete paraprake politike: principata, perandori... kanë luajtur një rol të rëndësishëm në çështjet që ndërlidhen me Evropën dhe përgjithësisht civilizimin perëndimor. Në epokën e Gjergj Kastriotit — Skënderbeut shqiptarët do të shndërroheshin në barrikada mbrojtëse të civilizimit perëndimor. Gjergji ynë do ta shndërrojë Shqipërinë në kështjellë mbrojtëse për gati një çerek shekulli, duke ia pamundësuar Perandorisë Osmane në ngjitje zbarkimin në Itali dhe më tej në Evropën Perëndimore. Shekuj më vonë, pas shpërthimit të Luftës në Lindje (1875) sërish do të jenë shqiptarët ata që do të bllokojnë zbarkimin e Rosisë drejt ujërave të ngrohta të Adriatikut dhe Mesdheut.

Në shekullin e 19-të, nën udhëheqjen e urtë të Ymer Prizrenit dhe diplomatit të pashoq Abdyl Frashërit, do të bëhet përpjekja e parë pas disa shekujve robërie, të ngritët në këmbë Shteti modern shqiptar, që do t'i shërbej sërish edhe interesave gjeopolitike të Evropës në dy nivele: e para, për të larguar Perandorinë Osmane dhe ndikimin e saj në Evropën Juglindore, dhe e dyta, për të pamundësuar shuarjen e Shqipërisë dhe shqiptarëve, siç pretendonin ideologët rus. Kjo u arrit përmes ringjalljes së ndjesive nacionale gjithandej ndër shqiptarë, pastaj përmes një kombinimi të guximshëm të fuqisë së përqendruar në ruajtjen e tërësisë tokësore dhe aftësive diplomatike.

Ndërkaq pas krijimit të Republikës së dytë shqiptare në rajon (Republikës së Kosovës — 2008) shqiptarët do të trajtohen gjithnjë e më shumë si faktor me peshë për ruajtjen, jo vetëm të paqes dhe sigurisë së rajonit, por edhe për fuqizimin e Aleancës historike ushtarake të Perëndimit — NATO-s, duke u bërë rezidente e bazave të fuqishme ushtarake të saj.

Në një mjedis shumë polar interesash e mosbesimi dhe armiqësie reciproke që ziejnë me shekuj në Ballkan, ringjallja e faktorit shqiptar, u pa si kërcënim real nga Serbia, veçanërisht duke pasur parasysh se forca shqiptare dhe planet për ristrukturimin e gjeopolitikës rajonale do ta prishnin status quo-në mbizotëruese të Serbisë.

Gjeopolitika dhe ndikimi i saj në Ballkan

Në enciklopedinë gjermane të Brockhaus-it, “gjeopolitika” cilësohet si “Shkenca që qëndron në kufijtë mes gjeografisë, shkencave politike, historisë dhe shkencave sociale” e themeluar dhe ngritur në rangun e shkencës në nivel shtetëror nga politologu R. Kjellén, ndërkaq në Gjermani e përfaqësuar nga K. Haushofer, e që po kërkon vendin e vet për hulumtim e raporteve mes zhvillimeve politike dhe hapësirës.

Friedrich Ratzel konsiderohet themelues i antropogjeografisë dhe gjeografisë politike dhe si rektor shpirtëror i gjeopolitikës.

Termi “gjeopolitikë” më në fund u iniciua dhe krijua nga politologu dhe politikani suedez Rudolf Kjellén në librin e tij “Staten som Lifsform”. [2] Në fjalorin e Sigurisë politike, “gjeopolitika” cilësohet “si një fushë e ndërmjetme e shkencës mes gjeografisë, shkencave politike, historisë dhe sociologjisë” që hulumton hapësirën, respektivisht marrëdhëniet midis hapësirës dhe realitetit politik. Ajo është edhe shkenca e ndërlidhjes hapësinore me proceset politike, ndërkaq për shtetin si organizëm gjeografik shërben më tej si analizë e ndikimit të kushteve gjeografike të tij, pra të Shtetit mbi politikën e tij kombëtare dhe ndërkombëtare.” [3]

Në thelbin e saj, prandaj, gjeopolitika supozon, ashtu si edhe ekonomia, se ngjarjet drejtohen nga këto forca jo personale dhe jo nga tekat apo ideologjitë individuale. [4]

E ardhmja gjeopolitike është rigorozisht jo ideologjike.

Duket që ky konkluzion ka ndikuar që studiuesi Rainer Mennel të pohoj me të drejtë se “gjeopolitika është një nga degët e shkencave politike më me ndikim në hapësira konkrete [rasti i Ballkanit], në politikën e një Shteti”. [5]

Në thelbin e saj gjeopolitika supozon, ashtu si edhe ekonomia, se ngjarjet drejtohen nga këto forca jo personale dhe jo nga tekat apo ideologjitë individuale. Zhvillimet e gjeopolitikës klasike në zonën e Evropës Juglindore, sidomos ato pas Luftës së Dytë Botërore, po rikthehen në jetë tani në dekadën e tretë të shekullit të 21-të. Për shumë vite gjykohej se shekulli i njëzetë do të mund të cilësohej si i kapërcyer. Këtë tezë e dëshmojnë botime të ndryshme shkencore ndërkombëtare, sidomos pas vitit 1989. Por, ishte pikërisht procesi i shkërmoqjes së ish Federatës Jugosllave me theks gjenocidi në Bosnjë dhe Kosovë, dhe tani aneksimi i Lindjes së Ukrainës dhe lufta që po vazhdon për Ukrainën, që po rikthejnë zhvillimet gjeopolitike klasike gjithandej, e me theks edhe në Evropën Juglindore. [6]

BE-ja, shih për këtë, nuk duhet të përqendrohet e tëra në Ukrainë, duke i lënë hapësirë të lirë veprimi Ruisë dhe satelitëve të saj në Evropën Juglindore. Shih për këtë, kundërvënia ndikimit rus në rajon, nuk arrihet dot duke hequr dorë nga Ballkani, respektivisht duke hedhur në parketin

e diplomacisë ide për gjoja “Komunitetin Politik Evropian” apo “Komunitetin gjeopolitik evropian”.

Idenë mbi të ashtuquajturin “Komunitet politik evropian” e bëri publik presidenti i Francës, Emanuel Makron më 9 maj 2022, duke e prezantuar si një lloj alternative të anëtarësimit në BE. Ndërkaq nëntë ditë pas tij, saktësisht në 18 maj 2022, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, e rimerr propozimin presidencial francez dhe i bën një redaktim terminologjik dhe propozon “komunitetin gjeopolitik evropian”. Në një fjalim të mbajtur në 18 maj në Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, Mishel parashtroi propozimin e tij: “Unë bëj thirrje për krijimin e një komuniteti gjeopolitik evropian”. Këtë propozim presidenti i Këshillit Evropian ia paraqiti edhe Serbisë, Shqipërisë dhe Bosnje-Hercegovinës, në turneun e tij të 19–20 majit në Ballkanin Perëndimor.[7]

Lufta në Ukrainë dhe pasojat e saj gjeopolitike për BE

Pozicionimi i paqartë i Francës rreth të ardhmes evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe me këtë edhe të vetë BE-së, me theks të veçantë trajtimi racist i Shqipërisë dhe shqiptarëve nga elita aktuale politike franceze, në një rënë anë dhe përqendrimi i Gjermanisë në marrëdhëniet me Rusinë, e shpënë pashmangshëm autonominë gjeopolitike të BE-së në kalendrat greke.

Krejt e natyrshme pastaj rezulton rritja e ndikimit të Uashingtonit dhe Londrës tok në shestimin, krijimin dhe zbatimin e politikave që do të mbarështojnë të ardhmen e Evropës Juglindore dhe jo vetëm asaj në kontinentin e vjetër.

Bashkimi Evropian kishte mundësi të mrekullueshme ta ndërtojë kapacitetin e tij gjeopolitik, që nga momenti kur Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 9 shtator 2010, miratoi rezolutën e sponsorizuar nga 27 vendet e atëhershme të Bashkimit Evropian dhe Serbia, e cila hapi rrugë për fillimin e dialogut Kosovë — Serbi, të lehtësuar nga BE.[7]

Kësaj rezolute i kishte parapri akti juridik që tashmë njihet me nocionin Mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) rreth shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Rezoluta në fjalë, e miratuar me konsensus nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, përshëndeste mendimin e GJND-së, si dhe e mirëpriste gatishmërinë e Bashkimit Evropian për të lehtësuar procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke theksuar se ky proces do të shërbente si faktor i paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Duke imponuar me kalimin e kohës një tip të dialogut asimetrik, në dobi të Beogradit e duke mos rënë ndesh me interesat ruse në rajon dhe duke koketuar me elementë e struktura autoritariste gjithandej në Ballkanin

Perëndimor, Brukseli humbi mundësitë për integrimin e përsheptuar të Ballkanit Perëndimor në BE dhe promovimin e primatit të tij në gjeopolitikë, së paku kur bëhet fjalë për këtë pjesë të kontinentit të vjetër. Tashti kur në një situatë lufte, kur politika e jashtme e Bashkimit Evropian është plotësisht e varur nga lidershpi amerikan dhe britanik, të pohosh siç bëri Borrell më 18 maj: “BE-ja është forcuar si një lojtar ndërkombëtar dhe madje mund të flitet për lindjen e një bashkimi gjeopolitik”, apo të promovosh ide si ajo e Makronit, d.t.th të tallesh me vetveten.

Dështimi i BE-së në raport me gjeopolitikën ruse kishte filluar në fakt në Ballkan, sidomos në koketimin e tepruar të Brukselit me Serbinë, ndërkaq kishte kulmuar me sjelljet në raport me fillet e marshutës ruse drejt Kievit.

Franca dhe Gjermania vazhdimisht, që prej pushtimit të Krimes (2014) kishin llogaritur gabimisht duke bërë përpjekje të gjejnë mënyra për të ndaluar Putinin duke aplikuar të bëmat e Neville Chamberlain, mbrojtja e pjesës tjetër të Ukrainës nga pushtimi rus është përgatitur dhe ndihmuar ekskluzivisht nga SHBA dhe Britania e Madhe.

Me këtë mosveprim, respektivisht me pozicionimin dubioz për ndërtim aleancash të reja që do të dobësonin ndikimin e SHBA-ve dhe Britanisë në Evropë, Berlini dhe Parisi, de fakto kanë bërë të kundërtën. Roli udhëheqës në Evropë në periudhën e ardhshme dhe për një kohë të gjatë sërish ju la në dorë ekskluzivisht NATO-s, e cila udhëhiqet nga Uashingtoni me ndihmën e Londrës. Ndërkaq zgjerimi i pritshëm i Aleancës në veri (Finlandë dhe Suedi) dhe ai pasuesi në Ballkanin Perëndimor (Kosovë dhe Bosnjë) e çimenton për dekadat e ardhshme arkitekturën e sigurisë evropiane, në kuadër të ombrellës së NATO-s.

Në këtë kuadër, politika gjermane dhe evropiane e gjetën veten praktikisht në bankën e të akuzuarve. Thomas Kleine-Brockhoff, nënkryetar i fondit gjerman Marshall me ndikim, një institut amerikan i themeluar për të zhvilluar marrëdhëniet SHBA-Gjermani, tha në një intervistë për FRANCE 24: “Evropa nuk ka bërë një gabim, por Gjermania dhe Franca kanë bërë. Franca dhe Gjermania vazhdimisht duhet të flasin në emër të pjesës tjetër të Evropës, por dështimet politike ndaj Rosisë janë bërë në Paris dhe Berlin, jo diku tjetër. Evropa Lindore nuk gaboi, Evropa Veriore nuk gaboi”.[8]

Ndërkohë derisa lufta në Ukrainë vazhdon, politika e jashtme dhe ajo e energjetikës e BE-së tashmë është në duart e SHBA-ve (ajo e sigurisë ishte edhe më parë, si pjesë e Aleancës në NATO).

Ky pozicion pretendohet sigurisht që të jetë i përkohshëm, me idenë se më vonë, kur “ti tregohet vendi” Federatës Ruse, BE-ja do të jetë në

gjendje ta rikthejë, respektivisht ta sigurojë autonominë e saj të gjakuar gjeopolitike.

Në këto rrethana të reja që janë edhe produkt i luftës në Ukrainë dhe pozicionimit amerikan në raport me Gjermaninë, gjasat që Polonia të zërë vendin e saj në BE janë reale.

Nëse ky pozicionim i rezervohet Polonisë në rastin e BE-së, a mund të llogarisim se Shqipërisë dhe shqiptarëve mund t'i rezervohet po i njëjti pozicion për Evropën Juglindore?

Nëse elitat tona politike dhe jo vetëm ato do të angazhoheshin për këtë pozicion, gjasat janë reale që ta kemi. Në të kundërtën, sërish nuk përjashtohet mundësia që këtë pozicion ta marrë Serbia, ashtu si de fakto e kishte për dekada të tëra sa ishte lokomotiva kryesore e ish Federatës Jugosllave. I ashtuquajhuri “Ballkan i hapur” në këtë rast Serbisë do t'i shërbente fare mirë si një ambalazhim, disi ngjashëm me atë që e kishte me Federatën e sllavëve të jugut (Jugosllavia).

Gjermania i rikthehet vetëvetes

Sipas Kleine-Brockhoff, lufta në Ukrainë kërkon një ndryshim urgjent në politikën gjermane ndaj Rusisë. “Jo vetëm që rendi evropian i krijuar pas Luftës së Ftohtë po shembet para syve tanë, por po ashtu edhe strategjitë e zbatuara nga Gjermania dhe Franca”, shtoi ai.

Dështimi i politikës gjermane dhe franceze, jo vetëm në raport me Rusinë e Putinit, por edhe me Beogradin e Vuçiqit, nuk është gjë tjetër veçse dështim i politikës së jashtme të Bashkimit Evropian.

Në këtë situatë, presidentit gjerman Frank-Walter Steinmeier nuk i mbetet tjetër, përveç se ta pranojë atë dhe të kërkoj falje publike. Ai e pranon këtë fakt, jo pa siklet, duke pohuar katërcipërisht se: “Ne jemi kapur pas urave me Rusinë”. [...] Nuk besoj se Vladimir Putin do të pranonte rrënimin e plotë ekonomik, politik dhe moral të vendit të tij për shkak të çmendurisë së tij perandorake. Si shumë të tjerë, gabova.”[9]

Ribashkimi i Gjermanisë në fund të shekullit 20-të nxiti ankthe strategjike edhe në Perëndim. Në fakt, dihet se si Margaret Thatcher ashtu edhe François Mitterrand hezitonin të mirëprisnin aktin e bashkimit të Gjermanisë Lindore [DDR] me Republikën Federale Gjermane (BRD), duke e konsideruar këtë akt si një lloj Anschluss 2.0. Ata nuk ngurruan madje t'i afroreshin kryeministrit sovjetik Mikhail Gorbachev për ta parandaluar aktin e ribashkimit gjerman. Ndërkaq zëra realist e ideolog si puna e John Mearsheimer, që në vitin 1990-të, do të paralajmëronte se “një Gjermani e sigurt do të përpiqej të siguronte armët e veta bërthamore në një mjedis strategjik në të cilin shpërbërja e bipolaritetit do të lindte një epokë telashe dhe tensionesh të rritura midis fuqive konkurruese.”[10]

Lufta në Ukrainë solli pikërisht epokën për të cilën paralajmëronte Mearsheimer-i.

Nëse në periudhën pas ribashkimit, Gjermania në planin ushtarak, madje hezitoi të përmbushte kriteret minimale të NATO-s lidhur me ndarjen e pjesës së buxhetit për nevoja të sigurisë, siç ka argumentuar bindshëm Stephen Szabo, gjatë gjithë kësaj epoke, ajo arriti të ri-shpikte veten si një fuqi gjeoekonomike. Fuqia e saj kombëtare nuk mbështetej nga aftësitë ushtarake konvencionale ose armët e shkatërrimit në masë, por nga ndjekja e një politike strategjike të realizmit tregtar, një rrugë që shfrytëzoi fuqinë industriale gjermane dhe avantazhet e saj pakrahasueshme. Në fund të fundit, duke marrë parasysh produktivitetin e ekonomisë gjermane, ajo duhej të siguronte tregje konsumi në të cilat mallrat e saj të prodhuara mund të eksportoheshin. Nga ana tjetër, ai kërkonte gjithashtu akses të besueshëm si në energji ashtu edhe në lëndët e para. Kjo u bë përmes kornizave të përbashkëta të dobishme bashkëpunuese, tregtisë dhe projeksionit të ndikimit nëpërmjet vektorëve jo konvencionalë, siç është zgjerimi i interesave të biznesit privat gjerman.[11] Sidomos ndjekja e kësaj strategjie u dëshmuar e suksesshme në raport me Rusinë.

Por, Britania e Madhe dhe SHBA-të, në përputhje me mendimin gjeopolitik të autorëve anglo-amerikanë (si klasikë ashtu edhe bashkëkohorë), e kishin cilësuar me ët drejtë si imperativ parandalimin e zhvillimit të një partneriteti ruso-gjerman. Prandaj luftën në Ukrainë dhe intencat për shndërrimin e Polonisë në një fuqi të re ushtarake, duhet riparë edhe në këtë kontekst.

Varshava, shih për këtë, shpërfaqë një lloj ndjesie të gërshetuar me atë të urgjencës, kur viktimat ndodhet para agresorit ët pritshëm, pikërisht për shkak të shpërfaqjes kaq agresive në Ukrainë të ultra nacionalizmi të rinovuar rus. Rimilitarizimi i Polonisë aktualisht nuk bazohet vetëm në përgatitjen për çfarëdo kërcënimi që vjen nga Kremli, por gjithashtu pasqyron një dëshirë për t'i dalë të keqes përpara edhe nëse ajo vjen nga palë tjera. Shih për këtë, Polonia ka nisur prokurimin më të madh të dërgesave të armëve konvencionale amerikane në histori. Në mars, Varshava nënshkroi raketa Patriot me vlerë 4.75 miliardë dollarë, duke forcuar sistemin e mbrojtjes kundër raketor.

Krahas blerjes në masë të armatimit modern dhe gjithandej tek prodhuesit më të mirë, ministri i Mbrojtjes Blaszczak paralajmëroi ndërkohë se Polonia do të rrisë forcat e saj në detyrë aktive në 400,000 me një rritje në alokimet e mbrojtjes në 3% të PBB-së së vendit.[12]

Strategjia e Berthholdit dhe shqiptarët

Por atë që e kishte parasysh ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë Leopold Berthold (1913) dhe përgjithësisht politika gjermane e kohës, mund të rikthehet në vëmendje tek tashti pas ripushtimit të Ukrainës dhe përballjes së interesave gjeopolitike edhe rreth Ballkanit Perëndimor. Berthold e kishte spikatur faktin se, vetëm krijimi i Shqipërisë në gjeografinë e saj reale (në katër ish vilajetet osmane) dhe aleanca me këtë Shqipëri të ngritur në Shtet të pavarur, do ta mundësonte shtrirjen e ndikimit gjeopolitik gjerman dhe perëndimor në këtë pjesë të Evropës dhe Mesdheut, duke i vënë kështu një ledh të natyrshëm ndikimit rus në Europa Juglindore. Rikthimi tek gjeopolitika e Bertholdit nuk do t'i bënte keq as Berlinit e as Perëndimit në tërësi, sidomos tani kur flakët e luftës mund ta përfshijnë edhe këtë pjesë të kontinentit të vjetër.

Shqipëria tashmë si anëtare e NATO-s, natyrisht tok me Kosovën si strukturë e saj e federuar, ka të gjitha predispozitat të bëhet një fuqi ushtarake shumë e rëndësishme në Evropë. Si e tillë, përfshi edhe ngushticën e Otrantos, Shqipëria marrë peshë specifike të natyrës gjeopolitike kundruall forcave tjera konkurruese në zonën e Mesdheut dhe rrafshnaltën e Ballkanit.

Në këtë proces të rikthimit gjerman tek vetvetja, një Shqipëri e fuqishme do të ishte pa dyshim në dobi edhe të interesave të Gjermanisë moderne. Në rishikim të gjeopolitikës gjermane Marshalli Thomas Kleine-Brockhoff pledon qartë: “Lufta në Ukrainë ka shpërthyer flluskën në të cilën Gjermania ka jetuar që nga vitet 1990”. Sipas tij, në atë flluskë Gjermania gëzonte një pozicion komod të sigurimit të energjisë së lirë nga Rusia dhe mungesës së nevojës për investime ushtarake, të cilat mundësonin rritjen e industrializimit, rritjen e pasurisë së shtetit dhe qytetarëve dhe një politikë të jashtme paqësore të bazuar mbi idenë se Gjermania mund të pajtohet me të gjithë dhe se për këtë arsye ajo nuk duhet të shqetësohet për mbrojtjen e saj. Jo pa një dozë hidhërimi Thomas Kleine-Brockhoff paralajmëron se kësaj i ka ardhur fundi. Think-tank-u kryesor amerikan i fokusuar në marrëdhëniet SHBA-Gjermani, Instituti Amerikan për Studime Bashkëkohore Gjermane (AICGS), në një përmbledhje të titulluar “Fundi i Evropës siç e dimë?”, me autor penën e njohur Jeffrey Rathke, fill pas agresionit rus ndaj Ukrainës, më 24 shkurt 2022, pohon se përgjegjësia politike për lëshimet ndaj Rusisë i përket evropianëve, veçanërisht Gjermanisë.

Në këtë artikull, Rathke nënvizon: “Do të ketë mjaft kohë për analiza, akuza dhe autokritikë — politika perëndimore nuk ka arritur të pengojë Rusinë nga një sulm i përgjithshëm brutal ndaj fqinjit të saj paqësor ukrainas dhe themeleve të paqes në Evropë, por përgjegjësia kryesore bie mbi Gjermanin...” Gjermania është qendra e gravitetit të veprimit evropian për t’ia imponuar koston e lartë Moskës në rast se lufta tej

zgjatet, por edhe për të pamundësuar shpërthimet e flakëve të luftës të nxitura nga Rusia në hapësira tjera të Evropës, para së gjithash në Baltik dhe Ballkan.

Duke ju rikthyer Gjermania vetvetes, ajo mund të nxjerrë përfundime të duhura nga ky moment historik. Në rast se përpiqet ta tejkalojë këtë në kurriz të integritetit ukrainas, paqja e brishtë që do të mund të imponohet, gjithsesi nuk do të jetë e shtrirë në kohë më shumë se ajo mes pushtimit të Krimesë (2014) dhe agresionit të ri rus mbi Ukrainën (24 shkurt 2022). Në themel të gjeopolitikës së re gjermane, sugjerojnë ekspertët e fushës, është ndryshimi rrënjësor i politikës pararendëse, duke ju rikthyer vetvetes dhe përkushtimit për Bashkimin Evropian. Kjo nënkupton heqjen dorë edhe për këtë shekull, nga rikthimi tek politika e vjetër e bashkëpunimit me Rusinë.

Sistemi i ri botëror

Ndërkohë që brezi ynë ka stivuar në kujtesën e vet epokën e Luftës së Ftohtë dhe shembjen e Bashkimit Sovjetik tok me zgjerimin e BE-së dhe NATO-s në Evropën Lindore e atë Juglindore, janë dy momente që shënjojnë prologun e Sistemit të ri botëror:

1. Në vitin 2020 dhe 2021, një sërë ngjarjesh i bindën liderët e Kinës (dhe shumë vëzhgues në SHBA dhe në mbarë botën) se sistemi i Kinës e kishte tejkaluar SHBA-në për sa i përket vitalitetit ekonomik, stabilitetit politik dhe fuqisë gjithëpërfshirëse kombëtare. [13]

2. Mungesa e agjendës evropiane në raport me të ardhmen e Ukrainës pas aneksimit të Krimesë (2014) i dha shenja të qarta Putinit për të filluar përgatitjet për pushtimin e plotë të saj. Hapi që pasoi më 24 shkurt 2022 ishte vetëm vazhdimi i asaj që kishte ndodhur me Krimenë. Madje, hezitimi për mbështetje të Ukrainës në fillim dhe afrimi i azilit për presidentin ukrainas Volodimir Zelenski, ishte edhe një dëshmi tjetër se Evropa nuk i kishte bërë llogaritë si duhet.

Lufta titanike e ushtrisë dhe popullit ukrainas ka përmbysur teorinë mbi pathyeshmërinë e ushtrisë ruse. Kjo luftë njëkohësisht shënjon prologun e sistemit të ri botëror.

Sistemi i ri ekonomik botëror që do të shënjohet me zinxhirë të ri të prodhimit, që duket se do të zhvendosen në blloqe. Kina duket se do të prezantojë një bllok më vete, të cilit mund t'i bashkohet Rusia. “Xi dhe ndjekësit e tij duan që Kina të prodhojë dhe të zotërojë çdo gjë të vlefshme në shtëpi dhe të mbështetet në vendet e tjera vetëm për lëndët e para dhe mallrat e tjera me vlerë të ulët. Në mungesë të rendit botëror liberal të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara për të zbatuar tregtinë e lirë, sigurimi i këtyre burimeve do të kërkojë veprime gjeopolitike dhe madje edhe ushtarake - një kthim, në një

formë ose në një tjetër, në epokën e para Luftës së Dytë Botërore.”[14] Këto zhvillime në plan global do të shoqërohen me ri ngritje të forcave të reja të neoimperializmit që priten të pasohen me ë beteja për burimet e disa vendeve neutrale, duke përfshirë vendet e varfra. Për shumëçka këto beteja do t ‘na rikujtojnë ato të epokës së Luftës së Ftohtë.

Por, duke parashikuar realizimin e një "shoqërie me prosperitet modest", ndërkohë Pekini pretendon hapur që përmes modernizimit të ekonomisë të ngritet në majat e botës politikisht dhe ekonomikisht. Ky është vendi që Pekini mendon se historikisht e meriton Kina. Për arritjen e këtij qëllimi presidenti kinez dhe njëkohësisht shefi I partisë-shtet në kongresin e fundit të partisë zuri në gojë edhe **“modernizimin e bashkësisë ndërkombëtare” me karakteristika kineze**. Për ta thënë troç, demokratizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare do të thotë se Pekini, në përputhje me peshën e tij të shtuar në politikën botërore, po kërkon më shumë hapësirë e ndikim ë në organizatat ndërkombëtare, veçanërisht për veten e tij dhe, në një farë mase, për vendet e tjera mike në zhvillim.[15]

Varësisht nga zhvillimet e brendshme në shoqërinë amerikane dhe konfrontimi i administratës dhe gjyqësorit amerikan me neofashistin Donald Trump dhe pasuesit e tij, duke kuptuar se SHBA-të nuk mund ta dominojnë botën si dikur, ka gjasa të mira që të krijohet blloku jo-kinez në krye me SHBA-të. Ky bllok “nuk do të përfshinte vetëm aleatët formalë të Amerikës ose demokracitë e zhvilluara; në vend të kësaj do të përfshinte shumë vende në zhvillim që do të donin të mbroheshin nga fuqia kineze dhe të siguronin akses në tregjet e botës së pasur. Dy shembuj kryesorë janë India dhe Vietnam. Këtij blloku është e pritshme t’i bashkohen edhe Indonezia, Bangladeshi, Filipinet, Meksika dhe Turqia. Nëse do të arrihet të krijohet ky bllok i demokracive liberale , atëherë rendi i ri ekonomik botëror, respektivisht përballja me Kinën do të jetë më e kontrollueshme. “SHBA, Evropa dhe demokracitë e pasura të Azisë Lindore do të përbënin një bllok prodhues që mund të përputhet me prodhimin e Kinës dhe një bllok teknologjik që mund të tejkalojë aftësitë e Kinës.” [16]

Në çdo rast, ky vizion - një sistem global i prodhimit dhe tregtisë kryesisht i dyfishuar, me dy blloqe të avancuara teknologjikisht me prodhim të lartë që konkurrojnë kokë më kokë - duket si zëvendësimi më i mundshëm për sistemin aktual që dominoi ekonominë globale mbi dy dekadat e fundit. Natyrisht ky është vetëm supozim i bazuar në zhvillimet e fundit. Por “ajo që nuk vihet në dyshim këtu është se ne kemi arritur një moment vendimtar në historinë e ekonomisë globale: sistemi që ne njohëm dhe mbështetemi gjatë dy dekadave të fundit është duke u shkatërruar dhe udhëheqësit dhe mendimtarët tanë duhet të përpiqen të planifikojnë atë që vjen më pas.”[17]

Çështja shqiptare në dioptrinë e re të gjeopolitikës

Nëse e gjithë teza politike mbi rikthimin e Gjermanisë ndaj vetëvetes ka të bëjë me nevojën për të mbajtur politikën dhe ekonominë gjermane larg Rusisë, në këtë dritë të re të gjeopolitikës, çështja shqiptare fiton peshën e duhur, sidomos në raportet transatlantike.

Në kuadër të rikthimit tek boshti i Aleancës (SHBA & Britani e Madhe), Gjermania mund të marrë rolin e koordinatores me vendet e BE-së në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë, që d.t.th thellim i bashkëpunimit ushtarak me Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar. Në këtë kuadër Shqipëria [Federata Shqiptare nesër] do t' mund të luante rol të ndjeshëm të forcimit të krahut jugor të BE-së, por edhe në selitjen e raporteve të mira në rrafshin transatlantik. Duke hequr kështu dorë Gjermania nga ëndrrat e liderëve francez për krijimin e një lloj industrie të integruar ushtarake të BE-së dhe të zhvillimit të një gjenerate të re të sistemeve evropiane të armëve, asaj do t'i kërkohet bashkëpunim më i madh ushtarak-teknik dhe industrial me palët amerikane dhe britanike të integritit euroatlantik. Në këtë kuadër, domethënës është vendimi gjerman për blerjen e avionëve luftarakë amerikanë F-35, me kushtin e ashtuquajtur gjerman që industria evropiane të përfshihet në prodhimin e këtij avioni luftarak dhe në zhvillimin e mëtejshëm të tij. Bëhet fjalë, në fakt, për interesin amerikan dhe një përsëritje të historisë nga epoka e Luftës së Ftohtë, kur F-104 amerikan "Starfighter" u bë avioni kryesor luftarak i anëtarëve evropianë të NATO-s.[18]

Meqë kur prodhimi i F-35, parashikohet të bëhet në disa vende evropiane për nevojat e aviacionit të tyre, do të ishte me shumë interes që një nga këto vende të ishte gjithsesi Shqipëria. Duke u bërë F-35 avioni kryesor luftarak i pjesës evropiane të NATO-s, sipas të njëjtit model të marrëdhënieve politike dhe ushtarake si në kohën kur atë rol e kishte F-104 "Starfighter" amerikan, ndërkaq Shqipëria njëra nga bazat për prodhimin e tij, ky fakt e rikthen plotësisht Shqipërinë dhe shqiptarët (përfshi në këtë kuadër jo vetëm Republikën e Kosovës, por edhe Maqedoninë dhe Malin e Zi) në sferë të garantuar të interesit afatgjatë perëndimor.

Rikthimi tek vetvetja, sidomos pas leksioneve që mund të nxirren nga lufta e Ukrainës, është i natyrës urgjente edhe për shqiptarët.

Lufta në Ukrainë, pra intenca e Vladimir Putinit për restaurimin e Rusisë imperiale të epokës së Pjetrit, në rrafshin politik, si për Evropën Juglindore edhe për vendet e Baltikut, duket se do të prodhojë efekte pozitive në rrafshin gjeopolitik.

Intelektuali bullgar Ivan Krastev, studiues në Institutin e Shkencave Humane në Vjenë, dhe një nga mendimtarët kryesorë politikë të kohës sonë. beson se Evropa mund të nxjerrë dy leksione nga kjo luftë: Asnjë vend nuk mund t'i rezistojë i vetëm sfidave të jashtme, dhe sigurisht jo atyre ushtarake. Por shton ai, lufta nuk është një betejë për Evropën. Ndërsa ukrainasit po mbrojnë vendin e tyre, polakët dhe shtetet baltike janë të shqetësuar për vendet e tyre, një dëshmi, thotë Krastev se, shtet-komb është ende i rëndësishëm për identitetin politik të njerëzve.[19]

Që të dy këto leksione vlejné mbi të gjitha për dy republikat shqiptare (Shqipërinë politike dhe Republikën e Kosovës). Pretendimi që përmes aderimit në iniciativa të tipit të “Ballkanit të Hapur” do të arrihet të shmanget agjenda e Beogradit për rikthim në Kosovë konform modelit rus në Ukrainë, de faktorizon shqiptarët në raportet e tyre me Brukselin dhe mbi të gjitha peshën dhe rolin pozitiv që do të mund ta kishim në marrëdhëniet transatlantike.

Në këtë kuadër, SHBA-të dhe Britania e Madhe ashtu siç morën drejtimin mbi çështjet kontinentale evropiane, në mungesë të një agjende të mirëfilltë evropiane për Ukrainën, ato do të shtyjnë përpara edhe agjendën për sigurimin e arkitekturës së sigurisë në Europën Juglindore. Dekadave të krijimit të iluzionit të stabilitetit në Evropën Juglindore duke ushqyer shpresat për rikthim të Serbisë në Kosovë, ose duke i premtuar nën tavolina Beogradit për shpërblim me aneksimin e veriut të Kosovës, po i vije fundi. Bota tashmë ka hyrë në fazën përfundimtare të procesit të riorganizimit të saj, në të cilën të fuqishmit, po vendosin kufij të rinj të sferave të tyre të interesit. Evropa Juglindore si tërësi dhe dy republikat shqiptare në veçanti, tashmë janë zona të garantuara të interesit amerikan. Dhe përderisa marrëdhëniet e SHBA-ve me Rusinë janë tashmë të “ngrira” për kohë të gjatë, ndërkaq Brukseli vazhdon të nanuriset sa me projektin e BE-së aq edhe me ide të reja të Makronit për njëfarë Komuniteti Politik Evropian, ku do të duhej të përfshiheshin, përveç vendeve anëtare të BE-së, edhe shtetet aspirantë, rikthimi i rolit të shtet-komb në vizionin për ruajtjen e sovranitetit, duke kultivuar ata cilësitë që i veçon, çështjen shqiptare në dioptrinë e re të gjeopolitikës e bën më specifike. Rrjedhimisht ky proces gjeopolitik në zhvillim, vizionin për Federatën Shqiptare e shndërron në vizion real, objektiv.

Ndërkohë derisa lufta në Ukrainë vazhdon, politika e jashtme dhe ajo e energjetikës e BE-së tashmë është në duart e SHBA-ve (ajo e sigurisë ishte edhe më parë, si pjesë e Aleancës në NATO).

Ky pozicion pretendohet sigurisht që të jetë i përkohshëm, me idenë se më vonë, kur “ti tregohet vendi” Federatës Ruse, BE-ja do të jetë në gjendje ta rikthejë, respektivisht ta sigurojë autonominë e saj të gjakuar gjeopolitike.

Në këto rrethana të reja që janë edhe produkt i luftës në Ukrainë dhe pozicionimit amerikan në raport me Gjermaninë, gjasat që Polonia të zërë vendin e saj në BE janë reale. Nëse ky pozicionim i rezervohet Polonisë në rastin e BE-së, a mund të llogarisim se Shqipërisë dhe shqiptarëve mund t'i rezervohet po i njëjti pozicion për Evropën Juglindore?

Nëse elitat tona politike dhe jo vetëm ato do të angazhoheshin për këtë pozicion, gjasat janë reale që ta kemi. Në të kundërtën, sërish nuk përjashtohet mundësia që këtë pozicion ta marrë Serbia, ashtu si de fakto e kishte për dekada të tëra sa ishte lokomotiva kryesore e ish Federatës Jugosllave.

I ashtuquajturit “Ballkan i hapur” në këtë rast Serbisë do t'i shërbente fare mirë si një ambalazhim disi ngjashëm me atë që e kishte me Federatën e sllavëve të jugut (Jugosllavinë).

PËRFUNDIM

Në këto rrethana, shqiptarët nuk do të duhej të kishin dilema për pozicionimin e tyre krejtësisht në përputhje edhe me interesat gjeopolitike. Nëse Franca, Gjermania dhe ndonjë vend tjetër i Evropës veriore tani mund të kenë preokupim edhe rikuperimin e pavarësisë së tyre strategjike nga SHBA-të, drejtuesit e dy republikave tona nuk guxojnë të tundohen nga ngasje të kësaj natyre. Prezenca ushtarake e fuqishme e SHBA-ve në dy republikat tona është garancia më e fuqishme

e ndalimit të çfarëdo projekti sllav për rikthim të mundshëm, së paku për aq kohë sa nuk do ta kemi një ushtri unike të fuqishme.

Lufta e Ukrainës dhe reflektimi i saj tejet i madh pakrahasimisht me atë në ish Jugosllavi, po përshpejtojnë rrjedhën e historisë dhe “gjeranëve po u mbaron koha”.

Rusët gjatë periudhës së pasluftës së ftohtë [1989–2014] kanë identifikuar saktësisht Gjermaninë si shtyllën dhe motorin e BE-së. Prandaj në përplasjen e pritshme me Perëndimin, ata duke investuar në shumë fusha, kishin llogaritur për të tërhequr Gjermaninë nga orbita gjeopolitike e SHBA-ve, disi ngjashëm siç kishin bërë edhe me disa shtete të Evropës Lindore e asaj Juglindore.

Kështu, nëpërmjet zhvillimit të projekteve të infrastrukturës (rrjetet e tubacioneve) për të furnizuar me sasi të konsiderueshme energjie ruse në tregun gjerman të konsumit, Kremli ishte siguruar që Berlioni të mos mbajë një qëndrim konfrontues ndaj Ruisë. Dërgesa të tilla nuk janë vetëm një burim i parave të forta, por edhe një mjet strategjik dhe politik ndikimi. Përmes kërcënimit të përçarjes, Kremli mund të tërheqë këmbëzën për të shkatërruar ekonominë gjermane [20]...

Por lufta në Ukrainë prodhoi kundër efekte të theksuara edhe në raportet Berlin-Moskë.

“Asnjë vend tjetër që unë njoh nuk është tronditur nga ky sulm i paprovokuar ushtarak në supozimet thelbësore të politikës së saj të jashtme dhe të sigurisë si Gjermania,”[21] deklaroi Ischinger më 28 korrik, në një konferencë në Salzburg, të cilën e sjell edhe e përditshmja Tagesspiegel e Berlinit.

Në këtë periudhë të përplasjeve me karakter të theksuar gjeopolitik, Franca doli me propozimin e ri për një Komuniteti Politik Evropian, bërthama e së cilës do të mbetet çështja fillestare e BE-së, ndërkaq periferia, pjesa tjetër tok me vendet ende të pa aderuar në BE. Ndërkaq Britania e Madhe po promovon krijimin e një aleance të re sigurie të shteteve evropiane që ndajnë tre emërues të përbashkët: një kundërshtim i ashpër ndaj Ruisë, një orientim i fortë strategjik atlanticist dhe një pikëpamje mosbesuese ndaj Gjermanisë.[22]

Rikthimi tek strategjia e Bertholdit do ta ndihmonte Gjermaninë që të ruante interesat e saj gjeopolitike në Evropën Juglindore, po aq sa do t'i jepte shkas Federatës Shqiptare që njëkohësisht të kontribuojë në përafrimin e këtyre interesave me ato të SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe, duke kushtëzuar këtë me kundërshtimin e ashpër të ndikimit të Ruisë dhe Turqisë në rajon.

Tani që historia është përmbysur tërësisht, Shqipëria dhe shqiptarët mund të llogarisin në garancinë amerikane të sigurisë e tok me të edhe komoditetin e të qenit një ekonomi e zhvilluar vetëm nëse dimë të luajmë

mirë në sferën e interesave gjeopolitike, që d.t.th. nëse pozicionohemi qartë dhe drejt.

Intenca e fuqive evropiane që kalkulonte dhe merrte në konsideratë edhe interesat ruso-serbe, duke promovuar një lloj status quo-je që promovonte ideja e Grupit të Kontaktit për mbajtjen e Kosovës disi ngjashëm me Austrinë, larg procesit të integritetit të saj me Shqipërinë politike, qoftë edhe në trajtën e një Federate Shqiptare fillimisht, tani shpejt do të zhduket vetvetiu dhe partneritetet ekzistuese nuk do ta përfillin tutje atë kushtëzim të sanksionuar madje edhe në kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sundimi shekullor osman, që filloi me pushtimin e qyteteve të periferisë së hapësirës jetike shqiptare — qytetet e Shtipit, të Përlepit, të Manastirit dhe të Kosturit, Shkupit, të Manastirit, të Janinës etj. (1385) dhe u përmyll me pushtimin e Shkodrës (1479), la gjurmë të thellë jo vetëm në gjenotipin, stilin e jetës dhe fjalorin e popullit shqiptar, veçmas të zonave fushore e bregdetare, por më shqetësues ishte ai në karakterin e tij socio-politik dhe moral.

Sidoqoftë, falë zonave të pamposhtura malore (Mirdita, Malësia Mbishkodrës, Rugova, Labëria, Malet e Zeza të Shkupit, Zonat rreth Sharrit, Medoka...) u arrit të ruhet gjenotipi shqiptar, ndërkaq në epokën e Rilindjes Kombëtare - të etablohet formimi i ndërgjegjes kombëtare.

Ky gjenotip modern post kolonial edhe pas çlirimit të Kosovës, përveç rrezikut serb, ndërkohë po përballlet me agresionin kulturor neootoman dhe pan arab.

Intenca për ta lidhur një pjesë të kombit me këtë ideologji agresive kulturore, për ta “rikoduar” gjenotipin shqiptar në një amalgamë “islame”, nënkupton objektivin gjeostrategjik për ta ndarë Shqipërinë dhe shqiptarët nga Perëndimi, që tashmë po hynë në një epokë të re ri konsolidimi, disi ngjashëm me epokën e Rilindjes.

Të qenit për kohë të gjatë të pushtuar ose në mëshirën e të tjerëve, është dëshmuar si pozicion tejet i rrezikshëm edhe për shtete me peshë si Gjermania, e mos të flasim për ne shqiptarët. Prandaj, shqiptarët, është krejtësisht në natyrën e gjërave, krahas gjermanëve e polakëve, së shpejti të përjetojnë një zgjim të theksuar nacional, pasojat pozitive të të cilit akt do t'i gëzojnë brezat që do të vijnë. Ky zgjim dhe rikthim tek vetvetja mund e do të bëhet duke u përballur sërish me projektin serb për të ashtuquajturën “Botë serbe” dhe mbi të gjitha duke punuar në përputhje me interesa aktuale. Ora e historisë po bie.

1. <https://deutschland-und-die-welt-2030.de/de/beitrag/strategiefaehigkeit-und-weltschmerz-die-deutsche-aussenpolitik-bis-2030/>
2. Shih për këtë R. Kjellén: Der Staat als Lebensform; 1917.
3. Krahaso edhe Ernst — Christoph Meier, Richard Roßmanith und Heinz-Uwe Schäfer: Wörterbuch zur Sicherheitspolitik; 2003; f. 144.
4. GPF [Geopoliticas Futurs], 19 korrik 2018
5. Rainer Mennel: Der Balkan — Eine Studie zur Geostrategie und Politischen Geographie eines alten Konfliktraumes; 1999; S. 11.
6. [https://www.bundesheer.at/pdf_pool/publikationen/09_vu1_01_gbf.pdf]
7. Shaban Murati, ISHGJ, maj 2022
8. Organizata e Kombeve të Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, “Rezoluta A/RES/64/298”, 9 shtator 2010. I qasshëm në, http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/64/298
9. <https://www.geopolitika.news/analize/m-stefanov-zbog-rata-u-ukrajini-eu-nece-postati-globalna-sila/>
10. <https://www.tagesspiegel.de/politik/steinmeiers-fehleranalyse-in-bellevue-in-putins-imperialem-wahn-habe-ich-mich-geirrt/28226810.html>
11. <https://www.geopoliticalmonitor.com/germanys-geopolitics-at-a-crossroads/>
12. Po aty
13. <https://www.eurasiareview.com/30072022-poland-europes-newest-military-superpower-analysis/>
14. <https://noahpinion.substack.com/p/the-end-of-the-system-of-the-world>
15. <https://www.ipg-journal.de/interviews/artikel/chinas-neue-aea-6270/>
16. <https://noahpinion.substack.com/p/the-end-of-the-system-of-the-world>
17. <https://noahpinion.substack.com/p/the-end-of-the-system-of-the-world>
18. <https://www.geopolitika.news/analize/m-stefanov-zbog-rata-u-ukrajini-eu-nece-postati-globalna-sila/>
19. <https://www.spiegel.de/international/europe/kremlin-threats-europe-has-to-learn-to-defend-itself-but-how-a-fb5bed7e-126c-47df-9dce-f677139cc2bf>
20. <https://www.geopoliticalmonitor.com/germanys-geopolitics-at-a-crossroads/>
21. <https://www.tagesspiegel.de/politik/kein-land-ist-so-erschuettert-worden-ischinger-raet-zur-neuaufstellung-der-deutschen-aussenpolitik/28556720.html>
22. Po aty

1.2 Akademik Ksenofon Krisafi

TË SHPËRNDARË NË 6 SHTETE TË GADISHULLIT BALLKANIK, SFIDAT POLITIKO-JURIDIKE TË BOTËS SHQIPTARE NË MILENIUMIN E RI

Në vitin 1897, Abdyl Frashëri, një ndër shtetarët dhe diplomatët më të mëdhenj të trojeve shqiptare, i shkruante kryeministrit italian, arbëreshit Francesco Crispi:

“Në rast se fuqitë e mëdha do ta dënojnë këtë popull trim dhe liridashës të mbetet në robëri dhe ca më keq të copëtohet midis shteteve fqinje, gadishulli Ballkanik nuk do të ketë kurrë qetësi, sepse shqiptarët nuk do të pushojnë asnjëherë së luftuari për të fituar pavarësinë e tyre kombëtare. Përkundrazi, në rast se shqiptarëve do t’u njihen të drejtat e tyre kombëtare, Shqipëria do të bëhet faktor i paqes dhe do të kthehet në një digë kundër ekspansionit carist, i cili rrezikon jo vetëm gadishullin Ballkanik, por edhe kontinentin Evropian”. Zhvillimet e deritanishme, përgjithësisht të karakterit toksik, e kanë provuar profecinë dhe aktualitetin e thënies së tij. Ballkani ka qenë dhe vazhdon të jetë “fuçi baroti”, paqja vazhdon të mbetet seriozisht e kërcënuar nga padrejtësitë e ricikluara kohë pas kohe dhe rreziku rus sërish i pranishëm si qëmoti. Një ndër këto padrejtësi lidhet me moszgjidhjen e duhur të të ardhmes politike të shqiptarëve, e cila, siç thotë profesori i madh, Rexhep Qosja, *“pjesërisht është përmirësuar, pjesërisht është zgjidhur, por nuk mund të quhet historikisht e zgjidhur. E shikuar e shprehur në gjithë shtrirjen e saj gjeografike dhe demografike me mënyrën e jetës së tyre në trojet ku shqiptarët janë popullatë e vetme a shumicë etnike, çështja kombëtare mbetet edhe më tej çështje e rëndë kombëtare, njëra nga më të rëndat në Evropë sot.”*

Ajo shtrohet në formën e pyetjes retorike se ç’do bëhet me shqiptarët, një popull që, duke qenë të shpërndarë në 6 shtete të gadishullit ballkanik, përbëjnë një nga rastet më të rralla në Europë e në botë?

Nga zgjidhja e saj me urtësi dhe sens objektiviteti do të varet jo vetëm e ardhmja e tyre, por edhe paqja dhe siguria në Ballkanin Perëndimor, zhvillimet dhe prosperiteti politik, ekonomik e social i popujve të tjerë në gadishull dhe në Evropë.

Në vijim do të flitet shkurt për aspektet juridiko-ndërkombëtare të alternativave të mundshme për zgjidhjen e saj.

Konservimi i *status quos* aktuale, do të nënkuptonte vazhdimin e politikave asimiluese ndaj shqiptarëve që nuk janë pjesë e Shqipërisë dhe Kosovës, do të inkurajonte për arbitraritete të tjera ata të cilët iu mohuan gjuhën, përkatësinë etnike, iu mbyllën shkollat, iu prishën kishat dhe xhamitë, iu ndërruan emrat, kombësinë, fenë, i dënuan me amnezi historike dhe kombëtare, çka nuk pajtohet me konceptet dhe sjelljet moderne të qytetërimit të sotëm.

Kjo çështje kombëtare, ende e pazgjidhur në formën e saj më të përshtatshme, pret ditë më të mira. Një ndër alternativat, e ndryshme nga ajo që u përmend më sipër, është organizimi i shqiptarëve në një shtet kombëtar, siç ka ndodhur me fqinjët rreth një shekull e gjysmë më parë.

Kjo është jashtëzakonisht e vështirë, në mos e pamundur, sepse mund të preken realitete, mund të cenohen tërësi territoriale shtetesh, mund të prishen ekuilibra gjeopolitikë që ekzistojnë prej rreth një shekulli dhe mund të hapen probleme të reja.

Prandaj, zgjidhja optimale, relativisht më pak e komplikuar dhe njëkohësisht më e mundshme nga pikëpamja gjeopolitike dhe juridiko-ndërkombëtare, do të ishte integrimi-bashkimi kombëtar Shqipëri-Kosovë, shoqëruar edhe me ndërhyrje të rëndësishme për përmirësimin e statusit të shqiptarëve që mbeten jashtë këtij unioni. Është rekomanduar si një ndërmarrje që mund të kontribuonte pozitivisht krijimi i një *commonwealth*-i ekonomik ballkanik madje edhe shqiptar, por me sa duket jo i mirëpritur.

Kështu që diskutimet fokusohen te bashkimi Shqipëri-Kosovë, i përkufizuar butë si integrimi ose edhe vëllazërimi ndërshqiptar. Ai mund të shfaqet në dy variante. *I pari*, i ashtuquajtur "bashkim në Bruksel", mendohet se do të realizohet kur Shqipëria dhe Kosova dhe bashkë me to edhe Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ku jetojnë disa dhjetëra mijëra shqiptarë, të anëtarësohen në BE.

Aty shqiptarët do të kenë mundësi të gjithë ta konsiderojnë vetveten qytetarë të Evropës së Bashkuar, rrjedhimisht edhe pjesë e një Shqipërie të Bashkuar. Do të kenë mundësi që, si shtetas evropianë, të qarkullojnë, të vendosen, të jetojnë, punësohen, shkollohen, mjekohen etj. kudo, pra edhe në të gjitha territoret shqiptare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Serbi, Mal të Zi, Greqi etj.

Ky bashkim do të ishte më i thjeshti dhe pa kosto. Por nga disa qarqe shqiptare ai nuk konsiderohet si bashkimi i mirëfilltë, si realizimi i plotë i përfytyrimeve dhe dëshirës që kanë shqiptarët për të ardhmen e tyre politike. Dozat e mosbesimit shtohen sidomos nga qëndrimet e vazhdueshme kërcënuese të Beogradit, të përqendruara sistematikisht në veri të Kosovës, ku ndonjëherë marrin trajta të qarta agresive, që rrezikojnë jo vetëm shqiptarët, por edhe paqen dhe sigurinë në rajon.

Dëshirën e shqiptarëve për krijimin e një atmosfere besimi me serbët e komprometojnë keqas sidomos përqendrimet e forcave ushtarake përreth Kosovës, si dhe rritja e konsiderueshme e dispozitivit luftarak nga Serbia, nëpërmjet blerjeve të armëve moderne në Rusi dhe vende të tjera dhe stacionimi i tyre në kufij me të.

Ato shtojnë pikëpyetjet te shqiptarët për efikasitetin e integritimit ndërshqiptar në formën e lartpërmendur të anëtarësimit në strukturat e Brukselit të shteteve, në territoret e të cilëve banojnë shqiptarë. Në këto rrethana ata preferojnë një bashkim më të ngushtë, mundësisht ndërshqiptar, i cili shoqërohet me shumë vështirësi. Më së paku, për zbatimin e tij, duhen përballuar ky kushte, të lidhur dhe të kushtëzuar me njëri tjetrin.

I pari, ka të bëjë me përgatitjen e një mjedisi të përshtatshëm dhe të pranueshëm politik, i cili nuk varet vetëm nga faktori lokal, por domosdoshmërisht edhe nga pëlqimi, madje nga konsensusi i ndërkombëtarëve. Zhvillime të tilla shoqërohen me repkursione të thella politike, ekonomike, sociale etj. rajonale, çka, veç pëlqimit të fqinjëve, kërkon

detyrimisht edhe marrëveshjen me Fuqitë e Mëdha, sepse ato vazhdojnë të shfaqen në rolin e arbitrit suprem duke mbajtur ekskluzivitetin e prerogativave të përcaktimit të zgjidhjeve të një rëndësie kaq madhore.

Për identifikimin e zgjidhjes së pranueshme mund të mbahen parasysh disa nga përvojat pozitive ndërkombëtare, si ato të bashkimit të Vietnamit, Jemenit dhe sidomos precedenti gjerman, që duket si më i përshtatshmi. Për të janë shprehur rezerva me justifikimin se nuk ka ngjashmëri me rastin shqiptar, çka, sipas meje, nuk qëndron. Prej tij mësohet se duhen ndjekur paralel aspekti politiko-diplomatik dhe ai juridiko-ndërkombëtar.

Joshja e faktorit nërkombëtar drejt zgjidhjeve të qëndrueshme lypset sepse nuk përjashtohet që fuqi të interesuara, të përdorin ndikimin e vet për ruajtjen e *status quos* në arkitekturën politike në Ballkanin Perëndimor ose të pranojnë vetëm ndryshime në dobi të tyre.

Nëse do të arrihet që kushti politik, të realizohet me sukses duhet përballuar i dyti, gjetja e argumenteve me karakter juridiko-ndërkombëtar, mbi të cilat duhet të mbështetet kërkesa e shqiptarëve për afrim, integrim ose bashkim kombëtar. Doemos do të operohet nëpërmjet normave të së drejtës ndërkombëtare, e cila, ndryshe nga degët e tjera të së drejtës, është një *soft law*, efikasiteti i së cilës mbetet relativ, që do të thotë se shërbimi eventual i ofruar prej saj, të mos pranohet nga të gjitha palët.

Sidoqoftë, duke i parë me optimizëm zhvillimet e kësaj çështjeje, bashkimin kombëtar të shqiptarëve, mundësitë, format dhe emërtimet etj, e drejta ndërkombëtare i trajton në kuadrin e bashkimeve juridike, ndër të cilat më kryesoret janë bashkimi në formën e shtetit unitar, federal, unionit real, personal, konfederatës etj.

Natyrisht varianti më i favorshëm, do të ishte bashkimi i Kosovës dhe Shqipërisë në formën e shtetit unitar ose shtetit federativ. Por ato, në rrethanat aktuale, duken mjaft të vështira. Prandaj, zgjidhja e çështjes kombëtare të shqiptarëve, një hap të parë jo pa rëndësi, mund ta gjente në formën e konfederatës shqiptare, nëse nga faktori ndërkombëtar nuk do pranohet alternativë tjetër, më e favorshme.

Ajo do të ishte më e mundshme, më pak “komprometuese” sepse konfederata nuk është shtet i bashkuar, por bashkim politik shtetesh, aleancë ndërkombëtare, e krijuar nëpërmjet një traktati ndërkombëtar midis shteteve sovrane, për arritjen e një qëllimi të caktuar në fushën e politikës së mbrojtjes, asaj të jashtme, zhvillimit ekonomik etj. Konfederata është bashkim i përciptë, i paqëndrueshëm, i ndërmjetëm, që çon ose drejt shthurjes ose drejt një bashkimi më të ngushtë, federatës ose shtetit unitar.

Është formë tipike e shekujve të mëparshëm, por ka pasur të tilla edhe më vonë. Në vitet 1981-1982 u krijua bashkimi konfederativ i Senegalit dhe Gambias, me emrin Senegambia.

Anëtarët e konfederatës mbeten subjekte të së drejtës ndërkombëtare, që do të thotë se Shqipëria dhe Kosova, por nuk përjashtohen as Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, nëse themelojnë konfederatën shqiptare, nuk do të shkrihen në një shtet.

Konfederata mund të shërbejë për lehtësimin juridiko-institucional të intensifikimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve duke iu dhënë atyre edhe mundësinë që të krijojnë bindje të qëndrueshme nëse e duan bashkimin Shqipëri-Kosovë apo preferojnë të vijojnë rrugëtimin politik si dy shtete më vete. Ai mund të shërbejë gjithashtu për të bindur ndërkombëtarët për ta pranuar, kushtëzuar ose për ta penguar dëshirën e tyre për bashkim, siç vepruan 110 vjet më parë.

Avancimi i mëtejshëm në procesin e bashkimit Shqipëri-Kosovë si federatë, doemos në varësi të rrethanave, mund të ngjallte kundërshtimin e fqinjëve, ndoshta edhe të disa Fuqive të Mëdha. Nga pikëpamja formalo-juridike ato mund të vepronin duke mos akorduar njohjen ndërkombëtare.

Shqiptarët janë të detyruar të shpresojnë se faktori ndërkombëtar do të ndërgjegjësohet për domosdoshmërinë e bashkimit kombëtar Shqipëri-Kosovë në një formë të pranueshme për të gjithë faktorët e interesuar. Ata duhet gjithashtu të tregojnë mirëkuptimin e duhur, veçanërisht për qëndrimin e ndërkombëtarëve, të cilët i kanë dhënë provat e vlerësimit pozitiv të shqiptarëve, nëpërmjet kontributit vendimtar në çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Shqiptarët gjithashtu duhet të ndërgjegjësohen se nuk janë kërthiza e botës, dhe duhet të bëjnë kujdes që të mos këmbëngulin për adoptimin e zgjidhjeve që iu interesojnë vetëm atyre.

Duhet t'i akomodojnë interesat e veta brenda realiteteve gjeostrategjike të krijuara, të ngurtësuara dhe të certifikuara prej kohësh. Shqipëria nuk i ka as fuqitë, as mundësitë, as kapacitetet, (pavarësisht se ka aleatë strategjikë të mëdhenj si SHBA dhe disa vende të fuqishme të BE-së që janë të bindur në drejtësinë e kauzës shqiptare) prandaj hë për hë këto kërkesa tonat mund të mos pranohen sepse mund të konsiderohen si projekte që prishin ekuilibra dhe të përmbysin raporte forcash gjeopolitike.

Nuk duhet harruar gjithashtu fakti që kur ëndrrat dhe aspiratat e saj të ligjshme mund të mbroheshin dhe të realizoheshin, ajo nuk mundi, sepse ndoshta ishte pa aleatë, e rrethuar nga armiq të egër, ose edhe e pafuqishme. Dhe, megjithëse u përpoq, luftoi dhe derdhi gjak për mbrojtjen e trojeve të veta, ato ia morën, vendin e copëtuan, e përgjysmuan. Është fakt se ajo u çlirua e fundit nga zgjedha osmane. Dhe me keqardhje duhet pohuar se kur shqiptarët fituan pavarësinë, e para gjë që bënë disa prej tyre, ishte kacafytja se kush do të qeveriste.

Pas krijimit të qeverisë së Vlorës nga Kuvendi Kombëtar, të tjerë shqiptarë, krijuan edhe 5 të tjera, duke parcelizuar domenet e tyre. Një prej tyre ishte

Esat Pasha, të cilit Ismail Qemali i besoi portofolin e ministrit të brendshëm në qeverinë e Vlorës. Disa muaj më pas, nën pretekstin e një inspektimi në rajonet e Shqipërisë së Mesme, ai u largua nga Vlora drejt Durrësit, ku më 12 tetor 1913, shpalli krijimin e Pleqësisë së Durrësit.

Siç u tha, qëndrime të tilla nuk mund të jenë pa kosto për paqen dhe sigurinë aktuale rajonale e më gjerë, prandaj lypset realizëm, mirëkuptim dhe prurësi e madhe për opsionet që do të përzgjidhen.

Afrimi ose bashkimi i Shqipërisë me Kosovën, do të ndikonte në radhë të parë në të ardhmen politike, ekonomike, sociale etj të shqiptarëve të të dy vendeve. Por, ai do të krijonte situata të favorshme që edhe çështja e statusit të popullsisë shqiptare shtet formuese në Maqedoninë e Veriut, ose pakicave shqiptare në Kosovën Lindore (Lugina e Preshevës), Malin e Zi etj., të trajtohet më mirë, në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Nën mbrojtjen e dy shteteve shqiptarë, të cilët, të bashkuar në një formë të caktuar juridiko-ndërkombëtare, do të shfaqen me një zë më autoritar, ata do të kenë mundësi të deklarojnë lirshëm se ndjehen shqiptarë, se duan të kenë institucionet e veta politike, shkollore, kulturore, fetare, duan të flasin dhe të mësojnë gjuhën amtare.

Zgjidhjet bashkëkohore për ta dhe për rajonin vijnë vetëm nga forcimi i bashkëpunimit midis shteteve të tij, respektimi rigoroz i normave dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare. Mbështetja te Rusia, siç thoshte Abdyl Frashëri, është rrezik i përhershëm i lirisë dhe pavarësisë së shqiptarëve, ballkanasve në përgjithësi dhe i Evropës. Dëshmi janë zhvillimet tragjike të vitit 2022 në Ukrainë dhe situatat potencialisht eksplozive në veriun e Kosovës.

Vihet re se qarqe të ndryshme politike në disa nga shtetet fqinjë, i intimidojnë shqiptarët, i akuzojnë se bashkimin e duan për të krijuar Shqipërinë e Madhe, gogolin e krijuar dhe të hedhur në qarkullim prej tyre, me qëllimin djallëzor të frikësimit të faktorit ndërkombëtar. Duket se nisur nga shëmbëlltyrat e projektuara në shtetet e tyre, mendojnë se shqiptarët kërkojnë Shqipërinë e Madhe që të hakmerren ndaj fqinjëve mëkatarë dhe të krijojnë probleme për ta dhe paqen ballkanike.

Ndërkohë disa nga Fuqitë e Mëdha, teksa iu tërheqin pa të drejtë vëmendjen shqiptarëve, heshtin për shkaktarët e vërtetë, serbët dhe të tjerët, për të mos thënë që ndonjëherë edhe i llastojnë.

Shqiptarët dhe sidomos ata që janë në krye të tyre, nuk kanë arsye që të ngurojnë për ta shprehur haptas dëshirën për integrimin – vëllazërimin Shqipëri-Kosovë, si një ndër të drejtat e veta natyrore më sublime. Përveçse realizim i pjesshëm i një aspirate legjitime, ai nuk drejtohet kundër fqinjëve. Nuk synohet që t’iu prishen atyre shtetet e veta. Shqiptarët duan vetëm të restaurojnë, për aq sa është e mundur, brenda logjikës dhe arsyes, normave dhe parimeve themelore të së drejtës aktuale ndërkombëtare, drejtësinë e dhunuar

një shekull e ca më parë, të integrojnë dy hapësirat territoriale të banuara gati 100 % nga popullsi autoktone kompakte shqiptare, që shtrihen në vazhdim të njëra tjetrës.

Nëse realisht e dëshirojnë atë, ka ardhur koha që të përgatisin dhe të miratojnë zyrtarisht platformën strategjike të të ardhmes së vet politike, natyrisht jo si shëmbëlltyrë të “Megali Idesë” ose të “Naçertanias”, sepse ato janë ngritur dhe bazohen në politika agresive e ekspansioniste kundër fqinjëve. Platforma e tyre duhet të përshkohet nga integrimi ndërshqiptar, progresi ekonomik e social, garantimi i paqes dhe sigurisë rajonale, fqinjësia e mirë, bashkëpunimi me fqinjët dhe shtetet e tjerë etj.

Përgatitja e saj iu duhet besuar politikanëve me integritet, të përkushtuar ndaj interesave kombëtare shqiptare, që vlerësojnë dhe ushqejnë respekt ndaj fqinjëve. Ata duhet të njohin shumë mirë historinë, realitetet aktuale, të shohin me largpamësi të ardhmen, të kenë dëshmuar mençuri, përgjegjshmëri, realizëm dhe mirëkuptim për bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar. Së bashku me ta duhen angazhuar edhe studiuesit, akademikët, specialistët më të spikatur në këtë fushë, nga Shqipëria, Kosova, territoret shqiptare përreth dhe në diasporë, që të identifikojnë dhe të argumentojnë në çdo aspekt alternativat më të përshtatshme të zgjidhjes së çështjes shqiptare.

Ajo nuk iu duhet lënë improvizimeve të imponuara nga entuziazmi folklorik, romantizmi nacionalist ose nga reagimet emocionale që mund të shkaktohen nga zhvillime ekstreme në kufijtë e Kosovës me Serbinë.

Në këtë mënyrë do të jetë më i lehtë adoptimi nga organet kompetente të shteteve shqiptare, fqinjëve dhe Fuqive të Mëdha, i një zgjidhjeje të drejtë të një çështjeje që ekziston realisht.

Kështu do të kontribuohet më mirë për arritjen e qëllimit të shqiptarëve, afirmimin e tyre ndërkombëtar, anëtarësinë e Shqipërisë dhe Kosovës në BE, të Kosovës në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare etj. Do të kontribuohet edhe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë.

Duke folur për këtë çështje është e domosdoshme të mos harrohet se prej rreth dy shekujsh, historia ka dëshmuar që shqiptarët janë trajtuar si kurbani i paqes dhe i stabilitetit rajonal e kontinental. Kështu veproi 110 vjet më parë Konferenca e Ambasadorëve e Londrës. Më 12 gusht 1913, të nesërmen e përfundimit të punimeve të saj, Eduard Grei që e kryesonte, deklaroi se “unë e di fare mirë se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të japë shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga një pikëpamje e ngushtë lokale.

Duhet të mos harrohet se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, *qëllimi kryesor ka qenë që të ruhej marrëveshja midis vetë Fuqive të Mëdha* (korsivi i autorit) dhe, në qoftë se vendimi mbi Shqipërinë e ka siguruar këtë, atëherë ai e ka bërë punën më të rëndësishme *në dobi të paqes në Evropë.*”

Kjo frymë padrejtësie ka vazhduar dhe, për fat të keq, vazhdon të shfaqet sërish herë pas here. Shfaqet në kërkesat që iu bëhen shqiptarëve për lëshime ndaj “më të fortëve” të gadishullit në emër të paqes dhe të sigurisë. Mendoj se qëndrimi skajshmërisht i përvulur ndaj thirrjeve të tilla, që mund të marrë trajtat e sakrifikimit të interesave dhe dinjitetit kombëtar, duhet të marrë fund.

Ndërkombëtarëve që ua kërkojnë paqen vetëm shqiptarëve, iu duhet lënë të kuptojnë se paqja nuk iu nevojitet vetëm atyre, por të gjithëve, ju duhet edhe fqinjëve, të cilët, prej rreth një shekulli e gjysmë, e turbullojnë dhe e shkatërrojnë atë, duke provokuar dhe sulmuar të tjerët, në mënyrë të veçantë shqiptarët, të cilët nuk kanë sulmuar asnjëherë të tjerët, por vetëm janë mbrojtur me heroizëm dhe dinjitet, siç bënë edhe në luftën e fundit të Kosovës. Duke shpresuar dhe insistuar në mirëkuptimin e të interesuarve, duhet të thuhet pa asnjë ndjenjë kompleksiteti se janë pikërisht fqinjët ata që kanë detyrime ndaj paqes ballkanike. Nuk iu lejohet që me pretekste të rëndomta të simulojnë, të intimidojnë, të kërcënojnë dhe të trazojnë Ballkanin. Atyre iu duhet kërkuar që të kenë kurajën e duhur dhe të përballojnë, për aq sa iu takon, kostot e të ashtuquajturës paqe, për të cilën flasin ndonjëherë pa u menduar shumë edhe disa nga funksionarët e Brukselit a të Nju Jorkut.

E para gjithë që ata duhet të bëjnë është t'i lënë të qetë shqiptarët. Nuk ka pse në emër të një paqeje fiktive të ndalohen shqiptarët të kenë shtetin e vet kombëtar, në formën më të përshtatshme të mundshme, në një kohë kur të tjerët, i kanë krijuar shtetet “e veta” madje “të mëdhenj”, madje edhe në shkelje të parimeve dhe normave themelore të së drejtës ndërkombëtare, duke aneksuar trojet e shqiptarëve.

Nuk ka arsye që ata të përmbushin kërkesat tekanjoze të prindërve dhe të pranojnë të cedojnë nga territori, sovraniteti, paqa dhe siguria e tyre kombëtare.

Nuk mund të mos vihet në dukje me kënaqësi se paralel me diskutimet teorike, politike, diplomatike e juridike rreth bashkimit Shqipëri-Kosovë, prej afro 15 vjetësh ekziston dhe zhvillohet dita-ditës një realitet tjetër, i pamohueshëm inkurajues edhe pse i pa certifikuar zyrtarisht. Ai është bashkimi *de facto* i një lloji të veçantë i Kosovës me Shqipërinë. Shprehet në faktin që kufiri i tyre sikurse edhe shumë barrierat e tjera që ndajnë shtetet, janë hequr ose janë duke u hequr. Janë ndërmarrë hapa sistematikë, të konkretizuara në mbledhjet e përbashkëta të të dy qeverive.

Madje këto ditë me rastin e kremtimit të përvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, pati një tjetër episod domethënës. Të dielën e 27 dhjetorit 2022, deputetet e të dy shteteve shqiptarë, Shqipërisë dhe Kosovës, zunë vend në sallën e Kuvendit të Shqipërisë, ku u zhvillua një seancë emocionuese, e pa ndodhur ndonjëherë më parë.

Ajo çka u pa në ekranet e televizioneve që e transmetuan, e çon kujtesën e cilitdo, 110 vjet më parë, në Kuvendin e Vlorës, të thirrur nga Ismail Qemali.

Edhe atëhere, në pasditen e 28 nëntorit 1912, në shtëpinë e kushërirut të tij, u mbledhën 37 vetë, të cilët në ditët në vazhdim u bënë 63. Ishin drejtues ose veprimtarë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që vinin nga të gjitha viset shqiptare, veçanërisht nga Kosova, Maqedonia, Çamëria etj.

Nuk mbërritën dot Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Idriz Seferi, Sait Hoxha etj., të burgosur në Beograd, si edhe Bajram Curri, që u pengua nga luftimet gjatë rrugës. Pjesëmarrja në Kuvend e delegatëve nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, të mandatuar në përshtatje edhe me rrethanat e kohës, si përfaqësues të të gjithë popullit shqiptar, duke përfshirë edhe rajonet “që ndodheshin të pushtuara nga ushtritë serbe, malazeze e greke, i dha atij karakterin e një asambleje kombëtare mbarë shqiptare. Kjo ishte njëherazi shprehje e vendosmërisë së të gjithë shqiptarëve për t’u bashkuar në shtetin e vet kombëtar, në të cilin do të përfshiheshin të gjitha viset shqiptare.”

Përngjasimet kanë të bëjnë vetëm me simbolikën dhe jo me thelbin e ngjarjeve. Sepse në 1912 përfaqësuesit e të gjithë shqiptarëve u mbledhën në Vlorë për ta bërë shtet gjithë Shqipërinë. Me shumë dhimbje dhe një peng të madh shpirtëror, e bënë vetëm në letër dhe në zemrën e tyre. Sepse diplomacia e Fuqive të Mëdha dhe fqinjët e penguan realizimin e projektit të tyre.

Mbledhja e përbashkët e dy kuvendeve shqiptare, në Tiranë, në nëntorin e 2022, mund të interpretohet edhe si tregues që ëndrra shekullore e shqiptarëve për bashkimin institucional të politikës në Shqipëri dhe në Kosovë, bëri një tjetër hap shumë të rëndësishëm. Për herë të parë deputetët e parlamentit të Kosovës dhe ata të Shqipërisë, të ulur së bashku në sallën e kuvendit në Tiranë, iu përcollën kancelarive vendimmarrëse botërore mesazhin e bashkimit jo thjesht në mënyrë simbolike. Transmetuan dëshirën e shqiptarëve për të menduar dhe për të gjetur zgjidhjen e duhur për çështjen shqiptare, ende të pazgjidhur.

Përvoja e tetë mbledhjeve të përbashkëta të qeverive u çua më përpara. Edhe pse arritjet nuk janë ato që do të dëshirohej, përsëri ka rezultate premtuese. Mund të përmenden abetarja e përbashkët, puna për fjalorin enciklopedik, unifikimi i tregjeve të punës, angazhimet për unifikimin doganor dhe një sërë projektesh të tjera të rëndësishme.

Shqipëria dhe Kosova janë dy shtete sovraane, por askush nuk mund ta mohojë se në hapësirat e tyre territoriale jeton një komb, një popull, që flet një gjuhë, që ka një kulturë, një histori, një qëllim, një aspiratë, një të ardhme dhe një orientim strategjik afatgjatë euro-atlantik. Aty mbizotëron ndjesia e përkatësisë së përbashkët etnike, shpirtërore, zakonore.

Pjesë të këtij kombi që ndodhen në Maqedoninë e Veriut dhe në Mal të Zi, po përjetojnë gjithashtu zhvillime pozitive, të cilat përfaqësojnë realitete të paimagjinueshme deri para disa vjetësh. Përveç Shqipërisë dhe Kosovës, të cilat drejtohen nga shqiptarët, edhe në dy shtete të tjerë në Ballkan në poste të larta drejtuese ka shqiptarë.

Në Mal të Zi është kryeministri Dritan Abazoviç, në Maqedoninë e Veriut shqiptari Talat Xhaferri drejton parlamentin, shqiptari tjetër Artan Grubi është zëvendëskryeministri i parë. Prania e tyre në drejtimin e organeve qendrore nuk mund të mos ndikojë pozitivisht në statusin e shqiptarëve që banojnë në trojet e veta në këto shtete.

Një tjetër zhvillim domethënës është edhe ai që vërtetohet me shqiptarët që jetojnë jashtë trojeve të veta. Me prejardhje nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Çamëria etj, ata mbledhen herë pas here së bashku për të kremtuar ngjarje të rëndësishme të historisë kombëtare ose krishtlindjet dhe festa të tjera fetare. Të gjithë edhe pse mund të kenë dekada që e kanë lënë vendin për arsye të ndryshme, ruajnë dashurinë për atdheun, vazhdojnë të ndjehen shqiptarë, të orientuar fuqimisht nga shqiptaria, punojnë me aq sa munden për të kontribuar në të mirë çështjes shqiptare, duke i dhënë një mësim të madh dhe shumë të çmuar politikës dhe politikanëve shqiptarë këtu në Ballkan.

Strategjia e përbashkët e zhvillimit ndërshqiptar nuk i kundërvihet bashkësive të tjera në rajon dhe në Evropë. Përkundrazi, fryma emancipuese dhe qytetëruese që sjell në këto kohë politika shqiptare në rajon, nivelet e zhvillimit të shqiptarëve në rajon, i kontribuojnë qëndrueshmërisë së Ballkanit dhe të Evropës. Disa prej fqinjëve të ngarkuar me makthe për shkak të padrejtësive ndaj tyre, i shohin me frikë e dyshim, duke menduar se edhe shqiptarët për simetri udhëhiqen nga të njëjtat paudhësi.

Qëndrimet korrekte të të gjithë segmenteve të politikës shqiptare si nga Tirana, Prishtina, Tetova etj ndaj fqinjëve, të cilëve iu kanë ofruar garanci për bashkëpunim, janë shndërruar në modele që kanë kontribuar për emancipimin e ndërgjegjes së kontinentit, për demokratizimin e rajonit për krijimin e një klime paqeje dhe sigurie rajonale.

Në raport me të huajt, por edhe me vetveten, shqiptarët kanë arritur nivele që nuk i kanë pasur kurrë më parë. Rrugëtimi historik i integritit-bashkimit kombëtar të shqiptarëve, ka filluar dhe nuk mund të ndalet. Le t'i besojmë Naim Frashërit, i cili një shekull e ca më parë, thoshte gjithë shpresë se “për Shqipërinë ditët e mira paskëtaj vijnë”. [DITA/ISHGJ]

1.3 Dr Skender ASANI

KOMBI SHQIPTAR PARA NJË RIKONFIGURIMI TË RI GLOBAL

Procesi i shpopullimit të vendeve tona ka krijuar një hartë të re globale të dipërimit etnik, ku tani kemi shumë shqiptar të shpërndara në çdo cep të botës dhe ky paraqet një moment të ri për të gjithë ata individë, subjekte e institucione që në një farë mënyre merren me studimin dhe menaxhimin e botës shqiptare, në tërësinë e saj, por tani në një konteskt më të gjerë global.

Në kohën kur bota po globalizohet, shqiptarët si komb po përjetojnë brenda vetes disa procese të pafavorshme që mund të kërcënojnë të ardhmen e tyre. Parasë gjithash këto procese kanë të bëjnë me faktorët politik, ekonomik dhe demografik. Në vitet nëntëdhjeta, deri në fillimet e mileniumit të ri, ishim të mobilizuar si komb rreth pavarësisht të Kosovës, demokratizimit të Shqipërisë dhe luftës politike për barazi nacionale në Maqedoni dhe në viset tjera shqiptare. Dhe i gjithë ky mobilizim, falë edhe mbështetjes euro-atlantike, ua mundësoi shqiptarëve, që pas sakrificave shekullore, të fitojnë shtetin e dytë në Ballkan – Kosovën e pavarur, Shqipëria u anëtarësua në NATO, kurse në Maqedoni u arritën disa objektiva politike të shqiptarëve, sidomos pas luftës së 2001-shit, për një barazi nacionale që nuk e kishin pasur më parë.

Pikërisht kur të gjitha këto zhvillime pozitive ndodhën, u krijua në anën tjetër një situatë kontradiktore e cila prodhoi elita politike që nuk ishin të gatshme t'i përmbyllin proceset e tranzicionit.

Akomodimi i gjatë në pushtet krijoi parakushte për kalbëzimin nga brenda të sistemit i cili filloi të bëhet gjithnjë e më tepër imun ndaj korrupsionit, krimit të organizuar, nepotizmit dhe prishjes së baraspeshave sociale në mes të shtresave shoqërore. Për pasojë, shtresa e mesme u eliminua gati tërësisht, dhe u krijua një inxhinjering i dhunshëm social-ekonomik si rrjedhojë e shpërndarjes së resurseve financiare e materiale, jo sipas meritave dhe aftësive profesionale e menaxheriale, por sipas një akriballaku politik që ndryshe mund të quhet edhe oligarki.

Në fakt gjatë gjithë procesit të tranzicionit të stërzgatur në hapësirën shqiptare, nuk patëm trende normale transformuese politike, që për bazë do të kishin demokracinë, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, por patëm zëvendësimin e oligarkive politike-ekonomike, kalimin e tyre nga njëri tabor politik te tjetri dhe ngadalësimin frymarrjes së lirë shoqërore.

Në rrethana të tilla, në vend të elitave të mirëfillta politike, me bagazhe profesionale e intelektuale, u krijuan elita të korruptuara, lehtë të shantazhueshme dhe të gatshme për çfarëdo lloj koncesioni. Kjo pastaj u reflektua negativisht në disa aspekte të shtet ndërtimit dhe të zhvillimit, ku spikat prishja e klimës së biznesit dhe investimeve, funksionimi me shumë defekte i sistemit të drejtësisë dhe krijimi i monopoleve biznese përmes lidhjeve korruptive me pushtetin, ku ngelën të përjashtuar mijëra njerëz (edhe nga diaspora) të cilët refuzuan të japin ryshfete për të nisur biznese. E gjithë kjo ndodhi para syve tanë, para pafuqisë sonë për të parandaluar këtë degradim, ndërkohë që vendet tona iu ekspozuan një kërcënimi shumë sfidues, siç është shpopullimi dhe shpërndarja e njerëzve tanë nëpër botë. Sipas një hulumtimi të realizuar tash së fundi, rezultoi që 30 për qind e shqiptarëve të lindur në Shqipëri jetojnë në emigracion. Shifra është publikuar nga revista Forbes, që ka renditur vendet me numrin më të madh të diasporës në raport me popullsinë totale të vendit. Forbes ka analizuar vendet me popullsi mbi 750 mijë banorë. Në këtë listë, Shqipëria renditet e treta, me 30.7 për qind të popullsisë së lindur brenda kufijve, që aktualisht jetojnë jashtë. Me rreth 1.2

milionë emigrantë, Shqipëria lë pas në këtë renditje vende si Siria, Moldavia, Armenia dhe Xhamajka.

Nga rajoni vetëm Bosnja është me diasporë më të madhe se Shqipëria, me 34 për qind të popullsisë së saj, ndërkohë që Ballkanit tashmë karakterizohen nga një përbërje e moshave të pafavorshme dhe popullsi në plakje. Numri mesatar i të rinjve deri në 14 vjeç në vendet e Ballkanit është rreth 16 për qind, ndërsa numri mesatar i popullsisë mbi 60 vjeç është gati 25 për qind.

Përrjashtim nga këto trende bën Kosova, e cila ka 7 për qind më shumë të rinj, kryesisht falë faktit që është shteti që ka një prej niveleve më të larta të lindjeve në Ballkan dhe Evropë dhe një norme relativisht të lartë të ndryshimeve pozitive natyrore, edhe pse edhe në këtë shtet ky faktor ka pasur rënie në vitet e fundit. Projektionet e OKB-së për strukturën e moshës në vitin 2050, konfirmojnë vazhdimin e tendencave të përmendura dhe rritjen e intensitetit të plakjes në vendet e Ballkanit.

OKB parashikon se shpopullimi i plotë (ulja e numrit të banorëve) ka qenë tipar dominues i kësaj zone për disa dekada, dhe sipas variantit të mesëm të vlerësimit të Kombeve të Bashkuara, shtetet ballkanike të krijuara nga shpërbërja e Jugosllavisë presin një humbje prej 2.8 miliona persona nga mesi i shekullit, ndërsa zona e gjerë e Ballkanit do të përballet me një rënie të popullsisë prej 8.2 milionë në vetëm 30 vjet.

Kur popullsitë e vogla si ato kryesisht në Ballkan, arrijnë një nivel të dukshëm shpopullimi, duhet pritur që të gjitha proceset e mëpasshme të jenë më të shpejta, që reflektojnë negativisht në zhvillimin hapësinor të mjediseve rajonale dhe lokale në kontekstin e zhdukjes së vendbanimeve më të vogla dhe zbrazjes së hapësirës, reduktimit të potencialit të pjellorisë (biologjik) dhe ekonomik (punës), plakja e kontingjenteve të pjesshme etj., gjë që redukton ndjeshëm perspektivat për rimëkëmbjen demografike nga popullsia rezidente.

Rënia e numrit, plakja dhe mungesa e fuqisë punëtore janë vetëm një nga sfidat bashkëkohore demografike me të cilat përballet të gjitha vendet evropiane pavarësisht nga niveli i zhvillimit të tyre.

Vazhdimësia e këtyre proceseve dhe indiferenca politike reduktojnë ndjeshëm shanset e mbijetesës demografike të kësaj zone dhe kjo vlen për çdo vend ballkanik pavarësisht nga perceptimi gjeografik e politik. Në këtë kontekst turbulencash demografike, hapësira shqiptare në Ballkan jo vetëm që nuk mund të jetë immune ndaj pasojave që jell shpopullimi, por ajo do të përballet me probleme të tjera, ndoshta edhe më të rënda, nëse bota shqiptare nuk arrin të konfigurohet ndryshe nga ajo që është tani. Sepse, siç po e shohim Kosova nuk po mundet dhe e ka shumë vështirë ta përmyllë procesin e shtet formimit, shqiptarët në Maqedoni nuk po arrijnë të kategorizojnë se cilat janë kërkesat e tyre minimale dhe cilat maksimale, kurse Shqipëria ka probleme me të kaluarën nga e cila nuk po mund të shkëputet. Atje nuk po përfundon tranzicioni, përplasja shoqërore vazhdon të prodhojë jo stabilitet politik dhe kjo po ndikon që të ngulfatet perspektiva e Shqipërisë.

Procesi i shpopullimit të vendeve tona ka krijuar një hartë të re globale të diperzimit etnik, ku tani kemi shumë e shumë shqiptar të shpërndar në çdo cep të botës dhe ky paraqet një moment të ri për të gjithë ata individë, subjekte e intitucione që në një farë mënyre merren me studimin dhe menaxhimin e botës shqiptare, në tërësinë e saj, por tani në një kontekst më të gjerë global.

Konsideroj se edhe kjo Konferencë shkencore që po mbahet sot, do të duhej t'i ketë parasysh disa fakte që e bëjnë botën shqiptare sot të ndodhet në një udhëkryq, kuptohet, nëse nuk ndërmerren disa veprime për ta orientuar atë drejt, siç kanë bërë para nesh kombet tjera. Parasegjithash duhet të vendoset një lidhje shumë aktive dhe përmbajtjesore në mes të mes të shqiptarëve dhe vendlindjeve të tyre. Ky është parakushti i parë i formatimit të botës shqiptare sipas një planimetrie të re globale, ku njerëzit tanë nuk do t'i përjetonin pasojat e asimilimit dhe të shkëputjeve të lidhjeve në mes veti.

Prandaj nevojitet krijimi i një plani që do ta bënte lidhjen e botës shqiptare me vendlindjen përmes projekteve të caktuara kulturore, arsimore, ekonomike e teknologjike. Departamenti i Mërgatës që është në themelim e sipër në ITSHKSH është një shembull i institucionalizimit të kësaj lidhjeje, sepse pa një institucionalizim të mirëfilltë të interaksionit tonë si komb e kemi vështirë të përballemi me sfidat që sjell globalizmi dhe deatomizimi i familjeve tona.

T'kurrja e popullsisë si pasojë e migrimeve, dobëson fuqinë demografike, politike e ekonomike në vendlindje, por në anën tjetër hap edhe disa dritare prej nga mund të depërtojnë rrezet e shpresës.

Prandaj duhet rishikuar mundësitë dhe shanset që kemi si botë shqiptare, duke zhvilluar një këmbim të brendshëm të përvojave, dijeve, vlerave e resurseve ekzistuese. Me fjalë të tjera, duhet të hulumtojmë hartën e nevojave tona si komb, duke plotësuar ato boshllëqe që mund të bëhen pengesë e zhvillimit tonë si komb. Kështu, bie fjala, vendlindja ka nevojë për zhvillim ekonomik dhe për dispilinë të re menaxhuese, aspekte këto që i ka mërgata jonë, ndërkohë që mërgata ka nevojë për ruajtjen e identitetit kombëtar, aspekte këto që i posedon vendlindja, por që duhet të bëhen pjesë e një plani bashkëpunimi afatgjatë, ku secili pjesëtar i botës shqiptare nuk do ta ndiente mungesën e një prej faktorëve që ndikon më së shumti në stagnimin e tyre.

Por që të ndodhë kjo, bota shqiptare duhet të huazojë disa prej modeleve më të avancuara të kombeve të tjera, të cilat mund të sjellin një qasje pozitive ndaj problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Lidhja e fëmijëve të mërgatë me vendlindjen, mund të jetë ky projekti më madhor i botës shqiptare, që për model mund të merret projekti izralit ku fëmijët nga diaspora dërgohen në vendlindje dhe qëndrojnë atje 2 – 3 javë. Në anën tjetër mos organizimi ose organizimi stihik në mërgatë, ku dimensionin fetar dominon mbi atë arsimor e kulturor, mund të sjell zbehje të identitetit kombëtar të gjeneratave të reja, që mund të jetë edhe si pasojë e humbjes së linkut me vendlindjen. Shtetet në të cilat jetojnë njerëzit tanë në mërgatë, kanë sistemet e tyre politike, arsimore e ekonomike dhe nuk mund të bëjmë asgjë që këto sisteme të ndryshojnë, por e

pakta që mund të bëjmë është që ne si botë shqiptare të krijojmë një sistem të brendshëm organizimi i cili do të funksiononte mbi parimet “çka të mungon ty – ta jap unë” dhe “çka më mungon mua – ma jep ti”.

Nëse një kuadër i shkolluar në Perëndim ka treguar rezultatet të kënaqshme në kompaninë apo institucionin ku ai punon dhe të tillë ka pot në Zvicër, Gjermani, Austri, Francë, Itali, Skandinavi, Amerikë, Kanada etj. atëherë prej kuadrove të tilla duhet të marrin mësim shkollat dhe universitetet tona në vendlindje, duke krijuar kështu shprehi të reja për punë dhe mendësi të reja për t’iu qasur problemeve.

Marrja e përvojave të reja nga mërgata dhe transferimi i tyre në vendlindje, do ta bënte botën shqiptare më rezistuese ndaj tendencave negative që po shfaqen si pasojë e ikjes së trurit nga vendlindja.

Ushqimi i institucioneve të trashëgimisë shpirtërore me materiale nga terreni, ku edhe mërgata duhet të ofrojë të dhënat e veta, e avancojnë botën shqiptare në nivelet e një horizonti ku mund të duken të gjitha vlerat që i posedojmë si komb, por edhe vlerat e kombeve të tjera me të cilët ne bashkëpunojmë.

Në anën tjetër, vendlindja nuk duhet t’i shërbejë mërgatës vetëm si hapësirë ku mund të bëhen dasmat, por edhe si mundësi investimi e zhvillimi. Por që të arrihet kjo, shtetet tona duhet të forcojnë sundimin e ligjit dhe garantimin e investimeve. Siguria ligjore, konkurrenca e lirë pa pasur nevojë për lidhje korruptive me politikën si dhe dhënia përparësi e kuadrove të shkolluar nga diaspora – janë elemente kyç të zhvillimit dhe përparimit të botës shqiptare, duke mos harruar edhe nevojën që ka diaspora për librin shqip, për përrallat dhe këngët shqipe, për programe kulturore-edukative dhe për një lidhje shpirtërore në mes të fëmijëve tanë që nesër mund të jenë motor të zhvillimit tonë si komb.

Shkup, nëntor 2022 (Kumtesë e paraqitur në Konferencën shkencore të Lidhjes Shqiptare në Botë –

“Sfidat e botës shqiptare në mileniumin e ri”)

1.4 Akademik Albert Doja

TJETËRSIM STRATEGJIK

Shtypi i ditës, rrjetet sociale dhe blogjet e ndryshme shpesh diskutojnë mbi gjendjen e studimeve shqiptare dhe vendin e studiuesve shqiptarë në raport dhe në marrëdhënie me botën akademike dhe shkencore ndërkombëtare. Çështja është komplekse dhe kjo më shtyu të përgatis këtë shkrim mbi tjetërsimin strategjik të historisë shqiptare në shkrimet e një historiane franceze, që është pjesë e një studimi më të gjere, të botuar kohët e fundit në anglisht,[1] mbi shkollën e re të studimeve të huaja mbi historinë, gjuhën, kulturën dhe shoqërinë shqiptare. Këtë shkrim, të përkthyer posaçërisht në shqip, ia paraqita për botim fillimisht revistës Studime Historike të Institutit të Historisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike.[2] Pavarësisht nga trumbetimi i lirisë së shprehjes së mendimeve kritike, shkrimi u refuzua me sa duket për shkak se notat e forta të argumentimeve kritike nuk përshtaten me natyrën e revistës Studime Historike, ose ndoshta historianët që kontrollojnë revistën në Tiranë u trembën se mos ky shkrim u prishte punë me studiuesit e huaj. Për fat të keq, nëse është kështu, kjo tregon kompleksin e inferioritetit intelektual që kemi si popull e si studiues ndaj çdo të huaji që vjen të na japë mend si studiues apo si ekspert.

Problemet me historianët e studiuesit tanë dhe në përgjithësi me studimet shqiptare janë shumë serioze dhe me to duhet të merremi seriozisht, por nuk duhen ngatërruar studiuesit dhe studimet shqiptare me disa tipa që zaptojnë mediat dhe ekranet televizive, as me disa mbeturina që do vazhdojnë edhe për pak kohë të mbajnë ofiqet dhe privilegjet politiko-shkencore të trashëguara nga regjimi i kaluar. Një problem shumë më i rëndësishëm është mënyra sesi disa studiues të huaj trajtojnë studimet dhe studiuesit shqiptarë, çka tregon jo vetëm kompleksin e superioritetit, arrogancën patronizuese dhe papjekurinë shkencore dhe profesionale, por edhe pikësynime të nënkuptuara për të mbajtur nën kontroll studiuesit dhe studimet shqiptare.

Shumë qasje kritike kanë vënë në dukje “Ballkanin imagjinar”,[3] ose “tranzicionin e munguar”,[4] si dhe qasje të tjera kritike ndaj paragjyqimeve ideologjike në studimet shqiptare,[5] duke përfshirë edhe përfytyrimet ndërkombëtare të Evropës Juglindore,[6] apo mytho-logjikat e tjetërsimit dhe të kontrollit.[7] Argumenti kryesor kërkon të tregojë se si studimet perëndimore bashkëkohore ri-prodhojnë qëndrime të modës së vjetër imperial-kolonialiste dhe stereotipat afatgjatë mbi prapambetjen e supozuar shoqërore dhe kulturore të Shqipërisë, ku post-socializmi duket se përjetëson një nga imazhet më të qëndrueshme të tjetrit në kontrast me të cilin është formuar identiteti evropian. Fabrikimi i këtyre njohurive mund të argumentohet se tregon superioritetin perëndimor për t’u siguruar politikanëve dhe burokratëve

perëndimorë një bazë legjitime për të zbatuar reformat politike, ekonomike dhe sociale, si pas rënies së komunizmit në Shqipëri, ashtu edhe pas shpalljes së pavarësisë në Kosovë.

Fabrikimi i njohurive është i ndërthurur në rrjete komplekse të marrëdhënieve të pushtetit. Kornizat politike dhe ideologjike na kushtëzojnë të gjithëve dhe interesat gjeostrategjike ashtu si dhe individuale i mbështesin kërkimet tona studimore. Kërkesa e qëllimshme për të qenë në përputhje me interesa të caktuara politike bëhet mashtroese, madje edhe e rrezikshme, sidomos kur agjendat politike duket sa janë më të diskutueshme mbi baza morale ose kur kërkimi studimor shtyhet të verifikojë disa keqinterpretime të padobishme ose selektive të të dhënave kulturore dhe historike. Tek e fundit, një paragjykim i tillë metodologjik dhe ideologjik normalisht nuk është gjithmonë i vetëdijshëm, por mund të riprodhojë modelet e vjetruara të veçantive kulturore dhe të determinizmit kulturor, në zonat marginale të Evropës Juglindore ashtu si dhe në vende të tjera, ndërsa nënvlerësohet padrejtësisht një potencial më i rëndësishëm për të gjeneruar më shumë njohuri analitike mbi veçoritë e kulturës, historisë dhe shoqërisë.

Kjo kritikë është e zbatueshme në përgjithësi ndaj studimeve kërkimore perëndimore në dy shekujt e fundit, si dhe më konkretisht ndaj traditës së vjetër gjermano-folëse nga shekulli i nëntëmbëdhjetë deri në mes të shekullit të njëzetë, kur Südostforschung, ose Balkanologie dhe Albanologie, ishin tipike të Kulturkreislehre e dominuar nga ideologjia e racizmit dhe kolonializmit.[8] Në një kthesë të papritur, kjo traditë është e përbrendësuar edhe nga kërkimet studimore lokale shqiptare në shekullin e njëzetë, sidomos studimet folklorike të kulturës popullore të dominuar nga ideologjia e nacionalizmit dhe nacional-komunizmit.[9] Kam argumentuar gjithashtu se në dekadat e fundit një shkollë e re gjermano-folëse, e përqendruar tek Balkankompetenzen, riprodhon e përjetëson, ndoshta pa dashje, një traditë të trashëguar të qëndrimeve perandorake dhe stereotipave tjetërsuese, si nëpërmjet paragjykimeve mbi realitetet vendase të huazuara nga hierarkitë e vjetra qytetërimore edhe nëpërmjet ndërthurjes me politikën neo-liberale dhe post-perandorake.[10]

Në veçanti, kam ngritur një numër kritikash të rëndësishme kundër studiuesve ballkankompetent të shkollës së re gjermano-folëse që kanë kolonizuar kërkimet studimore mbi Shqipërinë dhe vendet e tjera të Evropës Juglindore. Konkretisht, patronimi dhe mosrespektimi i vazhdueshëm ndaj studiuesve vendas, si dhe herë-herazi mbështetja me tepri mbi parimet e dekonstruksionizmit post-modern, shpesh kanë çuar në rezultate kërkimore të esencializuara, të pamjaftueshme ose të keqinterpretuara. Në këtë shkrim, synoj më tej ta shtrij kritikën mbi disa aspekte shtesë në vlerësimin e historisë shqiptare nga një historiane franceze. Ndonëse disa nga kritikrat mund të jenë të vërteta edhe për një pjesë të vlerësimeve masive të orientuara në qendrat

Evropiane-Perëndimore dhe Amerikano-Veriore të pushtetit, një qasje patronizuese me të meta të theksuara është e pranishme dhe e qëndrueshme veçanërisht për një historiane individuale franceze si **Nathalie Clayer**. Megjithatë, këtu nuk merrem individualisht me Clayer, por përpiqem të ilustroj këto prirje patologjike duke iu referuar shkrimeve të saj, veçanërisht kur ajo përpiqet të identifikojë atë që ajo beson të jetë karakteri i “saktë” i identitetit dhe i historisë kombëtare shqiptare.

Në seksionin e parë, argumentoj se kur Clayer merret me çështjet shqiptare, praktikrat përjashtuese rezultojnë në gabime thelbësore empirike dhe metodologjike në hulumtimet e saj. Në seksionin e dytë, tregoj më hollësisht se si të metat substanciale dhe paragjykimet ideologjike shndërrohen në mjete për të keqinterpretuar historinë dhe mitet themelore shqiptare, çka rezulton në një lloj tjetërsimi strategjik të historisë, fesë, kulturës dhe shoqërisë shqiptare. Seksioni vijues ilustron përpjekjet e historianes franceze për të sendërtuar tjetërsimin strategjik të identitetit dhe të historisë kombëtare shqiptare, të cilat reduktohen në “një komb të shumicës myslimane në Evropë”. Në seksionin e fundit, përfundoj me vërejtje për imperializmin metodologjik dhe implikimet për ndërgjegjësim të mëtejshëm. Në veçanti, argumentoj se efekti i njohurive ballkankompetente të fabrikua nga historiania franceze Nathalie Clayer mbi karakterin e supozuar mysliman të historisë, kulturës dhe shoqërisë shqiptare, është rindërtimi i kombit shqiptar si një aleat i përsosur i islamizmit dhe terrorizmit në Europë, duke kontribuar kështu për rrëshqitjet qytetërimore brenda Evropës në kufijtë e saj juglindorë.

Praktikat përjashtuese

Një mënyrë dikotomike e të menduarit thuhet se është e lidhur me strukturat shoqërore tradicionale shqiptare dhe se është theksuar gjatë socializmit,[11] sipas së cilës nuk ishte e pazakontë që studiuesit të klasifikohen nën kategoritë e vendasve dhe të huajve ose miqve dhe armiqve. Shpesh studiuesit perëndimorë përvetësojnë nën emrin e tyre të njëjtën mënyrë dikotomike të të menduarit, ashtu sikurse dështime të shumta për t’u angazhuar me studimet vendase shqiptare janë argumentuar diku tjetër se kanë molepsur sidomos shkollën e re gjermano-folëse të Balkankompetenzen.[12] Efekte të zgjatura qëndrimesh të ngjashme ekzotike dhe patronizuese i bëjnë shkrimet e shumë prej këtyre studiuesve moralisht dhe analitikisht të diskutueshme, pasi është e vështirë të mbrohen këto lloj praktikash akademike përjashtuese në shekullin e 21-të. Përjashtimi i studiuesve shqiptarë nga diskutimi shkencor i historisë, kulturës dhe shoqërisë shqiptare, apo trajtimi i kolegëve shqiptarë si të pazotë e të padenjë pikërisht për studimin e këtyre çështjeve, nuk ka dyshim se është një praktikë akademike e dyshimtë dhe një çështje e qartë e logjikës përjashtuese.

Studiues të aftë shqiptarë, ashtu si dhe kolegët e tjerë të Europës Qendrore dhe Lindore, shpesh shpërfillen thjesht sepse duket mendjemadhësi që studiues me prejardhje tjetërsore të kryejnë ndonjë kontribut të vërtetë në teoritë e rezervuara, dominuese, kozmopolite, ndërkombëtare, ndërkohë që në rastin më të mirë besohet se ata nuk mund të shtojnë veçse zbatime dhe shënime anësore për teorizimet perëndimore. Në një konferencë të sponsorizuar nga Akademia Austriake e Shkencave, për shembull, studiues Balkankompetent u mblodhën së bashku vetëm me “studiues që nuk kanë prejardhje nga rajoni” për të diskutuar mbi gjendjen e historiografisë shqiptare.[13] Siç ndodhi atje, çfarëdolloj proporcioni i një origjine shqiptare mund të ketë shkaktuar që edhe Nathalie Clayer të ketë mbyllur sytë qëllimisht në vlerësimin e saj ndaj kontributeve të caktuara prej studiuesve shqiptarë.[14]

Në fillim të viteve 1990, në Shkollën e Studimeve të Avancuara të Shkencave Sociale (EHESS) në Paris, bashkë-studentët e lindur në Shqipëri kanë ndarë kolegjisht me Clayer punimet e tyre mbi rindërtimin historik të identiteteve në Shqipërinë multi-fetare.[15] Këto punime përfshijnë edhe përdorimin e teorive moderne të përkatësisë etnike dhe të nacionalizmit,[16] të cilave iu desh në të vërtetë mjaft kohë për të fituar terren në Francë në përgjithësi dhe në shkrimet e Clayer në veçanti. Edhe pse kontributet e bashkë-studentëve të saj duhet të kenë qenë mjaft të rëndësishme për tematikat që ajo ka trajtuar, ajo nuk i ka përmendur kurrë në shkrimet e saj të mëvonshme mbi fenë ndër shqiptarë,[17] apo mbi “lindjen e një kombi me shumicë myslimane në Europë”. [18]

Clayer ndoqi një traditë tjetër që duket se ka filluar me **Alexandre Popoviç** në Paris dhe duket se do mbetet e kuptueshme dhe legjitime për aq kohë sa riprodhon një diskurs apologjetik apo synon të zbulojë thelbin e supozuar të një “Islami Ballkanik”. [19] Në gjurmët e mentorit dhe “udhëzuesit shpirtëror” siç e quan ajo, Clayer është një shkrimtare e palodhur në kërkimin e saj të devotshëm dhe të lavdërueshëm për të dokumentuar, për të katalogizuar dhe për të përshkruar tërësisht çdo lloj treguesi që mund të gjejë në kategorinë e Islamit mes shqiptarëve. Fillimisht ajo u përpoq të përpilojë një katalog të tërë të dhënash për enklavat myslimane dhe vëllazëritë myslimane në Shqipëri,[20] apo në zonat e përfaqësuara,[21] që u pasuan nga një fokus më i gjerë mbi situatën aktuale të popullsive historikisht të konvertuara myslimane në Evropën Juglindore.[22]

Si një eksperte ballkankompetente, Clayer është ndoshta e kufizuar nga konturet e ngushta të vetë objektit të studimeve të saj dhe duket më e shqetësuar për të justifikuar një marrëdhënie disi thelbësore me një objekt kërkimor që ajo beson se është i veçantë. Ndoshta kjo duhet ta ketë udhëhequr Clayer në përfytyrimin e nxituar dhe jo-kritik të origjinës së nacionalizmit shqiptar dhe të formimit të kombit shqiptar si një emanacion specifik dhe ekskluziv Islamizmit bektashian,[23] kryesisht përgjatë një zhvillimi të

përpunuar nën ndikimin e supozuar të aktivistëve bektashinj si Naim Frashëri dhe vëllezërit e tij.[24] Përsëri, megjithëse pa dhënë asnjë lloj dëshmie, Clayer pretendon se edhe “njohja e bektashizmit si një bashkësi fetare e pavarur nga regjimi komunist në vitin 1945 i është detyruar pjesërisht një lloj mendimi mes disa prej udhëheqësve komunistë që bektashizmi mund të përbënte një version kombëtar, progresiv, madje pothuajse jo-fetar të Islamizmit”.[25] Pas përvetësimit të njohurive prej studiuesve gjermanë,[26] si dhe pas rreshtimit në një trend edhe më të gjerë,[27] Clayer duket se ka pritur që një identitet kombëtar shqiptar mund të manifestohet vetëm në Islamizëm dhe prandaj e ka kuptuar nacionalizmin shqiptar si pjellë ekskluzive të një shumice të rindërtuar myslimane në Europë.[28]

Ky tregim anashkalon ose nënçmon historianët shqiptarë të nacionalizmit shqiptar,[29] sikur të njollosur me ideologjitë e “zgjimit kombëtar” dhe të “luftës klasore”,[30] duke hedhur poshtë edhe analizat shqiptare të shpikjes dhe të ndërtimit të trashëgimisë historike dhe kulturore shqiptare.[31] Nuk mund të mohohet se më shumë se çdo gjë tjetër, siç kam treguar diku tjetër, historia e lëvizshmërisë fetare të shqiptarëve mbetet e dobishme për të kuptuar politikën etnike dhe rindërtimin historik të identiteteve në Shqipërinë multi-fetare.[32] Po kështu edhe shumë variacione historike, kulturore, gjuhësore, fetare dhe lokale janë shqyrtuar dhe janë vlerësuar në mënyrë kritike gjatë kësaj. [33] Për më tepër, Clayer injoron mekanizmat komplekse që bëjnë të mundur vlerat shoqërore, besimet fetare dhe ideologjitë politike të takohen së bashku në lidhje me strukturën e shoqërisë në tërësi.[34] Ajo refuzon të shohë se një qasje më e gjerë krahasuese midis herezive të krishtera, misticizmit mysliman, kulteve milenariste dhe lëvizjeve të reja fetare mund të jetë më e dobishme për të siguruar një kuptim më të mirë të rolit kryesisht politik të ruajtjes dhe të transmetimit të njohurive shpirtërore, si dhe pastaj të përdorimit të tyre instrumental për mobilizimin e një lëvizjeje kulturore drejt nacionalizmit.

Edhe më afër çështjeve të saj, Clayer mbetet çuditërisht e verbër ndaj mundësisë së kapjes në mënyrë më të kuptueshme të natyrës së bektashizmit si një urdhër mistik dhe heterodoks brenda Islamit. Me sa duket, ajo injoron zhvillimin historik dhe mobilizimin politik të bektashizmit, ashtu si është ekzaminuar posaçërisht nga studiuesit e lindur shqiptarë, qoftë në Anatinë otomane dhe Turqinë bashkëkohore,[35] apo në Shqipërinë e midis-dy-luftërave dhe post-komuniste.[36] Clayer injoron veçanërisht instrumentalizimin politik të strukturës fetare bektashiane brenda një sistemi kulturor ideologjik të përgjithshëm.[37] Me këtë rast, ajo mund të kishte kuptuar se edhe afiniteti i supozuar i zgjedhor i Naim Frashërit me fenë dhe në mënyrë të veçantë me bektashizmin gjatë rrjedhës së nacionalizmit shqiptar në shekullin e nëntëmbëdhjetë është zbuluar dhe është artikuluar edhe më mirë.[38]

Me sa duket, injorimi i studiuesve shqiptarë është një zakon i konsoliduar i punës së saj. Në librin e saj të fundit, Clayer i referohet një shkrimtari amator të kohëve të fundit mbi “Studentët shqiptarë në Austri” për ta përdorur si argument mbi historinë kishtarë shqiptarë.[39] Përkundër meritave të këtij shkrimtari në aspekte të tjera, duhej pritur një referencë e ndryshme kur bëhet fjalë për historinë kishtarë të Shqipërisë, pasi Clayer është e vetëdijshme për veprat dhe për studiuesit seriozë që mund të citohen në këtë fushë, por ajo duket se injoron studiuesit shqiptarë dhe të tjerë që eksplorojnë çështjet që ajo ka në dorë. Përderisa është në kundërshtim me studiuesit e lindur shqiptarë, Clayer zgjedh thjesht t’i injorojë ata, pa hyrë në ndonjë debat dhe argumentim, apo pa u përpjekur t’u provojë atyre se ku i kanë gabimet. Nëse ata nuk e ndjekin në rrugën e saj, edhe ajo u përgjigjet me mungesë interesi në punën e tyre, çka nuk bazohet në gjëra faktike, por ndoshta vetëm në faktin se ata mund të kërcënojnë të kapërcejnë ndarjen midis vendasve dhe të huajve. Kjo është një mënyrë e lehtë për të dalë nga situata, një perspektivë që i lejon asaj thjesht të injorojë gjithçka që ajo e konsideron të parëndësishme, ose me më shumë gjasë, potencialisht të rrezikshme për kërkimet e saj.

Mangësi substanciale

Marrëdhënia midis shtrirjes së myslimanëve bektashinj në Shqipëri dhe zhvillimit të nacionalizmit shqiptar brenda bektashinjve shqiptarë është pa dyshim një çështje komplekse. Clayer është tashmë e prirë të shohë se bektashizmi esencializohet shpesh si një fe liberale dhe humaniste në opozitë me e Islamin sunit që lidhet me fanatizmin dhe despotizmin. Clayer duhet të pajtohet që duhet të jemi të kujdesshëm ndaj këtyre esencializimeve, sidomos kur kuptojmë se tjetërsia fetare e përfaqësuar nga bektashizmi në krahasim me Islamin sunit mund të jetë shndërruar në një tjetërsim kulturor dhe politik. Për fat të keq, jo vetëm që Clayer refuzon tërësisht të shqyrtojë mundësinë e këtij transformimi të ekzaminuar diku tjetër nga studiuesit shqiptarë si unë,[40] por ajo nuk njeh as edhe transformimin e qëndrimeve të veta.

Në fillim, Clayer “pyet veten”, madje “në mënyrë fare të natyrshme dhe legjitime”, pse kanë ekzistuar lidhje të veçanta midis bektashizmit dhe nacionalizmit shqiptar, – më saktësisht, “pse ky urdhër mysliman u ofroi nacionalistëve një kornizë të privilegjuar në shoqërinë shqiptarë të kohës”, si dhe pse madje “nuk ka pasur struktura të tjera që mund të ndihmonin lëvizjen kombëtare”. [41] Një pikëpamje e tillë është padyshim një ekzagjerim i pabazuar dhe Clayer vetë erdhi më vonë duke e modifikuar qëndrimin e saj. Kjo duket hapur në shkrimin e saj madhor mbi “bektashizmin dhe nacionalizmin shqiptar”, i cili ka kaluar nga pretendimet e patundshme në botimin e parë,[42] që nuk përmendet më në listimet e shkrimeve të saj, deri tek pohimet lehtëzi të modifikuara në ribotime të njëpasnjëshme.[43]

Clayer është megjithatë për t'u lavdëruar përderisa pranon se në shkrimet e veta të mëparshme ajo ka punuar me “një perspektivë të mangët mbi ndërtimet, diskutet dhe terminologjitë nacionaliste”, pa qenë në gjendje të çlirohej mjaftueshëm prej diskursit nacionalist shqiptar.[44] Ajo gjithashtu ka pranuar kohët e fundit se shumë autorë, “përfshirë edhe veten e vet, nuk kanë kuptuar mjaftueshëm se duhet larguar nga mistifikimet që kanë rrjedhur natyrshëm nga kjo afërsi midis bektashizmit dhe nacionalizmit”. [45] Përfundimisht, tashmë ajo mendon se “është e vështirë të dihet nëse dy fenomenet janë të lidhura dhe, nëse po, cili prej tyre e përfshin tjetrin”. [46] Në fund të fundit, ajo e di se nëse “disa tendenca sugjerojnë rëndësinë e bektashizmit si një medium i përhapjes së shqiptarizmit midis viteve 1896 dhe 1908, ende mbetet që ky nuk ishte veçse një medium midis të tjerëve. [47]

Shumë studiues si Clayer shpesh denoncojnë studiuesit vendas shqiptarë sikur janë të obsesionuar për ta rindërtuar identitetin shqiptar në imagjinatën historike nëpërmjet mitologjisë nacionaliste. Megjithatë, pretendimet e saj duket se janë po aq padrejtësisht të obsesionuara për ta kthyer nacionalizmin shqiptar në një lëvizje ekskluzivisht myslimane. Edhe pse një shumicë e shqiptarëve mund të ketë qenë dhe ende mund të jenë myslimanë, Clayer e kupton se këmbëngulja e saj për të parë identitetin kombëtar shqiptar nëpërmjet prizmit ekskluziv të identitetit mysliman duhet të jetë tek e fundit e pasaktë, sepse “në një pjesë të madhe, shqiptarët janë edhe të krishterë”. [48] Ndonëse shkrimet e saj ekzagjerojnë qëllimshëm një lloj ndryshimi midis aktivistëve shqiptarë myslimanë dhe të krishterë, ajo mund edhe të pranojë me ngurrim se aktivistët shqiptarë shpesh donin të shprehnin publikisht një lloj “solidariteti kombëtar”, i cili ishte “gjithnjë e më i dukshëm kur shkonte përtej kufijve fetarë”. [49]

Clayer vjen e shqyrton transformimin dhe instrumentalizimin e bektashizmit në shërbim të nacionalizmit shqiptar jo nga vetë natyra e bektashizmit, por nga faktorët “ekzogjenë”. Çuditërisht, lidhja konstante e bektashizmit me nacionalizmin shqiptar, nëse nuk ka rrjedhur nga një natyrë e supozuar liberale e bektashizmit, thuhet se nuk ka dalë “as nga politika e Ali Pashës së Janinës, as nga persekutimet bektashiane në 1826, por kryesisht nga zhvillimi i përpunuar nën ndikimin e Naim Frashërit dhe vëllezërve të tij”! [50]

Po kështu, siç kam treguar gjetiu me hollësi, është ekzagjerim të argumentohet, siç kanë bërë veç Clayer edhe autorë të tjerë, [51] se Naim Frashëri është përpjekur të kapërcejë ndarjen fetare shqiptare duke propozuar ta kthejë bektashizmin në një fe kombëtare gjithëpërfshirëse për të gjithë shqiptarët. [52] Shkrime të mëhershme në literaturë kanë sugjeruar se përpjekjet e Naim Frashërit synonin thjesht t'i jepnin bektashizmit në një mënyrë ose në një tjetër një farë karakteri shqiptar, [53] ndërsa pikëpamja e Duijzings duket se rrjedh nga një mbështetje jo kritike në përmbledhjet eklektike të historive letrare, [54] siç mund të duket përgjatë gjithë librit të tij

mbi “fenë dhe politikën identitare në Kosovë”. [55] Edhe në rastin e Nathalie Clayer, përpilimi jo-kritik i të dhënave që ajo ka akumuluar mbi rendet myslimane, [56] duhet ta kenë çuar atë në paraqitjen e origjinës së nacionalizmit shqiptar dhe të lindjes së kombit shqiptar si një emanacion posaçërisht bektashi.

Pikëpamje të ngjashme transmetohen zakonisht nga studiues si Clayer dhe Duijzings, por mbështeten edhe nga tradita standarde e studimeve mbi bektashizmin, ku mund të gjenden edhe deklaratat kurioze që argumentojnë se “tekstet bektashiane në përgjithësi heshtin për sa i takon etikës sociale”. [57] Besime të tilla duken thjesht të paqëndrueshme përballë asaj që dimë si për Naim Frashërin edhe për kontekstin shqiptar në të cilin ai veproi dhe krijoi. Ndonëse mendimi i Naimit kishte me të vërtetë një karakter fetar, Clayer injoron përfundimet e studiuesve të lindur shqiptarë që tregojnë se mendimi fetar i Naimit ka shkuar shumë më përtej bektashizmit në heterodoksinë e vet. Ai e transformoi bektashizmin në një lloj teologjie çlirimtare dhe përqafoi një panteizëm tërësor, që krijuan një kuadër gjithëpërfshirës për identitetit shqiptar, të pakufizuar në ndonjë mënyrë të veçantë vetëm te bektashizmi. [58] Besoj se mesazhi i Naimit mund të kuptohet më mirë, si dhe mund të përftohet një pamje tjetër, nëse dëshmitë empirike që kemi në dispozicion analizohen në mënyrë kritike nga këndvështrimi i qasjeve teorike të përpunuara në sociologji dhe në antropologji.

Pavarësisht nga përqendrimi i tyre në Shqipëri, bektashinjtë ishin një pakicë e vogël mjaft e marginalizuar brenda myslimanëve sunitë, ashtu si dhe brenda shoqërisë shqiptare në përgjithësi, veçanërisht para përhapjes së lëvizjes kombëtare. [59] Pa dyshim, Naim Frashëri nuk ishte i verbër ndaj këtij fakti. Megjithatë, së bashku me të tjerë ekspertë ballkankompetent për çështjet shqiptare, Clayer nuk arrin të kuptojë se aktivistët kombëtarë shqiptarë si Naimi nuk kanë pasur aq ndërmend ta bëjnë mit kombëtar martirizimin e Qerbelasë, as të krijojnë një fe unike për shqiptarët, por përkundrazi, t’i bëjnë idetë kombëtare të suksesshme për t’u pranuar prej bektashinjve shqiptarë dhe prej shqiptarëve të çfarëdolloj feje. Duket se edhe Clayer ka ardhur e i është afruar në mënyrë të përshtatshme këtij qëndrimi në shkrimet e saj më të fundit. [60] Në të gjithë krijimtarinë e Naimit, dhe sidomos te Historia e Skënderbeut, qëllimi i tij ishte të bëjë thirrje me forcë për bashkim duke minimizuar çdo lloj ndasie të dukshme fetare apo çdo lloj diferencimi social e kulturor midis shqiptarëve.

Si rezultat, Clayer refuzon të njohë *rindërtimin trans-fetar të nacionalizmit shqiptar* dhe instrumentalitetin politik të zhvendosjeve fetare mes shqiptarëve. Madje ajo nuk duket se përpiket të kuptojë se çfarë mund të jetë një lëvizje fetare dhe si të analizojë e të shpjegojë transformimet historike në terma sociale, kulturore, politike, apo në çfarëdolloj termash. E konsumuar me qasje deskriptiviste për të regjistruar çdo gjë myslimane mes shqiptarëve, sa më

shumë ajo shkruan e përshkruan dëshmitë aq më pak ajo ka nevojë për kapjen e tyre në mënyrë analitike, sikur të mos e shihte pyllin prapa drurëve.

Sendërtimi i një kombi me shumicë myslimane në Europë

Problemi me Clayer duket se ka të bëjë me identitetet kombëtare të Ballkanit që u formuan mbi vlerat fetare të përcjella nga kishat e tyre ortodokse përkatëse. Pas logjikës nacionaliste, sipas të cilës nacionalizmat shpesh janë ndërtuar në reagim dhe në kundërshtim me kërcënimin e nacionalizmave të kundërta, Clayer priste mundësia e një identiteti kombëtar shqiptar të manifestohej nëpërmjet Islamizmit. Ndasitë fetare ishin një kërcënim i vërtetë për unitetin shqiptar, që mund të komprometohej kur ngatërrohej me myslimanët otomanë ose kur shkrihej me të krishterët grekë apo serbë. Në kushtet e historisë së vështirë të lëvizjes kombëtare shqiptare, aktivistët shqiptarë nuk kishin zgjidhje tjetër veçse ta kundërshtojnë këtë logjikë dhe të ndërtojnë një identitet kombëtar mbi baza të tjera prej fesë. Veprat klasike të historiografisë shqiptare kanë theksuar tashmë dallimet rajonale dhe konfesionale që pothuajse penguan zhvillimin e nacionalizmit shqiptar.[61] Në të kundërt, studiues si Clayer shpesh mbivlerësojnë padrejtësisht ato lloj dallimesh lokale, sociale, politike, kulturore, dialektore, krahinore dhe fetare që mund të vërehen pak a shumë kudo tjetër, ashtu si dhe shumëllojshmërinë dhe rrëshqitshmërinë e mekanizmave të identifikimit që mbizotërojnë absolutisht kudo.

Clayer është e vetëdijshme se një numër i madh i myslimanëve shqiptarë, pavarësisht “besnikërisë së tyre të dyzuar”, [62] u shkëputën me dëshirë prej Perandorisë otomane myslimane. Megjithatë, për të treguar rolin në dukje të rëndësishëm që feja duhet të ketë luajtur në kulturën, shoqërinë dhe historinë shqiptare, Clayer i hakërrohet në mënyrë anakronike retorikës tashmë të vjetërsuar të propagandës komuniste, nacionaliste apo fetariste lidhur me karakterin thelbësisht tolerant dhe progresiv të disa grupeve fetare në një Shqipëri sinkretike shumë-fetare. Ajo fajëson edhe një të ashtuquajtur historiografi zyrtare ose paragjykimet ideologjike nacional-komuniste, shpesh pa shpjeguar se çfarë do të thotë me këto.

Natyrisht, ka shumë për të fajësuar historiografinë dhe studimet shqiptare nacional-komuniste dhe kritikën e thella tashmë janë dhënë diku tjetër nga studiuesit e lindur në Shqipëri.[63] Megjithatë, ekspertët ballkankompetent si Clayer fshehin paragjykimet e ngjashme ideologjike. Jo vetëm refuzojnë të pranojnë **karakterin trans-fetar të nacionalizmit shqiptar**, që është përcaktuar mjaft bindshëm nga një numër studimesh klasike dhe më të reja nga gjeneratat e studiuesve shqiptarë, por leximi tendencioz i historisë shqiptare nga studiues si Clayer nuk shton asgjë të re, përveçse përpiqet të anulojë identitetin shqiptar ashtu siç është ndërtuar që nga shekulli i nëntëmbëdhjetë. Në të vërtetë, disa nga pretendimet e tyre janë kokëfortë në

shfaqjen ekskluzive të tjetrit mysliman në Ballkan, ashtu si dhe të lindjes ekskluzive të “një kombi me shumicë myslimane në Evropë”.[64] që duken më tepër se kanë të bëjnë me rivendosjen e formave të reja të islamizmit dhe të otomanizmit në Shqipëri dhe në Ballkan.

Identiteti shqiptar është ndërtuar në shekullin e nëntëmbëdhjetë pas një mobilizimi nacionalist mbi bazën e një gjuhe të përbashkët dhe kundër ndasive fetare.[65] Megjithatë, në librin e saj të fundit, Clayer përpiket të shpërbëjë dhe të shkrijë esencializmin kombëtar të studiuesve shqiptarë në pretendime edhe më thellësisht esencialiste, por edhe më kaba dhe anakronike mbi identitetin shqiptar, gjoja i “lindur” nga përpjekjet e aktivistëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë për të krijuar “një komb me shumicë myslimane në Evropë”.[66] Zgjedhja e një “hipoteze” kërkimore nuk është kurrë e pafajshme, sepse “faktet flasin vetëm kur u bën thirrje historiania: është ajo që vendos se cilave fakte u duhet dhënë fjala, si dhe në cilën radhë apo në cilin kontekst”.[67] Siç ka ndodhur, nëse Clayer vendos të kërkojë “lindjen e një kombi evropian me shumicë myslimane”, ajo do ta gjejë një “identitet shqiptar mysliman” dhe do të kontribuojë për formimin e tij.

Projekti kërkimor udhëzues i punës së Clayer është të tregojë pasqyrimin e nacionalizmit shqiptar në mediat shqiptare nga fundi i Luftës së Krimesë (1853-1856) deri te fillimet e luftërave ballkanike (1912-1913) që çuan në pavarësinë e një Shteti shqiptar të cinguar. Gjatë asaj kohe, përdorimi i gjuhës shqipe ishte i ndaluar dhe botimi, mësimi, madje edhe leximi në gjuhën shqipe ishte një krim kundër shtetit otoman. Kjo do të thotë që Clayer mund të përqendrohej veçse në mediat shqiptare të diasporës dhe në raportet konsullore të Europës perëndimore, të cilat nuk mund të ofrojnë një tregues të saktë të zhvillimit të nacionalizmit shqiptar, thjesht sepse dëshmitë janë të kushtëzuara nga interesat politike si të shteteve ballkanike edhe të fuqive evropiane. Duke pasur parasysh se shtetet ballkanike nuk ishin dashamirëse ndaj nacionalizmit shqiptar dhe shpesh kërkonin të nxisnin ndasitë rajonale dhe fetare midis shqiptarëve, mund të pritej që burimet otomane mund të marrin një vend më të rëndësishëm në studimet e Clayer. Por ajo pranon se “nuk mund të përdorë më shumë burime nga arkivat otomane” dhe se “nuk mund të përdorë arkivat britanike”.[68] Me sa duket, burimet otomane dhe britanike mund të shfuqizojnë pretendimet e saj, ndërsa burimet konsullore franceze që ajo ka përdorur mund të jenë të njëanshme. Përkundër pretendimit të saj se “Franca është një aktor më neutral”, Franca u bë në fakt mbështetëse e rëndësishme për Greqinë dhe për Serbinë, dy nga shtetet ballkanike, interesat e të cilëve u vunë në kundërshtim me nacionalizmin shqiptar.

Këto çështje metodologjike e bëjnë problematik rrëfimin e Clayer-it mbi “lindjen e një kombi evropian me shumicë myslimane” dhe ky problem nuk mund të zgjidhet duke u mbështetur mbi një instrument sado të saktë metodologjik, siç janë teoritë që e konsiderojnë kombin si shpikje të

nacionalizmit në kushtet moderne të konsolidimit të shtetit. Këto teori tregojnë se shfaqja e nacionalizmit është një fenomen i lidhur ngushtë me modernizimin, industrializimin, racionalizmin dhe mbi të gjitha me përhapjen e gjuhës së shkruar dhe botimin e shkrimeve të shtypura. Edhe pse dolën me nocione shumë të përgjithshme të “bashkësive imagjinare”, [69] apo kanë marrë shprehimisht në konsideratë rajonet e pazhvilluara si “Ruritania”, [70] këta teoricienë i formuluan teoritë e tyre në bazë të analizave krahasuese të parakushteve shoqërore të ringjalljes kombëtare në historinë moderne të kombeve të Evropës qendrore dhe veriore. [71] Me këtë rast, një numër eksplorimesh në modelet e zhvillimit të identitetit kombëtar tregojnë se një pengesë e pakapërcyeshme lind kur këto modele zbatohen në Ballkan. [72] Përmirësime mbresëlënëse kanë ndodhur në dekadat e fundit të shekullit të nëntëmbëdhjetë në të gjitha shoqëritë ballkanike, por bashkësitë fetare-gjuhësore mbërritën në një shkallë të vetëdijes kombëtare brenda një mjedisi të pa strukturuar.

Kjo vlen në veçanti në rastin shqiptar nga viti 1856 deri në vitin 1912. Nën Perandorinë otomane, shoqëria shqiptare ishte jashtë proceseve të modernizimit evropian, të cilat në përputhje me teoritë moderne të nacionalizmit duhej të mundësojnë lindjen e kombit. Hobsbawm shpëtoi nga ky kurth duke e hedhur poshtë çështjen shqiptare si shumë të komplikuar për t’u studiuar, kur vuri re në kalim e sipër se kërkesa e nacionalistëve shqiptarë për të kërkuar një identitet kulturor shqiptar në një gjuhë të përbashkët të shkruar me alfabet latin “ishte padyshim e parëndësishme për njerëzit e zakonshëm që nuk mund të lexonin asnjë lloj alfabeti”. [73] Në një farë mase, ai bëri të njëjtën gjë edhe me shtet-kombet e tjera të Ballkanit, të cilat pas shkëputjes nga Perandoria otomane mbetën shoqëri fshatare të prapambetura deri në mesin e shekullit të njëzetë.

De-konstruktimi i identitetit shqiptar

Problemi me obsesionin e Clayer për të treguar ekskluzivisht “lindjen e një kombi me shumicë myslimane në Europë” nuk është thjesht që pretendimet e saj këmbëngulëse bazohen vetëm në përdorimin e qëllimshëm të të dhënave selektive dhe në përfundime të jashtëzakonshme dhe të ekzagjeruar. Heraherës duket se Clayer mund të interesohet papritmas edhe për çka ajo merr për “një qasje më shumë shkencore”, [74] e frymëzuar pa dyshim prej zhvillimit të përgjithshëm ndaj një lloj interesi ideologjik për konstruktivizmin social që ka nxjerrë në krye përkatësinë etnike dhe nacionalizmin instrumental. Nuk është për t’u çuditur që Clayer vjen edhe rreshtohet me të ashtuquajturat “teori ndërkombëtare” që janë të modës sidomos te ekspertët tjerë balkankompetent si ajo në shkollën e re gjermano-folëse, [75] të cilët janë shqyrtuar diku tjetër me hollësi. [76]

Në këtë prirje, shpikja post-moderniste e de-konstruktimit nga Jacques Derrida,[77] si dhe e kritikës gjenealogjike nga Michel Foucault,[78] kanë fituar një ndikim të konsiderueshëm sidomos në fushën e kritikës letrare, ndonëse shpesh ato përcaktohen me përshkrime më shumë apofatike negacioniste se sa me pohime pozitive. Veçanërisht filozofët analitikë kanë tendencë të përbuzin çka shihet si një prirje “tekstualizuese” e teoricienëve letrarë, të cilët sipas tyre shpërbëjnë çështjet e mëdha filozofike si e vërteta, madje edhe domethënia, me një zgjidhje të padepërtueshme duke përdorur një metafizikë të errët me dërdëllitje post-moderniste. Shumë prej tyre kanë pikëpamje të tilla sidomos për sa i takon Derridas i cili konsiderohet si kryepriifti i iracionalizmit, obskurantizmit, sofistiks dhe pedantizmit post-modern.[79] Ata denoncojnë haptazi dekonstruktivizmin për mungesë të metodologjisë, si një filozofi relativiste që nuk është asgjë tjetër veçse një “obskurantizëm terrorist”, një “mashttrim i koduar”, një “dërdëllitje e pavlerë”, një “rënie e errësuar e filozofisë”, apo një “mjeshtëri verbale e veshur me të folur neo-marksist të pakuptueshëm”. [80]

Një rast spektakolar është “letra e hapur kundër propozimit që Derrida të marrë një doktoratë nderi nga Universiteti i Kembrixhit”, e nënshkruar nga disa filozofë dhe profesorë të filozofisë së Kembrixhit dhe të universiteteve të tjera, botuar në London Times më 9 maj 1992. “Në sytë e filozofëve që punojnë në departamentet prestigjioze të filozofisë në të gjithë botën”, puna e Derridas “nuk i plotëson standardet e pranuar të qartësisë dhe të rreptësisë studimore”, filozofia e tij përshkruhet si e përbërë nga “marifete”, ndërsa “kur ka sadopak pohime koherente, këto janë ose të rreme ose të parëndësishme” dhe përbëhen “veçse nga sulme gjysmë të kuptueshme kundër vlerave të arsyes, kundër të vërtetës dhe kundër mbarë shkollarisë”. [81]

Për një traditë të filozofisë që krenohet me “qartësinë dhe rreptësinë” e vet studimore, vlerat që u thanë se janë në rrezik prej “marifeteve” të Derridas janë të lidhura ngushtë me marrëdhënien referenciale si thelbi i gjuhës. Filozofët analitikë hedhin poshtë punën e tij, pjesërisht sepse besojnë që Derrida ka braktisur vetë nocionin se gjuha mund të lidhet me botën. Një pikëpamje e tillë mbi gjuhën nuk është vetëm e rreme dhe konceptualisht e pështjelluar, por edhe moralisht e neveritshme, duke rrezikuar të humbasim krejt pikëpamjen e njerëzimit dhe të etikës njerëzore. Ezotericizmi semantik në rritje që përhapej nga llafazanëria e Derridas ka shkëputur shumë nga ideja e filozofit, detyrë kryesore e të cilit është të mendojë dhe që gjykohet kryesisht nga cilësia e mendimeve të tij, jo nga shkathtësia me të cilën i thur mendimet në një varg fjalë qitjesh.

Nga një anë tjetër, argumenti im mbi lidhjen e përfutimit të njohurive me marrëdhëniet e pushtetit postkolonial/postkomunist, siç ilustron në shkrimet e Clayer dhe në shkrimet e studiuesve të tjerë balkankompetent,[82] nuk do të ishte i mundur pa rikonceptualizimin prej Foucault të natyrës së pushtetit, që

ka shkaktuar mënyra të reja të kërkimit dhe të analizës studimore, të cilat kanë çuar në fund të fundit në pozicionimin e filozofisë post-moderniste, kritikës post-koloniale dhe kthesës dekonstruktiviste. Gjithë këto janë të shtyrë nga vullneti për të ndryshuar botën dhe për të shkaktuar një përmbysje të vazhdueshme dhe pa mbarim të vlerave perëndimore. Vështirë se studiuesit post-modernë janë në pajtim me njëri-tjetrin për çdo gjë, por të gjithë ndajnë të njëjtin interes për analizën gjenealogjike,[83] dekonstruktivizmin gramatikologjik,[84] të kombinuar së bashku në kritikën e orientalizmit.[85] Të gjithë përdorin këtë kuadër ku pushteti lidhet me diskutet për të vënë në dyshim dhe në fund të fundit për të de-konstruktuar thujse çdo gjë. Ndërsa analizat e tyre janë të formuara dhe të tejnigopura me terma të tilla si imperializmi, kolonializmi dhe hegjemonia, këta studiues janë veçanërisht të preokupuar me pabarazinë e marrëdhënieve të pushtetit ndërmjet Perëndimit (të krishterë) dhe Lindjes (myslimane) të kolonizuar apo të post-kolonizuar.

Me përmbysjen e moralit perëndimor, dekonstruktivizmi postmodern shtyej në një moral të pamoralshëm, duke mbrojtur shkaqë të dyshimta nën maskën e drejtësisë. Në këtë mes, mashtrimi famëkeq prej kritikës dhe keqinterpretimit të Derridas lidhur me implikimet politike të shkrimit dhe të gramatologjisë, që bëri të mundur riprodhimin retorik të post-modernizmit,[86] duket se është një “përgënjeshtim elokuent” i postulateve dekonstruktiviste.[87] Përveç kësaj, Foucault përqafoi revolucionin islamik iranian si një formë të re të “spiritualitetit politik”, edhe pse mizoritë e regjimit islamik kundër grave dhe homoseksualëve mund t’i jenë “kthyer për ta munduar” më vonë.[88] Mjafton të lexosh Foucault për të kuptuar tundimin e politikës identitare dhe për të ripërshkuar gjenealogjinë e gjatë dhe shumë të fuqishme që nuk ka pushuar kurrë së ndjekuri post-modernizmin, duke u caktuar të shtypurve origjinën e tyre, të kyçur brenda ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike apo kulturës fetare. Kjo ka shkaktuar një përshkallëzim të përhershëm të ekstremizmit dhe të apologjisë së dhunës politike, që përgatit tiraninë e korrektësisë politike dhe despotizmin e kulturës së anulimit të zbatuar nga minoritetet indigjeniste, raciste, mizandriste, islamisto-majtiste, apo ndërseksionaliste, duke shkuar aq larg sa të lavdërohet gjer edhe fundamentalizmi dhe terrorizmi islamik.

Një kurth specifik për dekonstruktivizmin ilustron në shkrimet e Clayer që theksojnë karakterin mysliman të nacionalizmit shqiptar, sidomos kur mistifikohet duke e quajtur “mit” çfarëdo që dëshirohet të de-konstruktohet në mënyrë që pastaj t’i nënshtrohet një ekzaminimi të paracaktuar dhe të njëanshëm. Në veçanti, kur Clayer pretendon se lëvizja kombëtare shqiptare është një “mit”, ajo do të shkojë gjer në fund për ta de-konstruktuar dhe anuluar. Megjithatë, de-konstruktimi dhe anulimi i diskursit të nacionalizmit shqiptar nuk do të thotë gjithmonë se Clayer përqafoi një qasje kritike ndaj

nacionalizmit. Më shpesh, ndonëse ndoshta pa dashur ose pa ditur, Clayer ka të ngjarë të përqafojë diskursin e kundërt të nacionalizmit serb.

Pretendimet sistematike të Clayer për de-konstruktimin e identitetit shqiptar jo vetëm që esencializojnë dhe sendëzojnë kombin shqiptar, duke e tjetërsuar si mysliman, por e rindërtojnë atë si “një komb me shumicë myslimane në Europë”, gjë që do ta bënte atë në mënyrë të nënkuptuar si aleatin e përsosur të islamizmit dhe të terrorizmit. Në fund të fundit, ekziston rreziku që kjo të kontribuojë në të tatëpjetat civilizacionale brenda Europës në kufijtë e saj juglindorë. Kjo mund të shkojë në linjë edhe me ideologjinë radikale etno-fetare, që përqafohet herë pas here nga lloji famëkeq i propagandës ultra-nacionaliste serbe, e cila përdoret për të karakterizuar si terrorizëm islamik, si lëvizjen separatiste shqiptare në Kosovë, ashtu edhe në përgjithësi identitetin dhe kulturën shqiptare.[89]

Me anë të rishkrimit të historisë së kombit shqiptar, Clayer duket se përpiket të kompensojë një vizion tradicional të historisë shqiptare të përqendruar te nacionalizmi etno-gjuhësor, por ndikimi i mbrapshtë i ideologjisë islamike në shkrimet e saj tashmë vishet me termat e respektueshëm të dekonstruktivizmit, të cilat kanë tendencë t’u bëjnë jo më pak dhunë studimeve historike. Në këtë kontekst, dekonstruktivizmi i dyshimtë dhe keqinterpretimi i drejtpërdrejtë i historisë kombëtare shqiptare janë tipike për një qasje sipas kulturës së anulimit. *Me një zell veçanërisht energjik për grumbullimin masiv mbi çdo të dhënë dokumentare me tregues të vjetërsuar dhe anakronikë të islamizmit për ta paraqitur nacionalizmin shqiptar dhe lindjen e kombit shqiptar si një emanacion specifik të bektashizmit, apo si një fenomen që lind ekskluzivisht nga një shumicë myslimane brenda Europës, Clayer sendëzon një histori, kulturë dhe shoqëri shqiptare të orientuara nga islamizmi.* Rrëfimi i saj balkankompetent duket se përgatit terrenin për një aktivizëm të ri studimor që përcaktohet nga programet neoliberalë të reformimit institucional dhe vendosja e një hapësire të re publike, prej së cilës është anuluar identiteti kombëtar shqiptar.

Vërejtje të fundit

Filozofi analitik John Searle thotë se Michel Foucault e ka karakterizuar stilin e Derridas si një “obskurantizëm terrorist”. [90] Në mënyrën se si Searle sjell fjalët e Foucault, Derrida “shkruan në mënyrë aq të paqartë sa nuk mund të kuptosh saktësisht se çfarë kërkon të thotë, kjo është pjesa e obskurantizmit, dhe pastaj kur e kritikon, ai gjithmonë mund të thotë, vous m’avez mal compris, vous êtes idiot (nuk më kuptoni, jeni idiot), dhe kjo është pjesa e terrorizmit”. [91] Edhe pse mund të kemi të bëjmë me një thashetheme tipike për një revistë të medias masive, që mund të dënohet si e dhunshme apo e papërshtatshme për të kundërshtuar një debat akademik, [92] ky është një përshkrim i saktë i strategjisë së dekonstruktivizmit. Në mënyrë të ngjashme,

në disa mendime ekstreme të shprehura në mediat shqiptare, Clayer dhe studiuesit balkankompetent të ngjashëm me të thuhet se merren me fabrikimin e një lloji të ri të shkrimit të historisë që është përshkruar si “terrorizëm metodologjik”.^[93] Jo sepse janë absurdë e pa kuptim, por ashtu si terroristët dhe gjahtarët e shtrigave, ata u japin një kuptim të demonizuar çfarëdolloj gjëje që bëhet objekt i sulmeve të tyre.

Synimi i tyre kryesor është më tepër të mësojnë një brez të tërë studiuesish të rinj me teknologjitë post-moderniste të dekonstruktivizmit, se si të ç’ mishërojnë dhe të anulojnë identitetin shqiptar, të ç’kulturojnë dhe të ç’politizojnë kombin shqiptar, të parandalojnë perspektivat alternative të njerëzve të zakonshëm dhe përfundimisht të ç’ndërtojnë dhe të shkatërrojnë mbarë shoqërinë shqiptare. *Nëse bëhet thirrje për tejkalimin e kombit shqiptar, ndërkohë që për shumicën e shqiptarëve kombi u siguron të vetmin kuadër interpretues të rëndësishëm, kjo bëhet për t’ua mbyllur gojën, apo për t’ua anuluar historinë, kulturën dhe shoqërinë.* Në mënyrë të ngjashme, nëse turbullohet tradita e studimeve shqiptare, kjo mund të shërbejë fshehtazi për justifikimet esencialiste të një politike të mëtejshme identitare në emër të motiveve ekskluziviste edhe më të papranueshme.

[1] **Albert Doja**, “The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context,” *New Perspectives: Interdisciplinary Journal of Central & East European Politics and International Relations* 30, no. 1 (2022): 87-118, <https://doi.org/10.1177/2336825X211065569>.

[2] Ky shkrim është botuar në aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Studimet për Shqiptarët në France” organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 29-30 tetor 2021. Titulli origjinal: “Tjetërsimi strategjik i historisë shqiptare në shkrimet e një historiane franceze”, Rexhep Ismajli (përg.) *Les études sur les Albanais en France* (Prishtina: ASHAK, 2022, ff. 413-440). Sillet për Peizazhe të Fjalës me kortezinë e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

[3] **Maria Todorova**, *Imagining the Balkans* (New York: Oxford University Press, 1997; repr., 2009).

[4] **Enika Abazi**, “Tranzicioni i munguar në shkencat sociale shqiptare: Deskriptivizmi empiriko-historicist kundrejt qasjes kritiko-analitike,” *Polis* 9 (2010): 63-76; **Enika Abazi**, “Tranzicioni dhe shkencat sociale shqiptare: një qasje kritike,” *Politikja* 2 (2011): 209-215.

[5] **Albert Doja**, “Folkloric archaism and cultural manipulation in Albania under socialism,” in *The Anthropological Field on the Margins of Europe, 1945-1991*, ed. Aleksandar Boskovic and Chris Hann (Berlin/Münster: LIT-Verlag, 2013): 153-

- 174; **Albert Doja**, “The Beautiful Blue Danube and the Accursed Black Mountain Wreath: German and Austrian Kulturpolitik of Knowledge on Southeast Europe and Albania,” *Soziale Welt: Zeitschrift für sozialwissenschaftliche Forschung und Praxis* 65, no. 3 (2014): 317-343, <https://doi.org/10.5771/0038-6073-2014-3-317>; **Albert Doja**, “From the German-speaking point of view: Unholy Empire, Balkanism, and the culture circle particularism of Albanian studies,” *Impact Factor 0.757, Critique of Anthropology* 34, no. 3 (2014): 290-326, <https://doi.org/10.1177/0308275X14531834>; **Albert Doja**, “From the native point of view: An insider/outsider perspective on folkloric archaism and modern anthropology in Albania,” *Impact Factor 0.442, History of the Human Sciences* 28, no. 4 (2015): 44-75, <https://doi.org/10.1177/0952695115594099>; **Enika Abazi and Albert Doja**, “From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism,” *Communist and Post-Communist Studies* 49, no. 2 (2016): 163-178, <https://doi.org/10.1016/j.postcomstud.2016.04.002>.
- [6] **Enika Abazi and Albert Doja**, “International Representations of Balkan Wars: A Socio-Anthropological Account in International Relations Perspective,” *Cambridge Review of International Affairs* 29, no. 2 (2016): 581-610, <https://doi.org/10.1080/09557571.2015.1118998>; **Enika Abazi and Albert Doja**, “The past in the present: time and narrative of Balkan wars in media industry and international politics,” *Third World Quarterly* 38, no. 4 (2017): 1012-1042, <https://doi.org/10.1080/01436597.2016.1191345>; **Enika Abazi and Albert Doja**, “Time and narrative: Temporality, memory, and instant history of Balkan wars,” *Time & Society* 27, no. 2 (2018): 239-272, <https://doi.org/10.1177/0961463x16678249>.
- [7] **Albert Doja and Enika Abazi**, “The Mytho-Logics of Othering and Containment: Culture, Politics and Theory in International Relations,” *International Critical Thought* 11, no. 1 (2021): 130-155, <https://doi.org/10.1080/21598282.2021.1886145>.
- [8] **Doja**, “Beautiful Blue Danube and Accursed Black Mountain Wreath.”; **Doja**, “From the German-speaking point of view.”
- [9] **Doja**, “From the native point of view: An insider/outsider perspective on folkloric archaism and modern anthropology in Albania.”; **Abazi and Doja**, “From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism.”
- [10] **Doja**, “The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context.”
- [11] **Stephanie Schwandner-Sievers**, “Freund, Feind, und Ehre,” in *Albanien: Stammesleben zwischen Tradition und Moderne*, ed. Helmut Eberhart and Karl Kaser (Wien: Böhlau, 1995): 117-132.
- [12] **Doja**, “The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context.”
- [13] **Shih Oliver-Jens Schmitt**, ed., *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung* (München: Oldenbourg, 2009).
- [14] **Nathalie Clayer**, “Religion, Nationsbildung und Gesellschaft,” in *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung*, ed. Oliver-Jens Schmitt (München: Oldenbourg, 2009): 107-118.
- [15] **Albert Doja**, “La société albanaise face à l’Islam: Approche ethnologique,” *Les Annales de l’Autre Islam* 1 (1993): 47-59; **Albert Doja**, “Ethnicité, construction nationale et nationalisme dans l’aire albanaise: Approche anthropologique du conflit et des relations interethniques,” *Ethnologia Balkanica: Journal for Southeast European*

- Anthropology 3 (1999): 155-179, <https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=75851>; **Albert Doja**, "Formation nationale et nationalisme dans l'aire de peuplement albanais," *Balkanologie: Revue d'Études Pluridisciplinaires* 3, no. 2 (1999): 23-43, <https://doi.org/10.4000/balkanologie.738>.
- [16] **Albert Doja**, "L'idée de nation: du postulat de Marcel Mauss à la question actuelle des identités nationales et culturelles," *Revue de l'Institut de Sociologie*, no. 1-4 (1996): 201-212; **Albert Doja**, "Entre invention et construction des traditions: l'héritage historique et culturel des Albanais," *Nationalities Papers: The Journal of Nationalism and Ethnicity* 28, no. 3 (2000): 417-448, <https://doi.org/10.1080/713687477>; **Albert Doja**, "The politics of religion in the reconstruction of identities: the Albanian situation," *Critique of Anthropology* 20, no. 4 (2000): 421-438, <https://doi.org/10.1177/0308275X0002000404>.
- [17] **Nathalie Clayer**, *Religion et nation chez les Albanais (XIXe-XXe siècles)* (Istanbul: Isis, 2002).
- [18] **Nathalie Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais: la naissance d'une nation majoritairement musulmane en Europe* (Paris: Karthala, 2007; repr., 2018).
- [19] **Alexandre Popovic**, *L'islam balkanique: les musulmans du sud-est européen dans la période post-ottomane* (Wiesbaden: Harrassowitz, 1986).
- [20] **Nathalie Clayer**, *L'Albanie, pays des derviches: les ordres mystiques musulmans en Albanie à l'époque post-ottomane, 1912-1967* (Wiesbaden: Harrassowitz, 1990).
- [21] **Nathalie Clayer**, *Mystiques, État et Société: les Halvetis dans l'aire balkanique de la fin du 15e siècle à nos jours* (Leiden: Brill, 1994).
- [22] **Xavier Bougarel and Nathalie Clayer**, eds., *Le nouvel Islam balkanique: les musulmans acteurs du post-communisme (1990-2000)* (Paris: Maisonneuve & Larose, 2001); **Nathalie Clayer and Xavier Bougarel**, *Les musulmans de l'Europe du sud-est: des empires aux États balkaniques* (Paris: Karthala, 2013).
- [23] **Nathalie Clayer**, "Bektachisme et nationalisme albanais," *Revue des Études Islamiques* 60, no. 1 (1992): 271-300.
- [24] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 475.
- [25] **Nathalie Clayer**, "The Bektashi institutions in Southeastern Europe: Alternative Muslim official structures and their limits," *Die Welt des Islams* 52, no. 2 (2012): 183-203, 186, <https://doi.org/10.1163/157006012x641692>.
- [26] **Peter Bartl**, *Die albanischen Muslime zur Zeit der nationalen Unabhängigkeitsbewegung, 1878-1912* (Wiesbaden: Harrassowitz, 1968).
- [27] **George Gawrych**, *The Crescent and the Eagle: Ottomans rule, Islam and the Albanians, 1874-1913* (London: I.B.Tauris, 2006).
- [28] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*.
- [29] **Stavro Skendi**, *The Albanian national awakening, 1878-1912* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 1967; repr., 2015); **Aleks Buda, Selim Islami, and Kristo Frashëri**, *Historia e Shqipërisë*, 2 vols. (Tirana: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1959-1964); **Stefanaq Pollo et al.**, *Histoire de l'Albanie des origines à nos jours* (Roanne: Horvath, 1974); **Stefanaq Pollo**, ed., *Historia e Shqipërisë*, 4 vols. (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1983).
- [30] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 10-11.
- [31] **Doja**, "Ethnicité, construction nationale et nationalisme dans l'aire albanaise: Approche anthropologique du conflit et des relations interethniques."; **Doja**, "Formation nationale et nationalisme dans l'aire de peuplement albanais."; **Doja**, "Entre invention et construction des traditions: l'héritage historique et culturel des Albanais."

- [32] **Doja**, “The politics of religion in the reconstruction of identities.”
- [33] **Albert Doja**, “À propos de la diversité locale des traditions culturelles albanaises,” *Ricerca Folklorica: Contributi allo Studio della Cultura delle Classi Popolari* 38, no. 1-2 (1998): 63-74, <https://doi.org/10.2307/1479953>.
- [34] **Albert Doja**, “Histoire et dialectique des idéologies et significations religieuses,” *The European Legacy: Towards New Paradigms* 5, no. 5 (2000): 663-686, <https://doi.org/10.1080/713665519>.
- [35] **Albert Doja**, “A political history of Bektashism from Ottoman Anatolia to Contemporary Turkey,” *Journal of Church and State* 48, no. 2 (2006): 421-450, <https://doi.org/10.1093/jcs/48.2.423>.
- [36] **Albert Doja**, “A political history of Bektashism in Albania,” *Politics, Religion & Ideology* 7, no. 1 (2006): 83-107, <https://doi.org/10.1080/14690760500477919>.
- [37] **Albert Doja**, “Spiritual surrender: from companionship to hierarchy in the history of Bektashism,” *Numen: International Review for the History of Religions* 53, no. 2 (2006): 448-510, <https://doi.org/10.1163/156852706778941996>.
- [38] **Albert Doja**, “The politics of religious dualism: Naim Frashëri and his elective affinity to religion in the course of 19th-century Albanian activism,” *Social Compass: International Review of Sociology of Religion* 60, no. 1 (2012): 115-133, <https://doi.org/10.1177/0037768612471770>; **Enika Abazi and Albert Doja**, “Further considerations on the politics of religious discourse: Naim Frashëri and his Pantheism in the course of nineteenth-century Albanian nationalism,” *Middle Eastern Studies* 49, no. 6 (2013): 859-879, <https://doi.org/10.1080/00263206.2013.836495>.
- [39] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 57.
- [40] **Doja**, “The politics of religion in the reconstruction of identities.”; **Doja**, “A political history of Bektashism in Albania.”; **Albert Doja**, *Bektashizmi në Shqipëri: Histori Politike e një Lëvizjeje Fetare / Bektashism in Albania: political history of a religious movement*, Bilingual ed. (Tirana: AIIS Press, 2008).
- [41] **Clayer**, *Religion et nation chez les Albanais*, 135.
- [42] **Clayer**, “Bektachisme et nationalisme albanais.”
- [43] Si p.sh. radhazi tek **Alexandre Popovic and Gilles Veinstein**, eds., *Bektachiyya: études sur l'ordre mystique des Bektachis et les groupes relevant de Hadji Bektach* (Istanbul: Isis, 1995), 277-308; **Clayer**, *Religion et nation chez les Albanais*, 103-135; **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 474-493.
- [44] **Clayer**, *Religion et nation chez les Albanais*, 7.
- [45] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 474, theksimi i shtuar.
- [46] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 491.
- [47] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 493.
- [48] **Clayer**, *Religion et nation chez les Albanais*, 5.
- [49] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 568.
- [50] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 475.
- [51] **Ger Duijzings**, *Religion and the politics of identity in Kosovo* (London: Hurst, 2000), 157–175.
- [52] Shih **Albert Doja**, “Cultural politics and spiritual making of anthropologists,” *Reviews in Anthropology* 33, no. 1 (2004): 73-94, <https://doi.org/10.1080/713649341>; **Albert Doja**, “The dangerous politics of identity,” *Focaal: Journal of Global and Historical Anthropology* 43, no. 1 (2004): 149-156, <https://doi.org/10.3167/092012904782311443>; **Albert Doja**, “Kurthe të një etnografie të rrezikshme në përfytyrimin antropologjik,” review of Ger

- Duijzings, Religion and the politics of identity in Kosovo (London: Hurst, 2000), Përpejka (Endeavour) 11, no. 20 (2005): 72-85.
- [53] **Georg Stadtmüller**, “Der Derwischorden der Bektaschi in Albanien,” in *Serta Slavica: In Memoriam Gedenkschrift für Alois Schmaus*, ed. Wolfgang Gesemann and Johannes Holthusen (München: Trofenik, 1971): 683-688.
- [54] Si p.sh. **Stuart Mann**, *Albanian literature: An outline of prose, poetry, and drama* (London: Quaritch, 1955); **Robert Elsie**, *History of Albanian literature*, East European monographs, 379, (Boulder/New York: Columbia University Press, 1995).
- [55] **Duijzings**, Religion in Kosovo.
- [56] **Clayer**, L’Albanie, pays des derviches; **Clayer**, *Mystiques, État et Société*.
- [57] **Frederick DeJong**, “The iconography of Bektashism: a survey of themes and symbolism in clerical costume, liturgical objects and pictorial art,” *Manuscripts of the Middle East* 4 (1989): 7-29, 10.
- [58] **Albert Doja**, “Confraternal religion: from liberation theology to political reversal,” *History and Anthropology* 14, no. 4 (2003): 349-381, <https://doi.org/10.1080/0275720032000156488>; **Doja**, “The politics of religious dualism in Naim Frashëri.”; **Abazi and Doja**, “Further considerations on the politics of religious discourse in Naim Frashëri.”
- [59] Shih **Doja**, “A political history of Bektashism in Albania.”; **Doja**, *Bektashizmi në Shqipëri*.
- [60] Shih, p.sh., **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 481.
- [61] **Skendi**, *The Albanian national awakening, 1878-1912*.
- [62] **Skendi**, *The Albanian national awakening, 1878-1912*, 469-470.
- [63] **Abazi and Doja**, “From the communist point of view: Cultural hegemony and folkloric manipulation in Albanian studies under socialism.”
- [64] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*.
- [65] **Skendi**, *The Albanian national awakening, 1878-1912*; shih edhe **Doja**, “Ethnicité, construction nationale et nationalisme dans l’aire albanaise: Approche anthropologique du conflit et des relations interethniques.”; **Doja**, “Formation nationale et nationalisme dans l’aire de peuplement albanais.”; **Doja**, “Entre invention et construction des traditions: l’héritage historique et culturel des Albanais.”
- [66] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*.
- [67] **Edward-Hallett Carr**, *What is history*, 2nd ed. (London: Macmillan, 1961; repr., 1987), 11.
- [68] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 16.
- [69] **Benedict Anderson**, *Imagined communities: reflections on the origin and spread of nationalism*, Revised ed. (London/New York: Verso, 1983; repr., 2006).
- [70] **Ernest Gellner**, *Nations and nationalism* (Ithaca: Cornell University Press, 1983).
- [71] **Miroslav Hroch**, *Die Vorkämpfer der nationalen Bewegung bei den kleinen Völkern Europas: Eine vergleichende Analyse zur gesellschaftlichen Schichtung der patriotischen Gruppen* (Praha: Universita Karlova, 1968).
- [72] **Slobodan Markovich**, “Patterns of National Identity Development among the Balkan Orthodox Christians during the Nineteenth Century,” *Balkanica* 44 (2013): 209-254, <https://doi.org/10.2298/BALC1344209M>.
- [73] **Eric Hobsbawm**, *Nations and nationalism since 1780: programme, myth, reality* (Cambridge: Cambridge University Press, 1992), <https://doi.org/10.1017/CCOL0521439612>, 115.
- [74] **Clayer**, *Aux origines du nationalisme albanais*, 12.

- [75] Si p.sh. **Stephanie Schwandner-Sievers**, “Jungfrauen und Elefanten im Porzellanladen: Zur internationaler Herausforderung der albanischen Ethnologie im Postsozialismus,” in *Albanische Geschichte: Stand und Perspektiven der Forschung*, ed. Oliver-Jens Schmitt (München: Oldenbourg, 2009): 187-214, 207.
- [76] **Doja**, “The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context.”
- [77] **Jacques Derrida**, *De la grammatologie* (Paris: Minuit, 1967).
- [78] **Michel Foucault**, *L’Archéologie du savoir* (Paris: Gallimard, 1969).
- [79] **David Schalkwyk**, “What’s in a name? Derrida, apartheid, and the logic of the proper name,” *Language Sciences* 22, no. 2 (2000): 167-191, 168, [https://doi.org/10.1016/S0388-0001\(99\)00011-X](https://doi.org/10.1016/S0388-0001(99)00011-X).
- [80] **John Searle**, “The Word Turned Upside Down,” *The New York Review of Books*, 27 October 1983, Followed by “An Exchange on Deconstruction”, 02 February 1984, <http://www.nybooks.com/articles/1983/10/27/the-word-turned-upside-down/>, <https://www.nybooks.com/articles/1984/02/02/an-exchange-on-deconstruction/>; **John Searle**, “Literary Theory and its Discontents,” *New Literary History* 25, no. 3 (1994): 637-667, <https://doi.org/10.2307/469470>; **John-Martin Ellis**, *Against deconstruction* (Princeton, N.J.: Princeton University Press, 1989); **Renaud Garcia**, *Le Désert de la critique: Déconstruction et politique* (Paris: l’Échappée, 2015); **Morgan Brown**, *A Rationalist Critique of Deconstruction: Demystifying Poststructuralism and Derrida’s Science of the Non* (Dallas, GA: Culture-Anarchy, 2017).
- [81] Barry Smith et al. “Open letter against Derrida receiving an honorary doctorate from Cambridge University”, *The Times* (London), Saturday, 09 May 1992.
- [82] Shih **Doja**, “The New German-speaking School of Balkankompetenzen: Knowledge production and truth claims in post-colonial post-communist context.”
- [83] **Foucault**, *L’Archéologie du savoir*.
- [84] **Derrida**, *De la grammatologie*.
- [85] **Edward Said**, *Orientalism* (New York: Pantheon, 1978; repr., 1994, 2003).
- [86] **Albert Doja**, “The kind of writing: anthropology and the rhetorical reproduction of post-modernism,” *Critique of Anthropology* 26, no. 2 (2006): 157-180, <https://doi.org/10.1177/0308275X06064993>; **Albert Doja**, “Creative misreading and bricolage writing: A structural appraisal of a poststructuralist debate,” *Portuguese Review of the History of the Book* 11, no. 22 (2007): 89-104, <http://halshs.archives-ouvertes.fr/halshs-00405944>.
- [87] **Schwandner-Sievers**, “Jungfrauen und Elefanten im Porzellanladen: Zur internationaler Herausforderung der albanischen Ethnologie im Postsozialismus,” 207.
- [88] **Janet Afary and Kevin Anderson**, *Foucault and the Iranian Revolution: gender and the seductions of Islamism* (Chicago: University of Chicago Press, 2005), 90-93.
- [89] Shih **Elena Pokalova**, “Framing Separatism as Terrorism: Lessons from Kosovo,” *Studies in Conflict & Terrorism* 33, no. 5 (2010): 429-447, <https://doi.org/10.1080/10576101003691564>; **Albert Doja**, “In Hoc Signo Vincas: The Politics of Religion as a Source of Power and Conflict,” *Politics, Religion & Ideology* 20, no. 4 (2019): 447-466, <https://doi.org/10.1080/21567689.2019.1697871>.
- [90] **Searle**, “The Word Turned Upside Down.”
- [91] Shih edhe “Reality Principles: An Interview with John Searle”, *Reason Magazine*, 01 February 2000, <https://reason.com/archives/2000/02/01/reality-principles-an-intervie/print>.

[92] Jacques Derrida, "Afterword: Toward an Ethic of Discussion", Limited Inc. (Northwestern University Press, 1988), p. 158, n. 12.

[93] **Kastriot Myftaraj**, Terrorizmi historiografik (Tirana: Plejad, 2009).

* **Studimi** është botuar fillimisht në aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Studimet për Shqiptarët në France" organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 29-30 tetor 2021.

1.5 ABD Grid RROJI

Paria e Tiranës si penguesja kryesore e shtetkombit të shqiptarëve

Çështja Kombëtare Shqiptare mbetet e pazgjidhur. Shqiptarët sot jetojnë të ndarë në disa shtete me dinamika dhe specifika të ndryshme. Sakaq, sistemi ndërkombëtar është fazën e një transformimi epokal, ku po përballen interesa të fuqive të mëdha si SHBA, Kina, BE-ja, dhe Rusia për rolin e secilës në sistemin e ri që po përvijohet. Shqiptarët e gjejnë veten në ballë të stuhive që po përvijohen, pa qenë nën mbrojtjen e një shtetkombi të përbashkët i cili do t'i mbronte interesat e kombit nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme.

Në këtë shkrim do të argumentoj se interesat e Parisë së Tiranës, një grupim kompakt që udhëheq shtetin e Shqipërisë londineze qysh prej rënies së komunizmit drejton shtetin shqiptar londinez bien ndesh kryekëput me interesat e kombit shqiptar. Duke përqafuar konceptin liberal të shtetit, I cili e sheh atë thjesht si një instrument dhune për të përmbushur racionalisht objektivat e veta të kontrollit, Paria e Tiranës i ka dalë ndesh interesave shqiptare dhe e rrezikon së tepërmi Çështjen Kombëtare Shqiptare.

Ky përfundim mbështetet në tri teza : së pari, Paria e Tiranës e përbërë nga shtresat drejtuese të regjimit enverist bashkë me një pjesë të profesorati krijoi atë që Shinasi A. Rama e përkufizon si një aleancë arriviste me mendësi të theksuar katundare, emëruesi i përbashkët i të cilës ishte interesi personal dhe i ngushtë dhe jo ruajtja dhe ndërtimi i shtetit. Duke adoptuar këtë mendësi anti-kombëtare, Paria e Tiranës e ka minuar shtetkombin, ka krijuar një shtet funksional që ka objektiv mbajtjen e kontrollit mbi shqiptarët dhe pasurimin e vet, dhe e ka vënë atë në shërbim të interesave personale dhe të huaja; së dyti, duke kapur strukturat e shtetit dhe duke i vendosur ato në shërbim të interesave personale, Paria e Tiranës ka krijuar një regjim gjithnjë e më autoritar, i cili legjitimohet nga një demokraci fasade. Kjo demokraci fasade shërben si mbuloja për të garantuar pushtetin e Parisë, i cili kësajsoj bëhet pengesa kryesore e shtetkombit të shqiptarëve. Për pasojë, megjithëse është përpjekur, Paria e Tiranës e ka humbur gradualisht legjitimitetin për t'u konsideruar si drejtuesja natyrale e shqiptarëve drejt mbërritjes së objektivave tona strategjike kombëtare.

Përditë e më tepër po vërehet se boshti kombëtar shqiptar është zhvendosur nga Tirana drejt aksit Prishtinë-Shkup; së treti, Paria ka krijuar mekanizma të sofistikuar e me shumë shtresa kontrolli të opinionit, dhe ja ka dalë të shfrytëzojë mendësinë katundare për të garantuar mbështetjen e mjaftueshme në sistemin e demokracisë fasadë.

Duke qenë së objektivi kryesor i saj është ruajtja e pushtetit dhe pasurimi i familjeve përkatëse, agjenda kombëtariste shqiptare përbën të pengesën kryesore për arritjen e synimeve politike dhe ekonomike të tyre. Ndaj dhe Paria ka përdorur një strategji të dyfishtë. Herë e ka shfaqur veten si europianiste dhe ithtare e integritit globalist, e kur i është dashur për të ruajtur kontrollin e shtetit, e ka përdorur kombëtarizmin si strehën e fundit.

Më tej, përqaftimi i këtij kamaleontizmi hiperpragmatik i ka lejuar të hidhen në prehrin e interesave të huaja armiqësore për Shqipërinë. Për shembull, qysh prej 1991-shit Shqipëria ka pasur drejtues të shtetit të cilët kanë ndihmuar regjimin kriminal të Millosheviçit duke i shitur naftë, si dhe kanë përqaftuar agjendën e ish-pazhit të Millosheviçit sot drejtues i agjendës serbe Vuçiç duke u bërë pjesë e Ballkanit të Hapur pa Kosovën.

Më në jug, udhëheqësit e shtetit shqiptar kanë shitur pjesë të territorit detar në kufi me Greqinë, kanë pritur kryeministra shovinistë si Miçotaqi në Himarë me flamuj grek e nën parrullat e të ashtuquajturit Vorio Epiri, dhe kanë lejuar pa dallime ideologjike zbatimin e agjendës greke në Shqipëri. Shembuj të spikatur janë vendosja e një ish koloneli të Asfalisë në krye të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, dhënia e kontrollit Greqisë mbi sistemin e bankave dytësore, shpopullimi i zonave Juglindore për të krijuar kordonin vllaho-ortodoks i cili i shërben projektit të Vorio Epirit etj.

Nga pikëpamja e forcimit të shtetit, Paria ka delegitimuar drejtësinë duke lejuar korruptimin deri në kriminalitet të të gjitha hallkave administrative të shtetit, ka zhbërë në themel strukturën ushtarake shqiptare duke e zëvendësuar konceptin e parandalimit me anë të fuqisë kombëtare me atë të parandalimit si pjesë e një aleance, dhe po vazhdon në rrugën e çshqiptarizimit të territorit me anë të mekanizmave migratore në dalje dhe në hyrje.

Për t'i mbërritur objektivat e veta, Paria e Tiranës ka shfaqur një dyzim të thellë midis retorikës dhe veprimtarisë së vet. Retorika shpeshherë i referohet historisë së shqiptarëve, ndërsa në të njëjtën kohë veprimtaria e drejtuesve të shtetit shqiptar gjatë këtyre tri dekadave përpiket t'ja zhveshë identitetin shqiptar shtetit, duke treguar kështu se shtetkombi është armiku kryesor i tyre. Duhet theksuar se megjithë retorikën e ndezur dhe dasitë e forta që kultivon në popull për interesat e veta, Paria vepron kompaktësisht dhe në unison për ruajtjen e kontrollit mbi shtetin autoritarist. Sali Berisha, Fatos Nano, Edi Rama, Ilir Meta, dhe të gjithë liderucët e tjerë të Parisë nuk dallojnë kur vjen puna tek ruajtja e karakterit të shtetit si shtet pa thelb kombëtar, shitja e interesave shqiptare për hir të ruajtjes së pushtetit dhe influencës së tyre në zona të caktuara, dhe përdorimi i Çështjes Kombëtare dhe veçanërisht Kosovës si mall shkëmbimi në marrëdhëniet e tyre me pronarët e huaj të shtetit shqiptar. Aq më pak ka dallime në mënyrat që ata së bashku përdorin për të ruajtur kontrollin e pushtetit të cilat kanë sjellë kriminalizimin e theksuar të

strukturave shtetërore, pranimin e mendësisë hiperliberiste dhe tjetërsuar vullnetin popullor.

Në thelb, Paria e Tiranës ka dështuar në projektin e vet ideologjik dhe ka ngecur në mekanizma ideologjikë të tejkaluar e primitivë. Mirëpo, duke kontrolluar rreptësisht levat e shtetit, Paria ka dëmtuar dhe dëmton rëndë Çështjen Kombëtare Shqiptare duke zaptuar shtetin dhe duke e vendosur atë në kundërshtim me sintezën e sigurisë së shqiptarëve. Për t'a thënë shkurt, Paria e Tiranës punon haptazi për interesa që bien ndesh me interesat kombëtare shqiptare.

I.Shtetkombi që na duhet dhe e ardhmja e shqiptarëve

Njëri nga debatet më pak të lëvruara në dhjetëvjeçarët e fundit si nga Akademia e Shkencave por edhe nga profesori universitar në hapësirën shqiptare të Shqipërisë Londineze është ai për zgjidhjen e Çështjes Kombëtare shqiptare. Ky është një debat shumë i dobishëm dhe në gjykimin tim i domosdoshëm, i cili përfshin analizën mbi rolin e shtetit në shoqërinë shqiptare dhe mënyrën me të cilën mund dhe duhet të ndërtohet shteti i shqiptarëve.

Dy janë çështjet kyçe që meritojnë trajtim :(1) debati mbi kombformimin; dhe (2) debati mbi shtetin.

Debati për kombformimin lidhet me identitetin e shqiptarëve, transformimet që ka pësuar në përballjen me modernitetin si dhe faktorët politikë që ndikojnë në formimin, ngjizjen dhe përforcimin e procesit nga të qenit etni në komb. Përkufizimi i shqiptarisë përbën pikën themelore të këtij debati. Në këtë kuptim, kombi konceptohet si një bashkësi ekzistenciale e cila ka të përbashkët sintezën e sigurisë që garanton sigurinë fizike individuale dhe të përbashkët dhe që mëton të ndërtojë shtetin e vet .

Debati për shtetin, rolin e tij në shoqëri si dhe formën strukturore të shtetkombit është një tjetër pike kyçe e debatit në këtë pikë kthese për të ardhmen e shqiptarëve. Shteti është mekanizmi shtrëngues i cili garanton sintezën e sigurisë dhe e mbron kombin nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme.

Më poshtë, pa pretenduar të paraqes apo t'u jap përgjigje shteruese të gjitha debateve dhe pyetjeve në këtë fushë të rëndësishme për shqiptarët, do të jap disa mendime të miat mbi këtë çështje duke u ndalur veçanërisht tek ato aspekte të shtetndërtimit që garantojnë legjitimitetin e shtetit si dhe rolin e pazëvendësueshëm të identitetit për pranimin e ushtrimit të dhunës legjitime nga shteti.

Qëllimi im është të kontribuoj në një debat të shëndetshëm mbi kombin dhe shtetin dhe rolin e tij për shqiptarët, i cili është i domosdoshëm në këtë pikë kritike për Shqipërinë.

Pasi të shtjelloj disa mendime mbi rëndësinë e shtetit në organizimin e shoqërisë bashkohore, do të ndalem në disa nga teoritë më të përhapura të shtetndërtimit duke evidentuar pikat kryesore. Më tej do të shtjelloj arsyet pse përgjigjet më të plota në këtë pikëvështrim i japin teoritë kombëtariste, rolin e parisë së Tiranës në dështimin dhe shmangien e ndërtimit të strukturave shtetërore të duhura gjatë tranzicionit post-komunist, dhe do të përfundoj duke dhënë gjykimin tim mbi llojin e shtetit që na duhet për ti rezistuar trysnive të brendshme e të jashtme në kohët e sotme dhe për t'a përparuar Çështjen Kombëtare Shqiptare.

II. Teoritë e Shtetit dhe roli i tij në shoqëri

Roli i shtetit është kyç në mbarëvajtjen e një shoqërie moderne si një bashkësi strukturash me karakter autoritar, të cilat garantojnë pikësëpari sigurinë vetjake të qytetarit, por edhe fiksojnë dhe zbatojnë një seri rregullash të funksionimit të shoqërisë.

Shumica dërrmuese e studiuesve janë dakord se strukturat shtetërore kombëtare luajnë një rol qëndror në ndërtimin e shoqërive të stabilizuara dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Më konkretisht, të gjitha vendet me ekonomi dhe sistem politik të zhvilluar e të qëndrueshëm si SHBA-të, Gjermania, Britania e Madhe etj. kanë një shtet të fortë me struktura të konsoliduara, të cilat mbrojnë pa mëdyshje e me forcë sigurinë fizike dhe ekonomike të bashkëkombasve, në kuadrin e interesave shtetërore dhe kombëtare pavarësisht luhatjes së udhëheqësisë të diktuar nga sistemi demokratik i përzgjedhjes së drejtuesve të shtetit.

Nga pikëpamja e shtetndërtimit, edhe shtete të cilat nuk e kanë arritur nivelin ekonomik të mirëqenies të shteteve perëndimore si Rusia, Kina, Brazili, India etj., kanë ndërtuar struktura të konsoliduara shtetërore të cilat shërbejnë si për të kontrolluar pushtetin, mbrojtur interesat kombëtare përkatëse ashtu edhe për të garantuar ndikimin e këtyre vendeve në arenën ndërkombëtare. Thënë shkurt, shteti është struktura dominuese shoqërore në botën bashkohore e cila mbron sintezën e sigurisë individuale dhe të bashkësisë kombëtare.

Ka disa shkolla mendimi mbi origjinën dhe rolin e shtetit në shoqëri. Shumica e studiuesve të shtetit bashkohor e fillojnë analizën tek diagrama socio-politike e Maks Veberit, e cila e sheh shtetin si një aparat burokratik hierarkik që synon të marrë monopolin e dhunës së ligjshme mbi qytetarët brenda një territori caktuar. Shteti përkufizohet nga kufij të përfutueshëm dhe të qëndrueshëm, popullata brenda territorit, aftësia e një grupi brenda territorit për të qeverisur në mënyrë autonome dhe njohja nga shtetet e tjera si bashkësi sovrane.

Sipas Veberit, strukturat shtetërore janë institucione të cilat marrin përsipër ekskluzivitetin e dhunës së ligjshme mbi qytetarët me qëllim ruajtjen e ekulibrave shoqërorë. Më tej, Veberianët argumentojnë se burokratizimi i strukturave të shtetit krijon institucione dhe ekulibre të qëndrueshme institucionale, të cilat nuk varen nga pushteti por punojnë për të mbrojtur interesat autonome të shtetit. Po ashtu, zeitgeist-i i shtetit është nevoja e shoqërisë për të racionalizuar proceset e qeverisjes dhe pritshmëritë e qytetarit. Kësisoj, funksionet e shtetit përfshijnë vendosjen e ligjeve, mbrojtjen e sigurisë publike, mbrojtjen e interesave të veçanta individuale të sanksionuara me ligj, mirëfunksionimin e sistemeve të arsimit dhe mbrojtjes shoqërore, si dhe mbrojtjen e territorit të shtetit nga rreziqet e jashtme. Pra, Veberi na jep skeletin e një shteti modern, i cili funksionon rregullisht. Por forma strukturore nuk është i vetmi aspekt që përcakton shteti. Historia e shtetformimit ka një rëndësi po aq themelore. Më tej, modeli Veberian i shtetit nuk e shpjegon në mënyrë shteruese ekzistencën e kombit si një entitet më vetë, i cili rrjedh nga konsolidimi i etnisë në një formë më të përparuar.

Nga një pikëvështrim historik, Çarlls Tilli arrin në përfundimin se shteti modern në Evropën perëndimore u ndërtua si pasojë e proceseve të dhunshme të udhëhequra nga strukturat ushtarako-financiare, të cilat patën sukses në konsolidimin e pushtetit nëpërmjet shtetit. Tilli ripohon kësisoj karakterin e shtetit si një aparat burokratik i ushtrimit të dhunës së ligjshme nga disa shtresa të caktuara të shoqërisë në bashkëpunim të ngushtë me njëra tjetrën. Kjo dhunë legjitimohet mëpastaj me anë të konsolidimit të strukturave që garantojnë qëndrueshmërinë e shtetit dhe parimeve që i udhëheqin këto struktura.

Në të njëjtën frymë mendimi, Openhajmeri argumenton se shteti perëndimor u krijua në këtë formë dhe në këtë mënyrë për të konsoliduar raportet e pabarabarta midis popujve të ndryshëm të krijuara nga proceset pushtuese dhe kolonizuese. Pra për këtë grup studiuesish fokusi është tek aktorët e veçantë brenda strukturave shoqërore feudalo-kapitaliste, të cilët qenë të aftë të ushtrorin dhunën e duhur për të vendosur autoritetin absolut të shtetit si aparat ekskluziv të dhunës së ligjshme. Roli i shtetit edhe në këtë këndvështrim shihet si i ndarë nga bashkësia kombëtare.

Nisur nga një analizë klasore, një grup studiuesish marksistë kanë evidentuar se sidomos kur shteti ngrihet mbi rrënojat e shtetit kolonial, i cili kishte për qëllim të deklaruar sundimin e shtetit amë mbi territorin e kolonizuar, elitat vendase të dala nga revolucionet çliruese e përdorin strukturën koloniale për të krijuar sundimin e tyre mbi klasat e varfra duke rikrijuar marrëdhënien hegjemonike të kolonive.

Sipas Kroford Jang-ut, në Afrikën e dekolonizuar hegjemonia e jashtme u zëvendësua nga një hegjemoni e brendshme e elitave, e cila i përgjigjet nevojës së elitave për të mbajtur pushtetin ekonomik dhe politik edhe duke përdorur të

ashtuquajturin “shteti i lëmoshave”, si dhe për të mbajtur pjesën tjetër të shoqërisë nën sundim.

Në të njejtën frymë, Mamdani argumenton se shteti post kolonial është i dyzuar, me një palë rregulla për qendrën ku jetojnë elitat e perëndimorizuara që kontrollojnë burimet ekonomike, financiare dhe politike të vendit, dhe një palë rregulla të tjera për zonat ruralo-tribale të cilat përdorin mekanizma më tradicionale për të ruajtur kompaktësinë shoqërore.

Disa neo-marksistë të tjerë si Fernando Kardoza dhe Enco Faletto pohojnë se dështimi i shteteve post-koloniale i detyrohet vazhdimësisë së raporteve ekonomike të varësisë nga ish kolonizuesit, të cilët megjithëse u larguan, ruajtën raporte të privilegjua ekonomike me ish kolonitë e tyre.

Teoricienët e zgjedhjes racionale përqëndrohen tek roli i individit dhe përdorimin e arsyes në raport me interesin vetjak. Sipas racionalistëve, shteti përcaktohet në bazë të dy lloje kufizimesh: kufizimet që vijnë nga interesat dhe ato që vijnë nga institucionet. Sipas tyre, çdo individ vepron në bazë të arsyes për të maksimizuar interesin vetjak, dhe institucionet janë rrjedhojë e puqjes së interesave të shumë qytetarëve racionalë. Si pasojë, teoritë e zgjedhjes racionale përshkruajnë shumë saktë disa nga proceset që kanë të bëjnë me ndërveprimin midis shtetit, elitave dhe pushtetit, si për shembull rolin, interesat dhe sjelljen e elitave, si dhe e shpjegojnë pranimin e mekanizmave shtrëngues të shtetit me anë të mekanizmave të arsyetimit racional. Brus Bueno de Mesquita, Alaster Smith dhe Randolph Siverson e shpjegojnë strukturën e shtetit duke krijuar nocionin e "selektoratit", një grup sundues me interesa të përbashkëta ekonomike, politike dhe financiare i cili krijon marrëdhënie kontrolluese me levat e shtetit. Sipas këtyre studiuesve pra, interesat e këtij grupimi shtresash përcaktojnë kahjen e shtetit dhe kontrollojnë burimet e tij, të cilat më anë tjetër u garantojnë pushtetin.

Institucionalistët, si ata të shkollës së zgjedhjes racionale ashtu edhe ata që përdorin paradigmen e institucionalizmit historik, theksojnë rolin e rëndësishëm të institucioneve si struktura autonome që ndikojnë sjelljen e individëve. Siç shpjegojnë Holl dhe Tejlor, në të tria ravijëzimet e tij institucionalizmi tenton të shpjegojë proceset e konsolidimit të strukturave shtetërore me anë të formëzimit dhe konsolidimit të institucioneve dhe legjitimitetit të tyre. Mirëpo, në ndryshim nga racionalistët, institucionalistët historikë marrin në shqyrtim historinë, vlerat, traditat dhe kthesat historike të popujve të ndryshëm, për të analizuar cilësinë dhe shkallën e qëndrueshmërisë dhe legjitimitetit të shteteve.

Në mënyrë të ngjashme me institucionalistët historikë, disa studiues të cilët e bazojnë argumentin mbi ndërtimin e shtetit tek forma e strukturave shoqërore specifike për vende dhe popuj të ndryshëm, si bie fjala Xhoel Migdal, japin një ndihmesë të vyer për të kuptuar më në thellësi proceset dhe arsyet e pranimin të legjitimitetit të shtetit si mekanizëm shtrëngues dhe autoritar nga

popuj të ndryshëm. Shteti është një mekanizëm shoqëror autoritar i cili nuk mund të qëndrojë në këmbë apo të pranohet nga masa e qytetarëve pa patur në vazhdimësi legjitimitetin e duhur. Migdal argumenton se në varësi të grimcimit shoqëror, shtete të ndryshme kanë aftësi të ndryshme pranimi të autoritetit të shtetit. Mënyra e vetme me të cilën shtetin e fiton legjitimitetin në vazhdimësi në një territor të caktuar është pra për këtë rrymë mendimtarësh e lidhur katërcipërsisht me strukturën e shoqërisë. Ndërsa veberianët shpjegojnë deridiku mirë shtetet e forta, komunitarët përpiqen të shpjegojnë shtetet e dobëta. Duke njohur legjitimitetin e shtetit si pikë qendrore në pranimin e tij nga masa e gjerë, ky grup studiuesish bën një lidhje të qartë midis shtetit si strukturë shtrënguese dhe prirjes së popullit për t'a pranuar autoritetin e tij.

III. Identiteti si aspekt themelor i legjitimitetit të shtetit.

Ajo që në gjykimin tim mungon në të gjitha këto teori të shtetformimit, është përgjigja ndaj pyetjes pse duhet që qytetarët të pranojnë ushtrimin e dhunës nga struktura shtetërore? Cilat janë mekanizmat nëpër të cilat kalon procesi i pranimin të legjitimitetit të shtetit si strukturë themelore autoritare për popuj të ndryshëm, me histori dhe zakone të ndryshme, të cilat kanë objektiva të ndryshëm nga njëri tjetri? Çfarë roli luan identiteti në këto procese?

Përgjigjen e jep në gjykimin tim koncepti i shtetkombit. Ndërsa shteti është një koncept politik dhe nëse dëshirojmë edhe gjeo-politik, kombi përfaqëson një bashkësi etnike, kulturore dhe gjuhësore me identitet të përcaktuar qartë. Me pak fjalë, njeriu është qenie shoqërore dhe si e tillë organizohet në bashkësi. Me kohë, këto bashkësi fitojnë trajta të përbashkëta etnike, gjuhësore, dhe kulturore të cilat përcaktojnë kufijtë e vetë bashkësisë, pra një identitet të qartë e të qëndrueshëm. Pra, me kohë formohet kombi.

Më anë tjetër, paralelisht me formimin e kombit, shteti me autoritetin e vet të padiskutueshëm është verifikuar prej disa shekujsh si struktura më efikase dhe e dobishme për qeverisjen e një territori. Siç e thamë më lart, për të qenë i efektshëm në kryerjen e funksioneve të tij, shteti duhet të jetë legjitim në vazhdimësi. Pra, shteti efektiv duhet të gëzojë mbështetjen e bashkësisë në vendosjen e shtrëngesave dhe të garantojë zbatimin e tyre me anë të përdorimit të dhunës së ligjshme. Rrjedhimisht, shtetet efikase dhe funksionale por edhe të mirëpranuara si instrumenti i vetëm i duhur, janë për kombin mburoja më e mirë për interesat e bashkësisë. Më anë tjetër, shteti si përdorues i dhunës së ligjshme, sidomos në një kontekst demokratik të përzgjedhjes së drejtuesve të shtetit, mund t'i mbijetojë kundërshtive të brendshme vetëm nëse ka si bazë morale për ekzistencën e vet interesat kombëtare. Kombi është për shtetin

benzina e motorit të legjitimitetit, ndërsa shteti është për kombin parzmorja që mbron identitetin kombëtar nga rreziqet e jashtme dhe të brendshme.

Siç e shpreh Shinasi A. Rama “ forma më e epërt e shtetit dhe kombit është shtetkombi, domethënë një shtet dhe një komb të cilët janë amalgama e të njëjtës bashkësi të destinuar për me qenë bashkë për shkak sepse ndajnë një sintezë sigurie identike”.

Për t’ a përmbledhur, shteti gjen legjitimitet tek kombi kur përfaqon dhe mbron pa kompromis interesat kombëtare dhe identitetin kombëtar. Koncepti i kombit dhe lidhja e tij e pazgjidhshme me shtetin si struktura më efikase për të përparuar interesat kombëtare dhe mbrojtur identitetin e tij, janë baza e ndërtimit të një shteti komb të konsoliduar, me struktura shtrënguese të forta e të pranuar nga e gjithë bashkësia.

IV. Shteti Shqiptar gjatë tranzicionit post-komunist.

Nëse e kthejmë vëmendjen nga Shqipëria e tranzicionit post-komunist, vërejmë qartazi se roli i parisë së Tiranës, asaj shtrese drejtuesish të shtetit të dalë nga ish funksionarë të shtetit monist dhe të plotësuar me pjesë të profesoratit dhe inteligjencës, ka luajtur rol kyç në drejtimin që i ka dhënë shtetndërtimit. Mund të konstatohet pa frikë se me dijeni të plotë dhe qëllime të qarta, paria e ndarë në grupime në dukje armiqësore me njëra tjetrën, ka vepruar si një strukturë e mirëkonsoliduar për të shmangur ndërtimin e shtetkombit, për të dobësuar shtetin shqiptar, për të anashkaluar interesat kombëtare e madje për të punuar kundër tyre, në mënyrë që të sigurojë pushtetin dhe pasurimin e shpejtë që rrjedh prej tij. Ky konstatim bazohet në disa fakte të ditura e të pakundërshtuara edhe nga vetë paria.

Pikësëpari, me rënien e regjimit terrorist të Hoxhës, vëmendja e atyre që dolën në krye të shtetit u përqëndrua tek shkatërrimi dhe jo rindërtimi i shtetit. Me gjasë, ata kuptuan se e vetmja mënyrë që të rrinin në pushtet ishte t’ a përdornin shtetin për pushtet, duke shkatërruar legjitimitetin e tij. Megjithëse i vjetëruar dhe në shumë raste obsolet e terrorizues, shteti komunist ishte i ndërtuar mirë, me struktura të qarta e të konsoliduara, të cilat deri në 91shin mbronin klikën që ishte në pushtet. Udhëheqësit e rinj, të frymëzuar nga dora e vjetër e cila kërkonte thjesht një shndërrim të pushtetit të tyre nga komunist në protokapitalist, u kujdesën që t’ i shkatërrojnë një nga një strukturat ushtarake, shtetërore, të inteligjencës, si dhe me teorinë vrastare të çekut të bardhë shkatërruan çfarëdolloj baze për një ekonomi kombëtare të ekuilibruar. Arsyeja e ekzistencës së shtetit shqiptar nuk u bë përparimi i interesave kombëtare, siç do ishte dashur të kish qenë, por një ideologji e vakullt e pa shumë kuptim e mishëruar në togfjalëshin “integrimi euro-atlantik”. Për shembull, sipas strategjisë kombëtare për integrim të publikuar nga Departamenti i Administratës Publike për periudhën 2015-2020, e cila shpreh

vazhdimësinë e strategjive të tilla gjatë të gjitha qeverive “agjenda integruese me BE-në së bashku me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së përfaqësojnë vizionin strategjik duke nënvizuar aspiratën për integrim evropian.

Formulime të ngjashme gjinden në formulimet e programeve të të gjitha partive, paradoksalisht edhe atyre që mëtojnë të jenë ihtarë të kombëtarizmit. Kjo lloj mendësie është propaganduar aq fort, sa që integrimi është shndërruar në një kuazi-meme të cilën të gjithë qytetarët e njohin pa e kuptuar më tej se Çfarë përfaqëson.

Me pak fjalë, shteti shqiptar i tranzicionit paradoksalisht u ndërtua si shtet liberal për t’u integruar në ca struktura mbi shtetërore e mbi kombëtare e jo për të mbrojtur shqiptarët. Shteti i Parisë shërben për të na globalizuar e jo për të ruajtur identitetin shqiptar të shtetit, gjuhën dhe zakonet shqiptare, për të garantuar sundimin e klikave të reja, e jo për të ripërkufizuar e ripërtërirë elitat e vërteta kombëtare. Si pasojë, sipas INSTATIT popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2022 ka pësuar një rënie me 1.3% në krahasim me një vit më parë dhe 3.9% krahasuar me vitin 2011.

Më tej, nëse 96 përqind të banorëve të Shqipërisë deklaroheshin shqiptarë më 1990ën, sot kemi zbritur në 83 përqind. Ekonomia është kaotike dhe e drejtuar nga orekset korruptive të pushtetarëve të radhës, ku sipas një raporti të zyrës së Prezencës së OSBE-së, tre udhëheqësit kryesorë politikë kanë një pasuri të paktën 200 milion secili, kurse sovraniteti i vendit është thjesht një shaka e madhe që nxirret si bedat nga disa vetëm kur u rrezikohen privilegjet korruptive. Më tej, raportet ndërkombëtare tregojnë se vendi prodhon krim dhe zvetënim sa për gjithë Evropën, dhe shoqëria ndjen peshën e rëndë të kriminalizimit dhe “korrupsion është I përhapur në të gjitha degët e qeverisë dhe institucionet lokale” .

Për të ruajtur legjitimitetin, paria ka përdorur si karrotë gjatë këtyre viteve “rrethin vicioz të mendësisë katundare...përqëndrimin tek prona e vogël, si dhe frikën e pandërprerë të njeriut me sjellje jo të ndershme”. Shinasi A. Rama e shpreh shumë qartë këtë koncept tek Përrallat e Tranzicionit Shqiptar :

Duke u vënë në qendër të shoqërisë, paria formëson vlerat, mendësinë dhe e drejton procesin andej nga i intereson asaj. Pra, nga një anë, parisë i intereson që njerëzit të mos mendojnë më larg se sa pragu i shtëpisë së tyre, (koncepti mbisundues është, “larg vatrës sime”) apo më larg se sa kufiri i krimit që mund të kenë kryer. Kjo, d.m.th. që njerëzit të mos kenë mendësinë e një qytetari të interesuar për jetën publike e shoqërore në një shtet e shoqëri të caktuar. Në këtë mënyrë, mendësia e tyre e cunuar dhe ngushtësia e fushëpamjes së tyre, bën që ata të kenë një ide të shtrembëruar për realitetin ku jetojnë. Thënë shkurt, paria ka mbijetuar duke kriminalizuar në çdo qelizë ku ka mundur shoqërinë.

Pikësedyti, justifikimi i parisë se aq ishin mundësitë apo aq dinin nuk përkon me realitetin. Shteti komunist kishte krijuar një shtresë të gjerë, sipas burimeve rreth 2000-2500 vetë, e cila e njihte shtetin, ishte besnike ndaj tij sipas parimeve Veberiane, dhe i kishte të gjitha mundësitë për të ndërmarrë modernizimin e shtetit dhe shoqërisë. Vetë prijatarët e parisë dolën nga ajo shtresë. Sali Berisha ishte doktorant në Francë, ashtu si edhe Kastriot Islami e Skënder Gjinushi. Po ashtu edhe Fatos Nano dhe Gramoz Pashko ishin dërguar nga PPSH-ja për t'u njohur me kapitalizmin dhe strukturat e tij e madje kishin bërë edhe studime të detajuara për atë punë. Pra, nuk mungonte dijenia por vullneti politik për t'a vendosur shtetin në funksion të kombit. Paria ndërtoi struktura shtetërore formalisht të konsoliduara, por në vend që t'a përdorte pushtetin për të ndërtuar shtetkombin, krijoi një shtet veberian në funksion të pushtetit dhe pasurimit të vet.

Më tej, Shqipëria në atë fillim tranzicioni kishte mbështetjen strategjike të një serie aktorësh ndërkombëtarë të cilët ishin të interesuar që Shqipëria të shndërrohej në një pikë të fortë strategjike perëndimore. Një elitë kombëtare e përgjegjshme do t'a kishte shfrytëzuar kontekstin pozitiv ndërkombëtar në favor të ndërtimit të shtetit kombëtar shqiptar dhe mbrojtjes së interesave kombëtare për shkak se siç e shpreha më sipër kjo është e vetmja mënyrë për të ndërtuar një shtet efektiv i cili të ketë legjitimitetin e duhur.

Vështirësitë për parinë ishin po ashtu të mëdha, por jo më të pakapërcyeshme se ato të elitave të tjera në situata të ngjashme si p.sh. Koreja e Jugut më 1950 dhe Sllovenia më 1990. Dështimi i parisë pra ishte teorikisht i parashikueshëm dhe praktikisht i paevitueshëm për shkak se ideologjia e përqaftuar prej tyre ishte kryekëput në kundërshtim me interesat e shqiptarëve dhe si pasojë anti-kombëtare. Dështimi i tyre nuk përbën një dështim administrative por një dështim ideologjik dhe mungesë vullneti politik për të punuar për interesat e shqiptarëve.

Pra, paria e Tiranës është përgjegjësja e vetme e dështimit të shtetit shqiptar për të ruajtur sovranitetin faktik, dhe si pasojë minuesja më e madhe e agjendës kombëtare shqiptare.

Ajo që është e qartë është se në shtetin shqiptar nuk ka forca politike që dëshirojnë dhe kanë vullnetin për të ndërtuar shtetkombin. Siç e kam shprehur në shkrime të mëparshme armiku i vetëm ideologjik i Parisë, koncepti që konkurron me kontrollin e plotë të të gjitha levave të komunikimit dhe kontrollit të tyre mbi shtetin e drobitur shqiptar është kombëtarizmi. Ndaj edhe lufta ndaj tij është e fortë, shumëplanëshe dhe tejet e sofistikuar.

V. Në vend të përfundimit.

Në përfundim, rruga që duhet ndjekur për të krijuar struktura shtetërore të qëndrueshme, të konsoliduara dhe legjitime është e qartë. Shqiptarët kanë

nevojë për një shtet të shqiptarëve, prej shqiptarëve e për shqiptarët. Fqinjët tanë në rajon ka kohë që e kanë adoptuar këtë devizë dhe në këtë pikë shqiptarët janë shumë të vonuar. Një shtet i tillë do të mund të ndërtohej vetëm nëse do të përqafohej projekti i ndërtimit të shtetkombit shqiptar, me mbështetje të gjerë popullore. Trysnia e ushtruar nga poshtë është shndërruar në pikën ku jemi, në kyçin e vërtetë të zgjidhjes së çështjes së shtetkombit shqiptar për shkak të kontrollit të fortë të palëve të parisë mbi të gjitha hallkat e shtetit dhe pushtetit. Pa një shtysë nga poshtë, në gjykimin tim do të jetë e pamundur që të formëzohet vullneti dhe përfaqësimi i duhur politik që do të mundësonte ndryshimin. Shteti që na duhet është shtetkombi i shqiptarëve, sepse vetëm interesi kombëtar do të mund të garantojë ruajtjen e legjitimitetit të strukturave shtrënguese e autoritare të tij, të cilat janë të domosdoshme. Shqiptarët mund të pranojnë shtrëngime për hir të ruajtjes së identitetit të tyre shekullor dhe përparimin e interesave kombëtare. Duke ju referuar historisë, besoj se do të jetë e vështirë që shqiptarët të pranojnë një shtet me burime eksogjene legjitimiteti.

Duke marrë parasysh edhe situatën tejet të ndërlikuar ndërkombëtare, konkurrencën e fuqive të mëdha për ndikim në botë por veçanërisht në rajonin ku jetojnë shqiptarët, zgjidhja e vetme për ne është shtetkombi.

Në nivelin e parimeve politike, ndryshimi duhet mbështetur në vlerat e vërteta të një populli si shqiptarët dhe në një projekt të ri modernizues, të balancuar dhe të mbështetur në themelet e forta të elementëve të mëposhtëm.

Së pari, projekti i ri politik duhet mbështetur në identitetin e padiskutueshëm të shtetit-komb shqiptar. Së dyti, projekti duhet të mbështetet në një sistem politik demokratik. Së treti, në një administratë shtetërore të pakorruptueshme e të mbështetur në ligj. Së katërti, në një ekonomi tregu të institucionalizuar ku i jepet përparësi prodhimit kombëtar. Së pesti, në një politikë të jashtme të bazuar në interesin kombëtar shqiptar. Së gjashti, në luftën e pakompromis kundër krimit e kundër të keqes, në çdo formë që të materializohet e keqja shoqërore. Së shtati, në krijimin e në kultivimin e vlerave të vërteta të një shoqërie që krijon mundësi për të gjithë. Së teti, në kultivimin e vlerave të një shoqërie civile efektive. Së nënti, në ndërtimin dhe konsolidimin e strukturave të shërbimeve shoqërore si edukimi, shëndetësia, e mbrojtja e fëmijëve dhe e pensionistëve. Më në fund, por jo më e fundit, ndërtimi i strukturave funksionale të një sistemi të partive politike i cili të avancojë e të mbrojë interesat e bashkësisë ligjore-politike me mjete legjitime demokratike.

Pengesa kryesore për realizimin e një projekti të tillë politik mbetet Paria e Tiranës dhe veglat e saj të cilat kontrollojnë levat e shtetit dhe injektojnë elementë të mendësisë së ngushtë katundare. Shqiptarët do të arrijnë atë që dëshirojnë vetëm e vetëm kur të bëjnë atë që e kanë bërë të gjitha kombet e tjera të përparuar-të ndërtojnë shtetkombin e vet.

1.6 Dr. Skënder Demaliaj*

ROLI VENDIMTAR DHE PËRCAKTUES I SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË SHPALLJEN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Në 100 vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike Shqipëri-Amerikë

HYRJE

Shpallja e pavarësisë së Kosovës është bërë më 17 shkurt 2008, në Kuvendin e Republikës së Kosovës në Prishtinë. Nga 120 deputetë morën pjesë 109.

Shtetet e para që njohën Kosovën si shtet pas shpalljes së pavarësisë ishin: Kosta Rika, SHBA, Franca, Gjermania, Italia, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe etj.

Gjatë vitit 2008 e kanë njohur pavarësinë e Kosovës 53 shtete, në vitin 2009 – 11 shtete, në vitin 2010 – 8 shtete, në vitin 2011 - 12 shtete, në vitin 2012 – 12 shtete, në vitin 2013 – 8 shtete, në vitin 2014 – 4 shtete, në vitin 2015 – 3 shtete, në vitin 2016 – 2 shtete, në vitin 2017 – 2 shtete, në vitin 2018 – 1 shtet dhe në vitin 2021 – 1 shtet (Izraeli). Gjithsej deri më tani e kanë njohur pavarësinë e Kosovës 117 shtete.

Himni i Kosovës, i kompozuar nga kompozitori Mendi Mengjiçi, për herë të parë ishte intonuar në seancën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Yjet e bardhë në flamurin e Kosovës simbolizojnë komunitetet e ndryshme që jetojnë në Kosovë, harta e verdhë simbolizon pasurinë e Kosovës, ndërsa ngjyra e kaltër simbolizon Evropën.

Në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, ndër të tjera thuhet: “Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jo diskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse...

Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Europës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të

punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Evropën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avancuar të ardhmen tonë të përbashkët evropiane”.

1. Kosova i plotëson të gjitha kushtet për të qenë shtet i pavarur

Rrugëtimi i shqiptarëve të Kosovës për të patur shtetin e tyre të pavarur ka qenë i gjatë, gati një shekull, i vështirë, por i pandërprerë. Kosova i plotëson të gjitha kushtet për të qenë shtet i pavarur:

1. Kosova gëzonte mëvetësinë e saj që në vitin 1868 kur ishte Vilajet. Edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte “njësi e organizuar në pikëpamje partiake, ushtarake, juridike dhe si pjesë integrale e Frontit Antifashist të Ballkanit dhe më gjerë”. Ka patur Komitetin Krahinor të PKJ-së për Kosovë e Metohi, Shtabin e Kryesor të Luftës Nacional Çlirimtare për Kosovë e Metohi, të cilat vareshin nga PKJ dhe Shtabi Qëndor i Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë.
2. Kosova nuk ka qenë asnjëherë pjesë e Serbisë. Kam parasysh aktet juridike ndërkombëtare të Kongresit të Berlinit, vendimet e Kuvendit të Dytë të AVNOJ-it, më 1943, vendimet e Këshillit Antifashist të Çlirimit Popullor, më 1945 kur u shpall Republika Federative Popullore e Jugosllavisë. Edhe në vendimet e tjera të kësaj periudhe nuk është “në Serbinë sovrane dhe të pavarur”, veçse në përbërje “të Serbisë Federale në kuadër të Jugosllavisë Federative”.
3. Kosova është aneksuar me dhunë nga Serbia, më 1912, 1918, 1945, 1989 edhe pse prej kohësh “kishte identitetin e vet historik, etnik të shoqëruar me legjitimitetin e çlirimit të vet historik, qoftë nga pushtuesi ottoman (1912), qoftë nga pushtuesi fashist (1944), edhe pse kishte integritetin gjeografik, ekonomik, demografik dhe kulturor të saj. Është kjo një nga arsyet pse pavarësia e saj nuk bie ndesh me ligjet ndërkombëtare.
4. Sipas Kushtetutës së vitit 1974 të Republikës Socialiste të Jugosllavisë, Kosova është pjesë përbërëse të Federatës së Jugosllavisë (neni 1, 2 i Kushtetutës), kishte territor dhe kufijtë e saj, të cilët nuk mund të ndryshoheshin pa pëlqimin e saj (neni 5), kishte të drejtat dhe detyrat e organeve të administratës të njëjta me ato të organeve të administratës në Republikat e Jugosllavisë (neni 150). Bashkë me Republikat e tjera merrte pjesë në zbatimin e ligjeve, të dispozitave dhe të akteve të përgjithshme në Federatë (neni 273, paragrafi 1,2), ishte e përfaqësuar në Dhomën e Republikave dhe Krahinave të Kuvendit të Jugosllavisë (neni 291, paragrafi 1), në Dhomën Federative të Jugosllavisë (neni 291, paragrafi 1), në Kryesinë e Jugosllavisë, në Këshillin Ekzekutiv Federativ (neni 348, paragrafi 1), në Gjykatën Federative, në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë (neni 381, paragrafi 1). Gjithashtu Kosova është e barabartë me Republikat në çështjen e ndryshimit të Kushtetutës së Jugosllavisë (neni 398, 399, 402, paragrafi 1). Me ndryshimet kushtetuese të Serbisë, më 23 mars

1989 iu hoqën Kosovës këto të drejta me dhunë nga Kuvendi i Serbisë. Ky është edhe akti i parë i krizës kushtetuese në ish Jugosllavi¹.

5. Popullit shumicë (shqiptar) në Kosovë i takon të vetëvendosë për fatet e tij. E ka bërë në Konferencën e Bujanit, më 31 dhjetor 1943 dhe 1, 2 janar 1944, më 2 korrik 1990 me shpalljen e Kosovës Republikë nga Kuvendi i saj, me Kushtetutën e Kaçanikut, më 7 shtator 1990, me Referendumin mbarë popullor, më 26 shtator të vitit 1991 për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur. Populli i aneksuar me dhunë, në mënyrë plebishitare është deklaruar për pavarësi, por edhe me rezistencë të armatosur, më 1997-1999, me luftën heroike të pashembullt të UÇK-së.
6. Gjenocidi serb ndaj shqiptarëve të Kosovës ka qenë që në vitet '70 të shekullit 19, i pandërprerë, i mirë organizuar dhe i drejtuar nga strukturat më të larta shtetërore e partiake, nga Kisha Ortodokse, nga Akademia e Shkencave Serbe. Kulmin ai e arriti në vitin 1999 me shpërnguljen e dhunshme të mase një milion shqiptarëve të Kosovës.
7. Fakti që Shqipëria ekziston si shtet shqiptar nuk është pengesë që Kosova të jetë shtet i pavarur dhe sovran. Kemi rastin e Rumanisë dhe të Moldavisë, të Francës dhe kantonet – shtete të Zvicrës.
8. Janë 34 shtete në OKB me territor më të vogël se Kosova dhe 58 shtete me popullsi më të vogël.
9. Pohimet dashakeqëse se me pavarësinë e Kosovës “shkelen parimet e Helsinkit për krijimin e kufijve të rinj ndërkombëtarë” nuk qëndrojnë. Kemi shembullin e Kroacisë e të Sllovenisë. Bashkësia ndërkombëtare shumë shpejt e pranoi se ajo që po ndodhte me Kroacinë e Slloveninë nuk ishte krijimi i kufijve të rinj, por avancimi i kufijve ekzistues – kufijve të njësive federale – në status ndërkombëtar². Ndryshime me kufijtë pas Konferencës së Helsinkit kanë ndodhur me bashkimin e Gjermanisë, me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, të Jugosllavisë, me ndarjen e Çekisë e të Sllovakisë etj.

Serbia iu drejtua Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të mos e njohur pavarësinë e Kosovës. Më 22 korrik 2010, kjo Gjykatë përmes një Vendimi Këshillëdhënës ri konfirmoi se Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur asnjë nen të Ligjit Ndërkombëtar. Në vend që ta pranonte këtë vendim, sepse vetë iu kishte drejtuar kësaj Gjykate, të njëjtte shtetin e pavarur të Kosovës, kjo shtoi të gjitha përpjekjet për ta zhbërë pavarësinë e Kosovës, për ta penguar atë në organizmat ndërkombëtare, duke patur ndihmën dhe mbështetjen e Ruisë. Kam lexuar libra dhe komente të papranueshme,

1 Stavileci, Esat. (2009). Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve. Gjakovë: Forumi për Iniciativë Demokratike, f. 526.

2 Stavileci, Esat. (2009). Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve. Gjakovë: Forumi për Iniciativë Demokratike, f. 340.

tendencioze, antihistorike të pseudo intelektualëve dhe pseudo studiuesve shqiptarë se pavarësia e Shqipërisë erdhi si rezultat i kompromisit midis Austro-Hungarisë dhe Portës së Lartë, por jo edhe për shkak të luftës së shqiptarëve kundër Turqisë. Po ç'përfaqësojnë Kryengritjet e Mëdha të shqiptarëve në Veri dhe në Kosovë në vitet 1910-1912? Çfarë ndikimi patën ato në shpalljen e pavarësisë?... Kjo nuk do të thotë të mohojmë rolin e Austro-Hungarisë, por as të mos mohojmë luftën dhe gjakun e shqiptarëve në shekuj për liri e pavarësi.

Ose Kosovën e çliroi NATO dhe vetëm NATO me në krye SHBA-të. Pa mohuar rolin e tyre të madh dhe të rëndësishëm me sulmet 78 ditore kundër Beogradit përsëri shtrohet pyetja: Po roli i UÇK-së a duhet pranuar? A do të ndërhynte NATO po të mos ishte dhe të mos luftonte në terren UÇK-ja? Në themel të lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës është edhe gjaku i bijve e i bijave më të mirë të saj. Zilia, miopia dhe mllefi i këtyre pseudo intelektualëve dhe pseudo studiuesve ndaj lidershit të UÇK-së shkon aq larg sa ata shkruajnë: “Pavarësia e Kosovës mund të shpallej më së paku 1 ose 2 muaj pas shpalljes së pavarësisë së Malit të Zi. Por kjo ndodhi, sepse duhej të vinte në pushtet Hashim Thaçi e ai të lexonte Deklaratën e Pavarësisë. Shkurt shpallja e pavarësisë u vonua për ambicien e një njeriu që ai të ishte protagonist i saj”. Rasti i Malit të Zi është krejt tjetër me atë të Kosovës për vetë statusin që ai kishte në RSFJ, por edhe për moskundërshtimin nga Rusia e Serbia.

2. Roli i SHBA në shpalljen e Pavarësisë së Kosovës

Që në presidencën e Bushit të parë, SHBA-të u pozicionuan qartë dhe me vendosmëri në mbështetje të popullit shqiptar të Kosovës, duke dënuar heqjen e autonomisë, më 28 mars 1989, dhunën policore dhe shkeljen e të drejtave dhe lirive të tyre atje. George H. W. Bush i dërgoi një letër Sllobodan Millosheviçit në vitin 1992: “Në rast të konfliktit në Kosovë të shkakuar nga veprimi serb, SHBA do të jenë të gatshme të përdorin forcën ushtarake kundër serbëve në Kosovë dhe në Serbi”³.

Në cilësinë e senatorit në vitin 1995 Joe Biden deklaronte: “Të mos heshtim para krimeve që ushtria serbe po kryen mbi popullsinë civile... Nëse ajo që po ndodh atje nuk përfaqëson interesat dhe vlerat tona, atëherë nuk kemi bërë asgjë pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo nuk përfaqëson vlerat tona”⁴.

SHBA hapën Zyrën e Shërbimit Informativ në Kosovë në vitin 1996. Në vitin 1998 njohën UÇK-në, dënuan të parët Masakrën e Reçakut me ambasadorin William Walker. Më 6 shkurt 1999 bashkë me vendet më të fuqishme të BE-së dhe Rusinë organizuan Konferencën e Rambujesë. I bënë thirrje regjimit të Millosheviçit të ndërpriste represionin ndaj popullsisë

3 Ekonomia sot, 01.12.2018.

4 Ora News, 11 nëntor 2020.

shqiptare, të tërhiqte forcat e policisë e të ushtrisë, të kthente autonominë e vitit 1974..., por këto thirrje ranë në vesh të shurdhër. Kjo bëri që më 24 mars 1999, NATO me në krye SHBA të ndërmerte sulmet ajrore ndaj Beogradit, sulme që zgjatën 78 ditë dhe që e detyruan Millosheviçin të kapitullonte. Kosova u çlirua, më 12 qershor 1999. 50 mijë paqeruajtës me në krye NATO-n dhe SHBA-të hynë në këtë ditë në Kosovë dhe që nga ajo ditë janë garant për sigurinë dhe paqen në Kosovë. Presidenti Klinton në ditën e sulmit ajror të NATO-s iu drejtua kombit amerikan: “Ne po veprojmë për të mbrojtur njerëz të pafajshëm në Kosovë nga ofensiva ushtarake në rritje. Duke vepruar tani, ne mbrojmë vlerat tona, mbrojmë interesat tona dhe çojmë përpara çështjen e paqes”⁵. Pa çlirimin e Kosovës nuk do të kishte pavarësi të saj. Roli i SHBA është vendimtar.

Për Shtëpinë e Bardhë, ndjekja masive dhe sistematike e kosovarëve përfaqësonte në vetvete krim kundër njerëzimit. Shqetësimi i saj i madh ishte se në qoftë se zjarri nuk shuhet në Kosovë, konflikti përhapet dhe i kalon kufijtë shtetërorë⁶.

Qëllimi i fushatës që ndërmori NATO kundër Jugosllavisë (i bombardimeve) ishte: ose të thyhej vullneti i Millosheviçit (apo vullneti i përkrahësve të tij), ose që atij t'i shkatërroheshin kapacitetet për të vazhduar spastrimet etnike në Kosovë... Pas Samitit të NATO-s, pesë kushtet e parashtruara nga ministrat e jashtëm ishin: armëpushim, tërheqje e të gjitha forcave serbe nga Kosova, kthimi i të gjithë refugjatëve dhe i personave të zhvendosur, prania enjë force ndërkombëtare e kryesuar nga NATO⁷.

SHBA që në shtator 1998 paralajmëruan për një zgjidhje politike dhe për t'i dhënë fund dhunës kundër popullatës civile nga regjimi i Millosheviçit, duke kërcënuar edhe me ndërhyrje ushtarake të NATO-s. Në memon e Këshilltarit të Bill Klintonit për çështjet e sigurisë, Samuel Berger thuhet: "Me të afruar dimri e me rezistencën e mëtejshme të Slllobodan Millosheviçit është arritur pajtimi se ka ardhur koha, ku duhet mbështetur kërkesa ndërkombëtare për zgjidhje politike dhe për t'i dhënë fund dhunës kundër popullatës civile nëpërmjet kërcënimit me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s"⁸.

Masakra e Reçakut e 15 janarit 1999 e përshpejtoi nevojën për një zgjidhje politike. Kjo është edhe arsyeja përse u thirr Konferenca e Rambujesë, e cila dështoi, sepse nuk u firmos nga delegacioni jugosllav. Përballë refuzimit kategorik të Millosheviçit për zgjidhjen e krizës në Kosovë me mjete politike, nuk pati zgjidhje tjetër përveç sulmit ushtarak të

5 Zëri i Amerikës, 17.02.2018.

6 **Cernomyrdin, Viktor S, Talbott, Strobe.** *Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviçit.* (2014). Tiranë: Hegla's Secrets, f. 318.

7 Clark, Wesley. (2003). Të bësh një luftë moderne. Prishtinë: Zëri, f. 31.

8 Telegraf, 09.01.2014: f. 5.

NATO-s. Diplomatët perëndimorë theksuan se diplomacia pa forcën ishte bërë një armë e zbrazët, e pafuqishme dhe qesharake. Spastrimet etnike në Kosovë shkaktuan reagimin e menjëhershëm të Fuqive të Mëdha të Perëndimit. Drejtuesit më të lartë të administratës së Klintonit dhe udhëheqës të vendeve kryesore të NATO-s treguan vendosmëri dhe ndërmorën aksione konkrete e vendime të rëndësishme për të mos lejuar spastrimin etnik të shqiptarëve të Kosovës.

Presidenti Klinton deklaronte: "Qëllimi i vetëm i aleatëve të NATO-s është të ndalojmë barbarinë serbe"⁹.

Në këtë linjë ishin edhe pas çlirimit të Kosovës. Madeleine Albright: "Angazhimi im ishte strategjik. Evropa nuk kishte për të qenë kurrë në paqe, për sa kohë Ballkani dotë ishte i paqëndrueshëm dhe Ballkani nuk do të ishte kurrë i qëndrueshëm për sa kohë Millosheviçi do të ishte në pushtet. Motivimi kryesor gjithsesi ishte i moralshëm: Unë nuk doja të shihja të vriteshin njerëz të pafajshëm. Prania e NATO-s në Evropë na dha mundësinë për të ndaluar spastrimin etnik, kjo do të ndihmonte në parandalimin e mizorive të tilla diku tjetër"¹⁰.

William Kohen, Sekretar Shteti i Mbrojtjes, SHBA: "Kjo është luftë midis të mirës e të keqes, nuk do të lejojmë që e keqja të mund të mirën"¹¹.

Kongresmeni amerikan Frenk Wolf, më 5 prill 1999 në Kukës: "Askush nuk duhet të pajtohet me dëbimin nga shtëpia e vet, qoftë edhe të një njeriu të vetëm"¹².

Shtëpia e Bardhë, akoma pa u çliruar Kosova deklaronte se objektivat tona janë që të ndalojmë barbarinë serbe dhe kosovarët të kthehen në shtëpitë e tyre: "Tregues i suksesit është kthimi i refugjatëve në shtëpi. Këtë nuk mund ta bëjë kush tjetër, përveç NATO-s dhe SHBA"¹³.

Lidershipi amerikan u premtoi shqiptarëve në Kosovë siguri, rihapjen e shkollave shqipe, të flasin gjuhën e tyre, të ushtrojnë fenë e tyre, të zgjedhin liderët e tyre dhe të farkëtojnë fatin e tyre. Kryefjala e fjalimit të Bill Klintonit në takimin me kosovarët e dëbuar, të cilët ishin vendosur në kampet e ngritura në Maqedoni ishte: "**Aleanca nuk do të lejojë më spastrimin etnik**"¹⁴.

Sekretarja e Departamentit të Shtetit amerikan, Zonja Ollbrajt iu drejtua kosovarëve me këto fjalë: "Kosova do të jetë përgjithmonë shtëpia

9 [Cernomyrdin, Viktor S, Talbott, Strobe. Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviçit. \(2014\). Tiranë: Hegla's Secrets, f. 129.](#)

10 Zeneli, Bashkim. (2015). Për Gjermaninë. Tiranë: UETPRESS, f. 514-515.

11 Radio Kosova e Lirë, 08.08. 2016.

12 ATSH, 06.04.1999.

13 [Cernomyrdin, Viktor S, Talbott, Strobe. Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviçit. \(2014\). Tiranë: Hegla's Secrets, f. 36.](#)

14 ATSH, 22.06.1999.

juaj dhe njerëzit e armatosur nuk do t'iu vijnë kurrë më natën në shtëpi me armë. Kurrë më nuk do t'iu digjen shtëpitë dhe fshatrat dhe asnjëherë nuk do të ketë masakra dhe varre masive"¹⁵. Betim solemn!! Betim për një kauzë të drejtë!!! Betim, të cilin SHBA do ta mbronin me sakrificat më sublime!!!

George W. Bush, më 24 korrik 2001 vizitoi Kosovën. Ai theksoi idenë që kosovarëve t'u jepeshin më shumë përgjegjësi, për të qeverisur ata atje. Çka linte të kuptohej se duhej të ishte shtet i pavarur. UNMIK-u, në vitin 2002 doli me propozimin "Standardet përpara statusit". Nuk kishte një qartësi rreth këtyre standardeve. Gjithashtu kishte përpjekje veçanërisht nga Rusia dhe Serbia për ta vonuar e penguar pavarësinë e Kosovës.

Presidenti Bush dhe sekretarja e Shtetit Condoleezza Rice, në vitin 2005 të pakënaqur me progresin drejt pavarësisë, duke parë edhe përpjekjet e Rusisë e të Kinës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për ta penguar atë, vendosën ta shtyjë më përpara këtë proces. Ndërmorën nisma të reja diplomatike dhe ligjvënëse. Kongrsmeni Joe Dio Guardi u bë nismëtar për të paraqitur një rezolutë në mbështetje të pavarësisë së Kosovës. Kjo rezolutë u paraqit dy herë nga ligjvënësi Tom Lantosh, në vjeshtë të vitit 2004 dhe në janar të vitit 2005. Të dy partitë politike, si republikanët dhe demokratët arritën konsensusin për pavarësinë e Kosovës. SHBA-të dhe Fuqitë e Mëdha si Gjermania, Britania e Madhe, Italia, Franca deklaruan se nuk do të kishte një kthim të Kosovës nën kontrollin serb, hodhën poshtë propozimin serb "për më shumë autonomi, por jo pavarësi". Gjithashtu përjashtojnë çdo ndryshim kufijsh dhe çdo ndarje të Kosovës. Siç e theksuam edhe më lart viti 2005 shënon kthesën e madhe të politikës amerikane për fillimin e një procesi që do të përcaktonte statusin e Kosovës. Kjo lidhet me nismën e re politike që paraqiti para Kongresit Amerikan, nënsekretari i shtetit Nicholas Burns, më 18 maj 2005. Ambasadori i dikurshëm amerikan në Rusi dhe shefi aktual i CIA-s William J. Burns, në memoaret e tij ("The Back Channel") do të kujtonte se në vitet 2007-2008 marrëdhëniet SHBA-Rusi kishin dy çështje të mprehta: Pavarësinë e Kosovës dhe zgjerimin e NATO-s¹⁶.

Në vizitën e George W. Bush në Tiranë, më 10 qershor 2007 ai deklaroi se Kosova do të jetë shtet i pavarur dhe vetëm shtet i pavarur. "Ajo që mund të bëjmë ne është që të lejojmë që së bashku me kolegët rusë dhe të BE-së të kërkojmë një kompromis, një bazë të përbashkët, të cilën ta mbështesin të gjithë. Por në qoftë se ata nuk do t'ia dalin mbanë atëherë, në një moment në kohë më herët sesa vonë të detyrohesh të thuash: Durimi arriti deri aty sa nuk mban më. Kosova është e pavarur!"¹⁷ Porosia e tij ishte: "Duam që Serbia të dëgjojë që Amerika mbështet pavarësinë e Kosovës.

15 ATSH, 30.07. 1999.

16 Hoxhaj, Enver. (2022). Përplasja e madhe. Tiranë: UETPRESS, f. 37.

17 ATSH, 10.06. 2007.

Udhëheqësit kosovarë të mbajnë qetësinë në këta hapa të fundit.” Dhe erdhi dita e shumëpritur: Shpallja e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008. Gëzimi në Prishtinë e në gjithë vendin ishte i paparë. Flamujt amerikanë valëviteshin kudo. Njerëzit thërrisnin: “ Faleminderit USA!” , “Zoti e bekoftë Amerikën, Klintonin e Bushin!”

Një nxënëse e klasës së gjashtë atë ditë shkruan: “Pritëm me vite, me shekuj, por e arritëm ditën e 17 shkurtit 2008. Ditë e shumëpritur nga të gjithë ne. Nuk do të harrojmë asnjëherë dëshmorët që dhanë jetën e tyre për lirinë dhe pavarësinë e atdheut tonë. Jemi të lirë. Flamuri ynë valon krenar në qiellin e Kosovës. E ardhmja jonë në këtë ditë nuk ka qenë kurrë më e ndritshme, liria nuk ka qenë kurrë më e madhe dhe mundësitë kurrë më të mëdha për të ecur përpara, për t’u zhvilluar e për t’u gëzuar si vendet e tjera”.

SHBA-të e njohën pavarësinë e Kosovës në ditën e dytë të saj. Ato e kanë parë dhe trajtuar pavarësinë e Kosovës si udhëdalje nga rrethi i mbyllur, ku qëndronte ajo. Ndërmjet viteve 1999-2008, Zyra e SHBA-së në Prishtinë ka vepruar në cilësi të misionit diplomatik të SHBA-së në Kosovë. Në shtator të vitit 2012, SHBA-të iu bashkuan partnerëve në Grupin Drejtues Ndërkombëtar në njohjen e progresit që kishte arritur Kosova, duke deklaruar kështu fundin e pavarësisë së mbikëqyrur dhe shpërbërjen e Zyrës Civile Ndërkombëtare. Nga viti 1999-2019, SHBA-të kanë investuar rreth 2 miliardë dollarë, kanë ndërtuar bazën ushtarake në Ferizaj, kanë ndihmuar në ngritjen e Ushtrisë së Kosovës, në modernizimin dhe armatosjen e saj. Më 4 korrik 2019 në ditën e pavarësisë së SHBA-vë përuruar ndërtesën e re të Ambasadës: 12.4 hektarë në lagjen Arbën të Prishtinës. Kjo ndërtesë shumë funksionale, me një arkitekturë të përparuar - tregon vëmendjen që ato kanë ndaj Kosovës, rolin e saj, fuqinë diplomatike për ta ruajtur e mbështetur pavarësinë e Kosovës.

Në 20 vjetorin e çlirimit të Kosovës, ish presidenti Bill Klinton mbajti një fjalim në Prishtinë: “Unë gjithmonë do të jem krenar me faktin se unë isha President i SHBA në kohën kur ju patët nevojë që dikush të ngrihet e të thotë se nuk ka më spastrim etnik, nuk ka më përndjekje të njerëzve nga shtëpitë e tyre, jo më vrasje të civilëve të pafajshëm”¹⁸. Pothuajse një vit më vonë më 11 maj 2020, në diskutimin e Komitetit të Dhomës së Përfaqësuesve, Madeleine Albright i bënte thirrje administratës së Trump-it: “Kosova është një vend për të cilin ne kemi punuar për shumë vite me radhë dhe e kemi mbështetur faktin që Kosova duhet të jetë e pavarur. Çfarë ka ndodhur, fatkeqësisht është se tani ka keqardhje që SHBA-të nuk po ndihmojnë në zgjidhjen e kësaj çështje me presidentin serb, Aleksandër Vuçiq. Por edhe me atë që serbët kanë tentuar ta zhbëjnë gjenocidin, gjë, e cila është dënuar edhe

18 Radio Europa e Lirë, 11.06. 2019.

nga komuniteti ndërkombëtar¹⁹. Gjithnjë në këto vite SHBA-të kanë deklaruar se do të ndihmojnë Kosovën, se pavarësia është e pakthyeshme dhe SHBA-të do të jenë në Kosovën e lirë dhe të pavarur në çdo hap të saj.

Administrata e Presidentit Joe Biden ia ka bërë të qartë Serbisë, presidentit të saj, Aleksandër Vuçiç se kërkohet sa më shpejt “arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të normalizimit me Kosovën, e cila përqendrohet në njohjen e ndërsjellë”.

Në nderim të rolit përcaktues, vendimtar të SHBA-ve për çlirimin e Kosovës dhe pavarësinë e saj, Presidenti Bill Klinton është dekoruar me “Urdhërin e Lirisë”, Bulevardi në Prishtinë mban emrin e tij, statuja e tij ndodhet në qendër të Prishtinës, një rrugë atje mban emrin “George W. Bush”, një rrugë tjetër “Presidenti Woodrow Wilson”. Në Prishtinë është busti i Madeleine Albright.

Më datën 6 korrik 2022, Parlamenti European miratoi një rezolutë, ku kërkohet që marrëveshja përfundimtare midis Kosovës dhe Serbisë duhet të “bazohet në njohje të ndërsjellë”. Për Serbinë kjo është e papranueshme. Përgjigja e presidentit Vuçiç e shpreh qartë: “Bukur, dinjitetshëm dhe me mirësjellje, nuk do ta nënshkruajmë. Nuk na shkon mendja, nuk do ta konsiderojmë”²⁰.

Nuk ka stabilitet në Ballkan pa normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, pa njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

19 Sot. Com. Al, 11.05.2020.

20 Panorama, 06.07.2022.

PËRFUNDIM

Tipari më dallues i rrethanave botërore që mundësuan lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ishte fuqia amerikane²¹. Pavarësia e Kosovës ka rëndësi të trefishtë po të kemi parasysh: raportet shqiptaro-serbe në Kosovë, shqiptaro-serbe në gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe të kombit shqiptar me kombin serb²².

Çështja e Kosovës paraqet "çështje më vete" dhe nuk mund të krahasohet me çështje të tjera të hapura e të pazgjidhura dhe të shërbejë si një "precedent negativ", siç thotë Vladimir Putin. Krahasimi i rastit të pavarësisë së Kosovës me Osetinë Jugore, me Abkhazinë, Transnistrinë në Moldavi dhe Donjeck-in e Luhansk-un në Ukrainë nuk qëndron. Rusia e ka kundërshtuar njohjen e pavarësisë, duke e paraqitur Kosovën si një shtet të prapambetur islamik dhe mesjetar, në çdo dimension: atë ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Sipas ish ministrit të jashtëm të Kosovës, Enver Hoxhaj, Putin e ka përdorur dhe po e përdor rastin e Kosovës si antitezë ndaj Perëndimit. Gjithashtu faktorizimi i shqiptarëve në Ballkan ishte dhe është shqetësim për interesat e Rusisë²³. Qëndrimi i Putinit: ishte Kosova ajo që kishte nxitur rritjen e separatizmit brenda vetë BE-së, se Kosova hapi Kutinë e Pandorës, lista ishte e gjatë: kurdët (Irak), Skocia, Krimea, Kebek, Kanada -është i pavërtetë, i mirë llogaritur politikisht dhe në përputhje me doktrinën e tij.

Kosova është në një fazë të rëndësishme të konsolidimit të pavarësisë e të shtetit të saj:

- Mbi të gjitha shtrirja e pushtetit në të gjithë territorin e saj. Teoria e shtetit na mëson se sovraniteti, si një karakteristikë thelbësore e pushtetit shtetëror përfshin tre elementë të domosdoshëm:
 - pavarësinë ndaj pushtetit të çdo shteti tjetër,
 - mungesën e kufizimit formal për pushtetin shtetëror në nxjerrjen e ligjeve,
 - epërsinë e pushtetit shtetëror në territorin ku ai shtrihet, mbi çdo pushtet tjetër.
- Të përshpejtojë reformat ekonomike, të ulë papunësinë, ndërtimi dhe shfrytëzimi i kapaciteteve të brendshme, ku vëmendje të veçantë t'i kushtojë sektorit energjistik.
- Krijimi i shtetit demokratik dhe i shtetit të së drejtës, respektimi i ligjeve, pavarësia e pushtetit gjyqësor, funksionimi i mekanizmave të kontrollit.

21 Hoxhaj, Enver. (2022). Përplasja e madhe. Tiranë: UETPRESS, f. 11.

22 Stavileci, Esat. (2009). Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve. Gjakovë: Forumi për Iniciativë Demokratike, f. 306.

23 Hoxhaj, Enver. (2022). Përplasja e madhe. Tiranë: UETPRESS, f. 66, 71.

- Të luftojë e të ndëshkojë korrupsionin, të shkëpusë lidhjet e krimit me politikën dhe të rritë mirëqenien.
- Të llobojë fuqishëm, në bashkëpunim me Shqipërinë e vendet mike për të rritur njohjet e pavarësisë nga shtete të ndryshme të botës.
- Të zbatojë e të zgjerojë marrëveshjet e bashkëpunimit me Shqipërinë, duke shumëfishuar tregtinë midis dy vendeve, duke krijuar një treg unik ekonomik pa pengesa e dogana, duke përafuar legjislacionin në tatime, në arsim, në shkencë, në shëndetësi dhe duke realizuar një politikë të jashtme të përbashkët.
- Pranimi, promovimi i vlerave të shqiptarëve kudo ku janë.
- Shikimi me “sy përpara”, por jo për të harruar të kaluarën, me qëllim që të mos lejojë përsëritjen e saj. Popujt që e harrojnë të kaluarën nuk kanë të ardhme.

Bibliografia

I. **Libra:**

1. Cernomyrdin, Viktor S. Talbott, Strobe. (2014). *Prapaskenat e kapitullimit të Millosheviçit*. Tiranë: Hegla’s Secrets.
2. Clark, Wesley. (2003). *Të bësh një luftë moderne*. Prishtinë: Zëri.
3. Hoxhaj, Enver. (2022). *Përplasja e madhe*. Tiranë: UETPRESS.
4. Stavileci, Esat. (2009). *Rrugëtimet dhe labirintet e Kosovës dhe të shqiptarëve*. Gjakovë: Forumi për Iniciativë Demokratike.
5. Zeneli, Bashkim. (2015). *Për Gjermaninë*. Tiranë: UETPRESS.

II. **Dokumenta:**

1. Deklarata e Pavarësisë, 17.02.2008. Prishtinë.
2. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë (1974). Prishtinë.

III. **Media:**

1. ATSH, 06.04.1999, 22.06.1999, 30.07. 1999, 10.06. 2007.
2. Ekonomia sot, 01.12.2018. Tiranë.
3. Ora News, 11 nëntor 2020. Tiranë.
4. Panorama, 06.07.2022. Tiranë.
5. Radio Evropa e Lirë, 11.06. 2019. Bruksel
6. Radio Kosova e Lirë, 08.08. 2016. Prishtinë.
7. Sot. Com. Al, 11.05.2020. Tiranë.
8. Telegraf, 09.01.2014. Tiranë.
9. Zëri i Amerikës, 17.02.2018. Washington.

1.7 Dr Mark Veller

MARRËVESHJA E BRUKSELIT PËR SHTEGUN DREJT NJOHJES

Rregullat e sistemit ndërkombëtar krijohen nga qeveritë. Qeveritë, në kushte normale, e shohin si detyrë të tyre të parën ruajtjen dhe mbrojtjen e integritetit territorial të shtetit që e përfaqësojnë. Prandaj sistemi ndërkombëtar është i stivitur kundër atyre që kërkojnë pavarësinë pa pëlqimin e qeverisë qendrore. Historia e shkatërrimit të Biafrës secesioniste nga Nigeria ndërmjet viteve 1967-1970 apo fati i katalonjasve në Spanjë tash së voni, e dëshmojnë këtë fakt me bollëk.

Pra, nuk është befasi që Kosova është ballafaquar me një luftë tejet të rëndë për ta fituar, e më pas për ta konsoliduar pavarësinë e saj, përballë kundërshtimit të Serbisë. Kjo u dëshmuar në Konferencën e Rambouillet-it, që i ngjasonte një tenxhereje nën presion, në negociatat e Ahtisaarit që pasuan dhe në negociatat e mëvonshme që u udhëhoqën nga Brukseli. Në secilin hap kishte një ndjenjë të fuqishme se Serbia do të duhej kompensuar për koncesionet e bëra në lidhje me Kosovën dhe, në fund, edhe për humbjen e Kosovës.

Deri më tash Serbia është përpjekur që të nxjerrë përfitime nga ky fenomen, duke shikuar të nxjerrë shumë e më shumë koncesione, fillimisht nga ndërmjetësit, më pas nga Kosova, në secilën fazë, pa u zotuar se do të japë ndonjë gjë në këmbim. Kosova, nga ana tjetër, tashmë e ka ritheksuar se ka ofruar të drejta të zgjeruara për serbët etnikë në Kosovë dhe për çështje të tjera që janë brengë legjitime e Serbisë.

Pa dyshim, procesi i Ahtisaarit që shpuri drejt shpalljes së pavarësisë së Kosovës, e detyroi Kosovën që të bënte kompromise të rëndësishme. Disa thoshin se atëherë këto nënkuptonin një derogim nga sovraniteti i Kosovës, në çastin kur sovraniteti u arrit më në fund. Në të vërtetë, megjithatë, këto nuk ishin koncesione që iu bënë Serbisë, apo vetëm Serbisë. Këto ishin pjesë e marrëveshjes me bashkësinë e organizuar ndërkombëtare si tërësi, para se Kosova të mund të kërkonte të bëhej pjesë e rrethit të shteteve sovrane. Bashkësia e shteteve nuk do ta kishte pranuar Kosovën po qe se kjo nuk do t'i merrte, me lirinë e plotë, obligimet në lidhje me minoritetet e veta dhe çështjet e tjera që i ngrihi dokumenti i Ahtisaarit.

Kjo strategji u shpagua. Me gjithë fushatën përherë e më të pashpresë të Serbisë kundër njohjeve, çështja është se mbi gjysma e shteteve në botë e kanë njohur Kosovën. Për më tepër, koncesionet që ishin bërë atëherë, nuk ishin aq dramatike sa paraqiteshin ndonjëherë. Shumica, si standardet e avancuara për trajtimin e pakicave, janë dëshmuar si praktikë e mirë dosido.

Arsyeja është se Kosova është një demokraci liberale e përkushtuar ndaj sundimit të ligjit. Pranimi i një sistemi të fuqishëm të të drejtave të njeriut dhe

të pakicave në fakt nuk është humbje. Është fuqi. Për më tepër, zbatimi i hershëm i këtyre standardeve do të shpaguhet - secili kandidat për anëtarësim në BE do të duhej të dëshmonte se i pranon dhe i respekton plotësisht këto kërkesa. Kosova, pra, tash është një hap para brenda rajonit në kuptimin e të drejtave të njeriut, lirisë së shtypit dhe përpjekjeve për t'i çrrënjësuar efektet mbylëse të korrupsionit. Në fakt, situata aktuale e paraqet një përvojë unike për Kosovën. Më në fund, pozita e saj shumëvjeçare e disavantazhit strukturor në sistemin ndërkombëtar karshi Serbisë ka ndryshuar radikalisht. Kosova i ka përmbushur, dhe vazhdon t'i përmbushë, të gjitha detyrimet që dalin nga Marrëveshja Ahtisaari, që shpuri drejt pavarësisë së saj. Tash, papritur, Serbia më në fund e gjen veten nën presion për të vepruar.

Ky presion lidhet për procesin e anëtarësimit të Serbisë në BE. Nën Kapitullin 35 të kriterëve për anëtarësim, ajo duhet të dëshmojë se ka arritur normalizim gjithëpërfshirës dhe ligjërisht të obligueshëm të raporteve me Kosovën. BE-ja nuk do të mund ta pranonte një anëtar të ri që aktivisht mban pretendime ndaj territorit të një fqinji, duke e përfshirë në Kushtetutën e vet. Në fund Serbia do të detyrohet ta njohë Kosovën, në rast se nuk do që të mbetet jashtë në acar, e izoluar në mes të Evropës.

Natyrisht, në këtë çast, nuk është e qartë po qe se popullata e Serbisë ende do të ishte në favor të anëtarësimit në BE. Megjithatë, kryetari i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, vështirë se mund ta këtë luksin që të bëhet i vetmi njeri në historinë e kombit të vet që e ka humbur mundësinë që t'i bashkohet bashkësisë së vlerave perëndimore. Izolimi përherë më i madh i Federatës Ruse, si pasojë e pushimit ilegal të Ukrainës, dora e shtrirë e miqësisë nga Moska si një alternativë ndaj integritetit euroatlantik nuk duket të jetë aq tërheqëse në këtë kontekst.

Kosovës iu premtua që nga fillimi i dialogut të udhëhequr nga BE-ja se një normalizim gjithëpërfshirës, në fakt është kodi përshkrues që nënkupton kërkesën që Serbia në fund duhet ta njohë Kosovën. Megjithatë, duke pasur parasysh ndërrimin e disponimit të opinionit publik në Serbi, BE-ja dhe SHBA-ja janë gjetur nën presion për ta futur Serbinë në BE, para se popullata e saj ta humbë krejtësisht besimin në integritetin evropian. Kjo do të thotë se edhe një herë Kosova rrezikonte që t'i sakrifikohej interesat në altarin e kalkulimeve gjeostrategjike të Fuqive të Mëdha.

Në veçanti, ishte edhe rasti i zbutjes së pozicionit të vendosur nga liderët e mëdhenj të brezit paraprak, sikurse ishte Angela Merkel. Ishte e palëkundshme në qëndrimin e saj se Serbia nuk mund të jetë kandidate për anëtarësim në BE nëse nuk e njeh Kosovën. Megjithatë, me shkuarjen e brezit të Merkelit, ekzistonte rreziku që ky kusht të mund të tretej. Nëse Serbia nuk do të tregonte vullnet të ecte para me çështjen e njohjes së Kosovës, disa sugjeronin se mbase do të duhej pastruar shtegun e saj drejt BE-së me zbutjen e këtij kushti. Kjo

mund të ishte e nevojshme në mënyrë që të bëheshin përpjekjet për ta lidhur Serbinë për Perëndimin para së të bëhej vonë.

Kjo brengë tashmë është tejkaluar. Pushtimi rus i Ukrainës dhe përpjekja e Serbisë që t'i akomodojë edhe pushtuesit rusë nën udhëheqjen e kryetarit Putin, si dhe aleancën Perëndimore që e përkrah kryetarin ukrainas Volodimir Zelensky, nuk janë pranuar mirë në Washington dhe Bruksel. E gjetur në pozitën nën trysinë pazakonshëm të rëndë, Serbia përnjëherë iu nënshtrua presionit që të vendoste, njëherë e përgjithmonë, nëse e sheh veten si pjesë të Perëndimit, apo si klient i ish-Perandorisë sovjetike. Kosova është dashur të manovrojë me shumë kujdes në këtë ambient. Me qasjen e vet në procesin e normalizimit, i kontrollon kriteret kyç për anëtarësimin e Serbisë në BE dhe integrimin më të gjerë në Perëndim. Po të luante keq, liderët perëndimorë do të mund të nxirrmin përfundimin se interes më i madh për ta do të ishte ta joshnin Serbinë nga kampi i tyre. Kjo mund të nënkuptojë zbutjen e kuptimit të asaj çfarë do të thotë “normalizimi”, përfshirë madje edhe kërkesën për njohjen e shprehur të Kosovës. Kjo do ta shfuqizonte Kosovën në këtë proces. Nga ana tjetër, po qe se Kosova do ta luante lojën me kujdes, do ta konsolidonte pozicionin e vet. Në fakt, ajo do të mundte, për herë të parë në histori, ta kthente balancën e interesave në sistemin ndërkombëtar që gjithmonë kishte ofruar terren të pabalancuara në favor të Serbisë.

Tash, papritur, Serbia ishte ajo që u ballafaqua me një situatë të vështirë. Do të duhej që zyrtarisht të hiqte dorë nga pretendimi i sanksionuar me Kushtetutë, se Kosova është territor i saj. Do të duhej ta tejkalonte narrativen e vet nacionaliste që disi shpreh pretendimin se Kosova është zemra e saj historike. Dhe do të duhej ta bënte njohjen zyrtarisht. Këto janë kërkesa të rënda dhe, duhet pranuar, nuk janë fare të lehta për Serbinë.

Nga ana tjetër, ishte gjithashtu e qartë se nuk do të kishte vendim të menjëhershëm për njohjen e Kosovës nga Serbia. Askush nuk do ta priste një kthesë të këtyre përmasave nga ana e Serbisë në këtë çast. Pra, nëse është kështu, a do të thotë kjo se procesi i integritit të Serbisë në BE, hë për hë i ndalur, do të mbeste i pezulluar, në kohën kur ekzistonte frika se Beogradi po rrëshqiste drejt orbitës së Moskës?

Këtu hyri nisma gjermano-franceze. Përderisa dueti i përbërë nga përfaqësuesi i lartë i BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrel, dhe nga përfaqësuesi i tij i posaçëm për normalizimin, Miroslav Lajçak, po arnonte një kornizë të tyre për një marrëveshje eventuale normalizimi, dy kryeqytetet, të përkrahura nga Italia, e paraqitën një propozim, në disa forma, mendjehollë.

Gjermania e kujtoi përvojën e saj të detantit në vitet '70 të shekullit të shkuar. Deri në atë çast, Gjermania Perëndimore dhe ajo Lindore nuk e njihnin njëra-tjetrën. Kjo nënkuptonte se nuk mund të bëheshin anëtare të OKB-së. Raportet e tyre të pazgjidhura shkaktonin probleme të tjera në menaxhimin e raporteve ndërkombëtare të të dyja palëve. Për ta adresuar këtë problem të përbashkët,

më 1972 të dy Gjermanitë e arritën Marrëveshjen Bazë. Në të e pranuan se do të ketë dallime në interpretimin e statuseve të tyre juridike. Megjithatë, gjithashtu u pajtuan për një diçka që nënkuptonte njohjen de facto.

Në veçanti, u pajtuan se një shtet nuk mund ta ushtrojë juridiksionin në raport me territorin e tjetrit apo të përfaqësojë atë që ndodh në territorin e shtetit tjetër në nivel ndërkombëtar. Gjithashtu u pajtuan që t'i këmbëjnë misionet diplomatike, edhe pse nuk i quajtën ambasada. Në vend të kësaj, u quajtën Misione të Përhershme. Dhe ishte e qartë që të dyja, së bashku, do të pranoheshin në OKB dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. Propozimi fillestar franko-gjerman e ofroi një kopje të asaj marrëveshjeje nga 1972-a, me disa shtesa e mungesa. Koncepti që të dyja palët do të merrnin një hap të madh para drejt normalizimit të raporteve të tyre në praktikë, duke e lënë çështjen e njohjes së ndërsjellë për një hap të radhës në formën e marrëveshjes përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme. Për Serbinë, kjo mund të jetë atraktive, ngase e liron nga presioni i njohjes së për të. Për Kosovën, ka disa elemente të rëndësishme dhe të dobishme në këtë qasje, por edhe kjo ngërthen rreziqe. E para, duhej të sigurohej se BE-ja nuk do ta merrte këtë marrëveshje fillestare si një përmbushje të kërkesës për normalizim gjithëpërfshirës, pra, hapjen e shtegut drejt anëtarësimit të palëve në BE pa njohje. E dyta, ekzistonte rreziku që kjo marrëveshje fillestare do të mund të ofronte mbulesë për Serbinë që ta shtyjë deri në pafund arritjen e normalizimit gjithëpërfshirës. E treta, marrëveshja siguronte konfirmimin e të gjitha marrëveshjeve paraprake të arritura në procesin e normalizimit në Bruksel. Kjo përfshinte marrëveshjen e parë të Brukselit të 2013-s, që e futi konceptin kontrovers të Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe. Këta tre faktorë e bënë Kosovën që të hamendej. Kjo qasje çiti rrezikun që të përmbyste pabarazinë strukturore, që për herë të parë në fakt e favorizonte Kosovën. Tash, duke pasur parasysh këtë ngurrim, duhej se që të dyja, Serbia e Kosova, njësoj po e pengonin procesin e normalizimit — një proces që për SHBA-në dhe BE-në nuk kishte të bënte në rend të parë me Kosovën, por me gjeopolitikën që e përfshinte Rusinë dhe rrëmbimin që kjo ia bënte Serbisë.

Pa dyshim, kishte tendencë që të fajësohej Kosova — viktimja e represionit të madh dhe e mohimit të të drejtave, si dhe të vrasjeve dhe të zhvendosjeve masive gjatë luftës së 1999-s që ia bëri Serbia – për pengimin e progresit, e jo Serbia e cila nuk kishte lëvizur asnjë milimetër drejt çështjes esenciale të njohjes së identitetit juridik të Kosovës. Prandaj Kosova, krahas Serbisë, iu nënshtrua një presioni të rëndë diplomatik nga partnerët e saj perëndimorë. Bri shteteve të BE-së, në veçanti Gjermanisë dhe Francës, të cilave iu bashkua Italia, edhe SHBA-ja u përfshi më thellë. Kosova u kërcënua se do ta humbte përkrahjen e aleatëve të saj tradicionalë dhe me izolim diplomatik — një çështje shumë me peshë për një shtet sikurse Kosova që ka njohje të pjesshme

ndërkombëtare dhe i cili ende varet nga mjetet që vijnë nga jashtë për ta zhvilluar ekonominë e tij.

Në këtë situatë, dukej mjaft e qartë se çfarë duhej të bënte Kosova. Duhej ta rifitonte iniciativën diplomatike dhe ta kthente disi alancën e interesave që më në fund e favorizonte pozicionin e saj. Dhe duhej ta bënte pa u detyruar për koncesione të cilat nuk mund t'i bënte.

Duke i shtyrë para këto qëllime, Kosova do të mund të përfitonte nga elementet e politikës së kryeministrit në ardhje, Albin Kurti. Ai kishte insistuar që nga fillimi që procesi i normalizimit në esencë kishte të bënte me njohjen, e jo për më shumë marrëveshje sektoriale për këtë apo atë çështje. Më shumë se kaq, njohja ishte vetëm njëri hap drejt qëllimit më të gjerë — t'i mundësohet Kosovës që ta konsolidojë plotësisht pozitën e saj në botë, t'i marrë përgjegjësitë si anëtare e OKB-së dhe të punojë për anëtarësimin në BE. Për të, dukej, të gjitha marrëveshjet paraprake normalizimi të ndërmjetësuara nga BE-ja ishin më pak relevante sesa qëllimi madhor.

Kjo qasje që e papëlqyeshme për lehtësuesit në Bruksel. Përderisa të gjithë e dinin se normalizimi në fund duhej ta përfshinte edhe njohjen, gjithashtu e dinin se kjo nuk ishte gjë që do të mund të realizohej menjëherë. Prandaj zgjodhën që ta përpunonin disi punën e normalizimit dhe të shtojnë edhe ca marrëveshje të pjesëshme për çështje specifike. Qeveria Kurti u përpoq që ta kthente njohjen në qendër të procesit.

Kjo strategji mori një përkrahje të rëndësishme kur presidenti amerikan Biden e shprehu përkrahjen e tij për procesin e normalizimit të udhëhequr nga BE-ja dhe shtoi se “ky proces duhet të përqendrohet në njohjen reciproke”. Pak më vonë, kancelari gjerman Olaf Scholz do të thoshte: “Është e qartë se marrëveshja do të duhej të zgjidhte çështjen e njohjes së Kosovës, për shkak se është e paimagjinueshme që dy shtete që nuk e njohin njëra-tjetrën mund të bëhen anëtare të BE-së”. Më në fund, më 6 korrik 2022, Parlamenti Evropian, që pjesërisht e kontrollon mandatin e lehtësimit të BE-së, si institucion kyç i BE-së miratoi një rezolutë që theksonte se dialogu i Brukselit duhej ta mbërrinte një “marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjërish të obligueshme të bazuar në njohjen e ndërsjellë”. Ishte e qartë se nisma franko-gjermane, ashtu siç u pranua nga lehtësuesit e BE-së, nuk e ofronte njohjen zyrtare, de jure. Por ofronte elemente që e nënkuptonin njohjen si fakt, por jo me ligj. Marrëveshja Bazë, së cilës iu zotuan të dyja palët të hënën, kërkon që të dyja palët të zhvillojnë “raporte normale, të mira fqinjësore me njëra-tjetrën në bazë të të drejtave të barabarta”. Do të sillen sipas qëllimeve dhe parimeve të Kartës së OKB-së, përfshirë edhe “barazinë sovraane të të gjitha shteteve, respektimin e pavarësisë së tyre, autonomisë dhe integritetit territorial, të drejtën për vetëvendosje, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin”.

Këto janë, natyrisht, obligimet kyç që i karakterizojnë raportet mes shteteve plotësisht sovraane. Pa dyshim, duke pasur parasysh referencën që i bëhet

barazisë sovrane të të gjitha shteteve, respektimit të pavarësisë dhe të drejtës së vetëvendosjes, është vështirë madje të dyshohet se Beogradi nuk e ka njohur ekzistimin e Kosovës si shtet sovran me pranimin e kësaj marrëveshjeje. Pavarësisht kësaj, kryetari Vuçiq natyrisht se menjëherë e reduktoi rëndësinë e pranimin të këtyre 11 neneve, si dhe të preambulës së Marrëveshjes Bazë.

Marrëveshja Bazë gjithashtu shton se palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet e tyre vetëm me mjete paqësore dhe sqaron se zbatohet obligimi i paluajtshëm në të drejtën ndërkombëtare që e ndalon kërcënimin apo përdorimin e forcës në raportet mes shteteve. Sërish, këto kërkesa zbatohen te entitetet që në fakt janë shtete.

Kjo qartësi balancohet me një referencë në preambulën e Marrëveshjes Bazë e cila thekson se “pa paragjykuar pikëpamjet e ndryshme të palëve për çështjet themelore, duke përfshirë çështjet e statusit”. Kështu, është e qartë që marrëveshja nuk e sjell njohjen reciproke. Entitetet do ta trajtojnë njëra-tjetrën në trajtën e shteteve sovrane, pa e pranuar formalisht statusin e njëra-tjetres si shtete dhe do të mbajnë marrëdhënie diplomatike të ndërsjella. Sërish, kjo normalisht do të konsiderohej njohje de facto, edhe pse pa dyshim se do të ketë kontestime të zgjeruara akademike nëse kjo lidhet me këtë marrëveshje apo jo, njëherë që të jetë përmbushur.

Nëpërmjet titullit të vet, marrëveshja gjithashtu e adreson edhe brengën e dytë të madhe të Kosovës. Marrëveshja Bazë ravijëzon një “shteg” drejt normalizimit. Kjo do të thotë, është hapi numër një drejt normalizimit gjithëpërfshirës dhe ligjrisht të obligueshëm. Dhe sikur Parlamenti i BE-së dhe të tjerët e kanë konfirmuar me autoritet sa e sa herë, normalizimi duhet, në fund, ta ketë njohjen në qendër. Hapi numër dy duhet të vijojë pas hakit numër një dhe duhet të ndodhë me qartësi dhe në afat arsyeshëm të shkurtër.

Natyrisht, përderisa substanca është pranuar dhe nuk mund të ndryshohet më në këtë çast, Marrëveshja Bazë vetvetiu nuk është e plotë. Në formën e vet përfundimtare do ta përfshijë një aneks që do të merret me zbatimin. Kosova do të ketë nevojë të bëjë presion për përcaktimin e afateve, jo vetëm në raport me zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe teksteve paraprake, por edhe në raport me përmbushjen e normalizimit.

Diskutimet e mëtejme për zbatimin janë paraparë të mbahen në Ohër, më 18 mars, duke treguar për një orar të përshpejtuar me synim plotësimin e Marrëveshjes Bazë. Një element kyç i diskutimeve do të ketë lidhje me futjen në veprim të disa nga 11 nenet, përfshirë edhe çështjet që janë brengë për Kosovën. Kjo e përfshin njohjen e ndërsjellë nga palët të dokumenteve të tyre dhe simboleve shtetërore, siç janë pasaportat, diplomat, targat e regjistrimit dhe vulat doganore. Ngjashëm janë edhe dispozita të rëndësishme që kanë të bëjnë me sjelljen e Serbisë ndaj fushatës së Kosovës për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Madje ekziston dispozita për këmbimin e

misioneve të përhershme, sipas shembullit të të dy Gjermanive dhe si i kanë menaxhuar marrëdhëniet e tyre diplomatike

Serbia tashmë ka bërë me dije se ajo do të kërkojë që Kosova t'i përmbushë detyrimet e saj e para. Në veçanti, shumë është diskutuar për zbatimin e Marrëveshjes së parë të Brukselit për normalizimin nga viti 2013 që parashihte, mes të tjerash, edhe themelimin e Bashkësisë së Komunave me Shumicë Serbe.

Kosova ka rezistuar zbatimin e kësaj marrëveshjeje duke argumentuar se nuk mund ta pranojë futjen e rrafshit të tretë të pushtetit që mund ta çrregullojë shtetin, sikurse ndodh me statusin e Republikës Serbe që e çrregullon unitetin dhe integritetin e Bosnjë-Hercegovinës. Për më tepër, teksti i 2013-s gjithashtu parasheh obligime, të cilat nuk janë zbatuar as nga pala tjetër siç kishte qenë e paraparë. Kësaj duhet shtuar se Kosova argumenton edhe se marrëveshjen e ka ratifikuar zyrtarisht, ndërsa Serbia nuk e ka bërë këtë. Serbia gjithashtu nuk i ka zbatuar një sërë marrëveshjesh të tjera që kanë dalë nga procesi i Brukselit, dhe nuk është e arsyeshme që fokusi të përqendrohet te zbatimi ose jo i vetëm njëres marrëveshjeje.

Çfarë është më thelbësore, siç e konfirmon edhe Catherine Ashton, ish-shefja e Politikës së Jashtme dhe e Sigurisë të BE-së, që i udhëhoqi negociatat më 2013, Qeveria e atëhershme e Kosovës vetë e propozoi këtë bashkësi. Kjo kishte për qëllim të shërbente si kompensim për Serbinë për ndërmarrjen që do ta bënte Serbia drejt shpërbërjes së strukturave paralele të pushtetit, posaçërisht në veri të Kosovës dhe për t'i lejuar Kosovës që ta ushtrojë juridiksionin e vet sovran në të gjithë territorin pa pengesa apo ndërhyrje. Është e tepërt të thuhet se kjo nuk u realizua.

Pra, Serbia ia doli ta shfrytëzojë çështjen e Marrëveshjes së parë të Brukselit si mjetin për ta përmbysur disavantazhin e saj në të gjithë procesin e normalizimit. Ia doli ta bindë BE-në dhe në fund me gjasë edhe SHBA-në se miratimi i Statutit të Bashkësisë nga Kosova do të ishte element esencial për përparimin e mëtejshëm. Dështimi i Kosovës për ta zbatuar premtimin nga 2013-a u transformua dhe përnjëherë u pa si bllokuesi kryesor i procesit të normalizimit, e jo Serbia e cila nuk lëvizte para drejt njohjes. Qasja gjeostrategjike ndaj çështjes, përfshirë edhe rirënditjen e botës pas agresionit rus ndaj Ukrainës, e ekspozoi Kosovën ndaj një trysnie të theksuar.

Këshilla që iu dha Kosovës për një kohë ishte që ta kopjonte shembullin nga bisedimet nën Ahtisaarin. Në atë proces, Kosova e parashikoi me saktësi se partnerët e saj do t'i konsideronin të drejtat e minoriteteve si çështjen kyç, ndaj së cilës Kosova do të tregonte më së shumti rezistencë. Kështu, Serbia do ta përdorte këtë çështje si shkopin kryesor për ta rrahur Kosovën, me idenë që ta lënë Kosovën në pozicionin e palës penguese.

Megjithatë, Kosova e parandaloi planin. Në vend se të priste që partnerët ndërkombëtarë ta impononin një zgjidhje ndaj rezistencës dhe pa i përfshirë ata në ndërtimin e planit, Kosova vetë u mor me çështjen. E nisi një proces konsultimesh me përfshirje të gjerë me komunitetet pakicë, i shqyrtoi praktikat dhe standardet evropiane dhe e ofroi një vizion mjaft të detajuar për mbrojtjen e pakicave. Kjo krejtësisht e topiti shpatën që duhej rrahur Kosovën në procesin e negociatave. Në vend të kësaj, çështja u zhduk nga lista e çështjeve të kontestuara dhe vizioni i Kosovës u miratua në pjesën më të madhe.

Ngjashëm, në këtë rast, mendohet se Kosova mund ta përdorte faktin se Gjykata e saj Kushtetuese kishte vendosur kufij për atë se çfarë mund të jetë bashkësia dhe se çfarë do të mund të vepronte konform Kushtetutës së Kosovës. Sikurse në procesin Ahtissari, Kosova mund ta projektojë vizionin e saj për Statutin, në përputhje të plotë me ligjin dhe praktikat e Kosovës dhe duke iu referuar shembujve të përshtatshëm ndërkombëtarë. Kjo do ta hiqte temën e Bashkësisë nga rendi i ditës dhe do ta shtynte BE-në dhe Serbinë që të vazhdojnë me substancën e bisedimeve.

Është korrekte të thuhet se Qeveria e Kosovës nuk reagoi me entuziazëm ndaj kësaj ideje, duke u frikësuar se përfshirja me punën e Bashkësisë në fund do të mund të shpinte drejt imponimit të një zgjidhjeje të papranueshme. Megjithatë, historia e negociatave të Kosovës tregon se mosveprimi është ai që çon te imponimi nga jashtë i propozimeve edhe më të papranueshme.

Megjithatë, ngurrimi i Kosovës sa i përket kësaj çështjeje u dëshmuua të jetë i dobishëm në kohën kur u përpilua Marrëveshja Bazë që tash është përkrahur nga të dyja palët. Aty nuk përmendet shprehimisht Marrëveshja e Brukselit e 2013-s.

Fjalët ‘Bashkësia e Komunave me shumicë serbe’ nuk figurojnë askund në tekst. Në vend të kësaj, i bëhet një referentë e tërthortë për të siguruar një nivel të përshtatshëm të vetadministrimit për bashkësinë serbe në Kosovë dhe kapacitetin për ofrimin e shërbimeve në sfera specifike. “Vetadministrimi” e ka zëvendësuar fjalën vetëqeverisje në tekst, si koncesion ndaj Kosovës.

Kosova ka marrë garanci nga partnerët e saj se mund ta zhvillojë një vizion të vetin për ta përmbushur këtë kërkesë e që nuk e krijon rrafshin e tretë të pushtetit në Kosovë. Është çështje koordinimi të kompetencave të cilat tashmë i gëzojnë komunat relevante. Këto nuk mund të marrin vendime ekzekutive si një trup – në vend të kësaj, është mekanizëm bashkëpunimi parësisht në raport me ofrimin e shërbimeve praktike dhe të nivelit të ulët. Është gjithashtu me rëndësi të sigurohet se cilido mekanizëm për koordinim funksional mes komunash nuk e shkel detyrimin e mos diskriminimit. Ky ishte rasti te procesi Sejdiq dhe Finci para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku u konstatua se disa dispozita të mbështetura në Marrëveshjen e Daytonit

duheshin hedhur poshtë mbi bazën e diskriminimit etnik apo fetar. Për më tepër, siç u theksua më lart, duhet kujtuar se propozimi për bashkësinë e reflektuar në Marrëveshjen e 2013-s duhej të shërbente për të balancuar një obligim që kishte marrë Serbia. Ky obligim ishte shpërbërja e strukturave paralele në veri. Kjo kërkesë, kryesisht e pazbatuar, do të duhej ritheksuar. Kjo do të mund ta zbusë edhe brengën e Kosovës për financimin që vjen nga Serbia. Në praktikën ndërkombëtare, shtetet fqinje ofrojnë financim për minoritetet e veta, por përbrenda kufijve të juridiksionit të atij shteti fqinj dhe në formë krejtësisht transparente.

Serbia do të mund të përgjigjej se Neni 10 i Marrëveshjes Bazë e konfirmon obligimin e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve nga dialogu që mbesin të vlefshme dhe obliguese. Në rend të parë, kjo vlen si për Kosovën ashtu edhe për Serbinë dhe për të gjitha marrëveshjet, e jo vetëm për tekstin e 2013-s. Nuk është e qartë se përse vështrohet vetëm performanca e Kosovës dhe përse vetëm një çështje po ngrihet. E dyta, sa i përket tekstit nga 2013-a, dispozitat e saj duhen të interpretohen në kuptimin e gjuhës të cilën të dyja palët e kanë pranuar në Marrëveshjen Bazë. Kjo gjuhë është në pajtim me vizionin e paraqitur më lart. Serbia gjithashtu mund të insistojë se mekanizmi për hartimin e Statutit duhet të jetë ai që është paraparë më 2013. Megjithatë, një dekadë ka kaluar dhe shumë nga institucionet relevante lokale hë për hë nuk kanë personel. Në vend të kësaj, Kosova mund të ofrojë të nisë konsultime të gjera edhe me, posaçërisht me qytetarët serbë etnikë, komunat e prekura dhe të dalë me një projekt të besueshëm.

Çfarëdo qasjeje tjetër do të ishte iluzore. Nëse Statuti ka për qëllim të miratohet dhe madje të kalohet si pjesë e rendit juridik të Kosovës, duhet të zhvillohet me kompetencë teknike të nivelit të lartë dhe në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Përndryshe, Qeveria nuk do të jetë e aftë për ta siguruar miratimin e tij dhe qëndrueshmërinë e mëtejme. Një sferë tjetër brengosëse është pozita e Kishës Ortodokse Serbe. Disi, lehtësimi duket se e vlerëson këtë si një sferë e cila nuk është trajtuar hollësisht. Megjithatë, ekziston një nivel i lartë i dispozitave që kanë të bëjnë me liritë fetare në Kosovë në Kushtetutë. Për më tepër, dokumenti i Athtisaarit, që është pjesë sipërore e rendit juridik të Kosovës, përfshin një mbrojtje të gjerë për komunitetin ortodoks serb, për pronën e tij dhe lokacionet historike, kulturore dhe fetare të lidhura për të. Pa dyshim, dikush do të mund të argumentonte se nuk do të ishte punë e mençur që të rihapej ky kapitull duke pasur parasysh se kjo tashmë është fuqishëm në vend.

Dispozitat e miratuara në atë kohë ndodhën në kohën e përshtypjeve të fuqishme nga lufta dhe ngjarjeve pas saj, përfshirë edhe trazirat e 2004-s. Një sistem mjaft rigoroz i zonave të mbrojtura që vendosur, që i mbron lokacionet por edhe i izolon nga kontakti i lehtë me bashkë fetarët dhe bashkësitë në mjedisin e tyre më të afërt. Po të ishin hartuar këto dispozita sot, me siguri nuk

do të kishte nevojë për një sistem kaq rigoroz të mbrojtjes që e izolon Kishën, në vend se ta integrojë në jetën e Kosovës. Marrëveshja Bazë u referohet modeleve ekzistuese evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si udhërrëfyes për këtë çështje. Këto, natyrisht as që i afrohen nivelit të mbrojtjes së ofruar aktualisht Kishën Ortodokse Serbe, lokacionet dhe ritet e saj. Sërish, nuk është e qartë nëse rihapja e kësaj çështjeje do ta ndihmonte në fakt çështjen e Kishës Ortodokse Serbe.

Sido që të jetë, e sigurt është se nuk do të ketë lëvizje nga ana e Kosovës për ta rishikuar atë për të cilën tashmë është pajtuar apo për t'u tërhequr nga kjo. Bindja është se Qeveria e Kosovës ka pak apo nuk ka fare ngurrim që të merret me Kishën Ortodokse Serbe dhe me çështjet që do të donte t'i ngrinte në lidhje me zbatimin e sistemit aktual dhe për sugjerimet që do të donte t'i bënte për ta përmirësuar ushtrimin e lirisë së rajonit.

Anasjelltas, Kosova mbase do të donte të ofronte mendime se si mund të përdoret përkrahja e saj për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare në mënyrë më të efektshme, pa paragjykime ndaj të drejtave të garantuara dhe autonomisë së Kishës. Janë zotuar me miliona euro nga Qeveria e Kosovës për këtë qëllim e që nuk janë tërhequr nga Kisha Ortodokse Serbe. Ngjashëm, dokumenti i Ahtisaarit i obligon palët të bashkëpunojnë, ashtu që lokacionet kulturore dhe fetare të jenë të qasshme jo vetëm për pelegrinët apo fetarët, por gjithashtu edhe për qëllimin e edukimit kulturor dhe turizmin. Sërish, siç e konfirmojnë dispozitat ekzistuese, kjo nuk do të duhej të shkelte të drejtën për ushtrimin e lirive fetare dhe jetën e përkushtuar të komuniteteve fetare.

Marrëveshja Bazë gjithashtu u referohet të drejtave të pakicave. Edhe një herë, atë që Kosova u ofron pjesëtarëve të komuniteteve pakicë e tejkalojnë për shumë atë që u ofrohen tjetërkund në Evropë apo çfarë parashihet në standardet e zbatueshme të Këshillit të Evropës. Supozohet se Qeveria e Kosovës nuk do të kishte asnjë ngurrim t'i dëgjonte pakicat etnike, përfshirë edhe komunitetin serb, në lidhje me ndonjë propozim specifik që do të kishte për ta përmirësuar situatën më tej. Dëshmitë deri tash tregojnë se Kosova e respekton nivelin e lartë të asaj që ua ofron. Aty ku telashet vazhdojnë, me gjithë përpjekjet e Kosovës, kryesisht nuk kanë të bëjnë me pjesëtarët e komunitetit serb (romët, për shembull). Ngjashëm me këtë, nuk duket se ka çfarëdo vërejtjeje për krijimin e një mekanizmi kontakti të dedikuar brenda Qeverisë së Kosovës, edhe në raport me komunitetin serb, siç e sugjeron Marrëveshja Bazë. Është praktikë e mirë nëpër vende të tjera të Evropës dhe nuk do të ishte problematike të veprohet sipas kësaj dispozite të Marrëveshjes Bazë.

Vetë Serbia e ka konfirmuar në raportet e saj dërguar Këshillit të Evropës se është në favor të traktateve bilaterale për pakicat, të cilat i ka lidhur me shumicën e shteteve të veta fqinje. Kjo bën të kuptosh se e njeh parimin e

interesit reciprok për fatin e pakicave të një fisi/soji ndër kufij. Kosova me gjasë do të kërkojë debat për këtë çështje duke u mbështetur në frymën e raportimit të Këshillit të Evropës dhe të tjerëve për performancën e Serbisë, edhe në raport me komunitetin e saj shqiptar etnik, duke iu referuar të drejtave të pakicave dhe raporteve të mira fqinjësore në Marrëveshjen Bazë.

Dispozitat e Marrëveshjes që e adresojnë anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare janë gjithashtu me interes. Për Kosovën këto duhen të jenë obligime me rezultate më parë sesa me qëllime. Thënë të drejtën, edhe nëse Serbia do ta inkurajonte anëtarësimin e Kosovës në OKB, kjo nuk do ta zgjidhte çështjen vetvetiu, duke pasur parasysh veton ruse në Këshillin e Sigurimit. Kundërshtimi i Rusisë ndaj anëtarësimit të Kosovës në OKB do të vazhdonte duke pasur parasysh qëndrimin e qartë të Prishtinës kundër pushtimit të Ukrainës.

Çështje të tjera në lidhje me anëtarësime janë pjesërisht të varura nga qasja e Serbisë. Për shembull, 27 shtetet e BE-së do të mund të ushtronin ndikim vendimtar për ta siguruar pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Pritjet janë se ashtu do të veprojnë duke pasur parasysh qasjen konstruktive të dëshmuar nga Kosova në raport me Marrëveshjen Bazë. Mbase mund të shpresohet se kjo mund t'i ndihmojë pesë shtetet e BE-së që ende nuk e kanë njohur Kosovën që së paku të nisin ta rimendojnë pozicionin e tyre apo që kjo të kontribuojë në gjetjen e rrugës drejt tejkalimit të pasojave të këtij pozicionimi në raport me hapat e ardhshëm të Kosovës drejt anëtarësimit.

Marrëveshja e konfirmon se palët nisen nga të kuptuarit se asnjëra palë nuk mund ta përfaqësojë tjetrën në sferën ndërkombëtare apo të veprojnë në emër të saj. Ky është një koncesion i rëndësishëm nga Serbia, e cila ende pretendon se e ka autoritetin për t'u marrë me çështjet e juridiksionit të brendshëm të Kosovës në raport me aktorët ndërkombëtarë.

Për më tepër, teksti thotë: "Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare". Serbia kishte luftuar shumë që të hiqej fjala "asnjë" nga teksti dhe e ka humbur këtë betejë të veçantë. Kosova do të ketë preferuar që formulimi të ishte pak më pozitiv, që do ta obligonte Serbinë që ta përkrahte aplikacionin e saj për anëtarësim. Se paku Kosova mund ta interpretojë formulimin e zgjedhur në kuptimin se Serbia nuk do të votojë kundër anëtarësimit të Kosovës, që qartazi do të ishte një formë kundërshtimi.

Në raport me BE-në, Marrëveshja Bazë i obligon palët që të mos bllokojnë apo inkurajojnë të tjerët të bllokojnë progresin e palës tjetër në rrugën e tyre evropiane bazuar në meritat e veta. Do të jetë me rëndësi që të sigurohet se ky zotim të qëndrojë edhe nëse ndonjëri shtet anëtarësohet para tjetrit. Shteti i cili i pari bëhet anëtar nuk duhet të ketë të drejtën që ta përdorë veton në raport me kandidaturën tjetër.

Në fund, BE-ja parasheh një pako investimesh dhe përkrahjeje financiare të rëndësishme dhe të veçantë për projekte të përbashkëta të palëve për zhvillimin ekonomik, konektivitetin, transicionin e gjelbër dhe sfera të tjera kyç. Kjo do të aktivizohej që në çastin kur palët do të kenë shënuar progres në zbatimin e Marrëveshjes Bazë. Gjasat janë që Kosova do të donte të përfshinte projekte për të zhvilluar një të kuptuar të përbashkët të historisë së vonshme, të llogaridhënies dhe pajtimit.

Në përgjithësi, Marrëveshja Bazë, siç qëndron tash e paraqet një hap pozitiv para në Kosovë. Është barazi me njohjen si fakt, por jo me ligj, ende. Duke e siguruar marrëveshjen, Kosova është përkujdesur që të mos i sakrifikojë interesat e tjera thelbësore. Kjo e përfshin edhe të kuptuarit se marrëveshja është pjesë e shtegut drejt një normalizimi gjithëpërfshirës, me synim njohjen, ligjërisht të obligueshme. Kosova do të ketë nevojë të ecë përpara me çështjet që më herët kanë shkaktuar ngurrim, përfshirë edhe bashkëpunimin funksional të komunave, por këtë mund ta bëjë në bazë të gjuhës së dakorduar në Marrëveshjen Bazë, që është një hap përpara.

Për çështjet e tjera, siç janë kontaktet me Kishën Ortodokse Serbe apo mekanizmi i komunikimit me komunitetin e serbëve etnikë (dhe natyrisht mekanizma të ngjashëm edhe për të tjerët që e duan), Kosova do të mund të zgjidhte qasje proaktive dosido. Diskutimet që pritet të vijojnë mbi zbatimin do të vazhdojnë të jenë të rënda dhe sfiduese. Gjasat janë që Serbia do të kërkojë t'i rihapë çështjet që janë zgjidhur përfundimisht me 11 nenet dhe preambulën e Marrëveshjes Bazë — tekst që tash nuk mund të rinegociohet. Interpretimet e ndryshme për këtë apo atë çështje do të shfaqen pa asnjë dyshim. Megjithatë, nëse Kosova e mban këtë qasje të angazhimit proaktiv, duke kërkuar zgjidhje konstruktive pa rrezikuar interesat thelbësore, atëherë gjendet, së paku, në një pozitë të mirë startuese. *[KOHA/ Përktheu nga anglishtja: ©Flaka Surroi]*

Marc Weller është profesor i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Studimeve Ndërkombëtare Kushtetuese në Universitetin e Cambridgeit. Ka qenë këshilltar i kohëpaskohshëm i qeverive të Kosovës që nga nisja e diskutimeve për të ardhmen e Kosovës më 1997. Mendimet e shprehura këtu janë ekskluzivisht personale dhe nuk mund t'i atribuohen asnjë qeverie apo institucioni.

1.8 Dritan GOXHAJ, Tiranë

KOSOVA, SËRRIA, NATO DHE LUFTA

Në fillim të viteve 1990 politika e atëhershme serbe bënte çmos që të ruante integritetin territorial të Jugosllavisë, jo si opSION për popujt që e përbënin atë, por vetëm për serbët. Pas shpërbërjes së asaj Jugosllavie, tashmë serbët sërish po bëjnë çmos që të ruajnë integritetin e mbetur territorial të ish Jugosllavisë, territor i cili tashmë përbëhet vetëm nga Republika e Serbisë dhe ajo e Kosovës.

Serbët që kur i pushtuan trojet shqiptare në Kosovë thirreshin në të drejtat historike mbi Kosovën, por ama shqiptarët kanë më tepër të drejta historike mbi Kosovën, ndërkaq kanë edhe të drejta legjitime që dalin nga realiteti i sotëm politik dhe nga ai i djeshmi e i sotmi demografik.

Serbët përherë në këtë aspekt e kanë shpresuar dhe evokuar edhe publikisht dhe shpresojnë në përkrahjen e Ruisë. Por edhe shqiptarët ashtu si e tregoi edhe historia e fund shekullit të kaluar por edhe sot, e kanë dhe e shpresojnë sërish përkrahjen e botës tjetër, sidomos tashti që kërkesat e tyre janë konsideruar si legjitime, jo vetëm nga NATO dhe Evropa por edhe nga Gjykata Ndërkombëtare.

Sot për shkak të disa përplasjeve politike me natyrë teknike sërish serbët kërcënojnë me luftë e përgjakje të këtyre trojeve.

Por përgjakja e serishme e historisë mund të jetë vetëm remenishencë tragjike e së kaluarës dhe në kundërshtim total me gjëndjen aktuale të zhvillimit e të qytetërimit në këtë pjesë të botës.

Luftërat gjithnjë janë zhvillime irracionale, por që zhvillohen për qëllime racionale.

Por a do të hynte realisht Serbia një aventure të tillë irracionale, sado racionale që të jenë qëllimet e saja?

Unë personalisht them që jo, ajo nuk do t'i hynte kësaj aventure.

Arsyet janë dy dhe shumë të rëndësishme.

Arsyeja e parë: Serbia është e izoluar ushtarakisht

Ashtu si e thashë më lartë, gjithnjë Serbia shpreson në përkrahjen e Ruisë në rast të një lufte të re. Kjo pasi ajo në rast se do të vendoste të sulmonte sot Kosovën, atëherë do të thyente marrëveshjen e Kumanovës që ka nënshkruar me NATO-n. Si e tillë ajo do të gjendej në një konflikt të armatosur me NATO-n.

Për momentin harta Evropiane tregon se Serbia është e rrethuar nga të gjitha anët nga vendet e NATO-s dhe aleatët e saj. Pas shkëputjes së Malit të Zi, Serbia nuk ka më as dalje në det.

Kjo është edhe arsyeja kryesore përse shqiptarët duhet të bëjnë çmos që të mbajnë të unikfikuar shtetin Malazez, që serbët mos të kenë dot kur dalje në det.

Kjo tregon se nga ana taktike Serbia është e rrethuar totalisht dhe komplet e izoluar, pasi NATO në një rast të agresionit serb mbi forcat e saja në Kosovë, kësaj radhe do të mund ta sulmonte Serbinë nga të gjitha drejtimet.

Sot me zhvillimet aktuale të luftës në Ukrainë, Serbia nuk do të mund të merrte as ndihmën që ajo shpreson t'i marr nga Rusia. Pasi asnjë lloj armatimi ose trupa ushtarake nuk do të mund të vinin në këtë kohë në ndihmë të serbëve nga toka, por as edhe nga ajri pasi do të duhet të kalojë mbi territore të kontrolluara nga NATO.

Dhe tashmë që me fillimin e luftës në Ukrainë gjithë Evropa dhe në veçanti vendet e NATO-s kanë ndaluar të gjitha fluturimet dhe lundrimet e mjeteve nga dhe për në Rusi, në dhe mbi hapësirat e tyre territoriale dhe ajrore. Edhe në rast se Rusia nën kërkesën e dëshpëruar të Serbisë do të lëshonte ndonjë raketë nga territori i saj në drejtim të qendrave të komandimit ose të grumbullimit të forcave të NATO-s në Kosovë, kjo raketë do të duhej të kalonte mbi hapësirën ajrore të disa shteteve të NATO-s.

Gjë që do e bënte të pamundur arritjen e saj në objektiv. Edhe nëse do të bëhet fjalë për raketat e saja më të avancuara që nuk kapen nga radari, sërish vendet e NATO-s ku do të kalonte kjo raketë do të mund të bënin rrëzimin dhe bllokimin e saj nëpërmjet perdes së zjarrit të artilerisë kundërajrore. Plus, duhet pasur parasysh që ky veprim rus do të kundërshtoj edhe nga një grup i plotë sulmues i Marinës Amerikane në të cilën bën pjesë aeroplanmbajtësja me energji bërthamore Harry Truman, e cila prej datës 1 gusht ndodhet duke lundruar në detin Jon.

Ky Grup Sulmues përbëhet nga një aeroplanmbajtëse që aktualisht ka në bordin e saj 90 mjete ajrore nga të cilat 70 janë avionë gjuajtës dhe bombardues dhe është e shoqëruar nga të paktën një kryqëzor dhe një skuadron shkatërrues të përbërë nga dy fregata dhe një destroyer, si dhe në shoqërimin e tyre janë edhe dy nëndetëse të pajisura me raketa Kruiz dhe Tomahok. Dhe disa anije furnizimi dhe logjistike.

Duhet të kemi parasysh që e gjithë artileria që ndodhet në bordin e këtyre anijeve është e gjitha artileri detare dhe artileria detare konsiderohet artileri kundërajrore.

Pra ashtu siç edhe shihet aventura ushtarake serbe në këtë rast do të ishte totalisht e izoluar dhe e vetme kundër gjithë NATO-s.

Dhe NATO do e shfrytëzonte në këtë aventurë të tillë të Serbisë për ta goditur atë me gjithë fuqinë e saj, si kundërpërgjigje të luftës që Rusia po zhvillon në Ukrainë.

Dhe eliminimin total ushtarak dhe ekonomik të Serbisë të mund ta paraqiste publikisht jo vetëm si një fitore ushtarake ndaj një aleati të Ruisë dhe si një

fitore politike në arenën ndërkombëtare, por më e rëndësishmja kjo aventurë serbe do e projektonte NATO-n si të vetmen organizatë aktuale politiko-ushtarake në gjendje të ruajë paqen në rajon e më gjerë.

Arsyeja e dytë: Rusia nuk do lejonte një aventurë të tillë

Në rast se serbët do çmendeshin e do ngulnin këmbë t'i hynin kësaj aventure, atëherë vet Rusia nuk do e lejonte një gjë të tillë, sepse ashtu si e kam bërë unë këtë analizë ushtarake të mundësive të tyre për t'i ardhur në ndihmë Serbisë, të jeni të bindur që ushtria Ruse e ka bërë shumë herë më të detajuar.

Dhe duke qenë që nuk ekziston asnjë opsion që t'i vinë në ndihmë, atëherë ata do t'i rekomandonin Serbisë që mos t'i hyjë kësaj aventure, se jo vetëm që do humbas ushtarakisht duke shkatërruar totalisht fuqinë e saj ushtarake dhe duke e degraduar kështu Serbinë, nga vendi me fuqinë më të madhe ushtarake për momentin në Ballkan, në vendin me fuqinë më të dobët.

Por njëkohësisht përveç që kjo aventurë do të sillte përfundimisht shkëputjen përfundimtare të Kosovës, pa nevojën më të bisedimeve, do të sillte edhe humbje tjetër territoriale për Serbinë, në këtë rast do të humbte Preshevën, Medokën [Medvegjën] e Bujanocin.

Kjo pasi shqiptarët, nderta unë i pari, në këtë aventurë të Serbisë do nisesha me armë drejt trojeve shqiptare në Preshevë e Medokë, e do i bëja thirrja gjithë atyre të aftë për luftë, që të na bashkoheshin për marrjen njëherë e mirë të këtyre territoreve të aneksuara padrejtësisht dhe mbi të cilat po ushtrohet edhe sot gjenocid dhe pastrim etnik.

Rusët nuk do e lejonin në asnjë mënyrë një aventurë të tillë, pasi pamundësia për të ndërhyrë në këtë konflikt, qoftë ushtarakisht, qoftë politikisht, do i tregonte ata të dobët në arenën ndërkombëtare dhe do i nxirrte vetëm si një fuqi rajonale aty ku kanë shtrirje territoriale.

Ndërkohë që rusët me këtë luftë që po bëjnë në Ukrainë duan pikërisht të ndërrojnë këtë realitet, të paraqiten si një fuqi globale. Por aventura serbe do t'jua shuante përfundimisht ëndrrën.

Këto janë arsyet pse Serbia asesi nuk do e ndërmerre këtë aventurë. Por, ama asaj i duhet kjo retorikë lufte, ose thënë më mirë, më shumë se Serbisë kjo retorikë i duhet vetëm Vuçiçit, për të mbajtur pushtetin si gjoja nacionalist, ndërkohë që edhe ai, ashtu si kolegët e tij në këtë rajonin tonë, është vetëm një maskara e hajdut që po kapet me thonj pas patriotizmit për të qëndruar në pushtet.

Ndaj jam i mendimit që Kosova në asnjë mënyrë nuk duhet t'i përgjigjet retorikave luftënxitëse boshe të Serbisë. Kjo është e gjitha si një lojë pokeri, ku duhet të kuptosh se kur bën bluf kundërshtari e kur jo. Në rastin tone, Serbia po luan vetëm me blufin, ndaj nuk duhet dhënë fare rëndësi, por duhet luajtur në krahun tjetër.

Kosova duhet të kërkojë BE sa më shumë data dialogu pasi vetëm duke e ulur në tavolinë qeverinë Serbe jua demaskon atyre edhe blufin edhe politikën dhe

kështu vet serbët do i rrëzojnë e do e kuptojnë më në fund se edhe ne, edhe serbët, nuk mund të zhvendosemi prej vendeve tona; por nuk mund as të zgjedhim ndonjë fqinj më të mirë dhe nuk mund të bëhemi të tjerë nga që jemi.

Do ta kuptojnë se ne do të qëndrojmë aty ku jemi ashtu si jemi. Prandaj është mirë që të përpiqemi të lejojmë njëri tjetrin të jetojë jetën në trojet e tyre shekullore dhe se Kosova e pavarur është çështje jetike, jo vetëm e shqiptarëve, por në këtë rast edhe e serbëve, në rast se duan të jetojnë të qetë e të ruajnë këtë prosperitet që kanë.

1.9 Dr Dritan HOTI

TENDENCAT E REJA TË POLITIKËS NDËRKOMBËTARE DHE MARRËDHËNIET SHQIPTARO-AMERIKANE

Parashikimi i ecurisë së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe, konkretisht, përcaktimi i përmbajtjes së marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve, kalon detyrimisht nga vlerësimi e analiza e përpiktë e tërësisë së elementeve përbërëse të saj. Këto elemente përfshijnë të shkuarën historike të ndërlidhur me filozofinë e të bërit diplomaci në rastin e shtetit më të madh apo më të fuqishëm, si dhe paralelisht me të, perceptimet politike të vendit më të vogël, pra më pak të fuqishëm, tok me prirjet që asociohen me evoluimin e kompleksitetit teknologjike-ekonomik, të cilat edhe mund të influencojnë përmbajtjen, natyrën e politikës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe aleancat midis shteteve si pjesë përbërëse e saj.

Në 100-vjetorin, vitin jubilar të kohështrirjes së marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë, u diskutua gjerësisht për dinamikën e këtyre raporteve përgjatë viteve të shkuara, por u artikulua edhe vazhdimësia, si dhe përthellimi apo përforcimi i këtij partneriteti edhe për 100 vitet e ardhshme, siç preferojnë ta cilësojnë edhe diplomatët amerikanë. Tërësia e ekspertëve apo diplomatëve që janë marrë e kanë mbuluar të shkuarën e këtyre marrëdhënieve ranë dakord mbi 2 motivet kryesore që kanë ushqyer pro amerikanizmin e shqiptarëve, por elementet përcaktuese mbi të cilat do të mbështetet vazhdimësia e përforcimi i kësaj aleance, nuk është se u përmendën shumë. Ndërsa dy pikat referuese të cilat influencuan në pro-amerikanizmin veçanërisht pasionant të shqiptarëve, kanë të bëjnë me përfshirjen e çështjes shqiptare në një doktrinë të re të politikës së jashtme mbështetur mbi një vlerësim të drejtë të çështjeve kombëtare nisur nga një filozofi e re mbi baza idealizmi e ushtrimit të diplomacisë, si dhe në këtë kontekst, angazhimin personal të Presidentit të atëhershëm amerikan Wilson, përfaqësuesi i doktrinës së mësipërme, në mbrojtje të integritetit të Shqipërisë, si dhe motivi i dytë, i cili mishërohet në kontrastin e rolit që Amerika përfaqësonte përkundrajt kufizimeve drastike antinjerëzore që iu impononte shqiptarëve një diktaturë e zyrtë komuniste; e ardhmja e një partneriteti edhe më të ngushtë amerikano-shqiptar nuk varet nga tendencat e përgjithshme aktuale të përcaktimit të aleancave në skenën ndërkombëtare.

Në morinë e objektivave dhe rrjedhojave të sulmit të papranueshëm dhe të keq kalkuluar të Rusisë në Ukrainë, është ndër të tjera edhe projeksioni i konturimit të një bote multipolare, jo në kuptimin e institucioneve multilaterale, por të një bote gjeopolitike multilaterale, që nënkupton një botë sa më shumë që të jetë e mundur e fragmentarizuar, në të cilën roli e misioni i Amerikës si superfuqia e vetme që ende promovon sistemet e guvernancës

demokratike të zbehet apo të pengohet sa më shumë që të jetë e mundur. Rrjedhje tjetër po e drejtpërdrejtë e kësaj lufte është nën vendosja e kompleksitetit teknologjiko-ekonomik, skemave të mirëfillta gjeopolitike, duke u dhënë kështu një kuptim tradicional rivaliteteve diplomatiko-strategjike. Mirëpo brenda hapësirës së vendeve të demokracive liberale, një fenomen në zhvillim e sipër po kërcënon unitetin e saj politik nëpërmjet modifikimeve të mundshme të qëndrimeve të politikës së jashtme është përfundimi gradual i terrenit politik, si edhe zgjerimit të influencës në vende të caktuara të Evropës i versioneve të ndryshme, por të ngjashme, të populizmit politik. Por ky ndryshim apo edhe përmbysje, mund të ndodhë në momentin kur në shoqëritë e vendeve në fjalë, perceptimet populiste të jenë dominuese në shumicën e saj duke mandatuar përfaqësuesit po të kësaj ideologjie politike si drejtuesit e pushtetit në këto vende. Si rrjedhojë, do të rrvijëzohej një skenar kontradiktor, aderimit zyrtar të këtyre vendeve në aleancat perëndimore (NATO, BE) do t'i kundërviheshin platformat kontroverse të politikës së jashtme, që këto formacione politike përfaqësojnë, në të shumtën e rasteve në kundërshtim apo të distancuara nga ky angazhim historikostrategjik.

Në Shqipëri, e cila ndodhet në një gjendje apo stad të ndryshëm të zhvillimit historiko-institucional, nuk e hasim këtë fenomen socio-politik, duke bërë që ky vend të kontrastojë me vendet e caktuara të prekura nga këto tendenca. Teksa populizmi politik aktivizohet apo shfaqet në vende me një zhvillim të caktuar institucional, por edhe demokratik, ku këto korrente politike populiste, aktualisht e paraqesin misionin e tyre si të motivuar nga ruajtja e disa “vlerave tradicionale kombëtare” të rrezikuara tashmë nga elitizmi, trysnitë e emigracionit apo tendencat e zhvillimit komunitaro-demografik, Shqipëria gjendet aktualisht ende në stadin e pritshmërive të zbatimit të praktikave të duhura ligjore në funksion të konturimit të një shteti funksional demokratik i administruar nga institucione të shëndosha në planin etik, të cilat veprojnë në një sinergji, por duke e ekuilibruar njëkohësisht njëra-tjetrën në emër të funksionimit demokratik. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mundësuan vazhdimin e ekzistencës së shtetit shqiptar (1920), iu kundërvunë çdo skenari të mundshëm të një ricopëtimit të ri të Shqipërisë edhe në kohën e luftës së ftohtë, ndonëse kjo e fundit ishte një shtet i një lloji absurd të një diktature leniniste, ndërhyne, për të riparuar një padrejtësi historike të kombinuar edhe me interesat e saj gjeopolitike, ushtarakisht kundër Serbisë në Evropën juglindore, duke çliruar çështjen shqiptare jo vetëm nga penalizimet e së shkuarës, por duke e zhvendosur atë në pozitat më optimale historike që hapësira e kombi shqiptar ka përjetuar ndonjëherë që ka të bëjë me ekzistencën e dy shteteve-kombe shqiptare, Shqipëria anëtare e NATO-s, si edhe pjesa tjetër e faktorit shqiptar e përfshirë në strukturat e institucionet drejtuese në vendet ku ato jetojnë. Shqiptarët, të cilët në këto kohëra të zhvillimeve politike komplekse e në raste jo të pakta kontroverse, spikasin si elementi me kompakt në qëndrimin e tyre të palëkundur pro-amerikan në Europën juglindore apo ndoshta

edhe në të gjithë kontinentin e vjetër, e shohin investimin e angazhimin e Amerikës në suksesin e Reformës së shumëpritur në Drejtësi, garancinë e vetme të përmirësimit të gjendjes institucionale të vendit të tyre, e cila, për arsye komplekse, ku edhe vetë kanë një përgjegjësi, përbën ende hallkën më të dobët të gjendjes së tyre. Momentalisht, në lojën që ka të bëjë me suksesin e Reformës në Drejtësi, qëndrojnë katër lojtarët kryesorë të saj: zotimi i Amerikës për performancën e kësaj sipërmarrjeje të jashtëzakonshme juridike, shoqëria shqiptare me pritshmëritë e saj të cilat drejtohen nga ky angazhim, institucionet e posaçme të Drejtësisë së re për SPAK-un dhe Gjykatat Speciale përreth tij, si edhe eksponentë të elitës politike, të cilët i druhen suksesit real të Reformës në Drejtësi, i cili do t'i çmontonte nga pozitë të tyre duke nxjerrë në pah edhe një bilanc të tyre në mënyrën se si ata e kanë drejtuar apo janë sjellë me vendin e tyre nisur nga pozitë të tyre drejtuese.

Në një kohe kur tendencat e sipërpërmendura të politikës ndërkombëtare po diktojnë edhe tek Amerika një preferencë për aleanca thelbësore e të patjetërsueshme, të mishëruara se si blloku i vendeve anglosaksone po reagon në mënyrë uniforme përkundrejt krizave të ndryshme e sfidave të ndryshme të sistemit aktual ndërkombëtar, Shqipëria duket se gëzon një pozitë të privilegjuar në piketat e skemave të diplomacisë amerikane në Europën Juglindore, si një aleat veçanërisht i besueshëm, por edhe si një pike mbështetëse për platformat gjeo-strategjike të saj në këtë pjesë të Europës. E ardhmja e aleancës Amerikë - Shqipëri nuk kondicionohet kurrsesi nga prirje socio-politike i tillë populizmi i ditëve tona, por për këtë, në stadin ku gjendemi si element përcaktues i saj është suksesi në një kohë reale dhe jo me vonesa të stisura (nga ana e institucioneve speciale të drejtësisë së re që në të vërtetë kamuflojnë një dobësi apo hezitim për të vepruar përkundrejt niveleve të caktuara të politikës), që nisin të shkaktojnë zhgënjime në pritshmëritë ndaj Reformës në Drejtësi. Suksesi i kësaj reforme do ta zhvendoste Shqipërinë në pozitën e asaj që diplomatët amerikanë e konsiderojnë si një “aleat i denjë” i Amerikës, por edhe mungesa e këtij suksesi do të vazhdonte ta ruante sërish këtë aleancë, por në kushte disi të ndryshme. Aty do të behej fjalë për një aleat të dobët institucionalisht. Për më tepër, vazhdimësia e kësaj dobësie do të rrezikonte të merrte një trajtë endemike, duke ripërtërirë edhe anakronizmat politikë shqiptarë. Në këto kushte, me kalimin e kohës, edhe pasioni i sinqertë pro-amerikan i shqiptarëve do të niste të pësonte një zbehje. A nuk do të trumbetohej kjo në fund të fundit edhe nga kundërshtarët e vendosur të Amerikës edhe si një lloj humbjeje e influencës së Amerikës apo një lloj disfatizmi politik i saj?

E ardhmja e afërt e marrëdhënieve të popullit shqiptar me Amerikën varet kësajsoj direkt nga mënyra se si institucionet amerikane, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në mënyrën e duhur do të diktojnë intensifikimin e përsheptimitin e rezultateve edhe më konkrete të drejtësisë së re. Dhe momenti për këtë ka ardhur...

2. Dr. Gurakuç Kuçi*

“BALLKANI I HAPUR” DHE HIJA E PAQES SË OSLLOS

Ruajtja dhe shtrirja ideologjike dhe gjeopolitike e Ruisë përdor decidivisht edhe civilizimin në kuptimin e ortodoksizmit si religjion nëpërmjet Kishës Globale Ortodokse, ku kanë krijuar edhe bazën e veprimit që quhet zyrtarisht “Doktrina Ruse”.

Pas pushtimit të Krimesë nga Rusia, Kisha Ortodokse Ruse bashkë me Sergei Lavrovin dhe Vladimir Putinin kishin dalë me një deklaratë “për rezistencë ndaj liberalizimit internacionalist dhe mbrojtjes së civilizimit ortodoks”. Gjë që po vazhdon edhe sot në rastin e pushtimit të Ukrainës.

Pra, sllavët nacionalizimin e tyre e kanë të ndërtuar mbi fenë ortodokse dhe uniteti i tyre është i pandashëm që nga rënia e Bizmarkut dhe prishja e Marrëveshjes së Risigurimit, që nga ajo kohë sllavët kanë pasur një model bashkëpunimi modern të fuqishëm imperialist (bashkëpunimi ka qenë gjithmonë, por këtu po flasim për atë në nivel shtetesh moderne). Rusia i ka dalë në ndihmë Serbisë në çdo luftë e është munduar që të bëjë luftë edhe me NATO-në për Kosovën.

Sot Serbia dhe Rusia po e vazhdojnë tendencën e imperializmit në Ballkan me metoda konservatore nacionaliste nëpërmjet Kishës Ortodokse dhe atyre moderne si “Open Ballkan”. Në këtë grackë po bien të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor të cilat pretendojnë që me zhdukjen dhe ndarjen e Kosovës do të përmbushen apetitet serbe dhe vendet tjera në Ballkanin Perëndimor nuk do të influencohen më nga Serbia.

Luftërat në Ballkan, Suzan Vuuzvard (Susan Woosward) thoshte se nxiten nga fraksionet e ndryshme etnike, ku secila lufton për të fituar “parakushtet gjeopolitike dhe institucionale të sovranitetit, marrjen e aseteve strategjike dhe ekonomike, duke siguruar kufij të sigurt për të ardhmen, duke shkatërruar ato të armiqve, dhe ndërtimin (në kontekst të luftës) e aleancave të jashtme për mbrojtjen e tyre”.

Serbia kur kishte suprimuar autonominë e Kosovës nuk ishte ngopur, ishte hedhur në sulm kundër Kroacisë, Sllovenisë e Bosnjës.

Sot në përvjetorin e masakrës së Serbrenicës jemi dëshmitarë të neo-imperializimit serb në Ballkanin Perëndimor duke shtrirë forcën e saj nëpërmjet kishës në Mal të Zi dhe Kosovë, e nëpërmjet “Open Ballkan” në gjithë rajonin.

Kjo lloj realpolitike e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor, është guri i varrit për rajonin. Kosova është stabiliteti i Ballkanit Perëndimor dhe shprishja e këtij rendi kalon nga Kosova.

Maqedonia e Veriut do të zhdukej duke u ndarë ndërmjet tri shteteve; Mali i Zi do shkrihej nën Serbi.

Besimi se “Open Ballkan” ka përkrahjen perëndimore është i njëjtë sikur besimi në paqen e Oslos të viteve ’90 ndërmjet Izraelit dhe Palestinës.

Kosova ka pasur opsione edhe për autonomi vazhdimisht dhe sikur të pranoheshin ato, sot do të ishim nën Serbi, por ka punuar për pavarësi, i ngjashëm është edhe puna me “Ballkanin e Hapur” si imperializëm serb modern dhe ai nacionalist nëpërmjet kishës ortodokse.

Në gjithë këtë paritet, Kosova po del që ka vetëm një aleat të sinqertë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kryeministri i Malit të Zi mund të besojë në politikën e tij, pasi deri tani ishte i suksesshëm, por me Serbinë nuk mund të ketë sukses. Realpolitika e Shqipërisë ndaj Kosovës është dhimbja më e madhe që mund t’i ndodhë shqiptarëve, e Kosova duke e pasur furnizimin ekonomik më të madh nga Serbia është ndihma më e mirë ndaj armikut të saj. Ndërsa Maqedonia e Veriut uroj të ketë kuptuar më shumë gjëra nga incidenti i fundit nacionalist-shovinist anti-shqiptar.

Instrumentet për paqe të gjitha janë që nga pavarësia e Kosovës, vendimi i GJND-së për Kosovën e procesi i Berlinit; këto janë të mjaftueshme. Pa u përmbushur këto, nuk ka nevojë për instrumente dhe koncesione të reja. Këto instrumente nuk janë vetëm për Kosovën por edhe fqinjët e saj.

**Autori është i lauruar doktor në lëmin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe historin e diplomacisë, anëtar i stafit drejtues të Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë*

2.1 Shaban Murati, ambasador

VDIQ BALLKANIZMI I “BALLKANIT TË HAPUR”

Sapo mbushi një vit, nisma e presidentit serb e “Ballkanit të hapur” pësoi dështimin e parë dhe ndërroi emrin e lindjes “Mini Shengen ballkanik”. Emri i parë ishte një skifo, sepse shtetasit e të gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor qysh përpara nismës serbe hynin në shtetet e njeri-tjetrit me karta identiteti dhe vetëm Serbia mbante viza hyrje dhe ndalime.

Mirëpo nisma me emrin e ri “Ballkan i hapur” sapo mbushi vitin e parë pësoi dështimin e dytë më të madh dhe duhet të ndërrojë prapë emrin, por edhe vendlindjen.

Nisma do të duhet të heqë fare fjalën “Ballkan”, sepse po ndërron identitetin e vet gjeografik. Me propozimet dhe lëvizjet e reja, që po ndërmer nisma e “Ballkanit të hapur”, do të çvleftësojë si të papërshtatshme fjalën Ballkan në kartën e saj të identitetit gjeografik.

Në mikrosamitin e tre shteteve anëtare të “Ballkanit të hapur”, që u mbajt në Beograd në 2 shtator, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, siç njoftonte agjencia zyrtare serbe e lajmeve “Tanjug” në 2 shtator, bëri këtë deklaratë:

“Liderët e shteteve anëtare të nismës së “Ballkanit të hapur” po konsiderojnë seriozisht që të ftojnë shtete të tjera domethënëse pranë saj si Greqia, Italia, Turqia dhe Hungaria, që të bashkohen me këtë nismë rajonale”.

Pavarësisht se mburravecëria ballkanike tentoi ta shiste si sukses të madh që “Ballkani i Hapur” po u drejton ftesa për anëtarësim shteteve jashtë Ballkanit Perëndimor dhe jashtë gadishullit ballkanik, e vërteta është se kemi të bëjmë me një dështim të madh të nismës, e cila po heq dorë nga identiteti gjeografik i saj. Me këtë pretendim shtrirje anëtarësimi pa kufi “Ballkani i Hapur” po çballkanikohet dhe mund të thuhet se ballkanizmi i “Ballkanit të hapur” vdiq. Nisma serbe, ku janë anëtarësuar me zell të paparë jugosllav Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, nuk do të mund të mbajë më emrin “Ballkan i hapur” përderisa po fton për anëtarësim shtete, që janë jashtë Ballkanit në tërësi.

Gazeta serbe “Telegraf” njoftonte në 2 shtator se ministri i jashtëm hungarez, Peter Szijjarto, i ftuar në samitin e Beogradit, deklaroi se Hungaria është gati t’i bashkohet kësaj nisme. Por nëse Hungaria bëhet anëtare bashkë me shtete të tjera jashtë Ballkanit, kjo do të imponojë ndryshimin e emrit të nismës, sepse gjeografia e saj bëhet krejt tjetër dhe ikën nga vendlindja e saj ballkanike.

Përfshirja e shteteve të tjera jashtë ballkanike i ndërron identitetin gjeografik dhe diplomatik dhe nismës as i takon dhe as mund të quhet më ballkanike.

Po ta krahasosh me nisma apo me grupime të tjera të ngushta subrajonale në kontinentin europian, dështimi i “Ballkanit të hapur” është uluritës. Kështu nisma apo grupimi subrajonale i “Këshillit Nordik” është krijuar që në vitin

1952 dhe nuk e ka ndryshuar asnjëherë as emrin e vet, as shtetet anëtare, dhe as identitetin gjeografik dhe quhet njëloj edhe sot si para 70 viteve.

Nisma tjetër subrajonale “Grupi i Vishegradit” është themeluar në vitin 1991 dhe ka po ato vende anëtare, po atë identitet gjeografik dhe po atë emër sot e kësaj dite si 31 vite më parë. Grupi subrajonal serb i “Ballkanit të hapur”, përqafuar vetëm nga tre shtete, Serbia, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, po ndërron emër dhe identitet gjeografik dy herë brenda dy vite e gjysmë që nga krijimi i saj.

Pyetja, që del nga novacioni i ri allballkanik i ftesës së tre shteteve të aleancës subrajonale të “Ballkanit të hapur” drejtuar për anëtarësim shteteve të tjera jashtë Ballkanit Perëndimor dhe jashtë gadishullit ballkanik, është se përse doli kjo befasi diplomatike dhe organizative për çballkanizmin e “Ballkanit të hapur”.

Shpjegimi i parë është dështimi i tre krerëve të tre shteteve anëtare të “Ballkanit të hapur” për të detyruar tre shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor që t’i bashkohen nismës serbe. Kosova, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi kanë refuzuar të futen në atë mikroaleancë, sepse e dinë se Serbia nëpërmjet nismës së saj të “Ballkanit të hapur” synon t’i zhbëjë ato tre shtete.

Samitxhijtë e Beogradit u përpoqën në 2 shtator të bëjnë një truk dhe t’i servirin publikut sikur nisma e tyre po përkrahet nga Mali i Zi dhe nga Bosnje-Hercegovina, meqë dy politikanë të lartë të atyre dy shteteve ishin si mysafirë të ftuar për degustimin e verërave në samitin e Beogradit.

Mirëpo e vërteta është se Abazoviç është një kryeministër i shkarkuar nga parlamenti i Malit të Zi në gusht të këtij viti dhe nuk ka tagër ligjor të fusë Malin e Zi në nismën serbe. Abazoviç shkoi në Beograd si i ftuar personal i presidentit serb Vuçiç dhe i kishës ortodokse serbe.

Kryetari serb i Këshillit të Ministrave të Bosnje-Hercegovinës, Zoran Tegeltija, ishte në samit si ftuar i presidentit serb, pa asnjë mandat zyrtar dhe pa kompetencë ligjore dhe pa asnjë tagër që të fusë shtetin e Bosnje-Hercegovinës në nismën serbe.

Gazeta “Sarajevotimes” shkruante në 1 shtator se Tegeltija merr pjesë në samitin e Beogradit pa lejen e presidencës së përbashkët trepalëshe të Bosnje-Hercegovinës. Pra ai ishte në cilësi personale si politikan serb i ardhur nga e ashtuquajtura “serpska republika”. Dy anëtarët e presidencës së përbashkët të Bosnje-Hercegovinës, Xhaferoviç dhe Komsić, që përfaqësojnë popullin boshnjak dhe popullin kroat, janë kundër “Ballkanit të hapur” serb dhe pa firmën e pa pëlqimin e tyre nuk mund të ketë asnjë lloj përfaqësimi zyrtar apo anëtarësimi të shtetit në atë nismë.

Kështu që pjesëmarrja e Abazoviçit dhe e Tegeltisë në samitin e Beogradit ishte një reklamë artificiale për ta paraqitur të paqenën si të qenë. Për të mbuluar dështimin e nismës, e cila mbeti gjysmake me vetëm tre shtete nga

gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor, tre krerët e shteteve anëtare të nismës dolën me propozimin e ri që të ftojnë për anëtarësim në mikroaleancën e tyre shtete të tjera përtej Ballkanit Perëndimor dhe përtej gadishullit ballkanik. Sipas deklaratave zyrtare të diplomacisë së SHBA dhe të BE nisma e “Ballkanit të hapur” nuk mund të njihet dhe as të quhet e vlefshme nëse në të nuk marrin pjesë gjashtë shtetet përbërëse të Ballkanit Perëndimor. Duke parë se ky është një mision i pamundur, dhe për ta shpëtuar në një farë mënyre nismën serbe nga shkrirja, treshja e tre shteteve anëtare nxitoi në 2 shtator të dilte me blonin e ri diplomatik të ftesës për anëtarësim të shteteve të tjera jashtë Ballkanit Perëndimor.

Shpjegimi i dytë është realizimi i rolit të “Ballkanit të hapur” si nismë që devijon dhe i kundërvihet integritimit evropian. Duke marrë shtysë nga strategjia antieuropiane e Ruisë dhe me mbështetjen e fortë të diplomacisë ruse nisma serbe doli që në mbledhjen inaguruese në Novi Sad në tetor 2019 me devizën antieuropiane “të Ballkanit për ballkanasit pa tutorësinë e BE”. Një studim i ministrisë serbe të mbrojtjes i publikuar para pak kohësh në median zyrtare “vojnodeo.mod.gov.rs” thekson se “Rusia ka mbështetur nismën serbe të Ballkanit të hapur”.

Interesi strategjik dhe gjeopolitik i Ruisë në Ballkan është që të krijohet një pol politik lokal apo një mikroaleancë subrajonale e kontrolluar nga Serbia, që të distancohet nga integrimi i lodhshëm evropian dhe të kërkojë alternativën e lehtë ruse. Në këtë kuadër duhet parë refuzimi i presidentit serb Vuçiç për të harmonizuar politikën e jashtme serbe me atë të BE dhe kundërshtimi i tij kategorik për të mos vendosur sanksione ndaj Ruisë agresore.

Në këtë kuadër duhen parë edhe qëndrimet pro serbe dhe efektivisht pro ruse të kryeministrit të Hungarisë dhe të atij të Shqipërisë, që i kërkojnë BE-së të mos i bëjë presion Serbisë për vendosjen e sanksioneve kundër Ruisë.

Karakterin antieuropian të nismës serbe “Ballkan i hapur” e theksonte edhe një studim i Fondacionit amerikan “Rockefeller Brothers” i botuar në median “euractiv” në 30 gusht: “Nisma “Ballkan i hapur” mund të ndikojë negativisht në rajon. Liderët e shteteve të përfshira në “Ballkanin e hapur” duket se e mirëpresin idenë që ata nuk kanë pse mbështesin standardet evropiane brenda saj”.

Duke ftuar shtete jashtë ballkanike si Hungaria filoruse, “Ballkani i hapur” tenton të thellojë distancën nga BE. Madje në mesin e tre krerëve të tre shteteve pjesëmarrëse të nismës serbe po pompohet ideja megallomane se nisma e tyre do të bëhet qendër e madhe jo rajonale, por ndërkombëtare, ku do të aspirojnë të hyjnë gjitha shtetet evropiane.

Nuk është shaka! Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama deklaroi në samitin e Beogradit në 2 shtator se shtete evropiane mezi po presin të bëhen anëtarë të “Ballkanit të hapur”. Samiti dëgjoi rrëfimin e tij anekdotik se si kryeministri

i një shteti anëtar të BE e kishte thirrur në telefon dhe i ishte ankuar i mërzhitur pse nuk e kishin ftuar në samitin trepalësh të Beogradit.

Dhe me megallomaninë tipike ballkanike kryeministri u lavdërua se tani shtetet europiane po presin ftesa nga “Ballkani i hapur” dhe këto kërkesa vijnë “nga shtete europiane nga të cilët ne kemi pritur ftesa të llojeve të ndryshme prej një kohe të gjatë”.

Hapu dhe të futem, ku katandiset diplomacia ballkanike, që dëftën përrallat se anëtarët e BE, që kanë zvarritur kërkesat e integritit për shtetet e Ballkanit Perëndimor, tani presin në rradhë për të hyrë në “Ballkanin e hapur”.

Kemi një autosugjestion të habitshëm halucinant, ku jo Ballkani do të hyjë në Evropë, por BE do të hyjë në “Ballkanin e hapur”. Këto janë broçkullat e nivelit të lartë, që vijnë nga mikrosamiti i Beogradit, me kryetarë të dehur pas ahengut të verës dhe të konjakut lumë dhe betimit para flamurit të ri të përbashkët trepalësh të vëllazërim-bashkimit jugosllav.

Samiti i fundit i mikroaleancës “Ballkan i hapur” prodhoi një lëvizje të re antieuropiane dhe antiamerikane. Kundërvënia e parë antiamerikane është ndaj të dërguarit të posaçëm të SHBA për Ballkanin, Gabriel Escobar, i cili në 8 qershor 2022 i dërgoi samitit të tre krerëve të tre shteteve të “Ballkanit të hapur” në Ohër mesazhin e rëndësishëm që nisma e tyre të mbetet ekonomike dhe “ky nuk është projekt politik”.

Samiti i Beogradit doli hapur kundër qëndrimit amerikan dhe kryeministri i Shqipërisë me karshillëk deklaroi në Beograd se “nisma është shumë më tepër se politike, po e po”.

Nuk mund të mos bëjë përshtypje befasia diplomatike e samitit të Beogradit që, ndërsa fton për anëtarësim shtete jashtë Ballkanit Perëndimor dhe jashtë gadishullit të Ballkanit, nuk ftohen Kroacia dhe Bullgaria, që janë dy shtete fqinjë të Serbisë dhe anëtare të BE dhe të NATO-s.

Shpjegimi është se listat i bën Serbia dhe dy shtetet e tjera anëtare të nismës vetëm ngrejnë dorën. Serbia ka marrëdhënie të acaruar edhe me Kroacinë, edhe me Bullgarinë. Me Kroacinë Serbia ka rivendikime kufitare dhe territoriale dhe ditët e fundit presidenti serb Vuçiç pretendonte rivendosjen e kontrollit të Serbisë në territorin kroat, që pat pushtuar në vitet 1992-1995 ushtria agresore e Millosheviçit. Me Bullgarinë Serbia ka acaruar marrëdhëniet, sepse Beogradi ka përkrahur qëndrimet antibullgare të Shkupit me qëllimin që të ruajë dominimin e lobit serb në Shkup, i cili sipas diplomacisë serbe rrezikohet nga Bullgaria.

Ç’ballkanizmi i “Ballkanit të hapur”, që vjen si prova e re e dështimit të kësaj nisme, tregon karakterin artificial dhe antiballkanik të nismës së presidentit serb. Është një nismë që po shkon drejt varrit, dhe të cilën nuk e shpëtojnë dot salvaxhentet e shpuar diplomatikë të ftësive për anëtarësim të shteteve jashtë Ballkanit Perëndimor dhe jashtë Ballkanit.

Edhe nëse për një moment supozohet se shtetet jo ballkanike anëtare apo kandidatë të BE mund të marrin në konsideratë ftesën e re, a mund të ketë naiv ose idiot, që mund të besojë se Italia apo Turqia do të lejojnë të drejtohen nga presidenti Vuçiç në politikat e tyre ballkanike?

Bretkosa ballkanike mund të ëndërrojë të bëhet ka evropian, por siç ka thënë La Fonteni, ajo do të plasë nga marazi i dështimit të ëndrrës së saj.

2.2 Dr Lisen Bashkurti

“MINISHENGENI” BALLKANIK, TROJKA E DËSHPËRUAR PA MBËSHTETJE BALLKANIKE

Këto ditë u bë në Shkup takimi i tetë i radhës për “Minishengenin” ballkanik. Në takim morën pjesë Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut. Tre shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina nuk morën pjesë. Pas takimit u firmosën disa marrëveshje që synojnë jetësimin e nismës. Parashihet që në vitin 2023 qytetarët e këtyre tre vendeve të lëvizin lirshëm në tërë hapësirën e trojkës.

Debate të shumta e kanë shoqëruar dhe pasuar takimin e tetë të Shkupit. Disa debate janë politike, disa patriotike dhe të tjerat janë teknike, pra ekonomike dhe tregtare. Pavarësisht nga karakteri i debateve, fakti që nisma shoqërohet dhe pasohet me papajtueshmëri të shumta dhe të forta tregon se ka disa gjëra që nuk shkojnë mirë me të.

Nismat apo organizatat rajonale kanë definicionin e tyre në shkencat e marrëdhënieve ndërkombëtare. Ky definicion vjen nga historia dhe afirmimi në të drejtën dhe në praktikën ndërkombëtare. Butros Butros Gali i definonte nismat apo organizatat rajonale si “organizata të përhershme, të cilat në një hapsirë të caktuar gjeografike tubojnë disa shtete, që, për shkak të fqinjësisë, të interesave të përbashkëta ose të lidhjeve kulturore, gjuhësore, historike a shpirtërore, solidarizohen për zgjidhjen paqësore të të gjitha mosmarrëveshjeve që do të mund të shfaqeshin midis tyre, për ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në rajonin e tyre, si dhe për ruajtjen e interesave të tyre dhe për zhvillimin e marrëdhënieve të tyre ekonomike e kulturore” (Pedro Pablo Comargo, ‘Dereco International, Tomo III, p.252)

Ky definicion i pranuar gjërësisht në të drejtën ndërkombëtare dhe praktikën botërore vlen për çdo organizatë apo iniciativë rajonale. Bazuar mbi këtë definicion dhe duke bërë analizë krahasuese me “Minishengenin” ballkanik, duke u përpjekur të mbetem mëndjeftohtë do e ndërtoj shkrimin mbi disa pyetje.

1. Gjithëpërfshirës apo përjashtues?

Në fillimet e saj nisma për “Minishengenin” ballkanik synonte të tërhiqte gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë edhe Malin e Zi, Bosnje-Hercegovinën dhe Kosovën. Edhe mbas tetë takimesh kjo nuk ndodhi. Nismëtarët, Shqipëria, Serbia dhe Maqedonia e Veriut nuk arritën dot të ndërtonin një proces gjithëpërfshirës për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Ata dështuan të krijonin bindjen tek fqinjët e tyre. Për këtë ka shkaqe dhe faktorë të shumtë.

Disa shkaqe burojnë nga mungesa e kushteve e rrethanave rajonale për bashkëpunim, ka faktorë mosbesimi midis palëve, ka dallueshmëri në nivelet e zhvillimit ekonomik e tregtar, ka mospërputhshmëri legislative dhe institucionale, ka mungesa infrastrukture, ka kontradikta të thella papajtueshmërie politike e gjeopolitike. Mbi të gjithë ka një zhvendosje të paarsyetuar nga procesi i Berlinit (që hap dhe njëkohësisht lidh tregjet e Ballkanit me BE dhe njëzet e shtatë vendet anëtarë të tij) drejt një nisme plot paqartësi e vizione që nuk të shpien drejt një qëllimi e objektivash të qartë. Me fjalë të tjera “Minishengeni” ballkanik edhe mbas tetë takimesh nuk ka arritur të sigurojë harmonizimin e qëllimit dhe objektivave të përbashkët me interesat e gjashtë shteteve individuale të Ballkanit Perëndimor.

Në këto kushte e rrethana, nisma nuk gjeti mbështetje ballkanike, por u tkurr në një trojkë ballkanike. Bazuar në praktikën e nismave dhe organizatave rajonale trojka Tiranë-Shkup-Beograd nuk arriti të ngrihet në nivel të hapur ballkanik, por në nivel të tkurrur ballkanik, duke mbetur në thelb nismë perjashtuese dhe jo gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst mbetën më të vlefshme iniciativat rajonale si CEFTA apo procesi i Berlinit që janë gjithëpërfshirëse për mbarë Ballkanin Perëndimor dhe e integrojnë atë me Bashkimin Evropian.

2. Bashkim kaotik apo me kriteret?

Krijimi i nismave apo organizatave rajonale synon krijimin e grupimeve të disa shteteve që vendosin të bashkëpunojnë në një ose disa fusha me qëllim përfitimet e përbashkëta dhe të secilit veçmas. Shtetet që i bashkohen këtyre nismave apo organizatave krijojnë një grup nismëtar që vendos qysh në fillim kriteret që duhet të plotësojë secili vend që të mund t’u bashkohet atyre. A ka kriteret të tilla nisma e “Minishengenit” ballkanik? Nëse po, cilat janë kriteret politike, ekonomike, juridike dhe administrative që duhet të plotësojë secili vend individualisht?

Deri tani askund nuk janë bërë me dije kriteret që i bashkojnë këto vënde. Pra kemi të bëjmë me një tentativë për të bashkuar shtete konglomerat, pa kriteret të unifikuara dhe të standardizuara politike, ekonomike, juridike dhe administrative. Në këto kushte nisma ose do të dështojë, siç ka dështuar në tetë hapat e parë të saj, ose do të adoptojë masa gjatë rrugës, që mund të jenë të ndryshme nga kriteret e Kopenhagës së BE. Mund të jenë devijime nga legjislacioni “Acquis Communautaire”, mund të jenë përplasje me të, ose, akoma më keq mund të krijojnë një konglomerat regjimesh demokratikë e autokratikë apo hibridë, me mirë-qeverisje apo keq-qeverisje, me mungesë transparence, korrupsion dhe të inkrimnuar, me mungesë lirie e konkurrence ekonomike, me trafike të paligjshme dhe pastrime parash.

Ky eksperiment duket të jetë krejt i panevojshëm dhe madje i rrezikshëm për sa kohë të gjithë vendet e Ballkanit Perëndimor janë të ndërfutura në procesin e integritimit në BE dhe për këtë arsye u referohen kriterëve të Kopenhagës në

rrafshet politike, ekonomike, juridike dhe administrative. Këto kritere lidhen me demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut, fqinjësinë e mirë, bashkëpunimin rajonal dhe vijojnë me standardet e lirisë ekonomike e tregëtare, kushtet financiare dhe monetare, përafrimin e legjislacionit dhe funksionimin e kapaciteteve administrative. Referenca e kritereve të Kopenhagës është e patjetërsueshme dhe e pazëvendësueshme. Për këto arsye nisma e trojkës Tiranë-Shkup-Beograd ngjan më shumë si “nisma e të dëshpëruarve apo e të inatosurve me BE” se sa një nismë që i shpie vendet e trojkës drejt BE.

3. Projekte me financa apo me propagandë?

Bazuar në Traktatin e Vjenës për organizatat dhe nismat rajonale dhe në praktikën e krijimit dhe funksionimit të tyre, është e domosdoshme që palët të krijojnë themelet financuese për realizimin e qëllimit, objektivave dhe projekteve të përbashkëta. Ky kontribut jepet nga shtetet pjesëmarrëse, por edhe nga shtete të tjera donatore e sponsorizuese apo institucione bankare e financiare ndërkombëtare. Ka mjaft raste që organizatat e nismat rajonale kanë krijuar bankat apo fondacionet e tyre me kapitale të mjaftueshme për përmbushjen e qëllimit, objektivave dhe projekteve të tyre.

“Shengeni ballkanik” ose “Ballkani i tkurrur” nuk është deklaruar për krijimin e themeleve financuese për realizimin e qëllimit, objektivave dhe projekteve të veta. Si mund të zbatohet një nismë e tillë pa kapitale financiare? Edhe ndryshimet e legjislacionit, të logjistikës, infrastrukturës në nivel shumëpalësh për t’u adoptuar nismës kërkojnë para për t’u realizuar. Pa para asgjë nuk mund të lëvizë. Nismëtarët nuk kanë arritur të bindin as vetveten dhe as shtetet e tjera apo institucionet bankare dhe financiare për të mbështetur financiarisht iniciativën e tyre. Mungesa e mbështetjes financiare është reagimi diplomatik injorues më i mirë ndërkombëtar ndaj kësaj nisme.

4. Lidërship e administrim spontan apo i strukturuar?

Bazuar në Traktatin e Vjenës dhe në praktikën ndërkombëtare për krijimin dhe funksionimin e organizatave dhe nismave rajonale, është e domosdoshme që të krijohen organet drejtuese si dhe një qendër administrimi e përbashkët e shteteve pjesëmarrëse në iniciativë. Në krye të administrimit ka dy struktura: një strukturë politikë-bërëse dhe vendim-marrëse, që përbëhet nga përfaqësues të lartë të vendeve anëtare dhe një strukturë administrative që krijohet me stafe teknike dhe udhëhiqet nga një sekretar i përgjithshëm. Në krye të organeve drejtuese politike vendoset një përfaqësues i lartë, zakonisht me rotacion nga shtetet anëtare të nismës.

Këto organe politike dhe qendra e përbashkët administrative synojnë që të ndjekin zbatimin e traktatit e marrëveshjeve të lidhura mes palëve, të

firmosfera dhe ratifikuara në këtë kuadër, të informojë rregullisht pjesëmarrësit për ecurinë, problematikat dhe aspekte të tjera, të organizojë takimet e rregullta periodike të parashikuara në statutin e organizatës apo nismës, duke filluar nga agjenda deri te protokollin dhe dokumentet që miratohen në proces. Nisma e “Minishengenit” ballkanik apo e “Ballkanit të tkurrur”, nuk duket të ketë themeluar një strukturë të tillë me organet drejtuese dhe strukturë drejtimi administrativ politik dhe administrativ. Gjithçka duket t’i jetë lënë spontanitetit diletant, pa parashikime profesionale, pa vizione afatgjatë, pa përgjegjshmëri dhe pa llogaridhënie politike. Kështu, mund të themi që nismës, së paku deri tani i mungojnë organet kapilare drejtuese politike dhe administrative për zbatimin e qëllimit, objektivave dhe projekteve. Pa këto organe dhe pa këtë strukturë politike dhe administrative nisma rajonale nuk mund të ekzistojnë dhe aq më pak të nuk mund të jetësohen.

Si konkluzion mund të themi se nisma e “Minishengenit” ballkanik, e quajtur me emrin “Ballkani i hapur” nuk plotëson përgjithësisht parimet, normat juridike dhe praktikën ndërkombëtare të një nisme rajonale, nuk është gjithëpërfshirëse konform emrit të saj, por përjashtuese sepse nuk ka arritur të harmonizojë qëllimin e përbashkët të nismës me interesat e shteteve individuale ballkanike, nuk ka arritur të sigurojë bazat e saj të përbashkëta financiare për të funksionuar, nuk ka krijuar strukturën e saj drejtuese politike vendim-marrëse dhe atë administrative për menaxhimin e punëve.

Edhe mbas takimit të tetë të saj, iniciativa e “Minishengenit” ballkanik nuk arriti të konstitujë këto parime, norma, financa e struktura lidhëse dhe administrative, nuk i është bashkëngjitur qartësisht dhe vendosmërisht integritet në BE dhe procesit të Berlinit që rrjedh prej tij, duke ulur gjithnjë e më shumë pritshmëritë ndaj saj.

II GJEOPOLITIKA RAJONALE

3. Dr Albulenë HALILI

MAQEDONIA MES INTEGRIMIT NË STRUKTURAT EURO-ATLANTIKE DHE GJEOPOLITIKËS BALLKANIKE

Abstrakt

Ky punim shkencor synon të paraqesë një analizë lidhur me shkaqet e mospranimit të Maqedonisë në organizatën politiko-ushtarake-NATO në Samitin e mbajtur vitin e kaluar në Bukuresht, si edhe pasojat që vijnë si rrjedhojë e këtij mospranimi. Meqenëse NATO kishte për qëllim ta zgjerojë shtrirjen e saj me tre shtete të reja në Ballkan gjë që do të ndikonte në stabilizimin e rajonit, mospranimi i Republikës së Maqedonisë në këtë organizatë në prill të vitit 2008, ka zgjuar shumë kundërshtime dhe ka shtuar mundësinë për jostabilitet rajonal. Punimi në fjalë do të shtjellohet përmes dy shtyllave: shkaqet dhe pasojat për mospranim. Në grupin e shkaqeve do të analizohen detajisht faktorët e brendshëm si politika jo e qartë e Maqedonisë dhe sfidat e saj të brendshme, si edhe ata të jashtëm – vetoja greke si pasojë e kontestit me emrin; ndërsa si pasojë e mundshme do të shtjellohet impakti negativ për Maqedoninë si një shtet tejet i brishtë dhe me tranzicion të tejzgjatur, ashtu edhe për tërë rajonin ballkanik i shquar me një jostabilitet të vazhdueshëm. Përfundimet e sjellura nga ky studim janë: (1) nevoja urgjente e profilizimit të politikës së brendshme të Maqedonisë në të mirë të integriteteve euro-atlantike, (2) praktika negative e shteteve ballkanike për të penguar anëtarësimin e shteteve të reja në strukturat euro-atlantike, sjell nevojën e reformimit të mekanizmit vendimmarrës të këtyre organizatave që kanë synim ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal.

NATO dhe gjeopolitika ballkanike

Sigurimi kolektiv është njëri nga parimet më të rëndësishme që u promovua pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Katërmbëdhjetë pikat[1] e presidentit amerikan Woodrow Willson parashihnin “formimin e një organizate të kombeve nën marrëveshje specifike me qëllim të dhënies së garancive të ndërsjella për pavarësi politike dhe integritet territorial, si shteteve të mëdha ashtu edhe atyre të vogla”. [2] Parimi i sigurisë kolektive u skicua gjatë ndërtimit të sistemit të Versajës, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Në traktatin që u nënshkrua në vitin 1919, për herë të parë u krijua një organizatë kolektive që do ruante paqen dhe sigurinë në botë me emrin Lidhja e Kombeve e cila ishte pararendëse e OKB-së. Qëllimet e Kombeve të Bashkuara janë: ruajtja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, zhvillimi i marrëdhënieve miqësore mes kombeve dhe arritja e bashkëpunimit në zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare të natyrës ekonomike, sociale, kulturore ose humanitare. [3] Megjithëse pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, ishin krijuar mekanizmat multilateralë të cilët do të garantonin paqen dhe sigurinë kolektive, rrethanat

politike të cilat determinuan sistemin ndërkombëtar, diktuan krijimin e një organizate ushtarake e cila do t'i shërbente kryesisht kontinentit evropian për t'u mbrojtur nga Bashkimi Sovjetik i cili në atë kohë përbente kërcënim për demokracitë perëndimore.

Traktati i Brukselit në vitin 1948 vuri bazat e një sistemi evropian të sigurisë, ndërsa akti themelues i Organizatës së Atlantikut Verior ishte Traktati i Uashingtonit[4], ku përveç shteteve evropiane, në këtë organizatë u bënë bashkëthemeluese edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kanadaja.

NATO me kalimin e kohës, ka pësuar transformime të mëdha, ndërsa siç shprehen studjuesit Jackson dhe Dutkiewicz “ajo ka ecur drejt një procesi të tërë të metamorfozës”. [5] NATO u krijua në periudhën e parë të Luftës së Ftohtë, ndërsa në përputhje me ndryshimin e rrethanave dhe sistemit ndërkombëtar në tërësi, ajo u konsolidua si organizatë me karakter politiko-ushtarak pas shpërbërjes së ish Bashkimit Sovjetik. Në vitin 1999 anëtarët e NATO-s kishin miratuar të ashtuquajturin Koncepti strategjik[6], i cili ishte një version i përpunuar dhe i plotësuar i strategjisë së vitit 1991. Me shfaqjen e një Evrope gjithnjë e më të integruar dhe me zhvillimin e strukturës së sigurisë euro-atlantike, lindin edhe sfidat e reja të kësaj organizate. Qëllimi themelor i kësaj organizate – “ruajtja e lirisë dhe sigurisë”[7] në zonën euro-atlantike dhe parimi udhëheqës i saj – “angazhimi i përbashkët dhe bashkëpunimi i ndërsjellë mes shteteve sovraane në mbështetje të pandashmërisë së sigurisë”[8], kushtëzojnë krijimin e politikave dhe strategjive të reja brenda fushëveprimit të kësaj organizate. Andaj edhe Koncepti strategjik që u miratua në vitin 1999 përveç aktiviteteve për parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, atyre për partneritet bashkëpunim dhe dialog, parashikoi edhe politikën e zgjerimit të organizatës. “Politika e dyerve të hapura” e NATO-s u parapa që në Traktatin e Uashingtonit, në nenin 10 [9] të tij. Kjo politikë promovon mundësinë e aderimit të shteteve të tjera në këtë organizatë, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit dhe bashkëpunimit, bashkimit të shteteve për mbrojtje kolektive, ndërtimit të një Evrope të bashkuar dhe me vlera të përbashkëta demokratike.

Ballkani gjithmonë ka qenë një zonë shumë e rëndësishme gjeostrategjike, e karakterizuar me një diversitet të theksuar të orientimit gjeopolitik. Kjo gjeopolitikë ka çuar në fragmentarizimin e këtij gadishulli të rëndësishëm për Evropën. Pozicioni i shteteve u determinua nga dy blloqet e kundërta. Prandaj, struktura gjeopolitike e këtij rajoni gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë kushtëzohet nga formula 2+2+2”. [10] Greqia e Turqia ishin anëtarësuar në aleancën veri-atlantike që në vitin 1952, Rumania e Bullgaria bënë pjesë në Paktin e Varshavës, ndërsa Jugosllavia e Shqipëria në atë kohë mbetën jashtë dy blloqeve.

Me mbarimin e Luftës së Ftohtë dhe shpërbërjen e ish Bashkimit Sovjetik, dolën shumë shtete të cilat ardhmërinë e tyre më të sigurtë e shihnin në

integrimin në strukturën euro-atlantike. Kështu, pothuajse të gjitha shtetet ballkanike shprehën interesat e tyre strategjike për anëtarësim në UE dhe NATO, gjë e cila sipas studiuesit Martin Kahl, u shndërrua në “parim kryesor të politikave të tyre të jashtme dhe të sigurisë”. [11] Çështja e anëtarësimit në këto organizata, është parësore pothuajse për çdo shtet që ka dalë nga sistemi socialist, të cilët ndodhen në fazën e tranzicionit. Këto prioritete të shteteve në tranzicion, u përputhën me qëllimet e kësaj organizate për të zgjeruar zonën e saj mbrojtëse të sigurisë, gjegjësisht “për të shtuar sigurinë dhe stabilitetin në tërë zonën euro-atlantike” [12]. Andaj dhe aleanca pati përpiluar disa plane veprimi për të arritur këtë qëllim të saj dhe për të lehtësuar procesin integrues të shteteve aspiruese. Në vitin 1994, në Samitin e Brukselit, NATO pati filluar me planin e veprimit për partneritet individual të emërtuar *Partneriteti për paqe*, ndërsa më vonë në samitin e Uashingtonit (1999), edhe me *Planin e veprimit për anëtarësim*. Programi i “Partneritetit për Paqe” kishte për qëllim vendosjen e marrëdhënies të reja të sigurisë si mekanizëm i largimit të kërcënimeve të paqes në Evropë, duke i ndërtuar urat lidhëse në mes NATO-s dhe vendeve të partneritetit për paqe. Përmes këtij programi, vendeve post-socialiste, e sidomos shteteve të Evropës Qendrore dhe atyre ballkanike, iu bë e qartë se bashkëpunimi me Paktin Veriatlantik është i domosdoshëm për të tejkaluar vështirësitë e reformave të brendshme. Ndarja e vlerave të përbashkëta në mes Aleancës Veriatlantike dhe shteteve aspirante ka qenë një vizion i qartë rreth zgjerimit të NATO-s, në rajonin që dikur ishte i ndarë përmes perdes së hekurt. Aleanca gjithashtu, përmes partneritetit për paqe ndihmoi integrimin dhe unifikimin e Evropës, duke sjellë stabilitet dhe konsolidim të demokracisë.

Pas konflikteve të shumta në Ballkan, ai u bë pjesë e këtyre planeve të veprimit duke intensifikuar marrëdhëniet miqësore me këtë organizatë dhe duke kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit, parandalimin dhe zgjidhjen e krizave në këtë gadishull, si edhe duke qenë pjesë e misioneve të kësaj organizate. Vendet ballkanike filluan kështu procedurën për integrimin e plotë në këtë aleancë të rëndësishme politiko-ushtarake. Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia të cilat ishin të përfshira në *Planin e veprimit për anëtarësim*, në vitin 2003 ecën një hap përpara. Ato të tria së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në maj të vitit 2003 nënshkruan Kartën e Adriatikut, në të cilën shprehej qartë “përkushtimi për forcimin e përpjekjeve individuale dhe bashkëpunuese për të intensifikuar dhe nxituar reformat e brendshme, të cilat kontribuojnë në rritjen e sigurisë, prosperitetit dhe stabilitetit në rajon.” [13]. Karta e Adriatikut ishte inspiruar nga grupimet e mëhershme siç ishin ato të Vilniusit dhe Vishegradit të cilët patën përdorur mënyrë të ngjashme për t’u integruar në strukturat euro-atlantike. Qëllimi i përbashkët i vendeve nënshkruese dhe SHBA-ve ishte integrimi i këtyre shteteve në organizatat evropiane dhe ato transatlantike dhe rritja e bashkëpunimit mes tyre.

Me transformimin e NATO-s pas Luftës së Ftohtë, ndryshuan edhe qëllimet e saj. Ajo po hyn tash në dekadën e gjashtë të ekzistencës së që nga krijimi i saj. Kjo organizatë u transformua nga një aleancë ushtarake mbrojtëse, në një organizatë që promovon sigurinë dhe stabilitetin edhe jashtë zonës euro-atlantike. Andaj për ta arritur këtë qëllim madhor nevojitet integrimi i plotë i tërë aktorëve evropianë.

Ballkani si një rajon i rëndësishëm gjeostrategjik zë vend shumë të rëndësishëm në prioritetet e NATO-s. Historikisht Ballkani ka qenë rajon ku janë gëshetuar interesat e fuqive të mëdha që nga periudha e Koncertit të Evropës e deri në fundin e Luftës së Ftohtë. Diplomacia Ruse këtë territor tradicionalisht e kishte përjetuar si sferë të ndikimit të saj.[14] Prandaj dhe politika amerikane, pikërisht për shkak të specifikasitetit të këtij rajoni, testoi mundësitë reale politike dhe ushtarake të dimensionit të veprimit rus, jo vetëm në Ballkan, por dhe më gjerë. NATO dëshmoi se ajo është një organizatë që ruan paqen dhe sigurinë në tërë territorin evropian. Me këtë rast, Shtetet e Bashkuara i treguan edhe pjesës tjetër të kontinentit vendin dhe rolin e Federatës Ruse në rendin e ri botëror. Intervenimi i NATO-s i dha fund luftërave dhe gjenocidit në ish Jugosllavi duke vendosur misione paqeruajtëse si garancë të paqes dhe sigurisë. NATO luajti një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe gjatë konfliktit në Maqedoni, duke u angazhuar politikisht dhe ushtarakisht në menaxhimin dhe zgjidhjen e krizës[15]. Strategjia e NATO-s për Ballkanin ka për qëllim zgjerimin e kontrollit të saj mbi këtë rajon. Përmes asistencës që ajo u jep shteteve aspirante, kontribuon në stabilizimin e Ballkanit turbulent.

Samiti i Bukureshtit dhe mospranimi i Maqedonisë në NATO

Samiti i Bukureshtit i vitit 2008 shtroi nevojën e draftimit të një “Koncepti të ri strategjik”. Në këtë samit u diskutua edhe për çështjen e zgjerimit të kësaj aleance, gjegjësisht anëtarësimin e vendeve të Kartës së Adriatikut. Specialisti i çështjeve evropiane Paul Gallis, në raportin e tij drejtuar Kongresit amerikan lidhur me Samitin e Bukureshtit shpreh qëllimin e organizatës për të ndërmarrë këtë hap:

“Asnjëra nga këto shtete nuk ka forcë ushtarake të mjaftueshme dhe të aftë që të mund të japë ndonjë kontribut domethënës në operacionet aleate. Megjithatë duke marrë parasysh jostabilitetin e vazhdueshëm në Evropën Juglindore, si pasojë nga kundërshtimi i ashpër i Serbisë ndaj pavarësisë së Kosovës, këto tri kandidat mund të kontribuojnë në stabilitetin e rajonit”[16] Në këtë samit, Shqipëria dhe Kroacia u ftuan që t’i fillojnë bisedimet për t’iu bashkëngjitur Aleancës. Këto dy shtete “kanë treguar përkushtim ndaj sigurisë sonë të përbashkët dhe vlerave të përbashkëta të NATO-s, ndërsa pranimi i tyre do ta forcojë sigurinë për të gjithë në zonën euro-atlantike dhe do të na çojë neve më afër qëllimit tonë – një Evropë e plotë, e lirë dhe në paqe”[17].

Ky pranim ka rëndësinë e tij në tre dimensione. Së pari, në dimensionin lokal ky pranim ka ndikuar në zhvillimin e shteteve individualisht. Ai do t'u ndihmojë Kroacisë dhe Shqipërisë të ecin përpara në rrugën e tyre drejt reformave dhe harmonizimit të legjislacioneve të tyre në pajtim me ato të shteteve anëtare në strukturat euro-atlantike. Ky proces ka për qëllim stabilizimin e brendshëm politik duke i shndërruar këto shtete në faktor stabilizues për tërë rajonin. Së dyti, në këndvështrimin rajonal, ky akt është një fillim i ri për tërë Ballkanin Perëndimor. Përderisa në shekujt e mëparshëm po edhe në këtë shekull Ballkani Perëndimor kishte qenë një rajon që kishte prodhuar vetëm kriza e luftëra, përqafimi i koncepteve euro-atlantike përgatit Ballkanin që të jetë një hapësirë që do të reflektojë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Së treti, dimensionin ndërkombëtar i pranimit të këtyre dy shteteve ballkanike në NATO, përfshin mundësinë e Shqipërisë dhe Kroacisë si dhe rajonit në tërësi për të kontribuar në mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Në këtë samit Maqedonisë nuk iu dha ftesë për fillim të bisedimeve për pranim në këtë aleancë. Kjo qe një sinjal jo i mirë si për të ardhmen e këtij shteti të brishtë ashtu edhe për tërë rajonin. Korrespondentja e BBC për çështje evropiane raportonte nga Bukureshti se: “Vendimi për të mos ftuar Maqedoninë së bashku me Kroacinë dhe Shqipërinë rrezikon dërgimin e sinjaleve të përziera dhe rritjen e frikës për jo stabilitet në rajon i cili edhe ashtu po lëkundet nga Serbia për shkak të deklaramit të pavarësisë së Kosovës.”[18] Mospranimi i këtij shteti multietnik, i cili duke marrë parasysh pozicionin e tij gjeografik, rezulton të jetë shumë i rëndësishëm për gjeopolitikën ballkanike dhe evropiane, zgjoi shqetësime si në strukturat e brendshme të shtetit ashtu edhe te faktori ndërkombëtar. Mospranimi i Maqedonisë në NATO dhe ndarja nga vendet nënshkruese të Kartës së Adriatikut për Maqedoninë do të thotë dështim dhe humbje e madhe.

Shkaqet për mospranim

Megjithëse deri tek opinioni i gjerë, akti i mospranimit të Maqedonisë në NATO u interpretua se ishte vetëm shkak i vetos greke, lidhur me çështjen e emrit, *de facto* ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në këtë vendim. “Maqedonia përballet me të tjera probleme përveç këtij, por çështja e emrit mbulon gjithçka” ishte shprehur Doris Pack gjatë një debati në Shkup menjëherë pas Samitit të Bukureshtit.[19]

Faktorët që kanë ndikuar në mos marrjen e ftesës për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, përfshijnë dy segmente: të brendshëm dhe të jashtëm.

Faktorët e brendshëm

Organizatrat euro-atlantike vazhdimisht promovojnë politikën e dyerve të hapura dhe zgjerimit, por kushtet[20] të cilat ato kanë vënë për anëtarësim të

shteteve të reja janë shumë të përpikta dhe përfshijnë shumë aspekte. Rruga bëhet edhe më e vështirë kur bëhet fjalë për shtete tejet të brishta, të dala nga sisteme socialiste, të cilat akoma mbeten në rrugën e gjatë të tranzicionit, me probleme të brendshme dhe me sfida të mëdha para vetes. Maqedonia vazhdon të ballafaqohet me këto sfida. Ndryshe nga Sllovenia dhe Kroacia, Maqedonia u pavarësua në mënyrë paqësore, me anë të referendumit në të cilin morën pjesë vetëm maqedonasit. Kështu, përderisa deri në vitin 2001 Maqedonia përmendej si model paqeje në Ballkan, e tëra kjo ishte një fasadë meqë përbrenda problemet thelloheshin, ndërsa tensioni ndëretnik rritej gjithnjë e më shumë.[21] Në vitin 2001 Maqedonia u lëkund nga një konflikt i armatosur maqedono-shqiptar. Me mbështetjen dhe ndihmën e faktorit ndërkombëtar, u arrit një marrëveshje që u emërtua Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila i dha fund krizës dhe prezantoi ndryshime të reja në sistemin kushtetues dhe politik të Maqedonisë.

Përkundër mendimit të Savo Klimovskit, i cili shkruan se intervenimet në Preambulën e Kushtetutës janë bërë në shpirtin e konstitucionalizmit evropian dhe shkëputjes radikale nga koncepti tradicional i shtetit komb,[22] përfaqësimi i shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore edhe pas tetë vjetësh mbetet vetëm një premtim i paralizuar, i shkruar vetëm në letër. Shqiptarët akoma trajtohen si qytetarë të dorës së dytë megjithëse ata përbëjnë më shumë se 25% të tërë popullsisë që jeton në këtë shtet.[23]

Kriteret të cilat Maqedonia duhet t'i përmbushë për t'u anëtarësuar në NATO janë pothuajse të ngjashme me ato të Kopenhagës për anëtarësim në Unionin Evropian. Raporti i progresit për Maqedoninë i përgatitur nga Komisioni Evropian në fund të vitit 2007 ka vlerësuar jo mirë progresin e bërë nga Maqedonia lidhur me përmbushjen e kriterëve të Kopenhagës, sidomos të atyre politike të cilat përfshijnë: stabilitetin e institucioneve për të garantuar demokraci, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave, bashkëpunimin rajonal, marrëdhëniet e mira fqinjësore, respektimin e obligimeve ndërkombëtare etj.[24] Organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike janë njëri ndër kriteret bazë politike për anëtarësim në organizatat euro-atlantike. Maqedonia organizoi zgjedhjet parlamentare ku u vunë re parregullsi të shumta dhe përdorje e dhunës. Poashtu, në periudhën para Samitit të Bukureshtit, në Maqedoni pati shumë konflikte politike madje edhe përdorim të dhunës fizike në parlament, të cilat u pasqyruan negativisht në punën e këtij institucioni si një ndër organet më të larta të shtetit. Këto konfrontime politike pengojnë funksionimin e rregullt të institucioneve demokratike në vend, si dhe ngadalësojnë reformat e nevojshme të cilat janë kusht për anëtarësimin e Maqedonisë në strukturat euro-atlantike. Mosrespektimi i pakicave, ka dëmtuar imazhin e Maqedonisë në arenën ndërkombëtare. Gjithnjë sipas raportit të UE-së për Maqedoninë i cili ishte botuar pak muaj para Samitit të Bukureshtit, thuhej se integrimi i pakicave

mbetet mjaft i kufizuar. Për vetë ekzistencën e Maqedonisë shqiptarët janë faktori numër një ndërsa kur vjen në pyetje qeverisja e vendit, ata shndërrohen në kategori dytësore. Ata mbeten në dizavantash pothuajse në të gjitha sferat. Duke marrë parasysh se kushtet dhe procedurat për anëtarësim në të dyja këto organizata, në të cilat Maqedonia ka shprehur prioritetet e saj për t'u integruar, janë pothuajse të njëjta, përfundojmë se Maqedonia ka pasur shumë zbrazëtira në plotësimin e kriterëve për anëtarësim që para Samitit të Bukureshtit. Martin Erdman[25] megjithëse kishte lavdëruar politikën e suksesshme rajonale të Maqedonisë dhe tërheqjen e investimeve, ai kishte numëruar kërkesat kryesore të cilat Maqedonia duhet t'i përmbushë për të siguruar një ftesë për t'u bashkuar NATO-s. Ato përfshinin: së pari, qëndrueshmërinë e procesit reformues të Maqedonisë dhe zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit; së dyti, përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, dialogun e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin mes partive politike dhe stabilitetin politik afatgjatë.[26] Procesi reformues është shumë i ngadaltë, reformat në gjyqësi kanë ngecur, ndërsa zbatimi i Marrëveshjes së Ohrit ka kohë që është lënë anash dhe është neglizhuar nga udhëheqësit e Maqedonisë. Marrëdhëniet ndëretnike gjatë kësaj kohe kishin vazhduar të mbeten shumë të brishta duke kulminuar kohë pas kohe përmes fërkimeve dhe përplasjeve të ndryshme sidomos në rajonet multietnike.[27]

Në fillim të vitit të kaluar, kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski kishte vizituar NATO-n për të diskutuar lidhur me raportin e progresit brenda *Planit të veprimit për anëtarësim*. Aleatët ishin shprehur se “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka bërë progres në zbatimin e reformave politike, ekonomike dhe ushtarake, por akoma duhet të punohet”[28], duke vazhduar se “përpjekjet për reforma të qëndrueshme do të mbeten kryesore për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë që ajo të arrijë aspiratat e saj euro-atlantike”. [29] Sipas këtyre deklaratave të shteteve aleate, shihet që ato kanë paralajmëruar qartë disa nga shkaqet për shkak të së cilave Maqedonia nuk do ta marrë ftesën për anëtarësim në këtë aleancë tre muaj më vonë.

Pra, vetë Maqedonia bart pjesën më të madhe të fajit për mos anëtarësimin e saj në NATO. Ajo më kot kërkon fajtorin për këtë mospranim jashtë kufijve të saj. Përveç zvarritjes së procesit të zgjidhjes së çështjes së emrit me Greqinë, struktura shtetërore maqedonase kishte zvarritur plotësimin e kriterëve të caktuara që më parë nga NATO- zbatimin e reformave të brendshme dhe zhvillimin e konceptit të bashkëjetesës në shtetin multietnik siç është Maqedonia.

Faktorët e jashtëm

Moszgjidhja e kontestit me Greqinë lidhur me emrin kushtetues të Maqedonisë, ishte ndër shkaqet kryesore që Maqedonia nuk mori ftesë për anëtarësim në organizatën më të madhe për ruajtjen e sigurisë në zonën euro-

atlantike. Në deklaratën e dhënë nga kryetarët dhe kryeministrat e shteteve pjesëmarrëse në takimin e Këshillit Veri-Atlantik në prill 2008, u tha që “megjithëse në kornizat e Kombeve të Bashkuara shumë aktorë kishin punuar fort që të zgjidhin çështjen e emrit, kjo gjë s’ ishte arrirë, andaj edhe ftesa për Maqedoninë do të zgjatet deri sa të arrihet një marrëveshje e pranueshme për të dyja palët”. [30] Kontesti i Maqedonisë me Greqinë ka filluar që nga pavarësimi i saj, ndërsa përpjekjet për zgjidhjen e tij kanë filluar që nga viti 1995, me ndërmjetësimin e Kombeve të Bashkuara. Sipas grekëve emri kushtetues i Maqedonisë vë në pah synime territoriale mbi një rajon verior të Greqisë me të njëjtin emër dhe paraqet keqpërdorim të traditës kulturore helenike.

Ky kontest nuk duhet të shikohet vetëm nga këndi bilateral në mes Greqisë dhe Maqedonisë. Për të pasur një tablo më të qartë është e domosdoshme që të kthehemi në retrospektivë, meqë zanafilla e këtij problemi lind që nga shthurja e Perandorisë Osmane dhe ka një gamë trekëndore. Traktati i Shën Stefanit [31] kishte krijuar Bullgarinë e Madhe e cila brenda saj përfshinte edhe Maqedoninë e Egjeut, që mund të merret si një pikënisje e ftohjes së raporteve në mes Greqisë dhe Bullgarisë për mbizotërim të Maqedonisë së Egjeut. Lufta e Dytë Ballkanike kishte rezultuar me një aleancë në mes të Greqisë dhe Serbisë kundër Bullgarisë, e cila përfundoi me Traktatin e Bukureshtit [32] në gusht të vitit 1913. Përmes këtij traktati, Greqia futi nën zotërimin e saj Maqedoninë e Egjeut. Ndërsa me Traktatin e Neit [33], Bullgaria humbi Thrakën Perëndimore, e me këtë edhe daljen në Egje, e cila edhe sot është nën sovranitetin e Greqisë. Ky fakt ka rritur frikën e revanshit të Bullgarisë ndaj Greqisë për Maqedoninë e Egjeut dhe Thrakën Perëndimore, i cili mund të merret edhe si arsye e përplasjes së Greqisë me Maqedoninë për çështjen e emrit. Vetë politika e Sofjes vazhdon ta konsiderojë popullsinë sllave të Maqedonisë me etnogjenezë bullgare, duke mos njohur kombin maqedonas dhe as gjuhën maqedonase. Bullgaria deri tani ka ndarë me mijëra pasaporta bullgare [34] në Maqedoninë Lindore duke mos përjashtuar as zyrtarë qeveritarë të Maqedonisë. Ky fakt sigurisht që ka trembur Greqinë, e cila kundërshton emrin kushtetues të Maqedonisë. Greqia ka frikë nga mundësia e bashkimit të Maqedonisë me Bullgarinë, pasi që Bullgaria mund të kërkojë në emër të Maqedonisë pjesën e Maqedonisë së Egjeut e cila gjendet nën Greqinë. Nga ana tjetër edhe kontesti me Serbinë për çështje të kishës vazhdon akoma të zvarritet. Prandaj Qeveria e Maqedonisë duhet të zbatojë dokumentet e nënshkruara me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, të cilat janë parametra për rregullimin e fqinjësisë së mirë në mes shteteve. Në të kundërtën problemi mund të zgjerohet, nga një Maqedoni të kalohet në tri Maqedoni: atë të Egjeut, të Pirinit dhe të Vardarit.

Megjithatë, Greqia tashmë ka pranuar prezencën e fjalës “maqedoni”, por e ka kushtëzuar atë me shtimin e epitetëve si “veriore”, “e re”, “shkupi” etj. Nga

ana tjetër Qeveria e Maqedonisë s'është treguar e gatshme për t'i kontribuar një zgjidhjeje fleksibile e cila do të ishte e pranueshme për të dyja palët. Ajo nuk ka hezitur të bëjë veprime madje shumë provokuese[35] ndaj Greqisë të cilat janë dënuar ashpër nga faktori ndërkombëtar. Maqedonia është këshilluar që të evitojë veprimet të cilat përkeqësojnë marrëdhëniet fqinjësore në rajon. Ngecja në përpjekjet për zgjidhjen e këtij kontesti po i kushton shumë shtrenjtë asaj.

Shqiptarët megjithëse lidhur me këtë çështje kishin qenë mjaft indiferentë, gjërat kanë ndryshuar dukshëm pas Samitit të Strasburgut në vitin 2009. Çështja parësore për shqiptarët mbetet integrimi i vendit në strukturat euro-atlantike. Lidhur me këtë çështje një studiuese maqedonase shkruan: *“Ashtu sikur edhe shihet në kampanjën aktuale zgjedhore, politikanët shqiptarë dhe shqiptarët etnikë janë bërë tani mbështetësit më të fuqishëm të integritit të Maqedonisë në UE dhe NATO, meqenëse ata çështjen e konfliktit të emrit me Greqinë e perceptojnë në mënyrë më pak emocionale dhe janë më shumë të prirë të bëjnë kompromise.”*[36] Por edhe vetë komuniteti maqedonas, edhe përkundër asaj që çështjen e kontestit të emrit e konsiderojnë si çështje ekskluzivisht të tyre, ende nuk duket qartë se cili është kompromisi i tyre. Meqenëse pas samitit të Strasburgut, mundësia për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO nuk duket gjëkund, ky fakt ka filluar t'i iritojë shumë shqiptarët që jetojnë në Maqedoni.

Mos përcaktimi i qartë dhe konkret i koncepteve politike të Maqedonisë po reflekton një pasiguri edhe në marrëdhëniet me fqinjët e tjerë. Kontesti i Maqedonisë me Greqinë lidhur me emrin, ka nxjerrë në pah një zinxhir çështjesh të tjera të cilat janë të lidhura me identitetin dhe gjuhën.[37] Fqinji lindor Bullgaria kishte pranuar emrin e shtetit si të tillë, por kurrë gjuhën maqedonase dhe kombin maqedonas. Megjithëse Bullgaria me Maqedoninë kishin nënshkruar një deklaratë të përbashkët ku ishin njohur gjuha bullgare dhe ajo maqedonase si dy gjuhë zyrtare, kryeministri Bullgar Ivajlo Kalfin në mars kishte deklaruar se vendi i tij do të mbështesë hyrjen e Maqedonisë në NATO kur Maqedonia t'i zgjidhë të gjitha kontestet me fqinjët.[38] Për të mos mbaruar me kaq, fqinji veri-lindor – Serbia, refuzon ta pranojë kishën autoqefale maqedonase duke pretenduar se kisha e vetme autoqefale është ajo ortodokse serbe. Gjithashtu që nga njohja e pavarësisë së Kosovës nga Maqedonia në tetor të 2008, marrëdhëniet mes këtyre dy ish-republikave jugosllave mbeten tejet të brishta.

Maqedonia për momentin po përjeton një krizë të thellë identiteti të kontestuar nga të gjithë fqinjët e saj. Sipas raportit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave thuhet se për maqedonasit çështja e identitetit të tyre është e lidhur me vetë ekzistencën e shtetit të tyre.[39] Kjo për shkakun se Maqedonia është një shtet multi-etnik dhe tejet i brishtë, ndërsa tensionet e vazhdueshme mes maqedonasve dhe shqiptarëve janë të pranishme dhe lëkundin dukshëm

stabilitetin e vendit. Këto shkaqe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi kanë ndikuar në mospranimin e Maqedonisë në superfuqinë politiko-ushtarake. Kontesti me Greqinë pati ndikuar drejtpërdrejt, me përdorimin e vetos nga Greqia për të penguar integrimin e Maqedonisë, ndërsa kontestet me fqinjët e tjerë kanë dhënë impakte të tjera negative. Marrëdhëniet me fqinjët dhe kontributi në sigurinë dhe mirëqenien rajonale janë kriteret bazë për anëtarësimin e një vendi si në Unionin Evropian ashtu edhe në NATO.

Pasojat e mundshme nga mospranimi i Maqedonisë në NATO

Përderisa dy fqinjët e saj në samitin e fundit që u mbajt në Strasburg, u bënë anëtare me të drejta të plota në këtë organizatë, Maqedonia kishte humbur edhe shansin e dytë. Mbetja e Maqedonisë jashtë kësaj strukture domosdo se jep impakte negative në radhë të parë për Maqedoninë, si dhe tërë rajonin e Ballkanit.

Impakti negativ për Maqedoninë

Maqedonia edhe një vit pas Samitit të Bukureshtit nuk arriti të asgjësojë pengesat që i zinin rrugën drejt NATO-s, por bëri pikërisht të kundërtën. Analisti shqiptar Petrit Haliti në një artikull me titull “I munguari me dashje i samitit të NATO-s” shkruan:

“Politika e acarimit dhe e krijimit të provokimeve politike, historike e diplomatike, që qeveria e Gruevskit zgjodhi për të zbatuar gjatë gjithë këtij viti atlantik, që nga samiti i Bukureshtit e deri tek samiti i Strasburgut, nuk mund të mos çojnë tek bindja se qeveria e Shkupit në mënyrë të ndërgjegjshme, jo vetëm nuk iu afrua, por iu largua një kompromisi për emrin me Greqinë.” [40]

Meqenëse Maqedonia mori në Bukuresht një ftesë të kushtëzuar, moszgjidhja e kontestit me Greqinë, për Maqedoninë do të thotë rrezik për vetë ekzistencën e saj dhe rilindjen e kontesteve me fqinjët e tjerë. Mbase shqiptarët ruajtën indiferencën e tyre lidhur me çështjen e emrit duke u treguar shumë konstruktivë, mospranimi i Maqedonisë në NATO i ka zhgënjyer shumë ata. Në raportin e vitit të kaluar të realizuar nga UNDP, “People centred analyses”, shihet se 14% nga shqiptarët e anketuar mendojnë se anëtarësimi në NATO përbën prioritet për zhvillimin e ardhshëm të Maqedonisë, për dallim nga maqedonasit të cilët përfshihen me 7%. [41] Për shqiptarët integrimi në NATO dhe UE është çështje parësore dhe për këtë nuk janë të gatshëm të bëjnë kompromise.

Maqedonia vazhdon të mbetet një vend mjaft i dobët ekonomikisht, me papunësi të lartë, ndërsa së fundmi aty ka gjithnjë e më pak investime të huaja. Klima e pavolitshme politike po ndikon fatalisht në zhvillimin ekonomik të saj dhe në marrëdhëniet e saja ekonomike me fqinjët, gjë e cila po e çon Maqedoninë, përveç izolimit politik edhe drejt izolimit ekonomik.

Vetoja greke për Maqedoninë paraqet edhe një paralajmërim për vështirësitë që do të ketë Maqedonia për t'u anëtarësuar edhe në Unionin Evropian, ku Greqia ka një pozitë edhe më të favorshme.[42] Përderisa deri në vitin 2008 nga Komisioni Evropian janë përdorur termet “maqedonas” dhe “gjuha maqedone”, ndikimi i theksuar i Greqisë në institucionet e Unionit Evropian ka bërë që kjo të ndryshohet. Në doracakun ndërinstytucional të kontrolluar nga Byroja për publikime zyrtare e unionit Evropian, termi “maqedonas” dhe kodi “MK” është zëvendësuar me “të definoohen”. [43]

Pengesa për Maqedoninë për t'u integruar në NATO dhe sipas të gjitha gjasave edhe në UE, do të thotë se Maqedonia po mbetet një vend pa orientim strategjik. Edhe pse kontesti me Greqinë është duke i kushtuar shtrenjtë Maqedonisë, udhëheqësja e shtetit maqedonas po keqpërdor si duket pozitën e saj gjeostrategjike në rajon si dhe mbështetjen e faktorit ndërkombëtar, sidomos SHBA-ve. SHBA-të kishin ripohuar mbështetjen e tyre për një Maqedoni unitare, multietnike brenda kufijve të saj ekzistues dhe kishin shprehur vullnetin për të rritur marrëdhëniet e tyre strategjike me Maqedoninë, menjëherë pas Samitit të Bukureshtit në maj të 2008.[44] Gjatë procesit të integritit të shteteve, “vrimat e zeza” mbeten të padëshirueshme për organizatat multilaterale, sidomos për ato që kanë për qëllim ruajtjen e stabilitetit dhe paqes. Meqenëse Maqedonia ndodhet gjeografikisht në mes të gadishullit, e rrethuar me shtete që tashmë janë pjesë e strukturave euro-atlantike, ajo po sillet shumë dinakërisht, duke zvarritur procese të cilat përveç se e dëmtojnë vetë atë, ndikojnë negativisht edhe për tërë rajonin e brishtë ballkanik.

Impakti negativ për tërë rajonin ballkanik

Ruajtja e paqes dhe stabilitetit rajonal si dhe zgjerimi i zonës së sigurisë në Evropë, janë qëllimet kryesore të NATO-s. Këto qëllime përputhen katërcipërisht me interesat strategjike dhe prioritetet e shteteve të Ballkanit. Andaj edhe ngecjet që bëhen në këto procese integruese, jetike, janë shumë të dëmshme madje edhe të rrezikshme për paqen dhe stabilitetin në rajon. Një Maqedoni jashtë strukturës mbrojtëse të sigurisë, përveç se prodhon një pasiguri të brendshme, bart pasoja edhe për fqinjët e saj dhe tërë rajonin. Me të drejtë analisti i revistës së njohur gjermane “Der Spiegel”, Edward P. Joseph, parashikon:

“Duke mbajtur të hapur çështjen e Maqedonisë, Serbia, Rusia dhe shtete të tjera mund të vazhdojnë që në agjendën e tyre të mbajnë të hapura edhe çështje të tjera, duke përfshirë këtu edhe kufijtë përfundimtarë të Kosovës. Në qoftë se Maqedonia do të hyjë sërish në konflikt, është e sigurt që ajo nuk do të mbetet më brenda kufijve të saj aktualë. (...) Para Bukureshtit shqetësimi i Shkupit ishte që ndarja e Kosovës e nxitur nga serbët do të mund të nxiste lëvizje secesioniste mes shqiptarëve etnikë në Maqedoni. Pas Bukureshtit, e vërtetë është e kundërta: agjenda serbo-ruse mund të avancojë nga trazirat në

Maqedoni. Së shpejti, çfarëdo trendi drejt shpërbërjes në Maqedoni, do të ketë pasoja të drejtpërdrejta dhe të paevitueshme për Kosovën. ” [45] Ky ndryshim është një indikator që Ballkani mund të jetë i qëndrueshëm vetëm në saje të stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së secilit vend veç e veç. Çdo lëkundje dhe jostabilitet në cilindo shtet të tij, jep impakt në tërë sipërfaqen e gadishullit. Prandaj, sekretari gjeneral i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer kishte vizituar Athinën në mars të 2008, dhe kishte bërë përpjekje t’i zhbindë grekët dhe t’i paralajmërojë ata lidhur me pasojat për stabilitetin rajonal që mund të shkaktohen në qoftë se nuk arrihet një marrëveshje.[46]

Kontesti midis Greqisë e Maqedonisë mund të sjellë pasoja në zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik të Ballkanit, destabilizimin e situatës rajonale, madje mund të vijë deri te devijimi i strategjisë kryesore të NATO-s dhe UE-së për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor dhe humbjen e besimit në këto organizata.

Përfundime dhe rekomandime

Nevoja për profilizim të politikës së brendshme të Maqedonisë

Lëvizja drejt NATO-s ka qenë një lëvizje me parametra të paracaktuar. Programi i Partneritetit për Paqe si një qasje strategjike për vendet aspirante, si dhe Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim si një mekanizëm për Evropën Juglindore, ishin kusht për vendosjen e marrëdhënieve ndërajonale dhe krijimin e stabilitetit të brendshëm politik, ekonomik dhe ndëretnik. Kjo ishte një kërkesë reale për bashkëpunim në rajon. Republika e Maqedonisë si nënshkruese e këtyre mekanizmave përcjellëse të integritimit, duhet të jetë më racionale në hartimin e politikave të saj, në mënyrë që vendin ta çojë drejt integritimit në strukturat euroatlantike. Përkundër nënshkrimit të këtyre akteve, Maqedonia ka ngecur në implementimin e dokumenteve që mundësojnë hyrjen në këto struktura. Marrëveshja e Ohrit sot përbën një dokument i cili ndodhet në pikën më të ulët të implementimit. Qeveria e Maqedonisë këtë marrëveshje e sheh më shumë si diktat të ndërkombëtarëve se sa si një dokument të funksionalizimit të shtetit (apo shpëtimit të shtetit). Mos implementimi i Marrëveshjes së Ohrit, shqiptarëve gjithnjë e më shumë po ua humb shpresat e jetësimit të shtetit multi-etnik dhe të konceptit të bashkëjetesës politike. Për Maqedoninë koncepti multi-etnik i shtetit është një faktor kyç për stabilitetin e vendit. Ky koncept do të bëjë një ambient më të sigurtë dhe një mirëqenie të barabartë të shtetasve të saj, duke krijuar një bazë të besimit dhe tolerancës mes njerëzve që jetojnë në këtë shtet.

Nevoja e reformimit të mekanizmave vendimmarrëse në organizatat euroatlantike

Që nga shpërbërja e BRSS-së, NATO shpeshherë ka qenë në zemër të kritikave në kontekstin e revitalizimit të saj. Kjo na bën të mendojmë se koncepti *Raison d'état* po dominon mbi politikën e integritimit, meqë disa shtete vazhdojnë të adaptojnë politika nacionaliste. Integritimi i shteteve në strukturat euroatlantike është një dëshmi se vetëm përmes këtij procesi paqja në Evropë u mbajt për gjashtëdhjetë vjet stabile, duke i kthyer armiqtë në partnerë të bashkëpunimit. NATO nuk duhet të lejojë pengimin e procesit të antarësimit i cili po mbahet peng nga disa shtete të cilat kanë probleme bilaterale. E drejta e vetos në strukturat euroatlantike për pranimin e antarëve të rinj nga shumë shtete po shikohet si një e drejtë për ta paralizuar tjetrin. Natyrisht, e drejta e vetos do të ishte më e justifikueshme, vetëm atëherë kur të gjitha shtetet anëtare të strukturave euroatlantike, do të ishin me plotkuptimin e fjalës demokraci të zhvilluara. Ndërsa, nga ana tjetër, kjo e drejtë mund të justifikohet vetëm po qe se shtetet anëtare të euroatlantizmit nuk kanë ambicie ekspansioniste ndaj fqinjëve të vet.

Në qoftë se kjo praktikë do të vazhdojë edhe për shtetet tjera të gadishullit, që sigurisht do jetë e pranishme për shkak të armiqtësive tradicionale, atëherë do

të duhet ose të kalojë një kohë shumë e gjatë që armiqtë të harrohen ose do të jetë e nevojshme një reformë e njëmendët në mekanizmin për anëtarësimin e anëtarëve të rinj në Unionin Evropian dhe NATO. Përndryshe një integrim i plotë i rajonit ballkanik në strukturat euro-atlantike do të jetë pothuajse i pamundshëm.

Referenca:

[1] “Fourteen conditions of peace”, Fjalim i mbajtur nga Woodrow Willson në Kongresin amerikan më 8 Janar 1918. *Selected addresses and public papers of Woodrow Wilson*, New York: Boni and Liveright, 1918. Fq. 244

[2] Po aty, fq. 249

[3] Karta e OKB-së. Neni 1. Marrë nga <http://www.un.org/aboutun/charter/chapter1.shtml> më 19 mars 2009

[4] The North Atlantic Treaty, Washington D.C. – 4 April 1949. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basicxt/treaty.htm> më 18 mars 2009

[5] “NATO looks East”, edited by Robert J. Jackson and Piotr Dutkiewicz, London: 1998. Fq. 1

[6] The Alliance’s Strategic Concept, approved by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. on 23rd and 24th April 1999. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-065e.htm> më 19 mars 2009.

[7] Po aty. Pika 6.

[8] Po aty. Pika 8.

[9] Neni 10 është si vijon: “Palët munden, me anë të marrëveshjes unanime, të ftojnë ndonjë shtet tjetër evropian që do t’i ndjekë parimet e këtij traktati dhe do të kontribuojë në sigurinë e zonës veri-atlantike, të aderojë në këtë traktat...”. The North Atlantic Treaty, Washington D.C. – 4 April 1949. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basicxt/treaty.htm> më 19 mars 2009

[10] Lisen Bashkurti, *Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare*, Tiranë: 2006. Fq.168

[11] *NATO looks East*, edited by Robert J. Jackson and Piotr Dutkiewicz, London: 1998. Fq.13. Edhe Maqedonia si prioritet strategjik të politikës së jashtme të saj kishte vendosur integrimin në NATO dhe UE. “Годишна национална програма за подготовки за членство на РМ во НАТО 2006-2007”, http://www.vlada.mk/files/doc/programa_clenstvo_NATO.pdf

[12] Study on NATO Enlargement issued by the Heads of State and Government participating in the Meeting of the North Atlantic Council. Kapitulli I, pika 2. Marrë nga <http://www.nato.int/docu/basicxt/enl-9502.htm> , më 20 mars 2009.

[13] Karta e Adriatikut, e nënshkruar në Tiranë më 2 maj 2003 nga përfaqësues të SHBA-ve, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë. Pika 2 e kartës. Versioni i saj në anglisht gjendet në <http://www.america.gov/st/washfile-english/2003/May/20030502165618rennefl0.4553644.html> më 20 mars 2009. Ndërsa versionin shqip mund ta gjeni në http://albanian.tirana.usembassy.gov/06pr_0411.html

[14] Vukadinović, R., *Kosovska kriza i ruska vanjska politika*, Europska unija-pravni, gospodarski i politicki aspekti”, Informator, Nr.4780-4782, Zagreb, 29 dhjetor 1999 dhe 1-5 janar 2000 ff, 5-9

[15] Tri mësimet e njohura të mësuara nga konfliktet në ish Jugosllavi janë: aleatët mund të jenë efektivë në qoftë se veprojnë herët, në qoftë se flasin njëzëri dhe në qoftë se janë të përgatitur të përdorin një sasi force për të mbështetur pozicionin e tyre. Lexo më shumë: *NATO and European security: alliance politics from the end of the Cold War to the*

age of terrorism, edited by Alexander Moens, Lenard J. Cohan and Allen G. Sens, London, 2003, fq. xxi

[16] CRS Report for Congress. "The NATO Summit at Bucharest", 2008. Paul Gallis, specialist in European Affairs, Foreign Affairs, Defence and Trade Division. Congressional Research Service, the Library of

Congress. <http://digital.library.unt.edu/govdocs/crs/permalink/meta-crs-10731:1>

[17] Bucharest Summit Declaration. Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Bucharest on 3 April 2008.

Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html> më 23 mars 2009

[18] Oana Lungescu, "Nato Macedonia veto seeks tension". BBC News. (04/04/2008). Marrë nga: <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7329963.stm> më 25 mars 2009.

[19] "Doris Pack: Uncertain EU future for Macedonia without name compromise", *Macedonian Information Agency*, April 5, 2008.

[20] Kushtet e vendosura nga NATO të cilat shtetet aspirante duhet t'i plotësojnë përfshijnë: funksionimin e sistemit politik demokratik të bazuar në ekonominë e tregut, trajtimi i drejtë i minoriteteve, angazhimi për zgjidhjen paqësore të konflikteve, aftësia dhe vullneti për të kontribuar në operacionet e NATO-s dhe angazhimi për marrëdhëniet demokratike civilo-ushtarake dhe strukturat institucionale. Për më tepër lexo <http://www.nato.int/issues/enlargement/index.html>. Marrë më 25 mars 2009.

[21] Albulena Halili, "Ndryshimet kushtetuese në RM sipas Marrëveshjes së Ohrit", maj 2003. Dorëshkrim.

[22] Klimovski, S., Mitkov, V., Treneska, R., Karakamisheva, T., *Ustavno ureduvanje na Republika Makedonija*, Prosvetno Dello, Skopje, 2003, faq. 36

[23] Megjithëse me regjistrimin e fundit të vitit 2002 ishte regjistruar një numër prej 25%, numri i popullatës shqiptare përfaqëson 33% nga tërë numri i popullsisë që jeton në Maqedoni. Rahim Veliu: "Geographical span and the Albanian population movement in Macedonia" Tetovë, 2002. Fq.40

[24] The Former Yugoslav Republic of Macedonia 2007 Progress Report. SEC (2007) 1432. Commission of the European Communities. Brussels, 2 November 2007. Gjithashtu lexo edhe Raportin e Departamentit të shtetit të SHBA-ve për vitin 2008, në pjesën ku flitet për

Maqedoninë thuhet se Maqedonia zvarritet me reformat gjyqësore duke shtuar se presioni politik dhe frikësimet ndikojnë negativisht në efikasitetin e gjyqësisë. Poashtu sipas këtij raporti vlerësohet se tensionimi mes popullatës maqedonase dhe shqiptare vazhdon të ndikojë në sferat si arsimit, punësimi dhe pjesëmarrja politike. *Shqipmedia*. 26 shkurt 2009

[25] Martin Erdman është asistent i sekretarit general të NATO-s për çështje politike dhe politikën e sigurisë si dhe udhëheqës i ekipit i cili vlerëson progresin e Maqedonisë për rrugën e saj drejt aleancës.

[26] "NATO urges more Macedonia reforms", November 12, 2007. *Macedonian news*. Marrë nga <http://www.vmacedonianews.com/2007/11/nato-urges-more-macedonia-reforms.html> më 26 mars 2009.

[27] Vlen të theksohet si shumë tensionues rasti me nxënësit e qytetit të Strugës

[28] "Prime Minister of former Yugoslav Republic of Macedonia discusses membership aspirations with NATO Allies". 23 January 2008. NATO official web page.

[29] Po aty.

[30] Bucharest Summit Declaration. Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Bucharest on 3 April 2008.

Marrë nga <http://www.nato.int/docu/pr/2008/p08-049e.html> më 23 mars 2009

[31] The Preliminary Treaty of Peace, signed at San Stefano, 1878 <http://www.uoregon.edu/~kimball/1878mr17.SanStef.trt.htm>

- [32] Peace treaty of Bucharest signed on 28 July/10 august 1913 between Rumania, Greece, Montenegro, Bulgaria and Serbia. R.B. Mowat, *Selected Treaties and Documents 1815-1916*, Oxford : Clarendon Press, 1916, pp.121-123; Në frëngjisht: Nouveau Recueil, 3me serie, t. viii ; Shih gjithashtu Jean-Arnault Dérens, *Balkans: la crise*, Editions Gallimard, 2000, ff. 54-58 dhe *La République de Macédoine*, sous la direction de Christophe Chiclet et Bernard Lory, Paris, 1998, ff. 16-20
- [33] Treaty of peace between the allied and associated powers and Bulgaria and Protokol, signed at Neuilly-sur-Seine, November 27, 1919. Biblioteka britanike. Koleksioni i Azisë. IOR/L/E/7/1202, Folderi 380(vi)
- [34] Sipas gazetës maqedonase “Veçer” thuhet se që nga viti 1990 e deri në nëntor të 2006, 10 198 maqedonas kanë marrë pasaporta bullgare. 14.11.2006, nr. 13348
- [35] Riemërtimi i aeroportit të Shkupit me emrin “Aleksandri i Maqedonisë”. Владимир Мирчевски “Македонскиот аеродром му даде нова димензија на спорот со името”, *Балкан инсајт*, 18 Јануари 2007. BIRN. Maqedonia vazhdoi edhe meemërtimin e magjstrales kryesore që lidh Maqedoninë me Greqinë me po të njëjtin emër, emërtimin e stadiumit me emrin e Filipit II si dhe vendosjen e statujave antike para objektit të qeverisë maqedonase në Shkup.
- [36] Cvete Koneska, “As elections near, euro-skepticism on the rise in Macedonia”, 10/03/2009. *Balkananalysis.com*. <http://www.balkananalysis.com/2009/03/10/as-elections-near-euro-skepticism-on-the-rise-in-macedonia/> marrë më 11 mars 2009
- [37] Albulena Halili, “Viti i brishtë”, Express, Prishtinë, 27 dhjetor 2008, fq.25.
- [38] Iliria News Agency, 18/03/2009.
- [39] “Macedonia’s Name: Breaking the Deadlock”, Crisis Group Europe Briefing Nr.52, 12 January 2009
- [40] Petrit Haliti, “I munguari me dashje i samitit të NATO-s”, 06/04/2009. <http://balkanweb.com/sitev4/lajme.php?id=36042>
- [41] *People centred analyses*, Raport përgatitur nga UNDP, Misioni Shkup. Mars 2008, fq. 54
- [42] Kjo për faktin se në UE nuk bëjnë pjesë SHBA-të të cilët janë mbështetës dhe aleatë strategjikë të Maqedonisë, ndërsa shtete të fuqishme si Franca dhe Spanja mbështetin Greqinë lidhur me këtë kontest. Ministri i punëve të jashtme të Francës, Bernard Kuchner kishte deklaruar se përderisa nuk zgjidhet çështja e emrit nuk mund të ketë progres të mëtejshëm në anëtarësimin e shtetit në UE. Heather McRobie, “A Macedonian identity crisis”, *guardian.co.uk*. 7 prill 2009. <http://www.guardian.co.uk/commentisfree/2009/apr/07/balkans-greece>
- [43] Raportuesi në Parlamentin Evropian për Maqedoninë, Erik Mejer kishte kërkuar sqarim nga Komisioni Evropian lidhur me këtë çështje dhe kjo ishte konfirmuar nga ata. Për më tepër lexo “Mejer kërkon shpjegim për termin “maqedonas””, 02/04/09, *INA online.net*
- [44] Declaration of strategic partnership and cooperation between the United States of America and the Republic of Macedonia, May 7, 2009, Washington DC. Bureau of European and Eurasian Affairs. <http://www.state.gov/p/eur/rls/or/104441.htm>
- [45] Edward P. Joseph, “How to solve the Greek dispute over Macedonia’s name”, *Der Spiegel*. 02/06/2009.
- [46] *Balkan Insight* 3 mars 2008; Gjithashtu lexo: *Macedonia’s Name: Breaking the Deadlock*. Crisis Group Briefing Nr. 52, 12 janar 2009
- *Botuar në bashkëautorësi me Fatmir Arifin në “*Perspektivat Euro-Atlantike të RM-së: Problemet, Sfidat dhe Realiteti Politik pas Dështimit në Samitin e NATO-s në Bukuresht 2008*”, ff. 131-147. UEJL, 2009. Punimin e gjeni edhe në linkun <http://www.seeu.edu.mk/files/research/NATO-sq.pdf>

3.1 Emin AZEMI, publicist

SHQIPTARËT, 21 VITE PAS NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË OHRIT

Faktorizimi i vërtetë i shqiptarëve do të bëhet vetëm atëherë kur ata do të jenë popull shtet formues në Maqedoninë e Veriut. Pa këtë komponentë, të gjitha marrëveshjet paraprake, përfshi edhe Marrëveshjen e Ohrit do ta kenë efektin e terapisë së përkohshme, sepse shqiptarët ende nuk janë “shëruar” nga pasojat e shtet ndërtimit të njëanshëm, ku atributi i shtetformësisë është zëvendësuar me terma eufemike, siç është 20 përqindshi, që më tepër janë statitike e thatë se sa që shprehin nevojat dhe synimet reale të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut

Marrëveshja kornizë e Ohrit u nënshkrua më 13 gusht 2001 në rezidencën presidenciale të Vodnos në Shkup nga presidenti i atëhershëm i shtetit Boris Trajkovski, kryeministri i atëhershëm dhe lideri i VMRO-DPMNE-së, Ljubço Georgievski, si dhe liderët e atëhershëm të LSDM-ja, Branko Cërvenkovski, për PPD-në, Imer Imeri dhe PDSH-ja, Arben Xhaferi.

Në parimet bazë të dokumentit thuhet se “përdorimi i dhunës për arritjen e qëllimeve politike refuzohet plotësisht dhe pa kushte”.

Kanë kaluar 21 vite nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Ohrit, një dokument ky që për kohën kur u miratua, u konsiderua si ‘zbulim’ që do të rregullonte të gjitha kontradiktat etnike, sociale e politike në shoqëritë multietnike. Askush nuk e kishte menduar se do të duhet kaq kohë e gjatë të flitet për këtë Marrëveshje, jo vetëm si dokument, por edhe si efekt frustrimi që kishte prodhuar mosimplemtimi i plotë i saj. Dhe tani kur kemi edhe një Marrëveshje tjetër, atë Prespës, analizës i ngelen edhe disa ngjyra për ta bërë më të plotë ylberin që bashkon këto dy ngjarje kapitale për shtetin e brishtë dhe të kërcënuar nga krizat e brendshme dhe të jashtme.

Parimet themelore të Marrëveshjes së Ohrit, sikundër dihet, ishin 4: Tërësisht dhe pa kusht hidhet poshtë përdorimi i dhunës për realizimin e qëllimeve politike. Vetëm zgjidhjet paqësore politike mund ta garantojnë stabilitetin dhe ardhmërinë demokratike të Maqedonisë; Sovraniteti dhe integriteti territorial i Maqedonisë dhe karakteri unitar i shtetit janë të pashkëlshëm dhe duhet të ruhen. Nuk ekzistojnë zgjidhje territoriale për çështjet etnike; Karakteri shumetnik i shoqërisë maqedonase duhet të ruhet dhe të gjejë shprehjen e vet në jetën publike. Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t’i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe vet të zhvillohen vazhdimisht;

Zhvillimi i pushtetit vendor është me rëndësi thelbësore për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën demokratike dhe për përparimin e respektimit të identitetit të bashkësive.

Mbi Marrëveshjen e Ohrit janë organizuar dhjetëra konferenca e shumë projekte dhe nga individë, institucione e faktorë të ndryshëm janë dhënë vlerësime të ndryshme mbi ecurinë e implementimit të kësaj marrëveshje. Por, emërues i përbashkët i të gjitha këtyre vlerësimeve ka qenë konstatimi se MO ka pësuar ngecje në segmente të caktuara dhe jo rrallë obstruimi i mos implementimit të saj ka ardhur nga vetë politikanët. Askush madje nuk është i sigurt se sa kjo marrëveshje do të mund të mbulojë të gjitha pikëpyetjet që janë ngritur si gjilpëra mbi fushën me kontraste etnike, sociale e politike të Maqedonisë së Veriut këto 21 vite..

Marrëveshja e Ohrit është një dokument i rëndësishëm që konfirmonte gjetjen e kompromisit politik në fund të një konflikti etnik. Sipas parashikimeve, kjo marrëveshje ka qenë dashur të implementohet deri në fund të vitit 2004, gjegjësisht në fillim të 2005.

Vonesat që sollën mos implementimin me kohë të kësaj marrëveshjeje kanë mjaftuar të frustrojnë shumë njerëz, por të shfaqin edhe ide e alternativa konkurruese në “tregun” e ideve politike. Ka shumë arsye të kërkohej llogari nga ata që e kanë vonuar procesin e implementimit të MO, qofshin ata në pushtetin aktual, apo pararendës. Emërues i përbashkët i të gjithë vonuesve të këtij procesi ka qenë obstruimi i afateve duke luajtur lojë jo të sigurtë në mes të partnerëve të koalicionit.

Një dilemë konstante që ka shoqëruar debatin ka qenë nëse ofertat e ndryshme politike duhet kuptuar si zëvendësim i Marrëveshjes së Ohrit, apo vazhdim i këtij procesi që do të dinamizonte jetën politike shqiptare këtu. Dhe si derivate logjike të këtij debati ka mundur të përvijohet konstatimi se të trumbetosh gjatë gjithë kohës se Marrëveshja e Ohrit është zeniti i kualitetit dhe kuantitetit të politik bërjes së shqiptarëve, në njërin anë, dhe të refuzosh të bashkëpunosh mbi bazat e një diversiteti normal idesh e strategjish politike, në anën tjetër, fsheh brenda vetes tendencën e ngurtësimit të veprimit politik për qëllime shumë speciale dhe në favor të pazareve jo transparente me faktorët politik maqedonas.

Nëse dikur papirusi përdorej për të ruajtur kohëgjatësinë e epokave, Marrëveshja e Ohrit dëshmoi se nuk arriti dot të fshehë tronditjet politike që u shfaqën herë pas herë në syprinën e trazuar të marrëdhënieve shqiptaro-maqedonase.

Në shtetet multietnike si Maqedonia e Veriut, asnjë projekt madhor politik nuk mund të implementohet vetëm. Edhe Marrëveshja e Ohrit kaloi nëpër sfidën e rëndë të konsensusit ndëretnik dhe jo rastësisht ajo u bë edhe gurë peshoje për sprovat e mundimshme të qeverive të këtyre 21 vjetëve. Por, në anën tjetër Marrëveshja e Ohrit sikur testonte edhe grafikunin e nacionalizmit maqedonas

brenda koalicioneve maqedono-shqiptare dhe fatkeqësisht sa më e obstruuar dilte kjo marrëveshje nga partnerë të caktuar maqedonas, aq më i besueshëm dilte në opinionin publik edhe kryeministri maqedonas.

Një temë që ka preokupuar vëzhgues të ndryshëm politik, ka qenë e ardhmja e raporteve shqiptaro-maqedonase në dritën e zbatimit të MO. Ka disa prej politikanëve shqiptarë, sidomos ata me stazh më të gjatë në pushtet, të cilët mendojnë se MO është përgjigja më e mirë ndaj sfidave që dalin në raportet shqiptaro-maqedonase. Sipas tyre MO është përgjigja më e mirë për të mbyllur disa nga problemet që tangojnë interesat e shqiptarëve.

Por, në anën tjetër, ndryshimet e fundit që ndodhën, që nga emri i shtetit, e deri te realitetet e reja politike e kulturore, e kanë gjetur tepër të papërgatitur shpirtërisht shoqërinë maqedonase. Kjo mos përgatitje po shihet çdo ditë dhe po vërehet në sytë e të gjithëve. Sidomos ka një shqetësim sa i përket implementimit të gjuhës shqipe. Ka plot maqedonas, të cilët nuk po mundën ta marrin me mend se në këtë shtet po lind edhe një gjuhë tjetër zyrtare. Dhe nuk është problemi gjithaq te refuzimi i këtij realiteti të ri gjuhësor, sa është te konfuziteti që ata po e krijojnë teksa po ballafaqohen me këtë ‘shok’ kulturologjik të shqiptarëve.

Në kapitullin e Marrëveshjes së Ohrit që flet për IMPLEMENTIMIN DHE MASAT PËR NDËRTIM TË MIRËBESIMIT, është aneksi C, i cili parashihte që “të vazhdojnë përpjekjet në projektet e destinuara për përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike”.

Paradoksaliteti i politikës së deritanishme mbështetëj në narrativin primitiv për shqiptarët si pakicë kombëtare, ndërkohë që nuk u realizuan parametrat kryesorë nga Marrëveshja e Ohrit që dilnin nga kapitulli ‘IMPLEMENTIMI DHE MASAT PËR NDËRTIM TË MIRËBESIMIT’, ku parashiheshin edhe objektiva konkrete në zhdukjen graduale të stereotipave ndëretnike.

Sikur të realizohej në tërësi ANEKSI C i Marrëveshjes së Ohrit, maqedonasit sot nuk do të përjetonin tërmet emocional kur dëgjojnë fqin shqiptar të flet në gjuhën shqipe zëshëm, pa pasur nevojë të brengoset se me këtë do të lëndojë ndjenjat e bashkëqytetarëve maqedonas.

Ka disa qasje sa i përket marrëdhënieve në mes të shqiptarëve dhe maqedonasve. Njëra qasje mbështetet nga politikanët, të cilët mendojnë se falë kontributit të tyre ka ardhur deri te përmirësimi i marrëdhënieve ndëretnike. Tjetra, nga sociologët dhe analistët, të cilët nuk e shohin situatën bardh e zi. Ata në njërën anë e shohin me pozitivizëm Marrëveshjen e Ohrit si pikënisje e një bashkëjetese të re në Maqedoni, por në anën tjetër e shikojnë me pesimizëm funksionimin e sistemit, duke aluduar në parimin e Badenderit dhe në principet e demokracisë konsensuale.

Por një qasje që gjithmonë ngel pezull dhe nuk është studiuar gjithaq, është vetë perceptimi i qytetarëve sa i përket evoluimit të raporteve ndëretnike. Sipas anketave të viteve të fundit është vërejtur se Marrëveshja e Ohrit ka

ndihmuar në relativizimin e marrëdhënieve të acaruar ndëretnike në mes të dy kombeve më të mëdha: maqedonasit dhe shqiptarët, ndonëse ky nuk ishte faktori kryesor që ka ndikuar në formimin e mendësisë së re dhe as që janë eliminuar plotësisht dallimet.

Këto të drejta që i kanë shqiptarët, do të arriheshin me luftë a me politikë paqësore? Rreth kësaj pyetjeje janë thyer shtizat më së shumti këto vitet e fundit. Hulumtimet e opinionit publik kanë rezultuar në të dhëna interesante, duke marrë përgjigjen e mbi 50 për qind të shqiptarëve, të cilët e arsyetojnë luftën e armatosur për arritjen e më shumë të drejtave për shqiptarët. Por, kështu nuk mendojnë mbi gjysma e të anketuarve maqedonas, të cilët me pezëm e mllef e kualifikojnë konfliktin si komplot kundër Maqedonisë.

Përpyekja për ta dekompozuar 'Maqedoninë e Ohrit' nga qarqe vendimmarrëse politike maqedonase, është kundërtendencë e frymës që ka gjeneruar kjo marrëveshje. Faktorizimi i më shumëtributeve shqiptare në institucionalizimin e jetës politike e shtetërore ka prodhuar jo pak bllokada nga vetë ata që janë të obliguar ta implementojnë Marrëveshjen e Ohrit. Por faktorizimi i vërtetë i shqiptarëve do të bëhet vetëm atëherë kur ata do të jenë popull shtet formues në Maqedoninë e Veriut. Pa këtë komponentë, të gjitha marrëveshjet paraprake, përfshi edhe Marrëveshjen e Ohrit do ta kenë efektin e terapisë së përkohshme, sepse shqiptarët ende nuk janë "shëruar" nga pasojat e shtet ndërtimit të njëanshëm, ku atributi i shtetformësisë është zëvendësuar me terma eufemike, siç është 20 përqindshi, që më tepër janë statitike e thatë se sa që shprehin nevojat dhe synimet reale të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

3.2 Shaban Murati, ambasador

PROVOKACIONI SERB ME REZOLUTËN 1244

Pse guximi i Vuçiqit është guxim rus? Mirënjohje Gjermanisë!

Në 11 dhjetor ministrja e jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, iu përgjigj brenda ditës me një deklaratë të ashpër kërkesës së presidentit serb Vuçiq në 11 dhjetor, që Serbia të lejohet të vendosë forcat e saj ushtarake dhe policore në Kosovë. Shefja e diplomacisë gjermane e hodhi poshtë në mënyrë kategorike kërkesën absurde të Serbisë, duke e cilësuar “krejtësisht të papranueshme”.

Qëndrimi i drejtë dhe i vendosur parimor i ministres së jashtme të Gjermanisë, shtetit më të fuqishëm të BE dhe të Evropës, ishte një goditje e fortë ndaj Serbisë dhe udhëheqjes së saj militariste dhe i dogji shumë Beogradit.

Kryeministrja antishqiptare e Serbisë, Ana Bernabiç, sulmoi ministren e jashtme gjermane për qëndrimin parimor gjerman, duke e mbrojtur veten me argumentin shvejkian se Serbia e mbështet kërkesën në rezolutën 1244 të OKB, dhe refuzimi i kërkesës për futjen e forcave ushtarake serbe në Kosovë qenka “nivel i papranueshëm i absurdit”.

Natyrisht diplomacia gjermane dhe Ministria e Jashtësme e Gjermanisë e njohin dhe e kuptojnë rezolutën 1244 të KS të OKB dhe gjithë dosjen e dokumenteve ndërkombëtare dhe evropiane për Kosovën shumë herë më mirë se sa ministrat dhe nëpunësit e Millosheviçit, që drejtojnë Serbinë e sotme.

Thjesht për kujtesë, Gjermania ka qenë një nga shtetet pjesëmarrëse të grupit G-8, që miratoi paraprakisht projekt-rezolutën 1244 në mbledhjen e ministrave të jashtëm të 8 vendeve në 8 qershor 1999, të zhvilluar në Këln. Gjermania ka qenë anëtare e “Grupit të Kontaktit për Kosovën”, që patën vendosur parimet e zgjidhjes së statusit të Kosovës, të firmosura edhe nga ministri i jashtëm rus Lavrov, se Kosova nuk do të bashkohet me një shtet tjetër apo me një pjesë të një shteti tjetër, pra që Kosova nuk do të bashkohet më me Serbinë.

Ndaj dhe qëndrimi i ministres së jashtme gjermane Baerbock, që hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën provokative të Serbisë për të dërguar forca ushtarake dhe policore në Kosovë, është një qëndrim që bazohet në njohjen e thellë me kompetencë profesionale të rezolutës 1244 të OKB për Kosovën.

Për këdo që e ka lexuar qoftë edhe njëherë rezolutën 1244 e din se ajo nuk e përmend në asnjë rresht dhe në asnjë germë Serbinë. Rezoluta 1244 nuk i takon fare Serbisë, sepse ajo u hartua për një shtet tjetër, RFJ, i cili pushoi së ekzistuari në vitin 2006, kur Serbia u njoh ndërkombëtarisht si shtet i ri.

Referenca frekvente, që presidenti i Serbisë dhe qeveria e Serbisë po i bëjnë rezolutës 1244 për të justifikuar kërkesën e dërgimit të forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë, është një referencë e stisur dhe false. Neni 6 i

aneksit 2 të rezolutës 1244 flet për se mundësitë e dakorduara me Këshillin e Sigurimit të kthimit të një personeli jugosllav dhe serb, ku fjala “serb” përcakton etninë dhe jo një shtet.

Kaq flagrant dhe mashtrues është rivendikimi i presidentit Vuçiç dhe i qeverisë së Serbisë për rezolutën 1244 si justifikim i provokacionit të futjes së forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë, sa që edhe ish-presidenti i Serbisë Boris Tadiç u detyrua të pranojë publikisht se argumentimi i qeverisë së tanishme serbe me rezolutën 1244 është një mashtrim.

Në një intervistë me median serbe “Vreme” në datën 9 dhjetor 2022, kur presidenti serb dhe kryeministrja Bernabiç dolën për herë të parë me provokimin se do të dërgojnë forca ushtarake në Kosovë, Tadiç, që ka qenë tetë vjet president i Serbisë, deklaroi se “kryeministrja Ana Bernabiç dhe drejtori i të ashtuquajturës “Zyrë e Kosovës” në qeverinë serbe po mashtrojnë opinionin publik mbi mundësinë e kthimit të forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë”.

Ish-presidenti serb Tadiç thekson se rezoluta 1244 nuk parashikon praninë e ushtrisë dhe të policisë serbe në veri apo në ndonjë vend tjetër të Kosovës. Tadiç iu referua direkt rezolutës, duke saktësuar se “Rezoluta 1244 e OKB, në aneksin 2, pika 6, nuk përmend ushtrinë serbe, por personelin jugosllav dhe serb”.

Pra, një nga figurat kryesore të politikës serbe, ish-presidenti i Serbisë dhe tani kryetar i Partisë Socialdemokrate, Boris Tadiç, pranon dhe e deklaron publikisht të vërtetën se rezoluta 1244 e OKB nuk ka lidhje me pretendimin e presidentit aktual serb dhe të qeverisë serbe për të dërguar trupa në Kosovë. Refuzimi dhe hedhja poshtë nga ministrja e jashtme e Gjermanisë bazohen në të vërtetën që rezoluta 1244 e OKB nuk ka lidhje dhe as mund të shërbejë si justifikim për rivendikimin absurd qeveritar serb.

Në një situatë të tillë me shantazhe ushtarake dhe provokime të reja lufte nga Serbia kundër Kosovës, aktualizohen si prioritare çështjet e reflektimit dhe të hapave e masave të politikës së jashtme dhe të diplomacisë së Shqipërisë përballë këtyre zhvillimeve tepër të rrezikshme për Kosovën, për Shqipërinë dhe për kombin shqiptar.

Presidenti serb Vuçiç ndërmori një provokacion shumë të rrezikshëm në datën 9 dhjetor kur shpalli se do t’i drejtojë KFOR-it kërkesën që të lejojë vendosjen e 1000 forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Është hera e parë që nga viti 1999 i dëbimit i Serbisë nga Kosova dhe i çlirimit të Kosovës nga forcat e NATO-s që një president i Serbisë kërkon t’i fusë forcat ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Pra është hera e parë që Serbia shpall se do ta ripushtojë Kosovën me forcë ushtarake, me luftë.

Shqipëria zyrtare nuk e kuptoi seriozitetin e kërcënimit të ri agresiv ushtarak të Serbisë kundër Kosovës për futjen e njëmijë forcave ushtarake dhe policore.

Reagimet e Shqipërisë zyrtare kishin intonacionin e një shteti të largët si Burundi, që bën thirrje për dialog.

Sepse Shqipëria nuk guxoi të dënojë Serbinë për provokacionin e ri të rrezikshëm, dhe të kundërshtonte me forcë rivendikimin e Serbisë për të ripushtuar Kosovën me forca ushtarake. Shqipëria nuk guxoi t'i drejtojë gishtin e dënimit presidentit Vuçiç, i cili si dorë millosheviçiane e shovinizmit serb ka kërcënuar me luftë Kosovën katër herë brenda një viti dhe tani guxoi të shpallë dërgimin e trupave ushtarake në Kosovë. Iu mur goja edhe opozitës shqiptare, e cila nuk dënoi konkretisht provokacionin e ri serb të dërgimit të njëmijë forcave ushtarake me pretekstin e rezolutës 1244.

Nuk e dënuan këtë provokacion konkret ushtarak as OJQ-të pro qeveritare dhe as ndonjë OJQ opozitare me plis diplomatik.

Nga Shqipëria nuk e kuptuan apo nuk deshën ta kuptojnë se presidenti serb dhe Serbia po kërkonin ripushtimin e Kosovës, kurse Tirana rrekej me tautollogjitë e vakëta duke u marrë me banditët dhe kriminelët e shërbimit sekret serb, që po krijojnë trazirat në Veriun e Kosovës me bllokada, plumba dhe bomba. Në Veriun e Kosovës po lufton qeveria dhe shteti serb kundër Kosovës. Serbia po ndez sherret, që të nisë luftën e re në Ballkan për llogari të Ruisë. Kjo shpjegon guximin e çmendur të Vuçiçit, që e pranoi edhe vetë në 11 dhjetor se NATO nuk do të lejojë trupat serbe të hyjnë në Kosovë, e megjithatë ai kërcënon me dërgimin e trupave.

E kam shkruar edhe herë të tjera se guximi i presidentit serb është guxim rus dhe është Moska që po e nxit drejt luftës. Jo rastësisht pak ditë më parë kompania ushtarake ruse e rekrutimit të mercenarëve “Wagner”, që drejtohet nga shërbimi sekret ushtarak rus GRU, hapi në 7 dhjetor në Beograd me lejen e qeverisë serbe zyrën e re të rekrutimit të mercenarëve. Mediat ndërkombëtare kanë njoftuar se njësitet e para të mercenarëve ruse të veshur nga qeveria serbe me uniforma të xhandarmërisë serbe janë dislokuar në kufijtë e Kosovës.

Moska doli menjëherë në mbështetje të rivendikimit të presidentit serb për të dërguar forca ushtarake dhe policore në Kosovë. Gazeta qeveritare ruse “Pravda” në datën 12 dhjetor, me titullin luftarak “O sot o kurrë: Vuçiçi duhet të mbrojtë serbët në Kosovë”, shkruan: “Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, duhet të dërgojë në Kosovë ushtrinë për të mbrojtur serbët. Përndryshe shqiptarët do të ndërmarrin një operacion të ngjashëm me operacionin “Stuhia”, që kroatët e ndërmorën kundër Krajinës serbe”.

Nuk doli në Tiranë një zë qeveritar apo opozitar që të hidhte poshtë rivendikimin e presidentit serb për ripushtimin e Kosovës si gjoja të bazuar te rezoluta 1244. Nuk bëri ndonjë zyrtar në Tirane as atë që bëri ish-presidenti i Serbisë Boris Tadiç dhe që e cituam me sipër.

Është rasti dhe vendi për të tërhequr vëmendjen e opinionit publik mbi një qëndrim të çuditshëm të qeverive dhe të diplomacisë së Shqipërisë, të cilët

kurrë nuk kanë përgënjeshtuar dhe as dënuar pretendimet absurde të Serbisë dhe të Rusisë për Rezolutën 1244. Edhe ripushtimin e Kosovës, që po tenton tani Vuçiçi, po e justifikon me referencën e rreme të rezolutës 1244.

Kam dekada që iu sugjeroj qeverive dhe diplomacive të Shqipërisë dhe të Kosovës se duhet të veprojnë në arenën ndërkombëtare diplomatike dhe mediatike për të hedhur poshtë të pavërtetën e përhapur çdo ditë nga Serbia dhe nga Rusia se gjoja Rezoluta 1244 e njeh Kosovën si pjesë të Serbisë. Kam theksuar vazhdimisht se Rezoluta 1244 është rezolutë e vdekur tashmë, cila nuk i takon fare Serbisë, por i takon historisë së diplomacisë.

Së pari, Rezoluta 1244 nuk e përmend në asnjë rresht dhe nën të saj emrin “Serbi”. Referenca e rezolutës për një farë sovraniteti të shtetit “RFJ”, është për një shtet tjetër që nuk ekziston më, kurse Serbia është shtet i ri i krijuar në vitin 2006.

Së dyti, në bazë të vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 15 dhjetorit të vitit 2004 Serbisë nuk i takon asnjë e drejtë, asnjë referencë dhe asnjë pretendim për OKB dhe për rezolutat e saj, për kohën kur Serbia nuk ka qenë anëtare e OKB. Serbia është pranuar anëtare e OKB në fund të vitit 2000. Me këtë argument juridik Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë hodhi poshtë në vitin 2004 padinë e Serbisë kundër SHBA, Gjermanisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë dhe vendeve perëndimore për gjoja agresionin e NATO-s në 1999. Serbia nuk ka qenë anëtare e OKB kur është miratuar rezoluta 1244 në 10 qershor 1999. Kështu që Serbia nuk ka asnjë të drejtë të pretendojë se rezoluta 1244 i takon asaj.

Së treti, Serbia dhe Rusia e dinë fare mirë se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në korrik 2010 me kërkesë të OKB shpalli verdiktin se pavarësia e Kosovës është në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe me rezolutën 1244. Tribunali më i lartë ndërkombëtar i drejtësisë sanksionoi të drejtën e pavarësisë së Kosovës si subjekt i pavarur i së drejtës ndërkombëtare. Serbia dhe Rusia janë të detyruar të respektojnë vendimin e këtij tribunali të OKB. Me njohjen e pavarësisë së Kosovës nga Tribunali më i lartë juridik i OKB ka marrë fund çdo vlerë juridike dhe reference e rezolutës 1244.

Së katërti, Serbia është larguar nga Kosova me vullnetin e saj në bazë të marrëveshjes së Kumanovës, të cilën e ka nënshkruar qeveria serbe. Pra sipas ligjit ndërkombëtar, Serbia është larguar nga Kosova në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare të firmosur prej saj.

Së pesti, Serbia është larguar me vullnetin e saj nga Kosova dhe i tërhoqi forcat ushtarake, policore, kufitare, administrative nga kufijtë aktualë të Kosovës. Kufijtë administrativë të Kosovës u shndërruan automatikisht në kufij shtetërorë midis dy shteteve, sipas praktikës dhe parimit të pranuar ndërkombëtarisht që kufijtë e shteteve të reja, që dolën nga ish Jugosllavia, do të ndërtohenin mbi kufijtë administrativë, që ata kanë pasur në kohën e

federatës. Ndaj është i pabazuar juridikisht qëndrimi i presidentit serb për ndryshimin e kufijve dhe për shkeljen e tyre me trupa ushtarake serbe.

Shqipëria dhe Kosova duhet t'i jenë mirënjohëse ministres së jashtme gjermane Annalena Baerbock dhe Gjermanisë, që i tregojnë vendin Serbisë. Mirënjohje për Gjermaninë që vendos barrikadën e saj të pathyeshme përballë provokimit të rrezikshëm luftë sjellës të Serbisë.

Mirënjohje për Gjermaninë dhe për kancelaren e saj të hekurit Angela Merkel, e cila qe barrikada e vetme që ndaloi me vendosmëri të ashtuquajturin shkëmbim të territoreve ose më saktë copëzimin e ri të Kosovës. Është një kontribut historik gjerman për Kosovën dhe për kombin shqiptar përballë një plani të errët ndërkombëtar për copëtimin e Kosovës, plan që bëri bashkë Serbinë, Rusinë, Francën, lobin filoserb në qeverinë e presidentit Trump, fatkeqësisht ishte bashkuar për turpin tonë kombëtar qeveria e Shqipërisë dhe qeveria e Kosovës.

Gjermania e shpëtoi Kosovën. Përballë kësaj të vërtete historike kuptohet se sa të mjera janë rrahgjokset mejhaneske të disa klounëve të vegjël të cirkut politik të Tiranës, që i kanë mbushur mendjen vetes se ata janë trimat që ndaluan planin e shkëmbimit të territoreve(!).

Unë nuk mund të kuptoj se si pas këtij akti të ri lufte të presidentit serb Vuçiç për ripushtimin ushtarak të Kosovës, Tirana zyrtare mund të vazhdojë të rrijë nën ombrellën e çarë serbe me emrin “Ballkan i hapur”. Në 11 dhjetor babai i “Ballkanit të hapur” presidenti Vuçiç sulmoi ish-kancelaren gjermane Merkel dhe lëshoi thirrjen e tij të re: “Perëndimit nuk duhet t'i besojmë”. Natyrisht sipas tij duhet t'i besohet Ruisë, drejt të cilës çon edhe “Ballkanin e hapur”, që në një formë apo tjetër kushtëzon pjesëmarrësit e projektit serb të përkrahin ambiciet koloniale të Serbisë ndaj Kosovës.

Këtu nuk ka më miopi diplomatike dhe politike, por është fenomeni, që mallkonte Naim Frashëri në kohën e tij: “popo, mos u qoftë thënë...”.

3.3 Dr Selim IBRAIMI

ZVARRITJA E PROBLEMEVE HISTORIKE, I JEP FAVORE NDIKIMT RUS NË BALLKAN

SHBA-ja dhe Rusia janë në proces të ndarjes së zonave të interesit, ku si duket një pjesë e mirë e Ukrainës do të mbetet nën Rusinë, kurse në Ballkan mund të kemi një pamje tjetër të territorit – të krijimit të dy shteteve të mëdha, të Serbisë dhe, pas 2030-tës, të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Në këtë fazë të re, nëpër të cilën po kalon Europa, nuk ka garanci as nga Brukseli, Uashingtoni dhe as nga NATO-ja se shtetet e Ballkanit, që janë nisur në rrugën drejt BE-së, do të mbeten të njëjtat. Aktualisht, Rusia do të vazhdojë të jetë në kërkim

Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria e kaluan një fazë jo të mirë dyvjeçare si shtete fqinjë. Me propozimin francez, Shkupi dhe Tirana i filluan konferencat e para ndërqeveritare, me shpresë se një ditë do t'i hapin edhe kapitujt e BE-së. Shqipëria e ka rrugën më të qetë gjatë hapjes dhe mbylljes së kapitujve dhe, në varësi nga dinamikat e brendshme politike dhe në BE, anëtarësimi do të jetë më shumë në duart e qeverisë shqiptare. Megjithatë, çështja më e rëndësishme në rajon përsëri mbetet Shkupi në raport me Sofjen pas konferencës së parë ndërqeveritare e deri në hapjen dhe mbylljen e Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut, e cila do të kërkojë 2/3 e votave të deputetëve. Kundërshtarët e propozimit, me akuza të llojit se qeveria në Shkup po bën tradhti, i përsëritën qëndrimet bullgare. Ish-ministri Nikolla Dimitrov në Twitter postoi një paragraf nga çfarë është thënë në dokumentet bullgare dhe, duke interpretuar Protokollin, ai shkruan: *“Krijimi i ‘gjuhës maqedonase’ në vitet 1944-45 në ish-Jugosllavi ishte një akt i kodifikimit dytësor të bazuar në gjuhën letrare bullgare, i ‘pasuruar’ edhe me forma lokale, që simulonin një proces ‘natyror’...”* Përkundër këtyre reagimeve, qeveria në Shkup ka dëshmuar se gjuha dhe identiteti maqedon është ruajtur dhe nuk është prekur nga propozimi dhe për këtë është kujdesur shumë edhe partia e Ali Ahmetit, BDI. Këtu duhet pranuar se edhe politikanët shqiptarë nga të gjitha partitë kanë dhënë ndihmën e tyre për ta mbrojtur gjuhën dhe historinë maqedone, në një absurd tjetër ku maqedonasit ua mohojnë të drejtat shqiptarëve. Sidoqoftë, gjuha maqedone është e sigurt dhe këtu kundërshtarët e qeverisë nuk kanë të drejtë. Duke e marrë në konsideratë gjendjen aktuale deri në mbylljen e kushtetutës maqedone dhe futjen e bullgarëve në të, rriten gjasat që të ketë përsëri zgjedhje të parakohshme në Maqedoninë e Veriut, me idenë që të krijohet një shumicë e re parlamentare më stabile që i afrohet 2/3 të votave për ndryshimet kushtetuese të nevojshme. Tani për tani kryeministri Kovaçevski dhe partneri në qeveri, Ahmeti, nuk e shohin si të domosdoshme për të shkuar

në zgjedhje. Ata besojnë se, deri në afatin e caktuar, të gjitha forcat politike pa përjashtim do të rreshtohen në rrugën europiane. Por, kjo njëherit nuk është një garanci e fortë se VMRO-DPMNE do ta ndryshojë qëndrimin dhe do t'i votojë ndryshimet kushtetuese. Një opsion që mbetet i hapur është që Hristian Mickovski, lideri i opozitës maqedone, ka mundësi të votojë për ndryshimet po qe se do të marrë drejtimin e qeverisë së re, pra në qoftë se deri në 2024 do të kemi zgjedhje të shpejta. Një opsion tjetër që flitet është votimi i ndryshimeve kushtetuese nga një pjesë e deputetëve të opozitës (VMRO-DPMNE), që tashmë kanë nënshkruar një dokument dhe i verifikuar në noter se nëse do të votojnë pro marrëveshjes, atëherë duhet ta lënë funksionin e deputetit...

Rruga e hapur që kërkon shumë punë

Pasi konferenca në Bruksel është mbajtur, punët për Shkupin zyrtar janë të qarta, se çka duhet të bëjë më tej deri në ndryshimet kushtetuese dhe si të silllet ndaj Bullgarisë. Pasi rruga është hapur, çështjet mbeten vetëm në Shkup, duke nisur nga sundimi i së drejtës, reformat e tjera të domosdoshme deri në hapjen e kapitujve dhe përshtatja e ligjeve të brendshme me të BE-së. Gjatë dy viteve të fundit qeveria ka deklaruar se ka bërë shumë punë në fushën e sundimit të së drejtës, por gjendja aktuale tregon se Maqedonia e Veriut ka një sistem drejtësie të kalbur, duke lënë pak shpresa se vendi do t'i mbyllë shpejt kapitujt me BE-në. Në Maqedoninë e Veriut politika dhe gjykatat vazhdojnë të mbrojnë individë të implikuar në procese të dyshimta financiare dhe keqpërdorime të pozitës. Duhet pranuar se gjendja e brendshme është rënduar dhe ky do të jetë faktori vendimtar deri në anëtarësimin e vendit në BE, pasi grupet radikale do të vazhdojnë të ndikohen nga jashtë për ta destabilizuar jo vetëm Shkupin, por edhe rajonin. Ndikim në rrugën e suksesshme apo jo të Shkupit do të kenë proceset politike, etnike dhe fetare në vend.

Ndikimi rus në katër fusha

Nga këndvështrimi gjeopolitik duket se BE-ja kësaj here është pak më afër Ballkanit dhe më larg Ukrainës, pasi Rusia ka fituar terren duke vendosur kështu kushtet e luftës dhe të paqes. Pavarësisht se Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, njëra më parë dhe tjera më vonë, do t'i nisin kapitujt me BE-në, Rusia do të vazhdojë të ndikojë me të gjitha mjetet në Kosovën Veriore, Serbi dhe në Bosnjën Serbe. Paqëndrueshmëria në rajon do të jetë e pranishme përderisa lufta në Ukrainë nuk do të përfundojë dhe ndarja e interesave nuk do të bëhet përfundimisht në mes Ruisë dhe SHBA-së në Europën Lindore. Për sa i përket ndikimit rus, ai nuk do të jetë si më parë, por do të ketë ngritje dhe ulje varësisht situatave politike dhe mosmarrëveshjeve etnike dhe ndërshtetërore.

Zvarritjet e problemeve historike do të jenë të mirëseardhura jo vetëm për Rusinë, por edhe për Serbinë. Manipulimet e Rusisë do të mbeten konstante në fushën e dezinformimit, sulmeve kibernetike, në aktivizimin e Kishës Ortodokse sipas nevojës dhe në disa faza aktivitete klandestine në Ballkan. Aktualisht, Rusia do të vazhdojë të jetë në kërkim të miqve dhe krijim të armiqve të rinj. Pjesërisht, SHBA-ja dhe Rusia janë në proces të ndarjes së zonave të interesit, ku si duket një pjesë e mirë e Ukrainës do të mbetet nën Rusinë, kurse në Ballkan mund të kemi një pamje tjetër të territorit – të krijimit të dy shteteve të mëdha, të Serbisë dhe, pas 2030-tës, të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, duke i lënë anësh të gjitha pengesat kufitare dhe ideologjike. Në këtë fazë të re, nëpër të cilën po kalon Europa, nuk ka garanci as nga Brukseli, Uashingtoni dhe as nga NATO-ja se shtetet e Ballkanit, që janë nisur në rrugën drejt BE-së, do të mbeten të njëjtat. Shtetet me përbërje etnike të pastër kanë gjasa të shpëtojnë nga rreziqet e dekadës dhe të vazhdojnë të jenë të pranishme në skenën globale përkundër sfidave.

Më keq do të jenë shtetet me përbërje etnike dhe fetare të përzier, ku për të mbijetuar në ambientin e ri do të duhet përveç anëtarësimeve në aleancat ushtarake, të vazhdojnë gjithashtu të mbajnë të qëndrueshme lidhjet politike, fetare, kulturore dhe ekonomike me shtetet që kanë një të kaluar të përbashkët historike dhe që janë kundërshtarë të BE-së apo NATO-s. Miqësia e pafundme ndërmjet Rusisë dhe Serbisë e bën Ballkanin Perëndimor jostabil, duke lënë vend për ndërhyrje nga Moska tani dhe në të ardhmen në rajon. Përderisa do të jetë aktive dhe e zhvilluar kjo lidhje dhe marrëdhënie, asnjëherë nuk do të ketë qetësi në Ballkan, për shkak të rolit serb si mbështetës i politikave ruse në Ballkan.

A do të jetë i gatshëm Ali Ahmeti për heqjen e 20-përqindëshit?

Në fund, pavarësisht dinamikave rajonale, politika shqiptare në Tetovë, gjatë hapjes së kushtetutës së Maqedonisë së Veriut, patjetër duhet të angazhohet në heqjen e 20 përqindëshit dhe forcimit të statusit juridik. Do të këtë zëra të ndryshëm, si çdoherë, se nuk është koha tani të bëhen këta kërkesa, mirëpo nëse këto ndryshime nuk bëhen brenda dy viteve, atëherë do të jenë të kota ankesat shqiptare rreth pozitës në kushtetutë. Nga reagimet aktuale të BDI-së së Ahmetit ekziston një drojë se ai dhe djemtë e rinj që i shkojnë pas, mund t'u bishtërojnë këtyre kërkesave, pasi janë rritur dhe edukuar në mjediset maqedone dhe interesi personal, grupor dhe shtetëror maqedon për ta është i pari. Nëse nuk do të ketë veprime të përbashkëta ndërshqiptare, atëherë këtë rol të forcimit të shqiptarëve brenda dy viteve në kushtetutë duhet ta marrë opozita shqiptare në Maqedoninë e Veriut. Do të ishte i kotë anëtarësimi në BE nëse dy etnitë më të mëdha do të vazhdojnë të jetojnë në armiqësi dhe në prag të konflikteve lokale. Kujt i duhet në BE një Maqedoni pa drejtësi, pa

nder dhe plot çështja të pambyllura ndëretnike?! Pasi treni për në BE nuk do të jetë i shpejtë, mbetet që qeveria të nisë të punojë për reforma të vërteta dhe vendi të transformohet për të mirën e të gjithëve. Ndryshe, do të jetë një shtet që i vjen era e keqe nga aeroporti, erë që mund ta nuhasësh rreth zyrave të ministrave dhe të përfundojë po e njëjta në zyrat e kryetarëve të partive politike. Një shtet që pretendon BE-në duhet të ndryshojë. A do ta bëjë këtë Shkupi? Kjo mbetet të shihet deri në mbylljen e kapitujve.

III. BOTA

4. Jürgen Habermas, filozof

LUFTË DHE INDINJATË

Toni i mprehtë, shantazhi moral: Në betejën e opinionëve midis ish-pacifistëve, një publiku të tronditur dhe një Kancelari të matur që diskuton pas pushtimit të Ukrainës

Pas 77 vjetësh pa luftë dhe 33 vjet pas përfundimit të një paqeje, edhe pse paqe e kërcënuar, të ruajtur vazhdimisht përmes ekuilibrit të frikës, imazhet shqetësuese të luftës të shkaktuara arbitrarisht nga Rusia janë rikthyer para pragun të shtëpisë tonë.

Si asnjëherë më parë prania mediatike e kësaj lufte dominon jetën tonë të përditshme.

Një president ukrainas I vetëdijshëm për fuqinë mediatike të imazheve jep mesazhe të fuqishme. Skenat e reja të përditshme të shkatërrimeve të papërpunuara dhe vuajtjet njerëzore zemërthyesë gjejnë jehonë përforcuese në mediat sociale perëndimore.

Ajo që është e re në lidhje me publikimin dhe ndikimin e llogaritur publik të ngjarjeve të paparashikueshme lufte, mund të na lërë më shumë përshtypjeve të moshuarve sesa të rinjve të mësuar me median e kohës.

Por përkundër inskenimeve të tejandjshme janë faktet ato që na tërheqin nervat dhe vetëdija jonë për afërsinë territoriale të kësaj lufte kontribuon në efektin e tyre tronditës.

Kështu, mes spektatorëve në Perëndim, shqetësimi rritet me çdo vdekje, tronditja me çdo person të vrarë, indinjata me çdo krim lufte, shtohet vazhdimisht dëshira për të bërë diçka kundër kësaj gjendjeje. Sfondi racional mbi të cilin vlojnë këto emocione në mbarë vendin është rreshtimi i vetëkuptueshëm kundër Putinit dhe një qeverie ruse e cila filloi një luftë masive agresioni në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, që me luftën e tyre sistematike çnjerëzore, shkelin të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Pavarësisht nga ky participim unik, një qasje e diferencuar midis qeverive të aleancës perëndimore të shteteve është në zhvillim e sipër; dhe në Gjermani një betejë e mprehtë mendimesh, e nxitur nga zërat e shtypit, ka shpërthyer në lidhje me llojin dhe masën e ndihmës ushtarake për Ukrainën e rrethuar. Kërkesat e Ukrainës së pafajshme të rrethuar, e cila pa hezitim i kthen gjykimet e gabuara politike dhe vendimet e gabuara të qeverive të mëparshme federale në shantazh moral, janë po aq të kuptueshme sa janë të vetëkuptueshme emocionet, dhembshuria dhe nevoja për të ndihmuar që ato ngjallin te të gjithë ne.

Megjithatë jam i irrituar nga vetëbesimi me të cilin flasin akuzuesit moralisht të indinjuar në Gjermani që veprojnë kundër një qeverie federale reflektuese dhe të kujdesshme. Në një intervistë me “Der Spiegel”, kancelari federal e përmbledhi politikën e tij me fjalinë: “Ne po përdorim të gjitha mjetet për të kundërshtuar vuajtjet që po shkakton Rusia në Ukrainë, pa shkaktuar një përshkallëzim të pakontrollueshëm që do të shkaktojë vuajtje të pamatshme në të gjithë kontinentin, e ndoshta edhe në të gjithë botën.” Edhe pse Perëndimi vendosi të mos ndërhyjë si palë ndërluftuese në këtë luftë, ekziston një prag rreziku që përjashton angazhimin e pakontrolluar për riarmatimin e Ukrainës. Kjo sapo është vënë në një dritë të ashpër përsëri nga aleanca e fundit e qeverisë sonë me aleatët në Ramstein dhe nga kërcënimi i përsëritur i Lavrovit për të përdorur armë bërthamore. Kushdo që, pavarësisht nga ky prag, dëshiron ta shtyjë kancelarin gjithnjë e më tej në këtë drejtim me një tenor agresiv, me vetëbesim, e anashkalon ose e keqkupton dilemën në të cilën po futet Perëndimi nga kjo luftë; sepse Perëndimi i lidhi duart me vendimin e bazuar moralisht për të mos u bërë palë në luftë.

Dilema që detyron Perëndimin të bëjë një shkëmbim të rrezikshëm midis dy të këqijave – një disfatë për Ukrainën ose përshkallëzimi i një konflikti të kufizuar në Luftën e Tretë Botërore – është e qartë. Nga njëra anë, mësimi që kemi nxjerrë nga Lufta e Ftohtë është se një luftë kundër një fuqie bërthamore nuk mund të "fitohet" më në asnjë kuptim të arsyeshëm, të paktën jo me anë të forcës ushtarake në të ardhmen e parashikueshme të një konflikti të nxehtë. Pasoja e potencialit të kërcënimit bërthamor është se pala e kërcënuar, pavarësisht nëse ka vetë armë bërthamore apo jo, nuk mund t'i japë fund shkatërrimit të pa tolerueshëm të shkakuar nga përdorimi i forcës ushtarake përmes fitores, por në rastin më të mirë me një kompromis që u shpëton fytyrën të dyja palëve. Më pas asnjëra palë nuk do të pritët të pësojë një disfatë që do t'i bëjë të largohen nga fusha si “humbës”. Negociatat e armëpushimit, të cilat aktualisht vazhdojnë ende paralelisht me luftimet, janë shprehje e këtij këndvështrimi; për momentin ata mbajnë të hapur pikëpamjen reciproke të kundërshtarit si një partner i mundshëm negociator.

Potenciali i kërcënimit rus varet nëse Perëndimi i beson Putinin për të përdorur armë ABC. Por në fakt CIA gjatë javëve të fundit paralajmëroi për të ashtuquajturat armë bërthamore "të vogla" (të cilat me sa duket u zhvilluan vetëm për të bërë të mundur përsëri luftërat midis fuqive bërthamore). Kjo i jep palës ruse një avantazh asimetric ndaj NATO-s, e cila nuk dëshiron të bëhet palë lufte për shkak të përmasave apokaliptike të një lufte botërore që përfshin katër fuqi bërthamore.

Putin tani është duke vendosur se kur Perëndimi do të kalojë prapë e përcaktuar sipas ligjit ndërkombëtar, përtej të cilit ai zyrtarisht e konsideron mbështetjen ushtarake për Ukrainën si Perëndimi që hyn në luftë. Duke pasur parasysh rrezikun e një zjarri botëror, i cili duhet shmangur me çdo kusht,

paqartësia e këtij vendimi nuk lë vend për poker të rrezikshëm. Edhe nëse Perëndimi do të ishte mjaft cinik për të llogaritur "paralajmërimin" me një nga këto armë bërthamore "të vogla" si një rrezik, pra për të pranuar skenarin më të keq, kush mund të garantonte se përshkallëzimi mund të ndalohej më pas? Ajo që mbetet është një liri veprimi për argumente, të cilat duhet të peshohen me kujdes në dritën e njohurive të nevojshme teknike dhe të gjithë informacionit të nevojshëm, i cili jo gjithmonë është i disponueshëm publikisht, në mënyrë që të mund të merren vendime të bazuara. Perëndimi, i cili duke vendosur sanksione drastike nuk la asnjë dyshim për pjesëmarrjen e tij faktike në luftë që në fillim, duhet të peshojë me kujdes me çdo hap të mëtejshëm të mbështetjes ushtarake nëse nuk po kalon edhe kufirin e pacaktuar të formalit, sepse varet mbi fuqinë e përkufizimit të hyrjes së Putinit në luftë.

Nga ana tjetër, për shkak të kësaj asimetrie, siç e di edhe pala ruse, Perëndimi nuk mund të lejojë që të shantazhohet sipas dëshirës. Nëse ai thjesht do ta linte Ukrainën në fatin e saj, kjo jo vetëm që do të ishte një skandal nga pikëpamja politike dhe morale, por nuk do të ishte gjithashtu në interesin e tyre. Sepse atëherë ai do të duhej të priste të luante përsëri të njëjtën ruletë ruse në rastin e Gjeorgjisë apo Moldavisë në të ardhmen e afërt – dhe kush do të ishte viktima e radhës? Sigurisht, asimetria që mund ta çojë Perëndimin në një rrugë pa krye në një afat më të gjatë ekziston vetëm për aq kohë sa ai ka arsye të mira për të shmangur rrezikimin e një lufte botërore bërthamore. Pra, argumentit për të mos e shtyrë Putinin në një qoshe, sepse atëherë ai do të ishte i aftë për çdo gjë, i kundërvihet faktit se vetëm kjo "politikë frike" i jep dorë të lirë kundërshtarit për të çuar hap pas hapi përshkallëzimin e konfliktit. (Ralf Fücks në SZ). Pa dyshim, ky argument vetëm konfirmon karakterin e një situatë të vështirë për t'u llogaritur. Sepse përderisa kemi arsye të mira për të vendosur të mos i bashkohemi luftës si një palë tjetër për të mbrojtur Ukrainën, lloji dhe shtrirja e mbështetjes ushtarake duhet të vlerësohet edhe nga ky këndvështrim. Kushdo që kundërshton një "politikë frike" në një mënyrë racionalisht të justifikueshme, tashmë po lëviz brenda fushës së argumentimit të asaj konsiderate politikisht të përgjegjshme dhe faktikisht të informuar plotësisht, mbi të cilën me të drejtë insiston Kancelari Federal Olaf Scholz. Bëhet fjalë për respektimin e një interpretimi të një kufiri të përcaktuar ligjërisht që ne i kemi vendosur vetes, i cili besojmë se është i pranueshëm për Putinin. Kundërshtarët e shqetësuar të linjës qeveritare janë të paqëndrueshëm në mohimin e implikimeve të një vendimi politik që ata nuk e vënë në dyshim. Vendimi për të mos marrë pjesë nuk do të thotë se Perëndimi duhet ta braktisë Ukrainën në fatin e luftës së saj me një kundërshtar superior deri në pikën e përfshirjes së menjëhershme. Furnizimet e Perëndimit me armë padyshim mund të ndikojnë në mënyrë të favorshme në rrjedhën e një lufte që Ukraina është e vendosur të vazhdojë, edhe me koston e sakrificave të mëdha. Por a

nuk është vetëmashtrim i devotshëm të vësh bast për fitoren e Ukrainës kundër luftës vrasare të Ruisë pa marrë armët? Retorika luftarake nuk shkon mirë me kutinë e audiencës, nga e cila tingëllon elokumente. Sepse nuk e zhvlerëson paparashikueshmërinë e një kundërshtari që mund të vendosë gjithçka në një kartë. Dilema e Perëndimit është se ai mund të sinjalizojë vetëm për një Putin, i cili mund të jetë i përgatitur për një përshkallëzim bërthamor, se ai (Perëndimi) po mbështetet në integritetin e kufijve shtetërorë në Evropë.

Shqyrtimi i ftohtë i ndihmës ushtarake vetëkufizuese ndërlikohet më tej nga vlerësimi i motiveve që e shtynë palën ruse të merrte vendimin e saj të keq llogaritur dukshëm. Përqendrimi te Putini si person çon në spekulime të egra, me të cilat mediat tona kryesore janë të mbushura sot, ashtu siç ishte në kulmin e sovjetikes spekulative.

Imazhi që mbizotëron sot e Putinit me vendosmëri revizionist duhet të paktën të krahasohet me një vlerësim racional të interesave të tij. Edhe nëse Putin e konsideron shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik si një gabim të madh, imazhi i vizionarit ambicioz, i cili, me bekimin e Kishës Ortodokse Ruse dhe nën ndikimin e ideologut autoritar Aleksandër Dugin, sheh restaurimin gradual të të Madhit. Perandoria Ruse si vepër e jetës së tij politike, vështirë se pasqyron të gjithë të vërtetën për karakterin e tij. Por pikërisht në parashikime të tilla qëndron supozimi i përhapur se synimet agresive të Putinit shtrihen përtej Ukrainës, në Gjeorgji dhe Moldavi, më pas në anëtarët e NATO-s në shtetet baltike dhe më në fund edhe në Ballkan. Ky profil personaliteti i një nostalgjiku deluzionist për historinë është në kontrast me një biografi të avancimit shoqëror dhe karrierën e një njeriu të pushtetit të trajnuar nga KGB, llogaritës racionalist, i cili hetoi kthesën drejt perëndimit të Ukrainës dhe lëvizjen e rezistencës politike në Bjellorusi, si dhe në shqetësimet e tij rreth protestave politike në qarqet e tyre progresive më liberale bjelloruse që e kanë forcuar shoqërinë. Nga ky këndvështrim, agresioni i përsëritur do të kuptohej më shumë si një përgjigje e frustruar ndaj refuzimit të Perëndimit për të negociuar mbi axhendën gjeopolitike të Putinit - veçanërisht për njohjen ndërkombëtare të pushtimeve të tij të paligjshme dhe neutralizimin e një "qasjeje" që synon të përfshijë Ukrainën. Spektri i këtij dhe spekulimeve të ngjashme vetëm sa thellon pasigurinë e një dileme që "kërkon kujdes dhe përmbytje ekstreme" (sipas përmbledhjes së një analize udhëzuese nga Peter Graf Kielmansegg në FAZ të 19 prillit 2022).

Si mund të shpjegohet atëherë debati i nxehtë brenda vendit rreth politikës së solidaritetit të pohuar në mënyrë të përsëritur të kancelarit Scholz me Ukrainën, e cila është konsideruar në marrëveshje me partnerët e BE-së dhe NATO-s? Për të zbrëthyer çështjet, do të lëjnë mënjanë argumentin për vazhdimin e politikës së detantit ndaj një Putini që ishte bërë i paparashikueshëm, i cili rezultoi i suksesshëm deri në fund të Bashkimit Sovjetik dhe më tej, dhe që tani ka rezultuar të jetë një gabim i rëndësishëm;

si dhe gabimi i qeverive gjermane që u varën nga importet e lira të gazit rus, edhe nën presionin e ekonomisë. Gjykimi i historianëve do të vendosë një ditë kujtesën e shkurtër të polemikave të sotme.

Ndryshe është situata me debatin, i cili, nën emrin kuptimplotë të “krizës së re të identitetit gjerman”, po trajton tashmë pasojat e “pikës së kthesës”, që fillimisht lidhej me Ostpolitikën gjermane dhe buxhetin e mbrojtjes. Sepse ky debat, i cili bazohet kryesisht në shembuj të konvertimit të mahnitshëm të shpirtave paqeruajtës, ka për qëllim të paralajmërojë një ndryshim historik në mentalitetin e pasluftës të gjermanëve, i cili është denoncuar vazhdimisht nga e djathta dhe në fakt është mjaft i vështirë për të arritur - dhe kështu fundin e një modusi të gjermanëve të bazuar në dialogun dhe politikën paqeruajtëse.

Ky lexim fikson shembullin e atyre të rinjve që janë edukuar të jenë të ndryshëm ndaj çështjeve normative, të cilët nuk i fshehin emocionet e tyre dhe që janë më të zëshmit për të kërkuar përkushtim më të madh. Ata japin përshtypjen se realiteti krejtësisht i ri i luftës i ka nxjerrë nga iluzionet e tyre pacifiste. Kjo të kujton edhe ministren e jashtme të kthyer në ikonë, e cila menjëherë pas fillimit të luftës i dha shprehje autentike tronditjes me gjeste të besueshme dhe retorikë rrëfimtare. Jo se ajo nuk përfaqëson gjithashtu dhembshurinë dhe përpjekjen për të ndihmuar që është kaq e përhapur në popullsinë tonë; por gjithashtu i dha një formë bindëse identifikimit spontan me nxitjet moralizuese të vrullshme të udhëheqjes ukrainase, të vendosur për të fituar. Me këtë ne prekim thelbin e konfliktit midis atyre që me empati, por menjëherë marrin perspektivën e një kombi që lufton për lirinë, të drejtat dhe jetën e tyre, dhe atyre që kanë nxjerrë një mësim të ndryshëm nga përvojat e Luftës së Ftohtë dhe - si edhe protestuesit në rrugët tona – kanë zhvilluar një mentalitet tjetër. Disa mund të imagjinojnë një luftë vetëm nën alternativën e fitores ose humbjes, të tjerë e dinë se luftërat kundër një fuqie bërthamore nuk mund të "fitohen" më në kuptimin tradicional.

Përafërsisht, sa më shumë mentalitete kombëtare dhe më postkombëtare të popullsisë formojnë sfondin e qëndrimeve të ndryshme ndaj luftës në përgjithësi. Ky dallim bëhet i qartë kur merret parasysh qëndresa heroike e admiruar dhe vetëshkatërruesi

krahason gatishmërinë për të bërë sakrifica të popullsisë ukrainase me atë që mund të pritej nga popullsitë "tona", le të themi përgjithësisht, e Evropës Perëndimore në një situatë të ngjashme. Admirimi ynë është i përzier me njëfarë habie për sigurinë e fitores dhe guximin e pashuar të ushtarëve dhe rekrutëve, të cilët janë të vendosur në mënyrë të errët për të mbrojtur atdheun e tyre kundër një armiku shumë më të lartë ushtarakisht. Nga ana tjetër, në Perëndim ne mbështetemi në ushtritë profesionale, të cilat i paguajmë që të mos mbrohemi me armë në dorë, por të na mbrojnë ushtarët profesionistë.

Ky mentalitet post-heroik u zhvillua në Evropën Perëndimore – nëse mund të them kështu në përgjithësi – gjatë gjysmës së dytë të shekullit të 20-të nën

ombrellën bërthamore të SHBA-së. Në lidhje me shkatërrimin e mundshëm të një lufte bërthamore, elita politike dhe shumica dërrmuese e popullsisë kanë kuptuar se konfliktet ndërkombëtare mund të zgjidhen në thelb vetëm përmes diplomacisë dhe sanksioneve - dhe se nëse shpërthejnë konflikte ushtarake, Lufta, që nga koha që ajo nuk mund të përfundojë më në kuptimin klasik me fitore ose humbje, për shkak të rrezikut të vështirë për t'u llogaritur nga përdorimi i afërt i armëve ABC, duhet të zgjidhet sa më shpejt që të jetë e mundur: "Nga lufta mund të mësohet vetëm për të bërë paqe", thotë Alexander Kluge. Ky orientim nuk do të thotë pacifizëm themelor, pra paqe me çdo çmim. Orientimi drejt përfundimit sa më të shpejtë të shkatërrimit, sakrificës njerëzore dhe decivilizimit nuk është sinonim me kërkesën për të sakrifikuar një ekzistencë të lirë politikisht për thjesht mbijetesë. Skepticizmi për mjetet e dhunës ushtarake gjenë një kufi prima facie me çmimin që kërkon një jetë e mbytur nga autoritarizmi - një ekzistencë nga e cila do të ishte zhdukur vetëdija për kontradiktën midis normalitetit të detyruar dhe jetës së vetëvendosur.

Përmbysjen e ish-pacifistëve tanë, të mirëpritur nga interpretuesit e djathtë të pikës së kthesës, e shpjegoj si një konfuzion të atyre dy mentaliteteve njëherësh të përplatura, por historikisht jo të njëkohshme. Ky grup goditës ndan besimin e ukrainasve në fitore dhe i bën thirrje të drejtës ndërkombëtare të shkelur si një çështje e natyrshme. Pas Buçës, slogani u përhap si flakë: "Putini në Hagë!" Kjo në përgjithësi sinjalizon vetëkuptimin e standardeve normative që ne zbatojmë sot në marrëdhëniet ndërkombëtare, pra shtrirjen aktuale të ndryshimit në pritshmëritë përkatëse dhe ndjeshmërinë humanitare të popullsisë.

Në moshën time, nuk mund ta fsheh një habi të caktuar: sa thellë duhet të jetë lëruar toka e marrë si e mirëqenë kulturalisht në të cilën jetojnë sot fëmijët dhe nipërit tanë, kur edhe shtypi konservator po bën thirrje për prokurorët e një Gjykate Penale Ndërkombëtare që nuk është në pronësi të saj e që njihet ende nga SHBA, por jo nga Rusia e Kina. Fatkeqësisht, realitete të tilla zbulojnë gjithashtu bazën e zbrazët të një identifikimi të ngazëllyer me akuzat morale gjithnjë e më të ashpra të përmbajtjes gjermane. Jo se kriminel i luftës Putin nuk e meritonte të dilte para një gjykate të tillë; por ai ende mban vendin e të drejtës së vetos në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe mund të kërcënojë kundërshtarët e tij me armë bërthamore. Një fund i luftës, ose të paktën një armëpushim, duhet ende të negociohet me të. Nuk shoh asnjë justifikim bindës për kërkesën për një politikë që - në pamjen e dhimbshme, gjithnjë e më të padurueshme të viktimitave të përditshme më të dhimbshme - po rrezikon de facto vendimin gjithsesi të bazuar mirë për të mos marrë pjesë në këtë luftë.

Aleatët nuk duhet të fajësojnë njëri-tjetrin për dallimet politike dhe mendore që mund të shpjegohen me zhvillime historike që nuk kanë ndodhur në të

njëjtën kohë. Por për sa kohë që këto dallime që formojnë perspektivë mbeten në plan të dytë, si në rastin e reagimit të deputetëve ndaj thirrjeve morale të presidentit ukrainas për rregull në fjalimin e tij video në Bundestag, ato shkaktojnë vetëm një konfuzion ndjenjash - një grumbull reagimesh të pambjella miratimesh, të kuptimit të thjeshtë të perspektivës së tjetrit dhe respektit të nevojshëm për veten. Neglizhimi i dallimeve të bazuara në histori në perceptimin dhe interpretimin e luftërave jo vetëm që çon në gabime të rëndësishme në trajtimin e njëri-tjetrit, si në rastin e aterimit të pa ndodhur të Presidentit Federal Gjerman.

Ato sjellin, çka është më e keqja, në keqkuptime reciproke që tjetri në të vërtetë nuk i mendon e dëshiron.

Ky realizim e vë në një dritë më të matur konvertimin e ish-pacifistëve. Sepse indinjata, tmerri dhe simpatia që përbëjnë sfondin motivues të kërkesave të tyre dritëshkurtër nuk mund të shpjegohen me një refuzim të orientimeve normative, me të cilat të ashtuquajturit realistë janë tallur gjithmonë. Por nga një lexim tepër i përmbledhur i këtyre parimeve. Ata nuk janë konvertuar në realistë, por pothuajse janë kthyer në realizëm: Sigurisht, pa ndjenja morale nuk mund të ketë gjykime morale; por gjykimi i përgjithësuar korrigjon nga ana e tij edhe diapazonin e kufizuar të ndjenjave të stimuluar nga afër.

Në fund të fundit, nuk është rastësi që autorët e "Zeitenwende" janë ata të majtë dhe liberalë që, përballë një plejade të ndryshuar në mënyrë drastike të fuqive të mëdha - dhe nën hijen e pasigurive transatlantike - duan të merren seriozisht për një kohë të gjatë. -kuptim i vonuar: Një Bashkimi Evropian mënyra e jetesës shoqërore dhe politike e të cilit nuk ndikohet as nga destabilizimi nga jashtë dhe as nga lejimi që ai të zbrazet nga brenda, do të jetë në gjendje të veprojë politikisht vetëm nëse mund të qëndrojë në këmbët e veta edhe ushtarakisht. Rizgjedhja e Macron shënon një pushim. Por së pari duhet të gjejmë një rrugë konstruktive për të dalë nga dilema jonë. Kjo shpresë reflektohet në formulimin e kujdesshëm të qëllimit që Ukraina të mos humbasë luftën.

(Jürgen Habermas, i lindur në vitin 1929, është një nga filozofët më me ndikim të kohës sonë. - Süddeutsche Zeitung, 29.04.2022 F.12-13; Përktheu: Nexhat Maliqi]

4.1 Agim KRASNIQI, PhD

ROLI I FUQIVE TË MËDHA NË POLITIKËN BASHKËKOHORE BALLKANIKE

Abstrakt

Ky punim përshkruan cilësinë e marrëdhënieve në Ballkan që mund të analizohen në kontekstin e gjeopolitikës ballkanike. Historia politike e Ballkanit nuk fillon me të kuptuarit e grupeve etnike dhe historisë së tyre, pa njohjen e ndikimit të interesave gjeopolitike të regjionit. Në këtë rast, gjeopolitika thekson analizën e marrëdhënieve midis disa vendeve, rajoneve ose territoreve në përgjithësi në lidhje me veçoritë e tyre ose karakteristikat gjeografike të tyre, ndërlidhur me rëndësinë politike ndërkombëtare, në nivel lokal, makro-rajonal dhe global. Lufta kundër terrorizmit, agresioni rus në Ukrainë, krizat ekonomike dhe të ngjashme, bëri që Uashingtoni të kthehet në gjeopolitikën ballkanike dhe me Brukselin shihet që harmonizuan veprimet e përbashkëta për agresionin rus në Ukrainë dhe në këtë pjesë të vogël të Evropës dhe në një pjesë akoma më të vogël të botës.

Vetitë socio-historike dhe gjeografike të Ballkanit

